



ISBN 978-9928-210-07-4

ISSN 2413-1334

Konferenca e II-të Shkencore Kombëtare



Policimi dhe **SIGURIA**

Dhuna ekstreme në familje dhe masat për
parandalimin e reduktimin e vrasjeve për
shkak të marrëdhënieve familjare

PRILL
2018

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2018



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË



POLICIMI DHE SIGURIA

Dhuna ekstreme në familje dhe masat
për parandalimin e reduktimin e vrasjeve
për shkak të marrëdhënieve familjare

PROCEEDINGS

PROCEEDINGS

Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

KONFERENCË
KOMBËTARE

2018

© - **Akademia e Sigurisë, Tiranë.**

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të këtij botimi, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.



AKADEMIA E SIGURISË

KONFERENCA E II SHKENCORE KOMBËTARE, prill 2018, Tiranë

*Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve
për shkak të marrëdhënieve familjare*

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Akademia e Sigurisë
Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e
reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare :
konferenca e 2-të shkencore kombëtare :
Tiranë, 26 prill 2018 /
RSH. Akademia e Sigurisë ; red. shkenc. Albert Hitoaliaj. –
Tiranë : Akademia e Sigurisë, 2018
190 f. ; 16.5X24 cm.
Bibliogr. në fund të punimeve

ISBN 978-9928-210-07-4

1.Të drejtat e njeriut 2.Dhuna në familje 3.Konferenca
343.43 (062)

NR 10
PRILL
2018

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Dr. Irvin Faniko

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

KONFERENCA II-të SHKENCORE KOMBËTARE

“Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare”

Bordi Shkencor i Konferencës

Prof. Dr. Ismet	ELEZI , <i>kriminolog, Kryetar i Bordit.</i>
Prof. Dr. Irakli	KOÇOLLARI , <i>Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit", anëtar.</i>
Dr. Bilbil	MEMAJ , <i>Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë, anëtar.</i>
Prof. Dr. Ilirjan	MANDRO , <i>Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, AS, anëtar.</i>
Prof. Asc. Ferdinand	ELEZI , <i>Prokuroria e Apelit, Durrës, anëtar.</i>
Dr. Xhavit	SHALA , <i>Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë, anëtar.</i>
Prof. Asc. Dr. Stavri	SINJARI , <i>Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë, anëtar.</i>
Dr. Bledi	CEKA , <i>Fakulteti i Shkencave Sociale, UT, anëtar.</i>
Dr. Sandër	LLESHI , <i>Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave, anëtar.</i>
Dr. Frank	HARRIS , <i>MSc, D.Crim. J., University of Portsmouth, anëtar.</i>
Av. Sajmir	VISHAJ , <i>Kryetar i Avokatëve Penalistë Shqiptarë, anëtar.</i>
Dr.(proc.) Albert	HITOALIAJ - <i>QKSH, Akademia e Sigurisë, anëtar.</i>

Komiteti organizator

Dr. Bilbil	MEMAJ - <i>Rektori/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë.</i>
Dr. Xhavit	SHALA - <i>Drejtori i QKSHN, Akademia e Sigurisë, Tiranë.</i>
MSc. Bilbil	DERVISHI - <i>QKSHN, Akademia e Sigurisë.</i>

Sekretariati dhe koordinimi

MSc. Anisa AGASTRA, (*koordinatore e konferencës*) Sektori i Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Redaktor Shkencor

Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ** – Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

P Ë R M B A J T J A

SESIONI I:

Aspektet juridike, hetimore e statistikore të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Dr. Xhavit Shala

Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale. Fokusi në vitet 2007-2016. 8

MSc. Arjan Muça

Vështrim i situatës ligjore në Shqipëri 26

Dr. (proc.) Besnik Muçi

Aspektet juridiko-penale të vrasjeve në familje, metodika e hetimit dhe mjetet e kërkimit të provave. . . 35

Av. Sajmir Vishaj

Dhuna në familje. 36

MSc. Bilbil Dervishi

Vështrim analitik mbi faktorët ndikues në kryerjen e krimit të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare. . 44

Dr. Andja Levanaku

Dhuna në familje si vepër penale dhe masat për parandalimin e saj. 68

MSc. Ervid Çobaj

Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar mbi masat për mbrojtjen ndaj dhunës në familje. 76

SESIONI II:

Praktika të trajtimit të konflikteve, dhunës dhe vrasjeve brenda familjeve shqiptare

Dr. Merita Poni

Këndvështrimi kulturor i dhunës ndaj grave. 86

MSc. Dorina Arapi

Ndikimi i mjedisit familjar tek veprat penale të të miturve. 96

MSc. Anisa Agastra

Perceptime dhe profile të vrasjeve në familjet shqiptare. 104

MSc. Qetësor Gurra

Dhuna në familje si shkak për keqtrajtim, abuzim dhe shfrytëzim. 126

MSc. Besnik Shehaj

Parandalimi i krimit në familje. 142

Dr. (proc.) Anisa Hysesani, MSc. Skënder Kalemi

Këndvështrim i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare sipas treguesve subjektivë (perceptimeve të popullatës, punonjësve të policisë, të dënuarve për vrasje etj). 156

Dr. Irvin Faniko, Dr. Shpëtim Karakushi

Dhuna në familje dhe masat ligjore në parandalimin e saj. 164

SESIONI III : Diskutime, Konkluzione dhe Rekomandime, (174-179)

Abstraktet në anglisht / Abstracts 180



~ *Sesioni I* ~

Aspektet juridike, hetimore e statistikore të
vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë historiko-juridike, analitike e psikosociale.

Fokusi në vitet 2007-2016



■ **Dr. Xhavit SHALA**
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë
xhavit.shala@asp.gov.al

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është trajtimi i problemit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në këndvështrim historik, ligjor, kronologjik, social, psikosocial e analitik, duke u përqendruar në dhjetëvjeçarin 2007-2016 dhe realizimi i një analize krahasuese me periudha të mëparshme, me synim evidentimin e problematikave, faktorët nxitës si dhe dhënien e disa rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e dukurisë së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe menaxhimit të konflikteve e dhunës, në shërbim të përmirësimit të mëtejshëm të procesit të një policimi komunitar të ndërthurur me atë të bazuar në inteligjencë. Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare nuk përbëjnë problem të ri për shoqërinë shqiptare. Kjo dukuri ka shoqëruar shoqërinë shqiptare ashtu si dhe kombet e tjera për shumë kohë. Prandaj, ajo që herët, ka gjetur një trajtim të veçantë edhe në të drejtën zakonore penale shqiptare. Shumë vende kanë arritur ta frenojnë këtë dukuri, ndërkohë që në Shqipëri në periudha të ndryshme vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare kanë shënuar rritje. Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Përveç trajtimit teorik, në aspektit historik e juridik të kësaj dukurie, në funksion të qëllimit, synimit dhe objektivave kërkimor, janë zhvilluar analiza të ndërthurura, të kryqëzuara e logjike të literaturës, të treguesve objektivë (statistikave dhe raporteve të rasteve realisht të evidentuara) e subjektivë, të dhënave nga tre pyetësorët e hartuar (me grupe të shënjuara nga popullsia, punonjësit e policisë dhe të dënuarit për vrasje në familje). Gjetjet kryesore të këtij punimi nxjerrin në pah nivelin e rrezikshmërisë dhe prijet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri, faktorët dhe motivet nxitëse, grupet më të rrezikuara si dhe fakte e sfida me të cilat duhet të përballen strukturat e Policisë së Shtetit, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit si dhe vetë shoqëria shqiptare në të ardhmen. Përfundimet dhe gjetjet e punimit na kanë ndihmuar në përcaktimin edhe të një prognoze të përafërt për këtë fenomen për një periudhë afatmesme si dhe na kanë mundësuar dhënien e rekomandimeve mbi punën e punonjësve të policisë dhe të strukturave të tjera në kuadër të kuptimit, informimit, ndërgjegjësimit, parandalimit dhe reduktimit dukurisë së vrasjeve në familje, duke diktuar dhe nevojën për hartimin e një strategjie kombëtare për këtë dukuri.

Fjalëkyçe:

vrasje në familje, kanun, tregues objektiv, tregues subjektiv, të anketuar, bashkëshort, bashkëshorte, motive.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

1. Hyrje

Duke marrë shkas nga perceptimi i një tendence në rritje të dhunës dhe të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, vëmendja e madhe dhe përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me raste të tilla, ndikimi i tyre në çështjet e rendit dhe të sigurisë në vendin tonë, Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë planifikoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “*Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016*”. Në vazhdim të këtij projekti kërkimor e duke u mbështetur në një pjesë të gjetjeve të tij, është përgatitur kjo kumtesë.

2. Vrasja në familje si forma më ekstreme e dhunës në familje: trajtimi historiko-juridik i dukurisë

Vrasjet në familje janë forma më ekstreme e dhunës në familje. Dhuna dhe vrasjet në familje i kapërcejnë kufijtë e një krahinë, të një kombi apo të një kulture. Ato shpesh janë pjesë e kronikave të zeza pothuajse në të gjitha kulturat. Por, si është trajtuar kjo dukuri në këndvështrimin historik e juridik nga shoqëria shqiptare?

2.1 Trajtimi i vrasjeve në familje sipas të drejtës sonë zakonore penale

Në të drejtën zakonore penale shqiptare si në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kanunin e Skënderbeut apo dhe Kanunin e Labërisë është bërë rregullimi juridik i institutit të

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

“ Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare ”

gjakmarrjes edhe të krimeve kundër jetës, në këtë kuadër të krimit të vrasjes si dhe më specifikisht për rastin e vrasjeve në familje. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit parashikohen rrethana të ndryshme cilësuese që lidhen me objektin e vrasjes siç janë rastet e vrasjeve në familje e në fis (vrasja e gruas, nënës, babait, vëllait apo kushëririt). Në shumë përcaktime duket sikur kanunet e marrin në mbrojtje gruan, bile edhe në rastet kur ajo kryen vrasje duke e përgjatur atë nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë¹ edhe si subjekt i krimit në familje². Megjithatë, sipas tyre “Gjaku i grues s’bahet krahas me gjak të burrit”³ pra gjaku i gruas nuk është baras me gjakun e burrit⁴, duke e justifikuar dhunën e burrit ndaj gruas së tij “me rrahë burri gruen, nuk bie në faj kah kanuja, e as prindja s’mund t’a kerkojn të rrahjen”⁵.

Ndonëse e justifikon dhunën ndaj gruas kanuni penalizon vrasjen e saj prej burrit. “Burri nuk ka tager mbi jetë të grues”⁶ thuhet në Kanunin e Lekës. “Burri e blen mundin e të jetuemit e grues, por jo jetën e saj”⁷, dhe “me vrà i shoqi të shoqen, bjen në gjak me prindt e grues”⁸. Kanunet shqiptare parashikojnë penaltete dhe përgjegjësinë e burrit kur ai kryen vrasje në familje e sidomos nëse vret gruan e tij. Kanuni i jepte të drejtë burrit të vriste gruan vetëm për çështje nderi si “për kurvni dhe për mik të premë”⁹. Nuk bie në gjak kush vret kënd më vajzë e grue të vet në kurvni”¹⁰. Gjithashtu, kanuni e falte vrasjen e burrit dhe të gruas kur ziheshin në flagrancë “ata qe kanë shtat e dhunë bashkë po u vranë në punë të keqe, shkojnë gjakhupës”¹¹. Burri si subjekt i krimit në familje në këtë rast përjashtohet nga “përgjegjësia penale”.

Kanuni gjithashtu ka kodifikuar edhe rastin e vrasjeve të tjera për shkak të marrëdhënieve familjare. Kështu, sipas Kanunit të Lekës “me vrà i biri t’amen, bien në

¹ Sipas Margaret Hasluck, më shumë se sa mbrojtje për gratë kjo ishte nënvlefësim për ato, pasi “shoqëria ndër malet shqiptare i vlerësonte shumë pak gratë” dhe sipas kanunit “burri ka gjak, ndërsa gruaja gjini” se “gruaja është bijë e tjetërkujt”. Për më tepër shih: Margaret Hasluck: Kanuni shqiptar. Cambridge: Universiti Press, 1954. Botuar në Shqip nga Lisitan. Tiranë 2005. Faqe 36.

² Në të tre kanunet (Kanunit të Lekës, Kanunit të Skënderbeut dhe Kanunit të Labërisë) përgjegjësia prindërore për vajzat ishte e obligueshme jo vetëm deri në ditën e martesës. Nëse ajo bënte vrasje ngarkonte me gjak prinderit e saj. Për më tepër shih: Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye i njetzetetëtë, “Gruja s’bjen në gjak” – “Grueja lshon më gjak prinden”, paragrafi 7; Prof. Dr. Ismet Elezi: E drejta zakonore e Labërisë. Botime Toena. Tiranë 2002. Faqe 171.

³ Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye i njetzetetëtë, “Gruja s’bjen në gjak” – “Grueja lshon më gjak prinden”, paragrafi 7.

⁴ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilija. Artikulli XIII “Fajet dhe damet”. Paragrafi 2949. Editrice La Rosa. Faqe 188. Milot 1993.

⁵ Libri i Tretë – Martesa, Nye i njetzetetëtë, “Gruja s’bjen në gjak” – “Grueja lshon më gjak prinden”, paragrafi pestë.

⁶ Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye e tridhjetëkatërt, “Nana – Grueja “. “Paperlimsija e grues”, paragrafi parë (a).

⁷ Me gjetë gja gruen per faj të burrit, prindja e kësaj i lypin arsye më kanu... Me plyrë burri gruen, e po bani vaj kjo ke prindt, burri do t’u apë arsye... Sikurse janë në detyrë prindja me dhanë arsye per çdo punë të ligë qi të bajë në derë të burrit a kuejdo bija e tyne, ashtu çmimin e gjakut të saj. Për më tepër shih: Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye i njetzetetëtë, “Gruja s’bjen në gjak” – “Grueja lshon më gjak prinden”, paragrafi 3 dhe 8.

⁸ Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Dhjetë, Kanuni Kundra Mbrapshitëvet, Nye e tridhjetëtetete, “Kush vret vendin, shkon gjak-hups.”, paragrafi 6 (963).

⁹ “Per dy punë e ka fishekun në shpinë grueja e per një punë i pritët theku e lëshohet: per kurvni; per mik të prem. Per këto dy punë të pabesijet i shoqi e vret të shoqen, e rrin pa ndore, pa besë e pa kenë i ndjekun për gjak, se prindja e nuses së vrame marrin çmimin e gjakut, e këtij do t’i napin fishekun e do t’i qesin dorëzaniët”. Për më tepër shih: Kanuni i Lekë Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye e tridhjetëenjë, “Theku i prem. (Me lshue gruen), paragrafi katër.

“Nana – Grueja “. “Paperlimsija e grues”, paragrafi parë.

¹⁰ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilija. Artikulli XIV “Gjaku nuk ngel për faj. Gjaku sbëhet gjobë”. Paragrafi 2958. Editrice La Rosa. Faqe 188. Milot 1993.

¹¹ Po aty. Nyja e njëqindnjëzetendët. “Gjaku për punë të liga”. Paragrafi parë (920).

gjak me prind e sâmes¹². Edhe në Kanunin e Skënderbeut është përcaktuar se “me vra burri grunë a i biri t’amën bie në gjak me prind e saj¹³”. Vrasja e babait si shtyllë e familjes dhe e autoritetit prindëror dënohej ashpër në të drejtën zakonore penale shqiptare. Sipas Kanunit të Lekës “po vrau i biri t’an, s’e ndjekë kush, porsë i biri, dorëras, grihet a prej fisit a edhe katundisht¹⁴. Edhe sipas Kanunit të Skënderbeut “kush vret babën e vet, djalin, nipin a stërnipin, vllanë, ungjin apo kushrinin e pandamë, në gjak nuk bie, por në faqe të zezë¹⁵ dhe “po vrau i vllai të vëllan, gjakhupës shkon¹⁶. Ndërsa në Kanun të Labërisë, kur babai vriste djalin apo djali vriste babanë, ose vëllanë dënohej nga opinioni shoqëror me shprehjen “pastë faqen e zezë”. Ky ishte një dënim moral, turpi më i madh që për nga pasojat morale, kapërcente dënimin me vdekje, si dënim fizik¹⁷.

Ndëshkime të rënda parashikoheshin në të drejtën zakonore penale shqiptare edhe rastin vrasjeve në fis. Kjo sepse përveç familjes edhe fisi ishte një strukturë shumë e rëndësishme shoqërore e kohës që garantonte mbijetesën e individit dhe të familjes së tij. Sipas kanunit të Lekës “kush vret të kushrinin, per me u bâ i zoti i pasunis së tij, grihet, digjet, giobitet e xieret prej vendit¹⁸. Ndërsa në Kanunin e Skënderbeut për këtë thuhet që “kush vret kushri, ungi a nip të ndamë, bie në gjak, por marrja e gjakut me gjak me kanu të burrërisë është e pahijshme¹⁹. Sipas tij “vrasësin e robve të vet, sidomos kur vrasja është e shëmtueme, katundi a bajraku, mund të ndëshkojnë atë shtëpi me gjobë, ndamje, qitje jashtë vendit dhe në ndonjë rast dhe me grimje katunisht të fajtorit fatzi²⁰.

2.2 Trajtimi i vrasjeve në familje në periudhën 1912-1944

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, qeveria e dalë nga Kuvendi i Vlorës, më 23 maj 1923 miratoi Kanunin e Zhurisë²¹, i cili përbënte një hap të rëndësishëm për krijimin e drejtësisë penale të shtetit të ri shqiptar. Ky hap u konsolidua më tej sidomos pas Kongresit të Lushnjës. Megjithatë, Qeveria e Vlorës ishte e detyruar të linte në fuqi Kodin Penal të Perandorisë Osmane²², derisa të përgatitej e të hynte në fuqi Kodi Penal i shtetit shqiptar, përgatitja e të cilit për shkak të shumë rrethanave, u vonua deri në vitin 1928. Gjithashtu, u la në fuqi edhe Kodi i Procedurës Penale²³ i Perandorisë Osmane i cili vazhdoi të vepronte edhe në Mbretërinë Shqiptare, me shtesa e ndryshime²⁴. Ligji

¹² Kanuni i Lekës Dukagjinit: Libri i Tretë – Martesa, Nye e tridhjetëekatërt, “Nana – Grueja “.Paperlimsija e grues”, paragrafi trete (c).

¹³ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilia. Kreu I. Dëme e faje kundër jetës. Artikulli XVII “Vrasa me rob të shpisë”. Paragrafi 3007. Editrice La Rosa. Faqe 191. Milot 1993.

¹⁴ Kanuni i Lekës Dukagjinit: Libri i Dhjetë, Kanuni Kundra Mbrapshitëvet, Nye e tridhjetëetete, “Kush vret vendin, shkon gjak-hups.”, paragrafi 4 (961).

¹⁵ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilia. Kreu I. Dëme e faje kundër jetës. Artikulli XVII “Vrasa me rob të shpisë”. Paragrafi 3004. Editrice La Rosa. Faqe 191. Milot 1993

¹⁶ Po aty. Paragrafi 3(960)

¹⁷ Prof. Dr. Ismet Elezi: E drejta zakonore e Labërisë. Botime Toena. Tiranë 2002. Faqe 176. Burim i cituar.

¹⁸ Kanuni i Lekës Dukagjinit: Libri i Njimbëdhjetë - Kanuni i Pleqnisë. Nyja e njëqinëseshdhjetëeshtatë. Paragrafi 7
¹⁹ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilia. Kreu I. Dëme e faje kundër jetës. Artikulli XVII “Vrasa me rob të shpisë”. Paragrafi 3006. Editrice La Rosa. Faqe 191. Milot 1993.

²⁰ Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilia. Kreu I. Dëme e faje kundër jetës. Artikulli XVII “Vrasa me rob të shpisë”. Paragrafi 3005. Editrice La Rosa. Faqe 191. Milot 1993.

²¹ Kanuni i Zhurisë (Jurisë), botuar në Përlindja e Shqipnise, Vlorë 1913, ribotuar në Jeta Juridike, N.1, Tiranë, 2007, f. 4-18. Kanuni i Zhurisë kishte si qëllim mbrojtjen e rendit e të sigurisë dhe luftën kundër veprave penale nëpërmjet hetimit e gjyqimit sipas ligjit. Në të jepej nocioni i fajit dhe ndarjen e tij(veprave penale) në tri kategori sipas modelit perëndimor, në dëme (kundërvajtje), faje të vështira (delikte) dhe faje të shëmtueme (krime). Aty parashikoheshin dhe rregullat procedurale të hetimit e të gjyqimit në gjuhë shqipe.

²² Kodi Penal i Perandorisë Osmane, i miratuar në vitin 1878.

²³ Kodi i Procedurës Penale të Perandorisë Osmane, i miratuar në vitin 1878.

²⁴ Ela Elezi: Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale kundër kriminalitetit në procesin e integritimit evropian. Tiranë 2013. Faqe 28.

penal otoman që veproi në Shqipëri deri në vitin 1928, me disa ndryshime e plotësime parashikonte si rrethanë cilësuese, si krim që prek autoritetin prindëror vrasjet në familje. Sipas tij “ai që me paramendim, me dashje vret një prej etënvet, gjyshënvet ndërkohet me vdekje”²⁵. Gjithashtu, ky kod, ashtu si në të drejtën zakonore penale shqiptare, e përjashtonte nga përgjegjësia penale rastet e vrasjes në familje për çështje nderi. Sipas tij “ai që e sheh të shoqen ose një prej gjinive të tij tue bam veprën e turpshme me ndokën dhe e rreh, e plagos apo e vret njanin apo të dy bashkë është i falun...”²⁶.

Pas shpalljes së Shqipërisë republikë parlamentare dhe miratimit të statutit të saj themeltar²⁷, u hartuar dhe u miratua Kodi Penal shqiptar²⁸ i cili hyri në fuqi me 1 janar 1928²⁹. Në këtë kod penal, i kushtohet një rëndësi e veçantë vrasjeve që përfshijnë rrethana të marrëdhënieve familjare, duke i parashikuar kryesisht si vrasje të cilësuar që lidhen me objektin e veprës penale. Pra, ky ligj penal merr në mbrojtje të veçantë rastet kur objekt i krimit të vrasjes janë pjesëtarë të familjes së subjektit të veprës penale si bashkëshorti, bashkëshortja, nëna, babai, djali, vajza, vjehri, vjehrra bile dhe në rastet kur kategori të tilla janë adoptivë, duke parashikuar sanksione shumë të rënda si burgime të përjetshme ose dënime me vdekje³⁰.

Ashtu si në të drejtën zakonore penale shqiptare si dhe në Kodin Penal të Perandorisë Osman, që mbeti në fuqi deri në fund të vitit 1927, edhe Kodi Penal i vitit 1928 parashikonte në nenin 418 pandëshkueshmërinë e veprës penale, pra përjashtimin nga përgjegjësia penale kur vrasja në familje bëhej për çështje nderi³¹, duke e trajtuar si vrasje të cilësuar, por që në këtë rast me anën subjektive të krimit të vrasjes në familje. Aq rëndësi i kushtohet mbrojtjes së familjes nëpërmjet mbrojtjes së pjesëtarëve të saj në mënyrë specifike nga krimi i vrasjes, duke i trajtuar ata si objekt të cilësuar të vrasjes, saqë për rastin e vrasjeve në familje, Kodi Penal i vitit 1928 parashikon specifikisht edhe mënyrën e ekzekutimit të dënimit me vdekje në rastin e vrasjes në familje³². Legjislacioni

²⁵ Kodi Penal i Perandorisë Osmane. Kreu II-të: “Krimet e deliktet kundër personave”. Cituar nga Ismet Elezi në “Krimet kundër jetës”. Faqe 153.

²⁶ Ismet Elezi: “Krimet kundër jetës”. Kombinati Poligrafik. Shtypshkronja ‘8 Nëntori”. Tiranë 1989. Faqe 138. Burim i cituar.

²⁷ Statuti themeltar i Republikës së Shqipërisë u miratuar më 7 mars 1925.

²⁸ Kodi Penal Shqiptar u dekretua me 3 qershorit 1927 dhe hyri në fuqi më 1 janar 1928.

²⁹ Fletorja zyrtare Nr. I, datë 1 janar 1928.

³⁰ Në nenin 404 përcaktohet se “ndëshkimi asht burgimi përjetshëm, në qoftë se vrasja bahet: 1) kundra bashkëshortit, vëllait, motrës, atit ose amës adoptive, djalit ose vajzës adoptive, vjehrit ose vjehrrës, dhandrit ose nuses;...”. Këto sanksione ashpërsohen akoma më tepër në nenin 405 kur bëhet fjalë për marrëdhënie “natyrale” dhe jo “adoptive” duke përcaktuar se “Ndëshkohet me vdekje ay që ban deliktin e parapamë në nenin 403, në qoftë se; 1) vret ndonjanin nga të parëlindunit ose të paslindunit të ligjshëm, ose amën atin, djalin ose bijën naturale, kur asht njoftun ose deklarue ligjërisht filiasioni naturel...”. Gjithashtu, në nenin 410 të atij Kodi penal ligjvënësit në atë kohë kanë përcaktuar se “Kushdo që për me ba gruen e vet ose njanin nga të parëlindunit ose të paslindunit ose motrën e vet, me të cilët bashkëjeton, që të determinojnë vet-vrasjen e tyne, u sjellet në një mënyrë aq të keqe e të jashtë-njerzishme sa q’i ban të vendojnë vet-vrasjen, ndëshkohet me burgim të randë nga pesë deri në pesmbëdhjet vjet, dhe në qoftë se vetëvrasja nuk mbarohet për shkaqe ndalimtare të cilat nuk mvaren as nga vullneti i determinuesit as nga ay i niasitorit, ndeshkimi asht burgim’i randë nga një deri në pesë vjet (Fletorja zyrtare Nr. I, datë 1 janar 1928) .

³¹ Konkretisht “... në qoftë se faji asht ba nga burri kundra grues nga prindi kundra të paslindunës, nga të paslindunit kundra amës ose gjyshes, nga vllaji kundra motrës nga vjehri kundra nuses dhe nga ungi kundra mbesës kur banojnë në një shtëpi ose kundra bashkëveprueseve të ktyne ose kundra të dyve bashkë, kur i gjen në turpënim e sipër ose i shef në një gjëndje që nuk lën as pak dyshim se kanë veprue ose do të veprojnë n’atë kohë turpërimin. Për më tepër shih: Kodi Penal Shqiptar: Titullin IX, Delikte kundra personit. Kaptina III. Neni 418.

³² Kështu, në nenin 12 ai kod parashikonte: “I dënuemi me vdekje si prind-vrasës ose fëmijë-vrasës sillet në vendin e ekzekutimit tue qënë kambë-sbathur kokë jashtë, dhe i veshur me këmishë të zeze, dhe kësilloj varet. Trupi i të varunit i dorëzohet gjinisë së tij dhe varoset pa as një ceremoni. Në rast që gjinija nuk pranon trupin e tij, varoset nga an’e Bashkis po pa as një ceremoni”. Për më tepër shih: Kodi Penal Shqiptar: Titullin II, Ndëshkimet. Tiranë 1928.

penal i mbretërisë shqiptare, me disa ndryshime, formalisht mbeti në fuqi edhe gjatë periudhës së pushtimit fashist të Shqipërisë (prill 1939- dhjetor 1944).

2.3. Trajtimi i vrasjet në familje sipas legjislacionit socialist, në periudhën 1945-1991

Me ligjin Nr. 46, datë 17.5.1945 u vendos që legjislacioni i cili kishte vepruar në Shqipëri para 7 prillit 1939, deri në aprovimin e kodit të ri penal, do të vazhdonte të shërbente për gjykatat si rregullim juridik për orientim, derisa nuk binte në kundërshtim me parimet e pushtetit popullor dhe me ndërgjegjen juridike revolucionare të gjykatave të reja të popullit. Kodi i ri penal u miratua në vitin 1952. Në legjislacionin penal të periudhës 1952-1991, vrasjet në familje nuk parashikoheshin me nen më vete³³. Kjo, me argumentin se, në shoqërinë socialiste jeta e gjithë anëtarëve të shoqërisë mbrohej njëllë, gjë që e përjashtonte nevojën e mbrojtjes së jetës së pjesëtarëve të familjes, me një dispozitë të veçantë. Vrasjet në familje përgjithësisht përfshiheshin në vrasjet në rrethana cilësuese dhe, kryesisht në vrasjet për xheloz, por edhe për shkaqe të tjera të dobëta (ku përfshiheshin edhe ato që në atë kohë quheshin “zakone prapanike”). Pra, në legjislacionin penal socialist, parashikoheshin vrasje në rrethana cilësuese që i përkasin anës subjektive në rastet kur vrasjet kryheshin për interes, hakmarrje, xheloz³⁴ ose për shkaqe të tjera të dobëta edhe kur këto kryheshin në rrethana familjare. Në këtë rast, vrasja bëhet e cilësuar jo për shkak të rrethanave që i përkasin objektit të krimit të vrasjes, siç ishte rasti i pjesëtarëve të familjes në legjislacionin penal të para vitit 1952, por për shkak motiveve dhe qëllimeve që vinin “në kundërshtim me moralin komunist dhe rendin shoqëror socialist”.³⁵ Në një analizë të Gjykatës së Lartë për vrasjet në Qarkun Gjyqësor të Tiranës për vitin 1963 është evidentuar se “...zakonet prapanike në lidhje me pozitën e gruas në familje dhe paragjykimi lidhur me nderin e saj kanë qenë shkak i shpeshtë i vrasjeve...”³⁶. Në 73% të rasteve të vrasjeve të vitit 1968, vrasjet janë shkaktuar “...për motive të dobëta që lidhen me konceptet prapanike të fajtorëve dhe të viktimave. Ato në disa

³³ Në Kodin Penal të vitit 1952, vrasjet (nenet 83-88) klasifikoheshin në: vrasje me dashje pa rrethana cilësuese e lehtësuese (neni 83); vrasjet në rrethana cilësuese (për interes, xheloz, hakmarrje ose shkaqe të tjera të dobëta-neni 84); vrasje në rrethana lehtësuese; vrasje nga pakujdesia dhe vetëvrasje.

³⁴ Vrasja për xheloz sipas Kodit Penal të vitit 1977 përfshinte rastet kur burri i shtyrë nga motivi i xhelozisë vret gruan, ose i fejuari të fejuarën, dashnori dashnoren ose anasjelltas ose me rivalin në dashuri me qëllim që të ndërpresë marrëdhënien intime me personin tjetër ose për shkak të dyshimeve që ka për besnikërinë ndaj tyre. Sipas atij kodi në vrasjen për xheloz çështja nuk është se kë vret, por kryesorja përse e vret. Motivi shtytës për vrasje duhet të jetë doemos xhelozia. Për më tepër shih: Prof. Dr. Ismet Elezi: “Krimet kundër jetës”... Faqe 139. Burim i cituar.

³⁵ Ndërsa vrasja e cilësuar për shkaqe të tjera të dobëta në praktikën gjyqësore të asaj kohe përfshinin dhe vrasjen e prindit që ishte pengesë për martesën e autorit të krimit me vajzën e viktimës, vrasjen e vjehrrës sepse ajo ankohej për sjelljet imorale të nuses së djalit, vrasjen e motrës nga vëllai ose nga prindi për t'i dhënë fund marrëdhënies dashurore me personin që nuk donin prindërit, vrasjen e gruas nga burri, sepse nuk pranon të kthehet në shtëpinë bashkëshortore, vrasje për shkak të qëndrimeve jo korrekte në marrëdhëniet bashkëshortore etj. Për më tepër shih: AQSH. Arkivi Qendror PPSH. Fondi Nr. 14. Lista Nr. 16. Dosje Nr. 477. “Përgjithësim i praktikës gjyqësore të vrasjeve me dashje”. Faqe Nr. 4. Në 8 raste nga 64 rastet e vrasjeve dhe ato të mbetura në tentative për vitin 1959 shkak ka qenë largim i gruas nga banesa bashkëshortore kryesisht për shkak të qëndrimit despotik të burrave ose të familjarëve të tyre, si dhe Prof. Dr. Ismet Elezi: “Krimet kundër jetës”..... Faqe 143.

³⁶ AQSH. Fondi “Gjykata e Lartë”. Dosje Nr. 13. Titulli dosjes: “Informacion i bërë nga Gjykata e Lartë mbi krimin e vrasjes, dërguar Komitetit Qendror të PPSH”. Dokumenti Nr. Prot. 27; datë 21.3.1964 “Gjeneralizim mbi krimin e vrasjeve në Qarkun e Tiranës”. Faqe 3. Ndërmjet të tjerave në atë dokument citohet se megjithatë: “në kundërshtim me sa ndodhte më parë kur vrasjet për shkelje të kurorës kryheshin sapo konstatohet fakti shkeljes së kurorës, tani në disa raste fajtorët tregohen me gjakftohtë dhe kanë këshilluar gratë e tyre që të heqin dorë ose me anë të miqve kanë ndërhyrë që të bindin dashnorin e gruas që të largohet. Vetëm atëherë kur kanë konstatuar se këto veprime nuk kanë dhënë rezultat, kanë vrarë gruan, dashnorin apo të dy...”.

raste kanë ndodhur për shkak se gruaja, vajza apo motra e fajtorit kanë hyrë më marrëdhënie dashurie me persona të tjerë ose për shkak të dyshimeve që kanë lindur nga thashethemet mbi qëndrimin moral të bashkëshortes...³⁷. Ndërsa për vitet 1981-1986 numri i të dënuarve për vrasje për xhelozitë zinte 12% të numrit total të personave të dënuar për vrasje³⁸. Këto të dhëna statistikore të asaj kohe tregojnë për një numër të madh të vrasjeve për shkak të rrethanave marrëdhënies familjare, siç quhen përndryshe sot.

2.4 Legjislacioni shqiptar mbi vrasjen në familje në periudhën 1992-2013

Pavarësisht se pas vitit 1991 u rrëzua baza ideologjike e konceptit të barazisë shoqërore që nuk lejonte mbrojtje të veçantë për familjen dhe anëtarët e saj duke i barazuar ata me gjithë anëtarët e shoqërisë, edhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995³⁹ nuk kishte një dispozitë për një mbrojtje të veçantë të pjesëtarëve të familjes⁴⁰. Kjo, për vite të tëra ka ndikuar negativisht në mundësinë e frenimit të rasteve të vrasjeve për shkak të marrëdhënies familjare. Vetëm në vitin 2013 u bënë ndryshimet në Kodin Penal shqiptar dhe me një nen të posaçëm iu dha një mbrojtje e veçantë pjesëtarëve të familjes ashtu siç ishte bërë me parë në legjislacionin penal dhe në të drejtën zakonore penale të para vitit 1945. Për herë të parë, ndryshimet dhe shtesat e bëra gati në vitin 2013 e bëjnë të cilësuar vrasjen kur midis autorit dhe viktimës ka marrëdhënie familjare⁴¹. Pra, i është dhënë një mbrojtje e posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet prej anëtarëve të saj. Kjo në vazhdimësi do të ndikojë në reduktimin e numrit të vrasjeve në familje.

Në përfundim, nga analiza krahasuese në planin historik dhe juridik mbi mënyrën e trajtimit të vrasjes në familje në të drejtën tonë zakonore, në Kodin Penal të Perandorisë Osmane që ka vepruar në Shqipëri deri në fund të vitit 1927, në Kodin Penal të vitit 1928 që ka qenë në fuqi deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, në legjislacionin penal të viteve 1945-1991 si dhe në legjislacionin penal të viteve 1992-2013, do të konkludojmë se:

- Në legjislacionin penal të para vitit 1945 dhe në të drejtën zakonore penale shqiptare, rastet e vrasjes në familje e në fis kanë gjetur një trajtim të veçantë. Këto vrasje janë klasifikuar e trajtuar të kryera kryesisht në rrethana cilësuese të lidhura me objektin e krimit, duke i dhënë kështu një mbrojtje të posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet brenda vetes. Kjo në vazhdimësi ka ndikuar në frenimin e dukurisë së vrasjes në familjen shqiptare të asaj periudhe.

- Në legjislacionin penal që përfshin periudhën, nga viti 1945 e deri në ndryshimet ligjore të vitit 2013, pjesëtarëve të familjes iu hoq mbrojtja e posaçme nga vrasjet brenda vetes, të cilën e kishin gëzuar në shekujt e mëparshëm. Kjo ka ndikuar negativisht në parandalimin e vrasjeve në familje dhe në mundësinë e reduktimit të rasteve të vrasjeve për shkak të marrëdhënies familjare.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënies
familjare »

³⁷ AQSH. Fondi "Gjykata e Lartë". Dosje Nr. 54. Titulli dosjes: Raport i Gjykatës së Lartë "Mbi kriminalitetin" dërguara shokëve Hysni Kapo, Haki Toska dhe Presidiumit të Kuvendit Popullor". Dokumenti Nr. Prot. 54; datë 22.3.1969 "Raport mbi kriminalitetin gjatë vitit 1968, i parë nëpërmjet gjykimit të çështjeve". Faqe 15.

³⁸ Ismet Elezi: "Krimet kundër jetës"... Faqe 137. Burim i cituar

³⁹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995.

⁴⁰ Nga vitin 1992 deri në vitin 2013 ligji penal parashikonte vetëm si rrethanë rënduese vrasjen kur kryhej ndaj fëmijëve të mitur, grave shtatzëna apo personave me mangësi fizike e psikike.


⁴¹ Neni 79/c i Kodit Penal "Vrasjen për shkak të marrëdhënies familjare", shtuar me Ligjin Nr. 144/2013 datë 2.5.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë").

- Ndryshimet në Kodin Penal të bëra në vitin 2013, duke shtuar nenin 79/c “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, pas pothuajse 70 vitesh i sigurojnë dhe rikthejnë mbrojtjen e posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare. Në planin afat gjatë kjo do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e numrit të vrasjeve në familje dhe në forcimin e institucionit të familjes shqiptare.

3. Vështrimi analitik i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare nisur nga treguesit objektiv (statistikat e Policisë së Shtetit dhe raporte të rasteve të evidentuara)

Treguesit objektiv të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, në paraqitje tabelore⁴² dhe grafike janë si më poshtë⁴³:

Vitet V. penale	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shuma	Mesatarja	%
Vrasje	21	22	11	18	27	31	24	17	10	13	194	19.40	54.5
Vrasje në tentative	22	21	18	11	18	22	21	16	10	3	162	16.20	45.5
Shuma	43	43	29	29	45	53	45	23	20	16	356	35.60	




Nga analiza krahasuese e treguesve objektivë, të dhënave statistikore (tabelore dhe grafike), të dinamikës së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për periudhën 2007-2016 gjejmë se, kanë ndodhur gjithsej 356 vrasje (nga këto 54.5% vrasje e 45.5% vrasje të mbetura në tentativë); mesatarisht në një vit 35.6 vrasje; në vitin 2016 (viti i fundit i periudhës analizuuese) kanë ndodhur 16 vrasje (së bashku më ato të mbetura në tentativë) ose 2.68 herë më pak se në vitin 2007 (vit i parë i periudhës analizuuese) dhe 3.3 herë më pak se në vitin 2012, i cili shënon nivelin më të lartë të vrasjeve për shkak

⁴² Të dhënat statistikore janë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

⁴³ Të dhënat statistikore janë përpunuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë, tetor 2017.

të rrethanave familjare të kësaj periudhe analizuese. Këto vrasje përbëjnë vetëm 3.54% të totalit të veprave penale të fushës së dhunës në familje, të cilat, për periudhën analizuese, kanë një tendencë në rritje.

Gjithashtu, në “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” janë evidentuar mesatarisht 13.91 viktima/100 mijë banorë në shkallë vendi. Këto kanë ndodhur kryesisht në qarqe të mëdha si Tirana, Durrësi, Fieri, etj., kryesisht në zona rurale (në 61.17% të rasteve) dhe më e theksuar në qarkun e Lezhës (me 32.55 viktima /100 000 banorë). Këto vrasje kryhen edhe në bashkëpunim dhe kanë pasur më shumë se një autor (në 10.37% të rasteve), më shumë se një viktimë (në 14.04% të rasteve), ku një pjesë jo e vogël e autorëve ka përfunduar me vetëvrasje (në 12.8% të rasteve). Kryesisht kanë ndodhur mes bashkëshortëve (në 28.79% të rasteve), më shumë për motive të dobëta (në 68.8% të rasteve); kryesisht i përkasin profesionit të fermerit me mbi 50%, të rasteve (51.01% të autorëve dhe 53.75% të viktimave), më shumë të vetëpunësuar (në 44.95% për autorët dhe 48.75% për viktimat).



Vrasjet në familje kryhen kryesisht me armë zjarri (në 49.72% të rasteve) pa leje (në 82.35% të rasteve), me AK-47 (në 37.97% të rasteve). Në 27.13% të rasteve janë kryer me mjete prerëse (thika). Janë kryer më shumë ditën (në 59.04% të rasteve), por edhe në mbrëmje (me 21.54% të rasteve) si dhe natën (me 19.41% të rasteve); më shumë në stinën e verës (në 31.38% të rasteve), kryesisht në banesa (në 55.5% rasteve).

Autorët (kryesisht meshkuj në 90.15% të rasteve) dhe viktimat (57% të rasteve meshkuj dhe 43% femra) janë kryesisht të grupmoshës 31-50 vjeç (47.2% të autorëve dhe 43.7% të viktimave), kryesisht me nivel të ulët arsimor (me arsim 8 vjeçar, fillor apo pa arsim) në rreth 80% të rasteve (autorët në 77.8% të rasteve dhe viktimat në 83.5% të rasteve) dhe më shumë të martuar (autorët në 69.19% të rasteve e viktimat në 69.25% të rasteve).

Në përfundim, nisur nga treguesit objektiv konkludojmë se për periudhën analizuese, sidomos pas vitit 2013, ka një tendencë të theksuar në rënie të numrit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe një rritje të evidentimit të rasteve të tjera të dhunës në familje. Tendencat e mësipërme mund të shpjegohen, ndërmjet të tjerave, si me rritjen e ndërgjegjësimit për denoncimin e rasteve të dhunë në familje, ashtu edhe

me efektin e ndryshimeve në Kodin Penal, të bëra në vitin 2013, ku vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare, kualifikohet si vrasje e cilësuar që lidhet me objektin e veprës penale, shoqëruar kjo dhe me sanksione shumë më të ashpra.

4. Vështrimi analitik i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare mbështetur në treguesit subjektivë⁴⁴

Treguesit e subjektivit të dukurisë së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve mbështeten në përpunimin analitik të dhënave të siguruar nga përgjigjet e të anketuarve nga grup-shënjestrat (*target grup*) “punonjës policie”, “popullata” dhe “të dënuar për vrasje në familje”, të përzgjedhur për këtë projekt kërkimor dhe që përfaqësojnë perceptimet e tyre për elemente të dukurisë së vrasjeve në familje.

4.1 Grup-shënjestra “punonjës policie” dhe “popullata”

Bazuar në treguesit subjektivë⁴⁵, gjejmë se të anketuarit nga grup-shënjestra “punonjës policie” dhe “popullata”, perceptojnë se ka rritje të nivelit të dhunës në familje (67.3% e punonjësve të policisë dhe 69.3% e popullatës) e të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare (51.9% e punonjësve të policisë dhe 69.8% e popullatës) në shoqërinë shqiptare; se ka më shumë autorë meshkuj (96%) dhe më shumë viktime femra (97%); se vrasjet brenda familjes ndodhin kryesisht mes bashkëjetuesve (sipas 39.96% të punonjësve të policisë), mes partnerëve (sipas 45.83% e popullatës), pavarësisht nëse janë të martuar ligjërisht apo jo, mes kushërinjve (sipas 10.14% e punonjësve të policisë dhe 15.05% e popullatës) apo nga djali ndaj prindërve (sipas 14.13% e punonjësve të policisë dhe 10.67% e popullatës) dhe se marrëdhëniet abuzive autor/viktimit vazhdojnë të ekzistojnë si pasojë e varësisë ekonomike (sipas 44.61% e punonjësve të policisë dhe 40.7% e popullatës).

Nga të anketuarit, 54% e punonjësve të policisë perceptojnë se vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare kryhen më së shumti me armë zjarri e objekte të mprehta, 53% e tyre mendojnë se ndodhin në mbrëmje, 96.8% mendojnë se ndodhin brenda banesës dhe 28% e tyre mendojnë se pjesa më e madhe e këtyre vrasjeve ndodhin në qarkun e Tiranës e 12% mendojnë se ndodhin në qarkun e Shkodrës.

Të anketuarit i perceptojnë autorët e vrasjeve brenda familjes kryesisht të grupmoshës 31-50 vjeç (sipas 55.6% e punonjësve të policisë dhe 53.6% e popullatës) ndërsa viktimat i perceptojnë të grupmoshës 31-50 vjeç (sipas 41% të punonjësve të policisë) dhe të grupmoshës deri në 18 vjeç (sipas 33.8% të popullatës); i perceptojnë autorët me arsim 8/9 vjeçar (sipas 49% të punonjësve të policisë) dhe pa arsim (sipas 62% të popullatës), ndërsa viktimat i perceptojnë me arsim të ulët (sipas 53.4% e punonjësve të policisë) dhe me çfarëdo arsimit, nga të paarsimuar (sipas 28% të popullatës) deri te ata me arsim post-universitar (sipas 5% të popullatës).

Sipas perceptimeve të së anketuarve, faktorët që nxisin më shumë autorët për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare janë: abuzimi me substancat (sipas

⁴⁴ Të dhënat janë nga anketimi i zhvilluar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore me grup-shënjestrat “punonjës policie”, “popullata” dhe “të dënuar për vrasje në familje”.

⁴⁵ Të dhënat statistikore të anketimeve janë përpunuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore .

59.87% e punonjësve të policisë dhe 67.7% e popullatës) e me alkoolin (sipas 63% e punonjësve të policisë dhe 67.46% e popullatës), xhelozia (sipas 45% e punonjësve të policisë dhe 55.56% e popullatës), papunësia (sipas 53.2% e punonjësve të policisë dhe 43.12% e popullatës), problemet e vështirësitë ekonomike (sipas 66% e punonjësve të policisë dhe 52.64% e popullatës), depresioni (sipas 61% e punonjësve të policisë dhe 59.26% e popullatës), çrregullimet mendore (sipas 52% e punonjësve të policisë dhe 59.5% e popullatës), sëmundjet mendore (sipas 48% e punonjësve të policisë dhe 59.26% e popullatës), zemërimi e tensioni i brendshëm (sipas 56% e punonjësve të policisë dhe 60.8% e popullatës), luhatjet e humorit (sipas 55.1% e punonjësve të policisë dhe 49.21% e popullatës), problemet e zbrazëtia emocionale (sipas 61% e punonjësve të policisë dhe 49.47% e popullatës).

Sipas perceptimit së të anketuarve, faktorët që nxisin më shumë viktimat për të manifestuar sjellje, të cilat shërbejnë si shkak për autorin për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, janë: abuzimi me substancat (sipas 42.9% të punonjësve të policisë dhe 57.41% e popullatës) e me alkoolin (sipas 47% e punonjësve të policisë dhe 54.76% e popullatës), xhelozia (sipas 48% e punonjësve të policisë dhe 54% e popullatës) dhe tradhtia (sipas 65% e punonjësve të policisë dhe 66.4% e popullatës).

Ndërsa faktorë si mentaliteti i trashëguar nga e kaluara, dobësimi i kontrollit të prindërve, rënia e figurës autoritare të babait, fjalët fyese të përdorura nga viktimat apo nga autori dhe grindjet e konfliktet e çastit, sipas mendimit së të anketuarve, ndikonin disi në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Ndërkohë që 64.5% e popullatës së anketuar shprehin besim te institucioni i policisë për trajtimin e zgjidhjen e problematikave të tyre familjare, ndërsa punonjësit e policisë nënvizojnë që duhet më shumë punë me organet e pushtetit vendor (29.1%) dhe sistemin e drejtësisë (20.2%) për trajtim dhe parandalim të çështjeve të tilla.

Të anketuarit perceptojnë se duhen marrë këto masa për të parandaluar konfliktet, dhunën dhe vrasjet brenda familjes: forcimi i bashkëpunimit institucional (sipas 26.6% e punonjësve të policisë dhe 21.7% e popullatës), nxitja dhe organizimi i fushatave sensibilizuese (sipas 20.8% e punonjësve të policisë dhe 30.2% e popullatës) dhe hartimi i programe të veçanta profesionale (sipas 13.9% e punonjësve të policisë dhe 12.5% e popullatës). Në përqindje më të vogla renditën ndryshimet ligjore, ndërtimin e uebsajteve/linjave telefonike mbështetëse për autorët e viktimat, marrjen e masave për kushtet e strehimit dhe shërbimeve për autorët, etj.

Rreth 82.1% e punonjësve të anketuar të policisë, theksuan nevojën për organizimin e trajnimeve të vazhdueshme për dhunën e vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Policinë e Shtetit, që të përmbajnë tema të profilit psikosocial, legjislativ e procedural policor. Nga këta punonjës policie, 19.6% e tyre parashtruan nevojën për tema që kanë lidhje me psikologjinë e ndërtimit të profilit të autorit/viktimës dhe trajtimin e kësaj të fundit; 19.3% parashtruan nevojën e temave për paraqitjen e ndryshimeve në legjislacion për dhunën e vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare dhe 14.7% parashtruan nevojën e temave që lidhen me procedura e masat për ndërhyrje në vendngjarje.

Punonjësit e policisë të anketuar u shprehën se detyrat e përgjegjësitë ku ndjejnë më shumë vështirësi në lidhje me ndjekjen e çështjeve të dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë mbrojtja dhe garantimi i sigurisë së viktimës (20.23%), përgjigja ndaj njoftimeve të viktimave (14.12%) dhe orientimi i viktimave për shërbime sociale (10.31%), ndërsa theksojnë se kanë më shumë vështirësi të bashkëpunojnë me organet e pushtetit vendor dhe sistemin e drejtësisë.

4.2 Grup-shënjestra “të dënuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”

Sipas anketimit të realizuar me 50 persona që i përkasin grup-shënjestrës “të dënuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” në IEVP-të në Shqipëri⁴⁶, rezultoi se: 88% e të dënuarve për këtë vepër penale janë meshkuj, 52% janë të grupmoshës 31-50 vjeç; 60% kishin qenë të martuar para dënimit; 70% banonin në qarqe të mëdha si Tirana, Shkodra, Elbasani; 10% e tyre kishin kryer krimin në muajin tetor, 10% në muajin dhjetor dhe 8% në muajin korrik; 54% jetonin në familje me nga 4-5 anëtarë; 52% kishin një nivel të ulët arsimor 8/9 vjeçar; 58% ishin të punësuar, nga të cilët 44% në sektor privat e punonin si punëtorë krahu (16%), elektrikistë e hidraulikë (14%), etj; me të ardhura të ulëta mujore mesatare familjare para dënimit, ku 34% fitonin deri më 20 000 lekë të reja në muaj kurse 22% fitonin nga 20 000 – 40 000 lekë të reja në muaj; 86% nuk kishin qenë të dënuar më parë, për vrasje apo vepra të tjera; 18% e tyre kishin vrarë bashkëshorten, 10% kishin vrarë kushëririn dhe 10% djalin. Nga këta, 86% deklaruan që krimin e kishin kryer si pasojë e debatit të çastit dhe që nuk kishte qenë i planifikuar dhe 76% u shfaqën të penduar; 76% e të dënuarve nuk kishin pasur më parë pjesëtarë të dhunshëm apo agresivë në familje ndërsa 74% e tyre deklaruan se nuk kishin pasur konflikte të mëparshme në familjen e tyre, përveç atij që çoi në kryerjen e vrasjes; 64% e tyre nuk kishin fyer apo ofenduar më parë viktimën; 54% e fajësonin viktimën se me sjelljet e manifestuara nga ana e tij/saj në momentin e ngjarjes e kishin nxitur atë për kryerjen e vrasjes; 52% e fajësonin viktimën për kryerjen e aktit, kryesisht për shkaqe si provokime me fyerje (15.31%), tradhti (8.16%) dhe ofendime e të bërtitura (8.16%).

Nga ky grup-shënjestër, 86% u përgjigjen se nuk kishin qenë përdorues droge më parë; 68% nuk kishin abuzuar me alkoolin; 62% deklaruan se nuk kishin qenë nën efektin e alkoolit kur kishte ndodhur vrasja; 50% kishin qenë të zemëruar e të acaruar kur kishte ndodhur ngjarja; 56% e tyre nuk vuanin nga depresioni ndërsa 58% nuk ishin vizituar para se të ndodhte vrasja, në profesionistë si mjek, psikolog, etj., për shqetësime të mundshme të shëndetit mendor dhe 56% nuk kishin marrë asnjëherë trajtime apo kura për shëndetin e tyre mendor; 52% nuk kishin menduar të kryenin vetëvrasje.

Nga këta 38% nuk kishin kërkuar ndihmë për zgjidhjen e konfliktit dhe 34% kishin kërkuar ndihmë, nga të cilët 18% tek familja, 13% tek shoqëria e miqtë dhe 9% tek policia, ndërsa 28.81% e tyre u shprehën se do të zgjidhnin policinë, si institucionin tek i cili do të drejtoheshin për ndihmë për zgjidhjen e konflikteve në të ardhmen, ndërsa 25.42% do të vazhdonin t’u drejtoheshin familjarëve e miqve.

Sipas perceptimit së të dënuarve, viktimat nuk kishin shfaqur probleme me abuzimin me alkoolin (sipas 36% të të dënuarve) apo me drogën (sipas 52% të të dënuarve), nuk kishin qenë nën efektin e alkoolit gjatë ngjarjes (sipas 44% të të dënuarve), nuk vuanin nga depresioni (sipas 36% të të dënuarve), ishte i/e irrituar dhe agresiv/ (sipas 38% të të dënuarve), kishte ofenduar e fyer autorin para ngjarjes (sipas 38% e të dënuarve) dhe kishte bërë presion (sipas 36% e të dënuarve).

⁴⁶ Të dhënat janë nga anketimi i zhvilluar nga Qendra e kërkimeve Shkencore në IEVP-të Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë Krujë, Lushnjë, Fier dhe Peqin, në muajt qershor-korrik 2017.

4.3. Bazuar në analizën krahasuese të treguesve subjektivë

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore që i përkasin treguesve subjektivë (të përgjigjeve së të anketuarve të tre pyetësorëve të kampioneve të përzgjedhur) konkludojmë se:

- Të anketuarit mendojnë se niveli i dhunës dhe i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, është shqetësues dhe ka një tendencë rritjeje në 10vjeçarin e fundit.

- Të anketuarit mendojnë se vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri, ndodhin kryesisht si rrjedhojë e kushteve ekonomike, konflikteve të akumuluarra dhe stresit e shqetësimeve emocionale.

- Pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, ose 88% e tyre, ishin meshkuj dhe kjo përputhet me mendimin e pjesës më të madhe të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, se autorët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë kryesisht meshkuj, ndërsa viktimat, kryesisht femra.

- Të anketuarit u shprehën se nuk kishin anëtarë abuzivë ose të dhunshëm në familjet e tyre, përveç viktimave që të dënuarit i konsideronin si agresive e të dhunshme.

- Të anketuarit u shprehën se vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare ndodhin kryesisht mes partnerëve, e bashkëjetuesve, si dhe mes kushërinjve e më pak nga djali ndaj babait.

- Pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare i përkisnin grupmoshës 31-50 vjeç, kryesisht të martuar, kjo përputhet me mendimin e shumicës së punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, se ata që abuzojnë apo kryejnë krime në familje priren të jenë të grupmoshës 31-50 vjeç.

- Punonjësit e policisë të anketuar mendonin se viktimat në rastet e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare do të ishte e grupmoshës 31-50 vjeç ndërsa popullata mendon se më shumë rrezik ka grupmosha deri në 18 vjeç.

- Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar mendojnë se marrëdhëniet abuzive vazhdojnë vetëm prej varësisë ekonomike.

- Nga deklaratat e të dënuarve të anketuar u konkludua se pjesa më e madhe e tyre ka të ardhura të ulëta mesatare mujore që variojnë nga nën 20 000 – 40 000 lekë të reja në muaj.

- Të anketuarit mendojnë se (të tre grup-shënjestrat), niveli i ulët arsimor, kryesisht 8 ose 9 vjeçar karakterizon autorët dhe viktimat e krimit në familje dhe ndikon në nxitjen e vrasjeve, ndërsa vetëm popullata e anketuar mendon se mund të jenë të rrezikuar për të qenë viktimat të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare persona me çfarëdolloj arsimit, nga pa arsim deri me arsim post-universitar.

- Të anketuarit mendojnë se (të tre grup-shënjestrat) anëtarët e familjes që kanë kryer apo kanë qenë viktimat të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, kanë pasur probleme ekonomike, punë të paqëndrueshme, nivel të ulët arsimor, nuk ishin abuzues të drogës apo alkoolit por kishin shqetësime emocionale që mund të ishin dhe në nivelin e shqetësimeve psikoemocionale, tendenca agresive e të dhunshme dhe stres.

- Sipas mendimit të të anketuarve punonjës policie&popullatë, faktorët që nxisin më shumë autorët për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare janë: abuzimi me substancat dhe drogën, xhelozia, papunësia, problemet dhe vështirësitë ekonomike, depresioni, çrregullimet mendore dhe sëmundjet mendore.

- Sipas mendimit të të anketuarve (punonjës policie&popullatë), faktorët që nxisin më shumë viktimat për të manifestuar veprime, që më pas shërbejnë për autorin si shkak i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, janë: abuzimi me substancat dhe alkoolin, xhelozia dhe tradhtia, ndërsa të dënuarit fajësonin viktimën për nxitjen e vrasjes kryesisht për shkak të fjalëve ofenduese e fyese dhe tradhtisë.

- Të anketuarit punonjës policie&popullatë e shohin një person që vuan nga probleme të shëndetit mendor si potenciali më i mundshëm për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, se sa për të nxitur vrasjen.

- Sipas mendimit të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, faktorë të jashtëm si abuzimi me substancat dhe alkoolin nga autori apo nga viktimja, ndikojnë shumë në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Sipas mendimit të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, xhelozia nga ana e autorit apo viktimës është një ndër shkaktarët më nxitës të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa të dënuarit theksonin fjalët ofenduese të viktimës si një ndër shkaktarët kryesorë.

- Sipas mendimit të tre grup-shënjestrave të anketuara, tradhtia nga autori apo nga viktimja, është ndër shkaktarët kryesorë nxitës të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Sipas mendimit të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, papunësia dhe vështirësitë ekonomike të autorit dhe deri diku të viktimës, shërbejnë si shkak që nxisin shumë vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare, ashtu sikundër pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar rezultoi të kishin probleme me punësimin, të kryenin punë të çfarëdoshme dhe jo të mirëpaguara dhe të kishin të ardhura të ulëta mujore mesatare.

- Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar mendojnë se mentaliteti patriarkal i trashëguar nga e kaluara ndikon ende në familjet shqiptare, sidomos tek autorët e deri diku të viktimat, duke nxitur në masë të mjaftueshme vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar mendojnë se janë mesatarisht tradicional apo liberal, që tregojnë se krimin nuk e kanë kryer nga mentaliteti.

- Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe të popullatës së anketuar mendojnë se fjalët fyese e ofenduese të përdorura nga autori apo nga viktimja ndikojnë deri diku si shkak në vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare kurse të dënuarit e anketuar u shprehën se nuk kishin fyer apo ofenduar më parë viktimën, ndërsa ankoheshim për përdorim të fjalëve fyese e ofenduese të viktimës.

- Shumica e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, mendojnë se grindjet dhe konfliktet e çastit mes autorit dhe viktimës, ndikojnë deri diku në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa të dënuarit e anketuar u shprehën se vrasjen e kishin kryer pikërisht si pasojë e konflikteve apo grindjeve të çastit dhe nuk e kishin planifikuar më parë.

- Në këtë pikë, nisur edhe nga bisedat me të dënuarit e anketuar përgjatë plotësimin të pyetësorit, të dënuarit kishin pasur probleme të mëparshme me anëtarë të caktuar të familjes, që mund të lidhen me hatërmbejtje, zbulim ose dyshime për tradhti, ushtrim të dhunës fizikë apo psikologjike, debate, zënka, etj., të cilat ishin akumuluar dhe kishin nxitur rritjen e tensionit të çastit për të çuar drejt vrasjes.

- Rastet kur vrasjet kishin ndodhur vetëm nga konflikti i çastit, i palidhur me një histori të mëparshme, qenë të rralla.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

- Nga informacionet me të dënuarit e anketuar, vrasjet e djalit ndaj babait ose vrasjet e babait kundrejt vajzës janë në përqindje të konsiderueshme dhe përkojnë me mendimin e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, se dobësimi i kontrollit të prindërve apo rënia e figurës autoritare të babait në familje ndikon disi në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Sipas mendimit të së tre grup-shënjestrave të anketuara, vuajtja nga sëmundje të tjera të rënda shëndetësore nuk ndikon në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ashtu siç ndikon mjaftueshëm në prirjen për vetëvrasje.

- Shumica e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar mendojnë që depresioni, çrregullimet apo sëmundjet mendore të autorëve apo të viktimave, ndikojnë shumë në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa shumica e të dënuarve të anketuar u shprehën se as ata, as viktimat, nuk vuanin nga depresioni para se të kryhej vrasja, por ndërkohë nuk ishin vizituar ndonjëherë në ndonjë profesionist të shëndetit mendor apo nuk kishin marrë ndonjëherë kura apo trajtime në lidhje me këto shqetësime.

- Sipas mendimit të shumicës së punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, zemërimi dhe tensioni i brendshëm i autorëve apo viktimave, ndikon disi në kryerjen e vrasjes, ndërsa të dënuarit e anketuar, u shprehën se edhe ata, edhe viktimat, ndiheshin të zemëruar e të tensionuar para ngjarjes dhe kjo ka ndikuar në nxitjen e vrasjes.

- Sipas mendimit të së tre grup-shënjestrave të anketuara, luhatjet e humorit të viktimës dhe të autorit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, kanë ndikuar deri diku në nxitjen e vrasjes.

- Sipas mendimit të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, ndjesi si frika, pasiguria, mungesa e besimit në vetvete apo nevoja për të nënshtruar ndikojnë deri diku si tek autori për të kryer vrasje, si dhe tek viktimat për të manifestuar veprime që për autorin kanë shërbyer si shkak i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Sipas mendimit të shumicës së punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, zbrazëtia dhe problemet emocionale të autorit apo viktimës, ndikojnë deri diku në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa të dënuarit e anketuar u shprehën se kishin pasur shqetësime emocionale, luhatje humori, por nuk kishin ndjerë irritim apo agresivitet, ndërsa viktimat sipas tyre ishte më emocionale, më të dhunshme e më agresive.

- Sipas mendimit të shumicës së punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, viktimat me veprimet e manifestuar prej tyre, shërbejnë deri diku si shkak për autorin për kryerjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar e cilësojnë viktimën si të dhunshme e agresive dhe e fajësojnë për krimin e ndodhur, për shkak të fyerjeve e ofendimeve të rënda ose për tradhti.

- Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, mendojnë se ka disi prirje për të ndodhur vetëvrasje pas vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare ndërsa pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar, u shprehën se nuk kishin menduar vetëvrasjen pas ngjarjes së ndodhur.

- Sipas pjesës më të madhe të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, format më të përhapura të dhunës në familje në Shqipëri janë dhuna fizike dhe dhuna psikologjike ndërsa pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar u shprehën se janë përballur deri diku me abuzim fizik e seksual, me ofendime dhe me presione kryesisht nga viktimat kundrejt tyre.

- Të dënuarit e anketuar treguan se në konfliktet apo problematikat e mëparshme

familjare, ose nuk kishin kërkuar ndihmë, ose kishin kërkuar ndihmë kryesisht te familjarët e miqtë dhe, kishin prirje për të bërë të njëjtën gjë; ndërsa një pjesë tjetër shprehej se, në një të ardhme, do i drejtohej policisë për zgjidhje të këtyre problematikave e konflikteve.

- Të dënuarit e anketuar, priren t'u drejtohen familjarëve e miqve e më pas policisë, për të zgjidhur mosmarrëveshjet apo konfliktet në familje, ndërsa pjesa më e madhe e popullatës së anketuar apo 64.5% e tyre u shprehën se kanë besim të Policia e Shtetit për të zgjidhur problemet apo konfliktet në familje.

5. Disa përfundime nga analiza krahasuese e treguesve objektivë dhe subjektivë

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore që i përkasin treguesve objektivë dhe subjektivë konkludojmë se:

Për periudhën analizuese, sidomos pas vitit 2013, ka një tendencë të theksuar në rënie të numrit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe një rritje të evidentimit të rasteve të tjera të dhunës në familje. Tendencat e mësipërme mund të shpjegohen, ndërmjet të tjerave, si më rritjen e ndërjegjësimit për denoncimin e rasteve të dhunë në familje ashtu dhe me efektin e ndryshimeve në Kodin Penal, të bëra në vitin 2013, ku familjes, pas pothuajse 70 vitesh, i rikthehet mbrojtja e posaçme nga vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare, duke i kualifikuar ato si vrasje të cilësuar që lidhet me objektin e veprës penale, shoqëruar kjo dhe me sanksione shumë më të ashpra.

Gjithashtu, në shumë gjetje e indikatorë të studimit ka një afërsi e përputhje mes treguesve objektivë dhe subjektivë. Ndërsa perceptimi se në vitet e fundit ka rritje të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare (fakt ky që nuk përputhet me treguesit objektivë, statistikata reale) shpjegohet me ndikimin e dimensionit psikologjik të sigurisë dhe me rritjen progresive të kërkesës së komunitetit për të. Siguria në këtë aspekt është dhe shpresë për të ruajtur dhe përmirësuar aftësinë ose zotësinë për të gëzuar e shijuar rezultatet e vlerave më të shtrenjta, për të qenë i lirë nga çdo pengesë apo kërcënim, për një jetë sa më të sigurt e pa kërcënime edhe të dhunës e vrasjeve në familje. Siguria e jetës edhe kur ajo kërcënohet nga pjesëtarë të familjes, është një vlerë e fituar të cilën shoqëria shqiptare kërkon jo vetëm ta mbrojë atë që ka arritur, por edhe ta përmirësojë atë në mënyrë progresive. Për këtë është e nevojshme përmirësimi i informimit të komunitetit për punën që bëhet për parandalimin dhe reduktimin e krimit në përgjithësi dhe në këtë kuadër edhe të dhunës ekstreme e të vrasjeve në familje. Kjo do të ndikojë në rritjen e shkallës së objektiviteti në perceptimin e nivelit të sigurisë dhe të krimeve në familje dhe në rritjen e nivelit të kënaqësisë së publikut për punën e Policisë së Shtetit.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

6. Rekomandime

Në përfundim, në përputhje me qëllimin e realizimit të këtij studimi, për trajtimin, parandalimin dhe reduktimin e dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, si dhe zanafillës së tyre, dhunës e konflikteve, ndërjegjësimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj tyre si një problem shqetësues dhe i vazhdueshëm, pavarësisht shifrave aktuale në rënie të vrasjeve për shkak të

marrëdhënieve familjare si dhe në shërbim të një policimi më efektiv në raport me këtë dukuri, *jepen* rekomandime të përgjithshme për hartimin e politikave si më poshtë:

- Hartimi dhe zhvillimi i politikave të studiuara afatgjata, për sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj fenomenit të konflikteve në familje, dhunës ekstreme dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për dhënien e informacionit të duhur mbi faktorët që ndikojnë dhe i kthejnë konfliktet në familje deri në vrasje si dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e tyre, etj.

- Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i politikave të studiuara afatgjata për fuqizimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj institucionalë gjithëpërfshirës dhe efikase, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunim të përgjegjshëm ndërinstucional, mes palëve të pjesëmarrëse, Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit), Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në nivel qendror e vendor, të institucioneve të tjera që do të përfshihen në këtë proces si dhe të organizatave të shoqërisë civile, nën drejtimin e një organizmi koordinues kombëtar, me synimin koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- *Në zbatim të këtyre politikave të hartohet një Strategji Kombëtare* për trajtimin me prioritet, ndërgjegjësimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, garantimin e drejtësisë, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave/mbijetuarve të kësaj dukurie, për të ndërtuar një shoqëri që iu garanton shtetasve të saj një jetë sa më të sigurt e pa kërcënime të dhunës ekstreme në familje si dhe të Planit Veprimi në zbatim të saj.

6.1 Prognoza për të ardhmen

Përfundimet dhe gjetjet e punimit na ndihmojnë në përcaktimin edhe të një prognoze të përafërt për këtë fenomen sipas së cilës dukuria e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në vendin tonë do të vazhdojë të ketë shifra të ulëta në raport me dhunën e konfliktet, por në linja të vazhdueshme, sidomos në raportet në çift. Kjo për shkak të problemeve të mëdha social-ekonomike, vetëgjyqësisë dhe mangësive në menaxhimin e situatave stresuese e konfliktuale që lidhet me nivelin e ulët ekonomik, kulturor e arsimor. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së rekomanduar për koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare do mundësojë që, të paktën për një periudhë afatmesme 5vjeçare, shoqëria shqiptare të ndërgjegjësohet më tepër e të ballafaqohet më seriozisht me pasojat e kësaj dukurie. Ky do të jetë fillimi i një investimi serioz për parandalimin e kësaj dukurie në të ardhmen, me ndikime në sigurinë publike.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Referenca

1. AQSH. Fondi "Gjykata e Lartë". Dosje Nr. 13. Titulli dosjes: "Informacion i bërë nga Gjykata e Lartë mbi krimin e vrasjes, dërguar Komitetit Qendror të PPSH". Dokumenti Nr. Prot. 27; datë 21.3.1964 "Gjeneralisim mbi krimin e vrasjeve në Qarkun e Tiranës".
2. AQSH. Arkivi Qendror PPSH. Fondi Nr. 14. Lista Nr. 16. Dosje Nr. 477. "Përgjithësim i praktikës gjyqësore të vrasjeve me dashje".
3. AQSH. Fondi "Gjykata e Lartë". Dosje Nr. 54. Titulli dosjes: Raport i Gjykatës së Lartë "Mbi kriminalitetin" dërguar shokëve Hysni Kapo, Haki Toska dhe Presidiumit të Kuvendit Popullor". Dokumenti Nr. Prot. 54; datë 22.3.1969 "Raport mbi kriminalitetin gjatë vitit 1968, i parë nëpërmjet gjykimit të çështjeve". Faqe 15.
4. Ismet Elezi: E drejta zakonore e Labërisë. Botime Toena. Tiranë 2002.
5. Ismet Elezi: Krimet kundër jetës. Kombinati Poligrafik. Shtypshkronja "8 Nëntori". Tiranë 1989.
6. Margaret Hasluck: Kanuni shqiptar. Cambridge: Universiti Press, 1954. Botuar në Shqip nga Lisitan. Tiranë 2005.
7. Kanuni i Skënderbegut. Mbledhë dhe kodifikuar nga Dom Frano Ilia. Editrice La Rosa. Faqe 188. Milot 1993.
8. Kanuni i Lekë Dukagjinit.
9. Kanuni i Zhurisë (Jurisë), botuar në Përlindja e Shqipërisë, Vlorë 1913, ribotuar në Jeta Juridike, N.1, Tiranë, 2007.
10. Kodi Penal i Perandorisë Osmane, i miratuar në vitin 1878.
11. Kodi i Procedurës Penale të Perandorisë Osmane, i miratuar në vitin 1878.
12. Statuti themeltar i Republikës së Shqipërisë u miratuar më 7 mars 1925.
13. Kodi Penal Shqiptar u dekretua me 3 qershorit 1927 dhe hyri në fuqi më 1 Janar 1928. Fletorja zyrtare Nr. I, datë 1 janar 1928.
14. Dekreti Nr. 392 datë 24.01.1947 i Presidiumit të Kuvendit Popullor.
15. Kodi Penal i RP Shqipërisë. 1952.
16. Të dhënat statistikore janë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
17. Të dhënat statistikore janë përpunuar nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë në Tetor 2017.
18. Të dhëna nga anketimi i zhvilluar nga Qendra e kërkimeve Shkencore në IEPV-të Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë Krujë, Lushnjë, Fier dhe Peqin, në muajt Qershor- Korrik 2017.
19. Të dhëna nga anketimi i zhvilluar nga Qendra e kërkimeve Shkencore me punonjësit e policisë të cilët vazhdojnë Fakultetin e Sigurisë dhe të Hetimit në Akademinë e Sigurisë, Tiranë, në muajin Qershor 2017.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Dhuna në familje - vështrim i situatës ligjore në Shqipëri



■ **MSc. Arjan Muça**
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë
arjan.mucaj@yahoo.com;

Abstrakt

Në vitet e fundit Shqipëria ka ndërmarrë masa për përmirësimin e legjislacionit në lidhje me mbrojtjen ndaj dhunës në familje dhe veçanti në mbrojtjen e grave dhe të fëmijëve. Shqipëria ka ratifikuar pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare që mbrojnë gratë dhe fëmijët nga çfarë do lloj dhune. Si pjesë e këtyre masave në mars të vitit 2012, në Kodin Penal është shtuar vepra penale specifike "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a. Deri në këtë kohë "Dhuna në familje" trajtohej me vepra penale të përgjithshme. Në këtë studim bëhet një analizë statistikore e mbledhur në 6 vitet e fundit me tregues të Prokurorisë së Përgjithshme. Në vitet 2012-2014 vërehet një rritje e madhe e numrit të regjistrimit të veprës penale të "Dhuna në familje" ndërsa pas vitit 2014 vërehet një stabilizim i kësaj vepre penale. Vështirësia ekonomike dhe financiare, frekuentimi i lojërave të fatit, përdorimi i alkoolit janë shkaqet kryesore të cilat çojnë në përdorimin e dhunës në familje.

Fjalëkyçe:

dhuna në familje, situata ligjore, të drejtat e njeriut, diskriminimi i gruas.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

1. Hyrje

Në luftën kundër dhunës ndaj grave, Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë disa masa ligjore për mbrojtjen e tyre duke ratifikuar pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare në drejtim të mbrojtjes së familjes dhe në veçanti të grave.¹

Ligje të posaçme janë miratuar në këtë drejtim.² Kodi Penal i vitit 1995 nuk parashikonte në mënyrë specifike ndonjë veprë penale që lidhej me dhunën në familje, por neni 50 cilësonte si rrethanë rënduese nëse veprat penale kryheshin kundër fëmijëve ose për shkak të marrëdhënieve familjare. Para ndryshimeve të Kodit Penal në vitin 2012, veprat penale të cilat lidheshin me dhunën në familje cilësoheshin në mënyrë të përgjithshme nga dhe ndaj çdo subjekti. Veprat më të zakonshme që lidheshin me dhunën në familje ishin plagosja e lehtë dhe e rëndë, kanosja, dëmtime të tjera me dashje, vrasje. Vepra penale specifike “dhuna në familje” u përcaktua dhe u përfshi për herë të parë në ndryshimet e Kodit penal të vitit 2012.³ Kjo veprë penale i parashikonte

¹ Konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991. Konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat civile dhe politike”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991. Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAË), ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 dhe ka hyrë në fuqi, më 11 maj 1994. Me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, Republika e Shqipëria ka ratifikuar edhe Protokollin Shtesë të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ratifikuar nga Shqipëria më 2 tetor 1996.

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese 1989; ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1997. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 104/2012.

² Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

³ Neni 130/a i Kodit Penal i shtuar me ligjin 23/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”. Ky nen është përfshirë në kreun “Vepra penale kundër personit”, seksionin IX “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” u shtua “vepra penale”.

pjesëtarët e familjes specifikisht si viktimë të një sërë veprimesh të dënueshme. Kjo vepër penale është ndryshuar vetëm një herë me Ligjin 144/2013, datë 2.5.2013.⁴

Veprimet e parashikuara në nenin 130/a janë të dënueshme edhe në vepra të tjera penale kur subjektet nuk janë pjesëtarë të familjes. Veprën penale “Dhuna në familje”, ligjvënësi e ka konsideruar me rrezikshmëri të lartë, duke parashikuar një dënim pothuajse dy herë më të lartë se të njëjtat vepra penale që nuk kryhen ndaj ose nga pjesëtarë të familjes. Për të garantuar mirërritjen e fëmijëve, në paragrafin 4 të nenit është parashikuar e njëjta rrezikshmëri e lartë nëse veprimet e dënueshme të nenit 130/a kryhen në prani të fëmijëve duke e barazuar rrezikshmërinë me përsëritjen e kësaj vepre penale. Ky nen ka parashikuar si veprime të dënueshme rrahjen, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë dhe plagosjen e kryer me dashje. Kodi Penal parashikon një mbrojtje të veçantë të subjekteve të posaçëm bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt.

Një përcaktim i saktë të subjekteve të posaçme të mbrojtura nga neni 130/a i Kodit Penal, gjendet në nenin 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përcakton se pjesëtarë të familjes janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;

b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;

c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;

ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;

d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;

dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

Në lidhje me përcaktimin e familjes, përkufizimi më i pranuar është ai që përcakton neni 16 i *Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut* të OKB-së se: “familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti”. Kjo deklaratë dhe konventat ndërkombëtare që janë aprovuar në vitet në vijim kanë krijuar një mbrojtje specifike për familjen. Në përgjithësi, regjistrimi i veprave penale të dhunës në familje bëhet me kallëzim nga viktimja. Momenti i marrjes së kallëzimit nga policia gjyqësore është një nga momentet kryesore për vazhdimin e hetimeve. Komunikimi me viktimën, që në shumicën e rasteve është grua, është moment i vështirë. Zakonisht viktimja është e tronditur gjatë kallëzimit, jo vetëm nga dhuna e përzjetuar, por edhe për faktin se po ndërmerret një veprim që cenon penalisht një nga pjesëtarët e familjes së saj. Për këtë arsye, është e nevojshme që oficeri i policisë gjyqësore të jetë specializuar për të komunikuar në të tilla rrethana, pasi ai duhet të jetë

⁴ Neni 130/ a Dhuna në Familje.

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

në gjendje të arrijë të sqarojë maksimalisht faktin kriminal. Ky moment është i rëndësishëm, pasi shpesh ndodh që pas pak kohe viktimat, veçanërisht kur janë gra, mendojnë të tërheqin kallëzimin. Nisur nga ky fakt i fundit, dhuna në familje është përfshirë me të drejtë në grupin e veprave që nuk ndiqen me ankim nga viktimat, duke mos lënë mundësi të tërhiqet ankimi nga viktimat.


Në momentin e parë të komunikimit me policinë gjyqësore, viktimat ka shpesh shenja dhune dhe është me rëndësi të madhe, që ajo të dërgohet menjëherë për ekspertim mjekoligjor për të vlerësuar shkallën e dëmtimeve dhe mjetet me të cilat është shkaktuar dhuna. Ekspertimi mjekoligjor, si mjeti i duhur procedural për të përcaktuar shkallën e dëmtimeve tek viktimat, është i domosdoshëm për të përcaktuar saktësisht nën cilin paragraf të nenit 130/a do të ndiqet vepra.

Në fakt, kallëzimi dhe ekspertimi mjekoligjor janë përgjithësisht dy provat kryesore dhe në shumë raste të vetmet prova në hetimin e veprës penale “dhuna në familje”. Gjykata e Lartë këto dy prova i ka konsideruar të mjaftueshme për dënimin e autorit të veprës penale.⁵

Në raste të veçanta mund të ketë edhe dëshmitarë të tjerë, por që edhe këta janë pjesëtarë të familjes, pasi dhuna në familje ndodh në përgjithësi në banesën e viktimës.

2. Prevalenca dhe karakteristikat e rasteve të dhunës në familje

Duke qenë se “dhuna në familje” u parashikua në mënyrë specifike në Kodin Penal në vitin 2012, edhe të dhënat statistikore rreth kësaj vepre mbulojnë vetëm periudhën 6 vjeçare që nga ky vit. Të dhënat tregojnë se, në përgjithësi, ka pasur një rritje të përvitshme të regjistrimit të kësaj vepre penale. Duke qenë se për vitin 2012 statistikën kanë filluar të mbahen pas hyrjes në fuqi të ligjit nga muaji prill, të dhënat vjetore të këtij viti janë të paplota. Gjithsesi, në periudhën prill-dhjetor 2012 u regjistruan 328 vepra penale. Viti 2013 është viti i parë me statistika të plota vjetore dhe në këtë vit ka pasur 826 vepra të regjistruara. Nga viti 2012 deri në vitin 2014 ka pasur rritje të ndjeshme vjetore të veprave të regjistruara, më rreth 50 për qind në vitin 2014. Ndërsa gjatë tre viteve të fundit ka një stabilizim të numrit të veprave të dhunës në familje të regjistruar që varion afërsisht nga 1200-1355. Me shumë gjasa, rritja e madhe në dy vitet e para, më shumë se sa ndryshimet në rastet e dhunës në familje të ndodhura, reflekton rritjen e vetëdijesimit si nga viktimat ashtu edhe nga organet e policisë gjyqësore dhe prokurorisë për këtë veprë penale. Në total nga viti 2012 në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore janë regjistruar 6240 procedime për veprën penale të “Dhuna në familje” që zënë 3.4% të së gjithë veprave penale të regjistruara.




⁵ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 131, datë 01.11.2017.

Qëndrueshmëria apo edhe ulja e lehtë e rasteve të dhunës në familje, të kallëzuara dhe regjistruara, mund të ketë ardhur nga një sërë faktorësh, por më i rëndësishmi është ndërgjegjësimi i individëve se dhuna në familje nuk është çështje brenda familjes, por çështje penale që ka pasoja për dhunuesin, çfarë shërben si frenues ndaj ngasjes së zgjidhjes pakënaqësive apo konflikteve në familje përmes dhunës.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është mundësia e grave për të siguruar nëpërmjet organeve të policisë për urdhër mbrojtje në gjykatë. Kjo kërkesë e cila konsiston në marrjen e masave të menjëhershme mbrojtëse ndaj grave, ka sjellë si pasojë frenimin e veprimeve të autorit të dhunës në familje, i cili me anë të vendimit të gjykatës paralajmërohet për pasojat ligjore që do të ketë në rast të vazhdimit të veprimeve të dhunës në familje si dhe të moszbatimit të masave mbrojtëse të marra nga gjykata. Në vendimarrjen e gjykatave urdhërohet që shkaktari i dhunës psikologjike ose i konflikteve në familje, përveç të tjerave, të qëndrojë larg viktimës. Fatkeqësisht, në shumë raste kushtet ekonomike dhe familjare jo të mira, bëjnë që edhe pas urdhrit të mbrojtjes viktimat dhe autorit të qëndrojnë në të njëjtin vend dhe të vazhdojnë të jetojnë bashkërisht. Në rastet e studiuar në qarkun Gjirokastrë, megjithëse në numër të vogël, ka rezultuar se pas urdhrit të mbrojtjes ka pasur dhunë në familje.


Kërkesa për urdhër mbrojtje viti 2012-2016



Grafiku i mëposhtëm paraqit përqindjen e veprave specifike nën ombrellën e veprës penale “Dhuna në familje”: 67 për qind e të gjitha rasteve janë rrahje dhe çdo veprim tjetër dhune (sipas përcaktimit të nenit 130/a/1 të Kodit Penal); 5 për qind e veprave, kanë qenë kanosje (Neni 130/a/2); 7 për qind plagosje të lehta (neni 130/a/3) dhe 21 për qind e totalit të veprës penale kanë qenë “dhunë në familje në prani të fëmijëve” (neni 130/a/4) - paragrafi i katërt i nenit 130/a ka ndryshuar me ligjin 144/2013, duke shtuar si rrethanë specifike dhunën në familje në prani të fëmijëve, e cilësuar si rrethanë rënduese për shkak të pasojave që ekspozimi ndaj dhunës ka në psikologjinë dhe mirëritjen e fëmijëve.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

**NDARJA SIPAS PARAGRAFËVE TË NENIT 130/a
2012-2017**




Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »


Numrin më të lartë në total, për 6 vjet, e zë rrethi gjyqësor Tiranë me 1957 raste të regjistruara që përbëjnë 31 për qind të së gjitha veprave të tilla në të gjithë vendin. Rrethi gjyqësor me numrin më të vogël të veprave penale të regjistruara është rrethi gjyqësor Tropojë me 25 procedime në 6 vjet dhe më pas Përmeti me 37 procedime.

VEPRA PENALE "DHUNA NË FAMILJE" SIPAS RRETHEVE GJYQËSORE 2012-2017



Për veprën penale “dhunë në familje” janë marrë si të pandehur në total 5637 persona, nga të cilët 5336 ose 94.7 për qind kanë qenë meshkuj dhe 301 ose 5.5 për qind kanë qenë femra. Për sa i përket vendbanimit ka një ndarje thuajse të barabartë mes atyre që vinë nga zona urbane (51 për qind) dhe atyre nga zona rurale (49 për qind). Duke qenë se popullsia që jeton në zonat rurale është më e vogël se ajo që jeton në zonat urbane, statistikat tregojnë një shpeshësi më të lartë për numër banorësh mes popullsisë rurale.


Të pandehur për veprën penale "Dhuna në familje" 2012-2017



3. Situata e veprës penale “Dhuna në familje” në rrethin gjyqësor Gjirokastrë


Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila mbulon si territor rrethet Gjirokastrë dhe Tepelenë, janë regjistruar në total 87 procedime gjatë 6 viteve të fundit.

Dhuna në familje Gjirokastër 2012-2017



Numri i rasteve të dhunës në familje, të regjistruara për 10 mijë banorë, në Qarkun e Gjirokastrës, statistika për 10 000 banorë është më e madhe se mesatarja për 10 000 banorë në totalin e Shqipërisë.

Treguesi i veprës penale "Dhuna në familje" për 10 000 banor



AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Nga studime i rasteve të këtij rrethi gjyqësor, rezultojnë se shkaqet kryesore, në përgjithësi, të dhunës në familje janë:

- Situata ekonomike dhe financiare në familje.⁶ Një rast tipik i dhunës për arsye ekonomike është procedimi penal 838/2015 i cili zbuloi si debatet për shkak të gjendjes së keqe ekonomike çuan në grindje të ashpra dhe pastaj në përdorimin të dhunës.

- Abuzimi me alkoolin dhe me lojërat e fatit të burrave në familje⁷. Një rast tipik është ai i procedimit penal 59/2017. Autori i veprës ishte përdorues i alkoolit, si pasojë e së cilës ai ushtronte dhunë të përsëritur ndaj bashkëshortes. Nga ana e bashkëshortes

⁶ Procedimi penal nr. 838/2015 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

⁷ Procedimi penal nr. 59/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

ishite kërkuar urdhër mbrojtje. Por kjo gjë nuk e pengoi autorin që të ushtronte sërish dhunë ndaj bashkëshortes, çfarë çoi në procedimin penal.

- Në rastet e studiuara të dhunës në familje janë edhe probleme pronësie. Në këto raste viktimat nuk janë vetëm femra, por dhuna ndodh edhe nga fëmijët ndaj prindërve ose ndaj vëllezërve ose motrave.⁸ Nga hetimi i procedimit i procedimit penal 462/2015 ka rezultuar dhunë në familje e përsëritur e cila kishte ardhur si pasojë e bashkëjetesës në të njëjtin vend, por pa u zgjidhur problemet ligjore me pronësinë.

- Faktor tjetër është edhe xhelozia, por ky faktor në përgjithësi është i shoqëruar me mospërshtatjen kulturore të anëtarëve të familjes.⁹

4. Rekomandime

Mbrojtja ligjore që i bëhet familjes në përgjithësi dhe, grave e fëmijëve në veçanti, është e kënaqshme dhe në përputhje me standardet evropiane. Qeveria duhet të marrë masa për fuqizimin e qendrave shtetërore ose joshtetërore, të cilat ofrojnë shërbime psikosociale, por në veçanti në ofrimin e kushteve për rehabilitim të viktimave të dhunës. Nga ana e qeverisë në bashkëpunim me këto organizata të shihet me përparësi punësimi i viktimave të dhunës në familje për të mundësuar atyre një “pavarësi” ekonomike. Ndërgjegjësimi i viktimave të dhunës në familje për të mos e konsideruar dhunën ndaj tyre vetëm një çështje familjare, por si një problem i shoqërisë dhe i dënueshëm penalisht.

Referenca

1. Konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.
2. Konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat civile dhe politike”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.
3. Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAW), ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe ka hyrë në fuqi, më 11 maj 1994.
4. Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003, ratifikimi i Republikës së Shqipërisë për Protokollin Shtesë të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.
5. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ratifikuar nga Shqipëria më 2 tetor 1996.
6. Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese 1989; ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1997.
7. Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 104/2012.
8. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.
9. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 131, datë 01.11.2017.
10. Procedimi penal nr. 838/2015 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
11. Procedimi penal nr. 59/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
12. Procedimi penal nr. 462/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
13. Procedimi penal nr. 311/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

⁸ Procedimi penal nr. 462/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

⁹ Procedimi penal nr. 311/2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

PËRMBLEDHJE

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Aspektet juridiko-penale të vrasjeve në familje, metodika e hetimit dhe mjetet e kërkimit të provave



■ **Dr. (proc.) Besnik MUÇI**
Prokuroria e Krimeve të Rënda
e-mail: besnik_muci@yahoo.com

Abstrakt

Vrasjet në familje janë një fenomen mjaft shqetësues për shoqërinë tonë. Kalimi nga një shoqëri relativisht konservatore në marrdhënie familjare, në një shoqëri të hapur dhe të lirë ku çdo pjesëtar i saj ka të drejta të barabarta, ka sjellë përplasje brenda saj. Po ashtu shkatërrimi, me forcë, plotësisht i marrëdhënieve të pronësisë gjatë regjimit komunist dhe situata ende pastabilizuar e pronësisë në vendin tonë, edhe brenda familjeve, sjell konflikte të vazhdueshme të cilat përfundojnë dhe në vrasje. Për këto arsye, përballja me këtë fenomen është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve të zbatimit të ligjit, që kanë për detyrë të identifikojnë, parandalojnë, hetojnë, procedojnë penalisht dhe dënojnë autorët e këtyre veprave penale. Për këtë, në radhë të parë është e nevojshme një analizë dhe kuptim sa më i mirë nga të gjykata, prokuroria dhe policia gjyqësore i elementëve juridiko-penalë të kësaj figure krimi. Analiza dhe kuptimi i të gjitha veçorive juridiko-penale të këtij krimi në objektin juridik dhe material të saj, anën objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, në subjektin dhe anën subjektive të saj. Në veçanti, objekti juridik dhe material si dhe subjekti i kësaj vepre penale të cilat njëkohësisht janë tiparet dalluese për kualifikimin juridik të saj. Si një krim me veçori mjaft specifike, i kryer shpesh brenda ambientit të ngushtë familjar, nga ana objektive jo shumë i shfaqur në mjedisin e jashtëm, mungesa shpesh e vullnetit të familjarëve për bashkëpunim me organet e ndjekjes penale, e vështirëson gjetjen dhe administrimin procedural të provave. Ndaj është e nevojshme aplikimi i metodave specifike të hetimit të cilat duhet t'i përshtaten këtij krimi. Në funksion të një metode specifike hetimi, duhet të jenë edhe mjete të përcaktuar qartë dhe efçente në gjetjen dhe marrjen e provave. Të gjitha provat klasike si, dëshmitë, ballafaqimi, njohjet, eksperimenti, ekspertimi, provat materiale dhe dokumentet, mund dhe duhet të shërbejnë në procesin e të provuarit të kësaj vepre penale. Por, kujdes shumë i veçantë i duhet kushtuar mjeteve të kërkimit të provës. Rëndësi të posaçme marrin këqyrjet, kontrollet dhe përgjimet. Në këtë punim bëhet një analizë juridiko-penale e kësaj vepre penale, e metodikës së hetimit, mjeteve të kërkimit të provave dhe mbi provat më tipike në këtë lloj procesi penal.

Fjalëkyçe:

Vrasjet në familje, objekti juridik dhe material i veprës penale, subjekti i veprës penale, metodika e hetimit, provat, mjetet e kërkimit të provave, këqyrje, përgjim.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Dhuna në familje dhe normat ligjore në Shqipëri



■ Av. Saimir Vishaj

Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
avokatetpenaliste@hotmail.com

Abstrakt

Në këtë punim do të paraqitet një tablo krahasuese e normave penale të ndërthurura në Kodin e Procedurës Penale në përfaqje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dhuna në familje është një element shqetësues me të cilin hasemi përditë. Si autorët, edhe viktimat kanë një rol aktiv porsa i përket kësaj vepre penale. Sa i përket legjislatorit, i cili ka marrë nisëm dhe nga normat evropiane, në vitin 2006 u miratua ligji për dhunën në familje. Problematikat në këtë fushë kanë boshllëqe dhe lënë vend për diskutim. Ashtu si dhe në normat e Kodit Penal nuk gjejnë një përfaqje adekuate të normale që lidhen me këtë fenomen. Shpesh herë ndodh një konflikt i brendshëm midis normave, ku qenia apo jo pjesë e një familjeje ndikon në masën shtrënguese, duke humbur funksionin riedukues i cili shprehet në Kushtetutë. I takon legjislatorit, operatorëve social, individëve, e jo vetëm, të marrin nisma e t'i drejtohen organeve kompetente për përditësimin e kësaj figure kriminale të parashikuar nga Kodi Penal. Një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe reduktimin e kësaj luan jo vetëm legjislatori, por edhe media në tërësinë e saj me forcën e zhvillimit.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

dhuna në familje, ligj, kushtetutë, norma juridike, vepër penale, shkelje ligjore.

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

1. Hyrje

Dhuna në familje shkatërron viktimat e saja. Mendoj se i duhet kushtuar një rëndësi mënyrës se si klasifikohet ajo. Kjo dhunë nuk duhet shfajësuar si një sjellje e keqe, sepse në realitet është një akt kriminal dhe tendencat prirën të tregojnë se dhuna përshkallëzohet në një dimension progresiv, çka e bën atë tepër shqetësuese. Kur flasim për dhunën në familje, kryesisht referojmë për formën më të përhapur të saj: *Dhuna ndaj grave*. Dhuna ndaj grave, ndonëse është shkelja më e përhapur e të drejtave të njeriut në botë, vazhdon të jetë më pak e vlerësuar. Dhuna është gjithashtu një problem i thellë shëndetësor që ka pasoja vdekjen dhe plagosjen, cenon mirëqenien e grave dhe shkatërron dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Tashmë dihet se dhuna në familje i kapërcen të gjitha kufijtë dhe është prezent në të gjitha kulturat.

Si rezultat i traditave të forta patriarkale, shoqëria shqiptare ka qenë historikisht e dominuar nga meshkujt. Grave u është diktuar prej kohësh që të pranojnë rolin e të nënshtruarave. Gjatë regjimit komunist u krijua një hendek i thellë midis teorisë për emancipimin e gruas dhe realitetit të saj përditshëm. Më 1991, pas përmbyesjes së regjimit komunist, Shqipëria kaloi një periudhë ndryshimesh të mëdha, shpesh herë dramatike sociale, politike dhe ekonomike që ka krijuar një ndikim të thellë në jetën e shqiptarëve. Barazia gjinore është për shoqërinë shqiptare një princip i ri, që nuk është përqafuar ende nga një përqindje e konsiderueshme e popullsisë.

2. Legjislatori shqiptar dhe instrumentet ligjore

Në vitin 2006, Parlamenti shqiptar kaloi ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006¹, i cili

¹ Ligji 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", datë 18.12.2006.

kishte si qëllim të parandalonte dhe të reduktonte dhunën në familje në të gjitha format e saja, nëpërmjet masave të përshtatshme ligjore dhe t'u garantonte mbrojtje nëpërmjet mjeteve ligjore anëtarëve të familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje. Ligji ka katër objektiva kryesore:

1. krijimin e një rrjeti të koordinuar autoritetesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;

2. orientimin e përpjekjeve për krijimin e strukturave dhe të autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për mbështetjen e viktimave dhe për parandalimin e dhunës në familje;

3. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje; dhe,

4. sigurimin/garantimin e shërbimeve të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta për viktimat e dhunës në familje të ofruara nga gjykatat dhe nga agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit, në përputhje me ligjin.

Ligji përkufizon si dhunë “*çdo veprim ose mosveprim të një personi ndaj një tjetri, që sjell si pasojë një cenim të integritetit fizik, moral psikologjik, seksual, social dhe ekonomik*”². Në vijim, si dhunë në familje përkufizohet “*çdo akt dhune i ushtruar ndërmjet personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare*”³. Sipas ligjit, te pjesëtarët e familjes përfshihen:

a. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesit ose ish-bashkëshorti/ja ose ish-partneri/ja bashkëjetues;

b. vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë.⁴

Ligji parashikon masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga gjykata (një vendim i lëshuar nga gjykata, i cili parashikon masat mbrojtëse për viktimën)⁵ dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (një urdhër i përkohshëm nga gjykata, i cili është i vlefshëm derisa ajo të lëshojë një urdhër mbrojtjeje)⁶. Kur kërkesa për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje paraqitet nga policia ose nga prokurori, edhe nëse viktimat (nën presion) dëshiron ta tërheqë padinë/paditë ose ta pushojë çështjen, kjo nuk do të ndikojë në vazhdimin e procesit gjyqësor⁷. Dhe meqë gruaja e dhunuar është dëshmitarja kryesore, ligji e përkufizon atë si: dëshmitare e detyruar për të dëshmuar⁸.

Moszbatimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje përbën veprë penale sipas nenit 320 të Kodit Penal⁹; për pasojë autori i saj mund të arrestohet pa mandat arresti. Në Shqipëri, megjithëse kompetencat e policisë për të hyrë në ambientet private janë përgjithësisht të kufizuara, ky ligj parashikon që policia mund të hyjë në një banesë private në kushtet e dhunës në familje nëse një gjë e tillë kërkohet nga një person, i cili në dukje banon në atë ambient ose nëse punonjësi i policisë ka arsye të besojë që një person në ambient është subjekt i një sulmi ose rrezikon të sulmohet.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

² Neni 1 i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006

³ Po aty.

⁴ Po aty

⁵ Neni 12, po aty.

⁶ Po aty paragrafi i-re.

⁷ Neni 16 paragrafi i trete po aty.

⁸ Neni 13 paragrafi I-re germa “a” po aty.

⁹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i përditësuar, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, janar 2016.

Është e rëndësishme të theksohet se ligji organizon gjashtë institucione qeveritare në një rrjet të koordinuar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, për lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Autoriteti drejtues sipas këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës sipas ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” janë lëshimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje që nuk i ndalon palët e interesuara të nisin gjithashtu një proces penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që klasifikohen si vepra penale.

2.1. Përcaktimi i figurës kriminale të dhunës në familje në Kodin Penal të RSH

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, ekzistojnë dispozita të tjera që mund të zbatohen për të trajtuar krimet lidhur me dhunën në familje; Këto vepra penale përfshijnë, por nuk kufizohen me figurën e dhunës në familje dhe më poshtë janë të pasqyruara disa nene të Kodit Penal të RSH që renditen si më poshtë:

- vrasja e kryer me dashje (dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet)¹⁰;
- vrasja me dashje që lidhet me një krim tjetër (vrasje me dashje që paraprin, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me jo më pak se 20 vjet burgim)¹¹;
- vrasja me paramendim (vrasja me paramendim dënohet me burgim nga 15 deri në 20 vjet; vrasja e kryer për interes, hakmarrje ose gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se 25 vjet ose me burgim të përjetshëm)¹²;
- vrasja me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës (e kryer ndaj një të mituri, ndaj një personi me aftësi të kufizuara fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; kundër një dëshmitari denoncues [të veprës penale], viktimës, palëve të tjera ndërgjyqëse; më shumë se një herë; kundër dy ose më shumë personave; në mënyrë të tillë që i shkakton vuajtje të veçanta viktimës, dënohet me jo më pak se 25 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm)¹³;
- kanosja (kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit)¹⁴;
- plagosja e rëndë me dashje (plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, shkaktimin e ndërprerjes së shtatzënisë ose që ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet; kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet)¹⁵;
- plagosja e lehtë me dashje (plagosja e lehtë me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet)¹⁶;
- dëmtime të tjera me dashje (rrahja), si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë; kur kjo vepër ka shkaktuar paaftësi të

¹⁰ Neni 76 i Kodit Penal të RSh.

¹¹ Neni 77, po aty.

¹² Neni 78, po aty.

¹³ Neni 79, po aty.

¹⁴ Neni 84, po aty.

¹⁵ Neni 88, po aty.

¹⁶ Neni 89, po aty.

përkohshme në punë deri në nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj)¹⁷;

- plagosja e rëndë nga pakujdesia (plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit)¹⁸;

- plagosja e lehtë nga pakujdesia (plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë)¹⁹;

- ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas (ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet)²⁰;

- marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet; kur marrëdhënia seksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë deri në 15 vjet; kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen apo vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet)²¹;

- marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale midis prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini, ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo birësimi, dënohet me burgim deri në shtatë vjet) [Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtje kombëtare me bazë popullatën]²²;

- braktisja e fëmijëve të mitur (braktisja e fëmijës nën moshën 16 vjeç nga prindi ose nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet; kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet)²³;

- mosdhënia e mjeteve për jetesë (mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit)²⁴;

Për sa më sipër, duket qartë për qasja që ka figura e dhunës në familje me këto vepra të parashikuara nga legjislatori penal. Si më lart janë pasqyruar format që ushtrohet dhuna në familjet në Shqipëri, elementët objektivë dhe subjektivë, si dhe janë dhënë përcaktimet nga minimalja në maksimale për masat ligjore shtrënguese për këtë veprimtari kriminale.

2.2 Kodi i Procedurës Penale të RSh dhe veprat penale që lidhen me dhunën në familje

Sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë²⁵, për

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

¹⁷ Neni 90, po aty.

¹⁸ Neni 91, po aty.

¹⁹ Neni 92, po aty.

²⁰ Neni 93, po aty.

²¹ Neni 102, po aty.

²² Neni 106, po aty.

²³ Neni 124, po aty.

²⁴ Neni 125, po aty.

²⁵ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, 2013.

veprat penale të parashikuara nga neni 89²⁶, neni 102²⁷ dhe 106²⁸ të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e palës së dëmtuar, e cila mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Me fjalë të tjera, çështja shqyrtohet vetëm nëse viktimja paraqet një ankim dhe zakonisht përgatitja e të gjithë çështjes është përgjegjësi e viktimës. Viktimja duhet të mbledhë prova dhe dëshmitarë dhe ta paraqesë çështjen në gjykatë. Shteti përgjithësisht nuk asiston në ndjekjen penale.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë²⁹ përmban gjithashtu një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj një bashkëshorti dhe fëmijës/fëmijëve. Kodi i Familjes trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve. Për shembull, neni 62 parashikon që “bashkëshorti abuzues mund të detyrohet të largohet nga banesa bashkëshortore”. Megjithatë, ky nen nuk ka dispozita të tjera procedurale. Gjithashtu, ligji “Për Shëndetin Riprodhues” përcakton që çdo grua duhet të vendosë me vullnetin e saj të lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, presioni ose dhune, për të gjitha çështjet në lidhje me seksualitetin e saj dhe me shëndetin e saj seksual dhe riprodhues.

3. A ekziston një konflikt ndërmjet normave ligjore?

Kjo dispozite bie ndesh me parimin kushtetues të parashikuar në nenin 18 të saj dhe konkretisht: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe së dyti, askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht, ndër të tjera edhe për shkak gjinie*”. Për veprat penale të rrahjes, kanosjes, plagosjes së lehtë apo të rëndë, dëmtime të tjera me dashje parashikohen nga nenet 84, 89, 90, ku këto vepra ndiqen mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit akuzues dhe ankimi mund të tërhiqet në çdo fazë të procedimit penal, për aq kohë sa vendimi s’ka marrë formë të prerë. Ndërsa për nenin 130/a të K.P., kjo çështje penale ndiqet kryesisht nga organi procedues, edhe pse e dëmtuara akuzuese heq dorë nga ndjekja penale ndaj subjektit, çështja penale ndaj subjektit vazhdon kryesisht nga ana e organit procedues. Pra, nuk mundet që një dispozitë brenda Kodit Penal Shqiptar të jetë edhe kundërvajtje penale, edhe krim!

Sipas nenit 130/a të K.P. *çdo rrahje e thjeshtë dënohet me burgim deri në 2 vjet në se është në gjini* me të dëmtuarin ndërsa për të njëjtin veprim të kryer nga persona jashtë familjes apo gjinisë aplikohet *neni 90 i K.P. që parashikon vetëm gjobë ose heqje lirie gjer në 6 muaj* dhe kjo vepër, ndiqet me ankim, drejtpërsëdrejti në gjykatë sipas nenit 59 të K.Pr.P.

Po kështu, kanosja serioze për të gjitha subjektet parashikohet si vepër penale nga neni 84 i K.P., është kundërvajtje penale me masë dënimi me gjobë ose burgim deri në një vit, ndërsa për subjekte që janë në gjini, aplikohet neni 130/a i K.P. që parashikon dënim deri në 3 vjet burgim. Edhe plagosja e lehtë me dashje për subjektet e përgjithshme ndiqet mbi ankimin e të dëmtuarit dhe parashikohet si kundërvajtje penale nga neni 89 i K.P. që parashikon gjobë ose dënim deri në 2 vjet, ndërkohë, e njëjta vepër po të kryhet nga persona në gjini, trajtohet sipas nenit 130/a, ku përveçse nuk kërkohet ankimi i të dëmtuarit, por parashikohet si krim me një masë dënimi deri në 5 vjet.

Për këto arsye mendoj se, në bazë të nenit 134 pika “d”, nenit 145 pika 2 të

²⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë “Marredhenie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”.

²⁹ Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, dhjetor 2014.

Kushtetutes te RSH³⁰ dhe nenit 68 të ligjit Nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” është e arsyeshme të kërkohet pezullim i gjykimeve në proces dhe dërgimin e tyre në Gjykatën Kushtetuese të RSH, në lidhje me shfuqizimin si antikushtetuese të nenit 130/a të KP ndryshuar me ligjin 144/2013 dhe 23/2012.

4. Përfundime

Referuar standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht, si dhe të jetë *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Po ashtu edhe për Këshillin e Evropës:

*“burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin te papërshtatshme për rëndësinë e veprës, duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë”.*³¹

Pas këtij prezantimi të shkurtër krahasues të veprave penale të cilat në brendësinë e tyre shprehin elementë të dhunës, qoftë në familje ose jo, duket qartë dëshira e legjislatorit për të frenuar këtë fenomen gjithnjë e në rritje shqetësues për shoqërinë shqiptare, ndërkohë që ndryshimet ligjore në vitin 2013 përqendrohen kryesisht tek ashpërsimi i burgimit.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

³⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, gusht 2016.

³¹ Rekomandimi R(2017)3 e Këshillit të Evropës.

Referenca

1. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i përditësuar*, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, janar 2016.
2. *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, 2013.
3. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar*, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, gusht 2016.
4. *Ligji 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, datë 18.12.2006.
5. *Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë*, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, dhjetor 2014.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Vështrim analitik mbi faktorët ndikues në kryerjen e krimit të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare



■ MSc. Bilbil DERVISHI
Qendra Kërkimore Shkencore
bilbil.dervishi@asp.gov.al

Abstrakt

Tek individi, në kryerjen ose mos, të një vepre penale, ekzistojnë faktorë të cilët nxisin apo e frenojnë atë në kryerjen e tyre. Këta faktorë, veç e veç, por edhe të mbledhur së bashku, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në kryerjen e krimeve kundër jetës dhe veçanërisht ato të vrasjes, të pasqyruara si nga doktrina, por edhe nga legjislatori, si forma më ekstreme e dhunës. Për krimin e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, i cili është qëllimi i këtij punimi, rrethanat e dhëna këtu, por edhe marrëdhëniet autor-viktimitë, janë me specifike, pasi si subjekti ashtu edhe objekti i këtij krimi, janë pjesë e të njëjtës familje, sipas përcaktimeve, jo vetëm të Kodit të Familjes, si një "familje biologjike me lidhje gjaku", por edhe të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar me ligjin nr. 10329, datë 30.9.2010, në të cilin janë të përfshirë edhe lidhjet e tjera familjare, si: krushqi e afërt, të birësuarit, kushëri, etj. Në këtë punim shkencor do të merren në shqyrtimin rastet e parashikuara në nenin 79/C të Kodit Penal "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare", si edhe ato të dhunës në familje në tërësi, duke u fokusuar e dhënë një rëndësi të veçante vlerësimit të faktorëve ndikues që çojnë në kryerjen e këtij krimi. Si, faktorë ndikues kryesorë, në kryerjen e këtij krimi, gjatë punimit janë evidentuar disa elementë, të cilët ndikojnë në mënyrë objektive dhe subjektive, sipas treguesve objektiv si: gjinia, lidhja familjare, statusi civil, arsimimi, profesioni dhe punësimi, si për autorët ashtu edhe për viktimat e tyre, edhe pse gjatë hulumtimit kanë buruar edhe elementë e faktorë të tjerë vlerësues e plotësues, si: vendi, koha, mjeti, zona, periudha dhe motivi i kryerjes së këtij krimi. Mbi bazën e treguesve statistikore të këtyre të dhënave, për periudhën studimore 2007-2016, që do të jetë objekti dhe synimi i këtij punimi do të përipiqemi të japim disa rekomandime në bazë të të dhënave statistikore të mbledhura, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e këtij fenomeni, i cili prek të gjitha shtresat sociale pa dallim, në hapësirë dhe në kohë.

Fjalëkyçe:

autor, viktimitë, familje, motiv, vrasje në familje, analizë statistikore.

1. Hyrje

Përpara se të marrim në studim çështjen e dhunës në familje në tërësi apo për dhunën ekstreme: *vrasjen për shkak të marrëdhënieve familjare*, le të themi dy fjalë për familjen (*familias*), si qeliza bazë e shoqërisë pa të cilën nuk mund të ekzistojë kjo e fundit. Një nga hallkat e para që lidh qenien njerëzore me shoqërinë, pasi aty lind e fillon jeta. Në familje gjejmë shprehjen e tyre më të plotë dashuria për tjetrin, fryma solidaritetit si dhe ndihma e ndërsjellët ndërmjet pjesëtareve të saj. Familja, institucioni i së cilës është i njohur prej romakëve të lashtë, përbën një nga format shoqërore, aktualisht më të emancipuara, e cila duke kënaqur interesat individuale të njeriut, i shërben njëherësh edhe shoqërisë. Pjesëtarët e saj lidhen ngushtë me njëri-tjetrin dhe krijojnë një qelizë të përbashkët, e cila nuk jeton e vetmuar dhe ndodhet midis shumë të tjerave, të cilat të gjitha së bashku formojnë *societas* (sipas romakëve të lashtë, “*Gens*”). Një bashkësi *gens-esh*, përbën atë që quhet *Res Publica* (diçka të përbashkët, nga më pas lind edhe termi *Republika*, pra e përkthyer letrare si “diçka e të tërëve së bashku”). Prandaj themi që familja është baza e shoqërisë, themeli i një shteti demokratik dhe të së drejtës. Problemet që lindin në familje nuk janë vetëm pjesë e rrethit të ngushtë të saj, por i përkasin të gjithë shoqërisë dhe sitë tilla, duhet të njihen, bëhen publike e studiohen në tërësinë e tyre. Prandaj marrëdhëniet familjare nuk mund të qëndrojnë të shkëputura nga marrëdhëniet dhe dukuritë e tjera shoqërore. Familja si dukuri shoqërore, ka pësuar ndryshime, në përshtatje me etapat e zhvillimit social-historik, duke filluar nga martesë në grupe (*consanguine* ose endogame), martesë në çifte, për të mbërritur tek familja e sotme monogame, pra martesë e një burri me një grua nëpërmjet kurorëzimit, por edhe kjo familje në vetvete, nga fundin e mijëvjeçarit të kaluar, në prag të erës së

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

globalizimit, ka pasur njëfarë evolucioni, duke futur si risi, bashkëjetesën apo martesat brenda të njëjtit seks.

Martesa tradicionale, e rregullt, ndërmjet burrit dhe gruas, është ajo që krijon dhe mban familjen të qëndrueshme, prandaj ajo gëzon një mbrojtje të veçantë nga shteti, kudo. Edhe në vendin tonë familja si institucion është e mbrojtur nga Karta Themeltare e Republikës, e cila në pjesën e dytë të saj tek “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, në kreun IV “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, përkatësisht në nenet 53¹ dhe 54² të saj si edhe në Kodin Familjes, në nenin 1 të së cilit përcaktohet: “*Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit*”.³ Por, fakti që familja gëzon të drejtën e mbrojtjes nga shteti, nuk do të thotë që në familje nuk ekzistojnë probleme që e cenojnë atë në tërësi, dhe që çojnë deri në marrjen e jetës së pjesëtarëve të saj, forma më ekstreme e dunës në familje, e cila do të jetë objekt studimor krahasues i këtij punimi shkencor.

Duke vlerësuar nevojën e një mbrojtje më të plotë të familjes në tërësi, por edhe për të përmbushur detyrimet kushtetuese e normat europiane së të drejtave të njeriut në përgjithësi e ato të familjes në veçanti, të cilat tashmë janë akte detyruese edhe për vendin tonë, legjislatori ynë, në fund të vitit 2009, miratoi ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili u ndryshua me ligjin nr. 10329, datë 30.9.2010, në të cilin janë përcaktuar norma dhe rregulla për mbrojtjen e familjes nga dhuna, si edhe janë përcaktuar subjektet që gëzojnë këtë mbrojtje, duke e zgjeruar rrethin e tyre, nga ajo tradicionale. Në këtë ligj, janë përcaktuar edhe detyrimet e institucioneve shtetërore përgjegjëse, ku një rol kryesor ka Policia e Shtetit.

Në vijim legjislatori, ka rishikuar edhe dispozitat penale për mbrojtjen e familjes dhe nëpërmjet ligjit nr. 144/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, që kanë hyrë në fuqi me 4 Qershor 2014, në të cilin janë shtuar ose ndryshuar disa dispozita të Kodit Penal, një nga të cilat është edhe neni 79/C “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, me përmbajtjen “Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”,⁴ e cila më parë ishte si rrethanë rënduese në nenin 79, pika “c” e KP, tashmë e shfuqizuar. Nga të dhënat e studimore të mbledhura nga ana e jonë dhe që janë pjesë këtij punimi shkencor konstatohet fakti, që me hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave ligjore, krimi vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, ka pasur rënie.

Për arritjen e objektivit kryesor, atë të parandalimit dhe reduktimit të dhunës në familje në tërësi dhe veçanërisht atë të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, duhen analizuar faktorët ndikues objektiv që çojnë në kryerjen e këtij krimi, si: gjinia, lidhja familjare, statusi civil, arsimimi, profesioni dhe punësimi, si për autorët ashtu edhe për viktimat, si edhe elementë e faktorë të tjerë vlerësues e plotësues, si: vendi, koha, mjeti, zona, periudha dhe motivi i kryerjes së këtij krimi.

¹Neni 53 i Kushtetutës së RSh: “Kushdo ka të drejtë martohet dhe të ketë familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.”

²Neni 54 i Kushtetutës së RSh: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.”

³Ligji nr. 9062, datë 08.5.2003 “Kodi i familjes”, ndryshuar me ligjin nr. 134/2015.


⁴Kodi Penal i RSh, i ndryshuar, neni 79/C.

2. Raporti gjinor autor-viktimë në vrasjen për shkak të marrëdhënieve familjare

Raporti gjinor autor-viktimë është treguesi kryesor për orientimin e punës në arritjen e objektivit për reduktimin dhe parandalimin e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare. Në periudhën studimore 2007-2016, sipas të dhënave statistikore kanë ndodhur gjithsej 376 vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, me një mesatare vjetore 37.6, nga të cilat: 194 vrasje, 162 vrasje të mbetura tentativë dhe 20 vrasje nga pakujdesia. Raporti i vrasje-tentativë vrasje është 1 : 0.84, ndërsa në % është 54.5% me 45.5%. Ndërsa autor janë 396 dhe viktimat 400⁵.

Sipas të dhënave statistikore rezultojnë se meshkujt janë autor në këtë krim në 357 raste ose në 90.15% të tyre, ndërsa femrat vetëm 39 raste ose 9.85% të tyre, me një diferencë prej 80% në favor të meshkujve.


Treguesit e raporteve gjinore për autorët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën 2007 – 2016



Raporti mesatar femra - meshkuj për autorët pothuajse është ruajtur në të gjitha vitet e periudhës studimore, por ka pasur edhe luhataje, si në vitet 2009 e 2015 ku autore femra ka pasur vetëm nga një rast ose 3% të tyre dhe në vitin 2013, ku numri i femrave autore ka arritur pikën kulmore me 9 raste ose 18.37% të tyre.

Ndryshe është raporti gjinorë tek viktimat e këtij krimi, nga 400 viktimat gjithsej, meshkujt janë në 228 raste ose në 57% të tyre, ndërsa femrat në 172 raste ose 43% të tyre. Diferenca e viktimave femër-mashkull është 14%, pra shumë herë më e vogël se tek autorët. Meshkujt janë më të shumtë në numër edhe në rastin e viktimave, por ka edhe numër të lartë të viktimave femra, ndryshe nga raporti gjinor mes autorëve

Treguesit e raporteve gjinore për viktimat e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën 2007 – 2016




⁵ Numri i autorëve dhe viktimave nuk është i njëjtë, por është më i madh se numri i ngjarjeve për shkak se ka pasur ngjarje me më shumë se një autor apo me më shumë se një viktimë.

Raporti femra-meshkuj për rastet e viktimave është ruajtur në të gjitha vitet e periudhës studimore, me përjashtim të viteve 2007 dhe 2016, ku numri i viktimave femra dhe meshkuj ka qenë i njëjtë (23 dhe 9), ndërsa në vitin 2010 numri i viktimave femra ka qenë më i lartë se i meshkujve (18 me 14).

3. Forma e familjes dhe statusi i pjesëtarëve të familjes në rastet e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare

a. Forma e familjes, pavarësisht se është jashtë përshkrimeve ligjore, është e rëndësishme në vlerësimin e rrethanave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe është analizuar me këto nënndarje: familja bazë (*burrë, grua, fëmijë*), familja e madhe (*përfshin gjyshin, gjyshen, xhaxhanë, hallën, etj.*), si dhe lidhjet e tjera familjare (*tezja, daja, kushërinjtë në vijë të drejtë, etj.*).

Treguesit e raporteve për vrasjet sipas kategorive të familjeve për periudhën 2007 – 2016



Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore të treguesve të vrasjeve sipas kategorive të familjes gjejmë se:


- Për kategorinë e familjes bazë janë evidentuar 242 raste, nga 376 të ndodhura gjithsej ose 64.36% e tyre, që është grupi me numrin më të madh.

- Për kategorinë e familjes së madhe janë evidentuar gjithsej 29 raste ose 7.71% e totalit. Ky grup ka numrin më të vogël të rasteve, mesatare vjetore të ulët (2.9) dhe një kurbë pothuajse të njëjtë në të gjithë periudhën në studim, me përjashtim të vitit 2012, që ka pasur 10 raste ose 1/3 e tyre.

- Për kategorinë e lidhjeve të tjera familjare janë evidentuar gjithsej 105 raste, ose 27.93% e tyre. Edhe në këtë grup, kurba është e njëjtë pothuajse në të gjithë periudhën studimore, me përjashtim të viti 2016 që është vetëm me një rast.

b. Statusi i pjesëtarit të familjes, referuar përcaktimeve ligjore, është i rëndësishëm për analizën dhe vlerësimin e rrethanave të kryerjes së këtyre vrasjeve, si ndërtimin e politikave për të ardhme, për uljen e parandalimin e tyre.

Treguesit e raporteve viktimë-autor të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën 2007 – 2016



Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore të treguesve, referuar statusit të pjesëtarit të familjes, në rolin e autorit apo viktimës, për periudhën studimore, gjejmë se:

- *Bashkëshortja*. Përbën numrin më të madh të viktimave me 114 raste dhe përqindjen më të lartë me 28.79% të tyre, në raport me pjesëtarët e tjerë të familjes, ndërsa si autore është në 20 raste ose 5.05% të tyre. Në këtë tregues janë përfshirë edhe ish-bashkëshortet, bashkëjetueset dhe ish-bashkëjetueset⁶.

- *Bashkëshorti*. Në të kundërt, rezulton se bashkëshorti përbën numrin më të madh të autorëve me 114 raste ose 28.79% të tyre dhe pothuajse numrin më të vogël të viktimave me 20 raste ose 5.05% të tyre.

- *Motra*. Është viktimë në 9 raste ose 2.27% të totalit, ku autorë mund të jenë vëllai ose motra. Por, sipas të dhënave rezulton se pjesa më e madhe vrasjeve janë kryer nga vëllezërit ndaj motrës dhe vetëm në një rast nga motra ndaj motrës.

- *Vëllai*. Në numër dhe në përqindje, si viktimë apo si autor, zë vendin e dytë pas bashkëshortit. Ai është viktimë në 42 raste ose në 10.61% e totalit, ku autorë janë kryesisht vëllezërit e tyre.

- *Vajza*. Është viktimë në 6 raste ose 1.52% të totalit, ku autor i vrasjes pothuajse në të gjitha rastet është babai, ndërsa rastet ku vajza është autore e vrasjes ndaj nënës apo babait, janë në një numër të papërfillshëm.

- *Djali*. Është viktimë në 25 raste ose 6.31% të totalit, ku autor janë prindërit (nëna ose babai), por nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e autorëve prindër ndaj fëmijëve (vajzës ose djalit) është babai.

- *Nëna*. Është viktimë në 15 raste ose 3.79% të totalit, ku autorët janë fëmijët (vajza ose djali) dhe është në një numër relativisht të vogël në raport me kategoritë e tjera të anëtarëve të familjes. Po kështu, edhe si autore e vrasjes ndaj fëmijëve, nëna është në një numër minimal.

- *Babai*. Është viktimë e fëmijëve (vajzës ose djalit) në një numër më të lartë se sa djali është viktimë e prindërve (babit), përkatësisht në 34 raste ose 8.59% të totalit, me një diferencë prej rreth 10%. Sipas të dhënave rezulton se edhe në këtë rast, djali është autor i pothuajse të gjitha rasteve të vrasjes së babait.

- *Të tjerët*. kategori në të cilën përfshihen të gjitha kategoritë që përmenden në ligj⁷, por që nuk janë përfshirë më lart dhe janë viktimë në 131 raste ose 33.8% të totalit. Për nga numri i viktimave dhe i autorëve, ky grup përbën numrin më të madh të tyre, me 131 raste ose 33.8% të së gjitha atyre.

4. Ndikimi i zonës së banimit dhe i territorit në vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare.


a. Krahas faktorëve të tjerë që nxisin apo frenojnë këtë krim edhe vendbanimi e vendndodhja gjeografike, ka ndikimin e vetë. Kjo e lidhur me mënyrën e jetesës, krijimin

⁶ Këto janë raste të pakta, që përfshihen në një raport tjetër të statistikës, tek pjesa statusi i viktimave apo autorëve me treguesin "të divorcuar", tregues që, në raport me numrin e përgjithshëm të autorëve dhe viktimave janë 1 : 012 për autorët dhe 1 : 0.10 për viktimat.

⁷ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", neni 3, pika 3. Pjesëtarët të familjes janë: gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i vëllezërve dhe motrave; gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit, fëmijët e bashkëshorteve apo partnereve bashkëjetues, si edhe disa lidhje familjare të tjera deri në kushëri nga nëna ose babai.

e familjes, kulturën e përgjithshme, funksionimin e organeve të qeverisjes vendore apo strukturave shtetërore në territor, etj.

Treguesit e raporteve për zonat (fshat – qytet) për periudhën 2007 – 2016, të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare




Nga analiza statistikore, lidhur me vendbanimin e autorëve dhe viktimave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për periudhën 2007-2016, gjejmë se:

- Në zonat rurale (fshat), janë evidentuar gjithsej 230 raste ose 61.17% e tyre, me 84 raste ose 22.34% më shumë se sa në zonat urbane
- Në zonat urbane (qytet), janë evidentuar gjithsej 146 raste ose 38.83% e totalit të tyre.
- Diferenca në përqindje mes zonave rurale dhe urbane është ruajtur me luhatje të vogla, pothuajse në vijimësi në gjatë gjithë periudhës studimore.
- Konstatohet një ulje numrit të këtij krimi në vitin e fundit të periudhës studimore (2016), me 2.8 herë në fshat dhe 2.57 herë në qytet, krahasuar me vitin 2007.


b. Lidhur me shtrirjen sipas ndarjes administrative territoriale (qarqeve) të raportit viktimë/autor për 100 mijë banorë⁸, për periudhën rezulton se janë evidentuar mesatarisht 13.91 viktima/100 mijë banorë në shkallë vendi. Nga këto 15.69 viktima meshkuj për 100 mijë banorë dhe 12.09 viktima femra/100 mijë banore. Numrin më të lartë të viktimave për 100 mijë banorë e ka qarku i Lezhës, me 32.55, ndërsa numrin më të vogël të këtyre treguesve e ka qarku i Gjirokastrës, me 9.1.

Treguesit sipas qarqeve të raporteve viktimë/ 100 mijë banorë



⁸Numri i popullsisë së banueshme në RSh, është marrë nga INSTAT, me të dhënat e datës 01.01.2017, që është edhe fundi i periudhës studimore. Sipas këtyre të dhënave numri i përgjithshëm i popullsisë banuese në RSh në këtë datë ishte 2 876 591 banorë (1 453 541 meshkuj dhe 1 423 050 femra).
<http://pxweb.instat.gov.al:8080/index.php/survey/index/sid/727424/newtest/Y/lang/sq>.

Treguesit e raporteve viktimë/100 mijë banorë femra e meshkuj sipas qarqeve për periudhën 2007 – 2016



Nga analiza statistikore, lidhur ndarjes administrative territoriale (qarqeve) të raportit viktimë/100 mijë banorë, gjejmë se për periudhën:

- Mesatarisht 13.91 viktimë/100 mijë banorë në shkallë vendi, 15.69 viktimë meshkuj/100 mijë banorë dhe 12.09 viktimë femra/100 mijë banorë.

- Qarku i Lezhës rezulton me numrin më të lartë të viktimave në raport me popullsinë, me 32.55/100 mijë banorë, si edhe të viktimave femra me 25.25/100 mijë banorë. Rezultojnë me numër të lartë të viktimave në raport me popullsinë edhe qarqet Kukës, me 27.65 viktimë/100 000 banorë; Dibër, me 19.11 viktimë/100 000 banorë dhe Shkodër me 18.76 viktimë/100 000 banorë.

- Qarku i Kukësit rezulton me numrin më të lartë të viktimave meshkuj, në raport me popullsinë, me 43.98/100 000 banorë.

- Rezultojnë me numër të lartë të viktimave femra, në raport me popullsinë edhe qarqet Shkodër, me 17.22/100 mijë banorë; Dibër, me 16.71/100 mijë banorë dhe Durrës me 13.63/100 mijë banorë.

- Qarku i Gjirokastrës rezulton me numrin më të ulët të viktimave në raport me popullsinë me 9.1/100 000 banorë, raport që e ruan edhe për femra me 9.16/100 000 banorë dhe për meshkujt me 9.04/100 000 banorë. Edhe qarku i Korçës ka numër të ulët të viktimave në raport me popullsinë, përkatësisht me 9.80/100 mijë banorë, për meshkuj 9.23/100 mijë banorë dhe për femra 10.38/100 mijë banorë.

- Këto raporte në qarqe të tjera, janë të përafërta me raportin e përgjithshëm në shkallë vendi me 13.91 viktimë/100 mijë banorë. Ndërsa, qarku i Tiranës, pavarësisht se ka numrin më të madh të viktimave (89), ka 10.32/100 mijë banorë, pra, më pak se mesatarja e vendit (13.91). Kjo lidhet me numrin e madh të popullsisë.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »


5. Profili i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri, në periudhën 2007-2016, nisur nga motivet, mjetet, kohën, periudhën, vendin, nivell arsimor, statusin civil, profesionin dhe punësimin e viktimave e autorëve.

a. Motivët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Për çdo vepër penale, motivi që shtyn autorin për kryerjen e saj ka shumë rëndësi, jo vetëm për përcaktimin e masës së dënimit të autorit, por edhe për marrjen e masave të tjera sociale, shoqërore e administrative që të gjenden mënyra efektive për t'i eliminuar ato. Por, në vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, motivi është shumë rëndësishëm, pasi ai nxitet dhe krijohet nga mënyra e krijimit të familjes dhe organizimi e funksionimi i saj në vazhdimësi.

Nga të dhënat statistikore për motivet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë evidentuar 9 grupe të tilla, si: xhelozë, pronësia konflikt i çastit, përfitim pasuror, alkoolizim, depresion, lidhje me një krim tjetër, të dobëta dhe aksidentale. Nga analiza e treguesve rezulton se:

- Vrasja “për motivet e dobëta”⁹ përbën me më shumë se 2/3 ose 68.88% të numrit të përgjithshëm të tyre.



AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

- Për nga përqindja që zënë në raport me totalin, disa nga motivet, si: përfitim pasuror, me 5 raste ose 1.33%; të alkoolizuar, 4 raste ose 1.06%; depresion, 8 raste ose 2.13%, lidhje me një krim tjetër, 8 raste ose 2.13%, janë të papërfillshme, por janë të shënuara në komunikatat operative të Policisë së Shtetit dhe janë pasqyruar si tregues.

- Vrasje për motive pronësi, janë 33 raste ose 8.78%. Ky motiv haset më shumë në

⁹ Përcaktimi “motive të dobëta” është një shprehje (terminologji) që përdoret si nga policia ashtu dhe nga institucionet e drejtësisë (gjykatë, prokurori), megjithëse nuk ka një përkufizim juridik për to. Mund të themi që grupon motivet për të cilat nuk ka një cilësim të veçantë në ligjin penal.



Shqipërinë e veriut dhe konkretisht, në qarqet Lezhë me 7 raste, Durrës me 6 raste, Shkodër me 5 raste dhe Kukës me 4 raste. Ndërmjet të tjerave këtu ka ndikuar edhe zhvendosja e popullsisë në periudhën 1991 – 2000, e shoqëruar me zaptimin e tokave dhe mos respektimi i ligjit “Për tokën”. Në disa qarqe, si në Korçë, Berat e Gjirokastrë ky motiv është zero dhe në qarqet e tjera është i papërfillshëm.

- Për periudhën studimore vrasjen për motivin e xhelozisë janë vetëm 22 raste ose 5.85% të tyre, e cila për nga numri është më shumë e përhapur në qarqet Tiranë, me 5 raste dhe Korçë, me 3 raste. Në qarqet Kukës dhe Gjirokastrë ky motiv është zero, ndërsa në qarqet e tjera 1-2 raste. Si vit, është viti 2007, që ka numrin më të madh, me 8 raste ose 36.36% e të gjitha rasteve.

- Krahas motiveve të mësipërme, pavarësisht që në vetvete nuk është i tillë, janë evidentuar edhe 20 raste ose 5.05% të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, nga pakujdesia ose aksidentale.

b. Mjetet¹⁰ e kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth mjeteve të kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë evidentuar 4 lloje mjeteve kryesore, si: mjete prerëse, mjete të forta, armë zjarri dhe vegla pune, si edhe “të tjera”, ku janë përfshirë rastet që nuk përshihen në 4 të parat, dhe rezulton se:



AKADEMIA E SIGURISË


Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »


¹⁰ Për analizën e mjeteve të përdorura në vrasjet e kryera për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën studimore, janë nxjerrë të dhënat statistikore si ngjarje dhe jo si viktimë, pra gjithsej 376 raste. Kjo për arsye se, në disa ngjarje, ka pasur më shumë se një viktimë, por krimi është kryer me të njëjtin mjet.

- Armët e zjarrit¹¹ përbëjnë numrin më të madh të mjeteve të përdorura, me 187 raste ose 49.73% të tyre, që do të thotë afërsisht gjysma e rasteve. Nga armët e zjarrit 4 lloje janë më të përdorurat e kryesisht: automatik (në 37.97% të rasteve), armë gjahu (në 30.48% të rasteve), pistoletë (në 26.74 % të rasteve) dhe pushkë (në 2.39 % të rasteve).

Treguesit e raporteve për armët e zjarrit në vrasjet në familje, për periudhën 2007 – 2016



Armët e zjarrit të përdorura janë poseduar me leje të organeve kompetente në 33 raste ose 17.65% dhe pa leje në 154 raste ose 82.35% të rasteve. Të ndara sipas viteve në paraqitje grafike si më poshtë:



AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

- Mjetet prerëse (thika), janë evidentuar 102 raste ose 27.13%. Këto mjete janë kryesisht: thikat e posaçme, por edhe biçaku, thikat e bukës apo mjete të tjera të mprehta (kaçavidë). Më të përhapura në qarkun Tiranë me 26 raste, nga 84 të ndodhura gjithsej ose 30.95% të tyre.

- Mjete të forta, janë evidentuar 42 raste ose 11.17%, të cilat janë: shkop bejsbolli, shkop i thjeshtë, bisht i veglave të punës, dru, këmbë karrige, etj. Vrasjet me këto mjete

¹¹Që është një vijim i traditës shekullore shqiptare që çdo kryefamiljar të ketë një armë, qoftë edhe pa leje, për të "ruajtur nderin e familjes", jo vetëm nga të tjerët, por edhe nga vetë anëtarët e familjes dhe mbi të gjitha është një vrasje që në përgjithësi përfundon shumë shpejt si akt dhe me vdekjen e menjëhershme të viktimës, pothuajse nuk ka asnjë rast të mbetur në tentativë dhe në shumë raste shoqërohet edhe me vetëvrasjen e autorit (nga 43 autorë që kanë bërë vetëvrasje, të gjithë janë me armë, shumica e të cilëve me pistoletë).

janë më të përhapura në qarqet Durrës me 9 raste, Elbasan me 8 dhe Dibër me 5 raste.


- Veglat e punës, si: sëpata, sqeparë, kosore, kazma, etj., janë evidentuar me 15 raste ose 3.99% dhe janë më të përhapura në qarqet Dibër, Berat e Fier me nga 3 raste.

- Mjete të tjera, janë: mbytyje me duar, mbytyje me litar (lak), me djegie, me hedhje të vajit në vesh, përplasje me automjet, etj., të cilat janë 30 raste ose 7.90%. Janë më të përhapura në qarqet Tiranë, me 8 raste, Lezha 5 raste dhe Elbasani 4 raste.

c. Koha e kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth kohës¹² së kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, gjejmë se:

Treguesit statistikorë për kohën (orën) e vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare



- Numri më i madh i këtyre vrasjeve ka ndodhur ditën, gjithsej në 222 raste ose 59.04% të tyre. Brenda kësaj kohe oraret që kanë ndodhur më shumë janë ato të mesditës, nga ora 12⁰⁰- 13⁰⁰ dhe të pasdites nga ora 15³⁰ – 16³⁰, që përkojnë me oraret e pushimit të drekës dhe ato të mbylljes së punës e kthimit në banesë. Kryesisht janë për motive të dobëta dhe ato për motive pronësie, ndërsa nga ana e marrëdhënieve familjare ato ndërmjet bashkëshortëve apo edhe e prindërve ndaj fëmijëve e anasjelltas. Kanë ndodhur më shumë në qarqet Tiranë, me 50 raste, Durrës, me 27 raste dhe Lezhë, me 25 raste, ndërsa në pak në qarkun Gjirokastrë, me 4 raste

- Në mbrëmje kanë ndodhur 81 raste ose 21.54% dhe janë kryesisht vrasje në familje të mëdha, që janë shoqëruar me më shumë se një viktimë dhe më shumë se një autor. Kryesisht në këtë orar vrasjet kanë ndodhur në familje me nivel të ulët arsimor e kulturor, ndërsa, si zona, në ato rurale. Në mbrëmje më shumë këto krime kanë ndodhur në qarqet Tiranë me 20 raste, Shkodër me 8 raste, ndërsa më pak në Berat me 4 raste,

¹² Në nxjerrjen e të dhënave statistikore për këtë, nuk është shënuar ora, pasi paraqiste vështirësi në analizën e përpunimit statistikor (me 24 orë), por janë përdorur 3 matës të kohës në një ditë-natë 24 orëshe, që janë: *dita*, e cila nënkupton kohën nga mëngjesi deri në mbrëmje ose atë të lindjes dhe perëndimit të diellit, pavarësisht stinës (në dimër kjo është më e shkurtër dhe në verë më e gjatë); *mbrëmja*, që kupton periudhën pas perëndimit të diellit deri në orën e fjetjes (ora 22⁰⁰) dhe, *nata*, që përfshin kohën nga fjetja (ora 22⁰⁰) deri në lindjen e diellit. Edhe këtu treguesit janë për ngjarjet (376) dhe jo për viktimat.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

ndërkohë që Gjirokastra nuk ka asnjë rast.

- Natën kanë ndodhur 73 raste ose 19.41% dhe janë kryesisht vrasje ndërmjet bashkëshortëve, ndërsa motivet xhelozie apo të dobëta. Kjo ndodh për shkak se konfliktet e krijuara në familjen e madhe transferohen në dhomën e çiftit, apo janë raste kur bashkëshortë për shkak të dyshimeve kthehen në shtëpi, nga puna e turnit të tretë ose nga një shërbim dhe gjejnë bashkëshorten me të dashurin dhe i vrasin njëherësh të dy, etj. Për nga metodat (mjetet) e kryerjes së krimit, janë rastet kur autorët zgjedhin natën për të bërë vrasjen në heshtje, pa zhurmë dhe ndoshta edhe për të fshehur viktimën, duke bërë vrasjen me mbytje, me duar, rroba, litar, etj. Më shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë, me 14 raste dhe Durrës, me 9 raste, ndërsa në pak në qarqet Gjirokastër, me 2 raste dhe Berat me 3 raste.

d. Periudha (stina) e kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, për periudhën¹³ e kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, gjejmë se:

Treguesit statistikore për periudhën e vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet periudha	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shum a	Mesa t.	%
pranvere	10	8	6	9	8	16	9	10	9	6	91	9.1	24.20
verë	18	11	11	10	14	15	15	14	5	5	118	11.8	31.38
vjeshtë	12	15	7	7	14	13	11	7	7	1	94	9.4	25.00
dimër	6	11	6	4	13	10	13	4	1	5	73	7.3	19.41

- Në periudhën e stinës së verës kanë ndodhur më shume vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, me 188 raste ose 31.38%. Brenda kësaj periudhe më shumë në gjysmën e dytë të Korrikut dhe gjatë Gushtit. Më shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë, me 30 raste dhe Berat, me 15 raste, ndërsa në pak Gjirokastër, me 2 raste.





- Në vjeshtë janë evidentuar, 4 raste ose 25% dhe brenda periudhës ka pothuajse një ndarje të barabartë. Më shumti kanë ndodhur në qarqet Tiranë, me 22 raste dhe Durrës, me 12 raste, ndërsa në pak në qarqet Gjirokastër e Kukës, me 2 dhe 3 raste.

- Në pranverë kanë ndodhur 94 raste ose 24.20% dhe brenda muajve ka një ndarje pothuajse të barabartë. Më së shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë, me 19 raste dhe Lezhë, me 14 raste, ndërsa në pak në qarqet Gjirokastër e Berat, me nga 2 raste.

- Në dimër kanë ndodhur më pak raste, 73 gjithsej ose 19.41 dhe brenda muajve ndarja është afërsisht e barabartë. Më së shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë e Durrës, me nga 13 raste, ndërsa Gjirokastër nuk ka asnjë rast.

Nga krahasimi i tabelave rezulton se në disa qarqe, kanë ndodhur më shumë ngjarje të tilla në stinën e dimrit, si në Durrës me 13 raste nga 42 gjithsej, ndërsa vera e vjeshta kanë nga 12 dhe pranvera vetëm 6. Qarku i Elbasanit ka rreth 62.5% të rasteve në periudhën dimër-pranverë, të ndarë përgjysmë, ndërsa pjesën tjetër të ndarë përgjysmë në periudhën verë-vjeshtë. Lezha ka 30% të rasteve në periudhën vjeshtë-dimër, ndërsa 70% në pranverë-verë. Pothuajse e njëjta gjë konstatohet edhe në Fier, ku 27% e ngjarjeve

¹³ Në analizimin e të dhënave statistikore për periudhën janë përdorur stinët dhe jo muajit, me 4 grupime, që janë: pranvera (mars - maj), vera (qershor - gusht), vjeshta (shtator - nëntor) dhe dimri (dhjetor - shkurt).



janë në periudhën vjeshtë-dimër, ndërsa 73% në pranverë-verë. Ndërsa Gjirokastra ka nga 33% në periudhat pranverë-verë-vjeshtë dhe asnjë rast në dimër.

dh. Vendi i kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth vendit¹⁴ të kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:


- Në banesë ka ndodhur 210 raste ose 55.85%, që duhet kuptuar brenda në banesë dhe objektet ndihmëse të saj. Në banesë vendi kryesor është dhoma e ndenjes dhe për vrasjet në çift edhe dhoma e gjumit. Më shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë, me 56 raste, Durrës, me 24 raste dhe Fier, me 23 raste, ndërsa në pak në qarqet Gjirokastër, me 4 raste dhe Kukës me 7 raste.

- Pranë banesës, kanë ndodhur 43 raste ose 11.44%, që nënkupton oborrin e banesës ose në zonat rurale, pjesën shumë afër banesës, që në disa raste ka shërbyer edhe si vend për fshehjen e viktimës (varrosjen, groposjen). Më shumë kanë ndodhur në qarqet Kukës, me 3 raste dhe Tiranë e Elbasan, me nga 2 raste.

Treguesit statistikorë për vendin e vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet Vendi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shuma	Mesat.	%
në banesë	27	24	14	20	30	28	27	18	9	13	210	21.0	55.85
pranë banesës	8	7	3	0	4	8	3	6	3	1	43	4.3	11.44
në pyll, arë	1	1	0	1	2	1	0	0	3	1	10	1.0	2.66
në automjet	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0.1	0.27
në ambiente tjera	10	13	13	9	13	17	18	11	6	2	112	11.2	29.79

¹⁴ Në nxjerrjen e të dhënave statistikore për vendin vrasjes, janë shfrytëzuar emërtimet e përdorura në komunikata e Policisë së Shtetit, me 5 tregues gjithsej, 3 prej të cilëve janë më së shumti, si: banesë; pranë banesës dhe pylli, ara, livadhet, si edhe ambiente të tjera, që janë në numër të vogël dhe janë grupuar.



- Në pyll (arë apo livadhe) kanë ndodhur gjithsej 10 raste ose 2.66%. Ndodh në zonat rurale dhe në përgjithësi janë vrasjet me paramendim ku autori synon të fshehtë viktimën dhe në disa raste janë aksidentale, në gjueti (një rast me 3 viktima në Kukës).

- Në ambiente të tjera, i cili për nga numri dhe përqindja është i dyti, me 112 raste gjithsej ose 29.79%, ku përfshihen raste që krimi është kryer në ambiente të tjera nga ato që përmenden më lart, si: në rrugë, në vendin e punës (kantier, fabrikë), në plazh (det), në zyrë apo lokale e dyqane private, etj. Më shumë kanë ndodhur në qarqet Tiranë, 18 raste dhe Lezhë, me 15 raste, ndërsa në pak në qarkun Gjirokastrë, 2 raste.

e. Niveli arsimor¹⁵ i autorëve dhe viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.


Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth nivelit arsimor të autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Niveli arsimor i autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare rezulton të jetë në pjesën më të madhe i ulët, me 77.8% të rasteve (me arsim 8 vjeçar, fillor apo pa arsim), në raport me 22.2% që janë më arsim të mesëm e të lartë.

Treguesit statistikorë për nivelin arsimor të autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

AKADEMIA E SIGURISË	Vitet												Shum a	Mes at.	%
	Niveli arsimor	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016				
Konferenca e II-të shkencore kombëtare: « Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »	pa arsim	3	4	1	1	2	1	0	0	1	1	14	1.4	3.54	
	fillor	8	2	3	0	7	6	2	8	1	1	38	3.8	9.60	
	8 vjeçar	31	30	25	22	31	39	30	19	19	10	256	25.6	64.6	
	i mesëm	12	14	3	2	10	7	14	5	4	6	77	7.7	19.4	
	i lartë	0	0	0	2	2	2	3	2	0	0	11	1.1	2.78	

¹⁵ Për analizën e nivelit arsimor të autorëve dhe viktimave të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën studimore, është bërë ndarje për 5 nivele të arsimit, që janë: pa arsim, me arsim fillor, me arsim 8 vjeçar, me arsim të mesëm dhe me arsim të lartë. Autorë janë 396, ndërsa viktima 400, kjo mospërputhje është pasi ka autorë që ka vrarë më shumë se një viktimë apo ka viktima që janë vrarë nga më shumë se një autor.



- Me arsim 8 vjeçar, janë 256 ose 64.65 %. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 46 raste dhe Fier, me 32 raste, ndërsa më pak Gjirokastrë, me 2 raste.

- Me arsim të mesëm janë 77 raste ose 19.44%. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 23 raste dhe Durrës e Shkodër me nga 8 raste, ndërsa më pak Dibra, me 2 raste.

- Me arsim fillor, janë 37 raste ose 9.60%. Konstatohet se numri i autorëve është 33.35% më i vogël se ai i viktimave për këtë kategori. Konstatohet më shumë në qarqet Tiranë, me 8 raste dhe Korçë, me 5 raste, ndërsa më pak në qarqet Dibër, me 2 raste.


- Autorët pa arsim zënë një përqindje të vogël dhe përbën 14 raste ose 3.54% dhe janë më shumë në qarqet Elbasan e Fier, me nga 4 raste.

- Grupi që përbën numrin më të vogël të autorëve është ai me arsim të lartë, me 11 raste ose 2.78% të tyre dhe janë më shumë në qarkun e Tiranës, me 5 raste.

Niveli arsimor i viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare rezulton të jetë i ulët. Me arsim 8 vjeçar, fillor apo pa arsim, në pjesën më të madhe, me 83.5 % të totalit, në raport me 16.5 % që janë më arsim të mesëm e të lartë.

Treguesit statistikor për nivelin arsimor të viktimave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Niveli arsimor	Vitet		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		Shuma	Mesa t.	%
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022					
pa arsim	3	3	1	2	2	2	0	3	1	0	17	1.7	4.25								
fillor	6	2	2	5	9	8	6	12	6	2	58	5.8	14.50								
8 vjeçar	24	33	26	18	30	42	32	23	20	11	259	25.9	64.75								
mesëm	13	6	5	7	9	4	8	3	1	5	61	6.1	15.25								
I lartë	0	0	1	0	0	1	2	1	0	0	5	0.5	1.25								



Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth nivelit arsimor të viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Me arsim 8 vjeçar janë 259 raste ose 64.75%. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 52 raste dhe Lezhë, me 30 raste ndërsa më pak në qarkun Gjirokastrë me 3 raste.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

- Me arsim të mesëm, janë 61 raste ose 15.25% të totalit. Për këtë nivel arsimor, numri i autorëve është 20% më i lartë se ai viktimave. Më shumë ka në qarqet Tiranë, me 21 raste dhe Durrës me 9 raste, ndërsa më pak në qarkun Kukës, më një rast.

- Me arsim fillor, janë 58 raste ose 14.50. Konstatohet se numri i autorëve është 33.35% më i vogël se ai viktimave për këtë kategori.

- Autorët pa arsim zënë një përqindje të vogël dhe përbën 17 raste ose 4.25% të tyre. Më shumë ka në qarkun e Elbasanit, 5 raste.


- Grupi që përbën numrin më të vogël të viktimave është ai me arsim të lartë, me 5 raste ose 1.25%. Më shumë ka në qarkun e Tiranës, me 3 raste.

ë. Statusi civil i autorëve dhe viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Nga analiza e të dhënave statistikore, lidhur me statusin civil të autorëve, në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare rezulton numri më i madh i viktimave i përket statusit civil “i/e martuar”, me 274 raste ose 69.19% të totalit.

Treguesit statistikorë lidhur me statusin civil të autorëve në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet	Vitet										Shu ma	Mes at.	%
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016			
Statusi civil	7	8	9	0	1	2	3	14	5	16			
beqar/e	15	10	11	3	13	15	9	4	7	4	91	9.1	22.98
i/e martuar	33	38	16	22	34	37	34	29	17	14	274	27.4	69.19
i/e divorcuar	3	0	2	1	2	3	3	1	1	0	16	1.6	4.04
bashkëjetues/e	2	2	2	1	3	0	3	0	0	0	13	1.3	3.28
i/e ve	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	2	0.2	0.51




**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Treguesit e raporteve për statusin civil të autorëve për periudhën 2007 – 2016



Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth statusit civil të autorëve në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Numri më i madh tyre janë me të martuar, me 274 raste ose 69.19%, që është pothuajse i barabartë si për autorët edhe viktimat. Më kanë qarqet Tiranë, me 55 raste, Fier, me 33 raste dhe Durrës, me 29 raste, ndërsa më pak Gjirokastra, me 6 raste.

- Beqar/e, janë 91 raste ose 22.98% të tyre. Konstatohet se numri i autorëve beqarë është 28% më i lartë se ai viktimave për këtë kategori. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 23 raste dhe Durrës, me 14 raste, ndërsa më pak në qarkun Gjirokastër, me 2 raste.

- Të divorcuar, janë 16 raste ose 4.04%. Më shumë kanë qarqet Tiranë me 5 raste dhe Durrës me 3 raste.


- Bashkëjetues/e, i cili është një status që ka hyrë së fundi në emërtimet e familjare, është i ulët në raport me numrin e përgjithshëm, si për autorët ashtu edhe për viktimat. Për autorët ka 13 raste ose 3.28% dhe janë më shumë në qarkun e Tiranës, me 6 raste. Kjo për faktin se në këtë qark është e përhapur si formë.

- I/e ve, përbën numrin më të vogël, me vetëm 2 raste ose 0.5%.

Lidhur me statusin civil të viktimave, në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, rezulton se numri më i madh i viktimave i përket statusit “i/e martuar”, 277 raste ose 69.25% të totalit.

Treguesit statistikorë lidhur me statusin civil të viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet Statusi civil	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shum a	Mes at.	%
beqar/e	6	7	9	3	7	11	8	11	6	3	71	7.1	17.75
i/e martuar	30	33	21	24	36	41	31	28	19	14	277	27.7	69.25
i/e divorcuar	2	1	2	1	2	2	2	0	1	0	13	1.3	3.28
bashkëjetue s/e	3	2	2	1	3	0	4	1	0	0	16	1.6	4.04
i/e ve	5	1	1	4	2	3	2	2	2	1	23	2.3	5.75



Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth statusit civil të viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Numri më i madh i tyre janë të martuar, me 277 raste ose 69.25%, i cili është pothuajse i barabartë me të autorëve nga kjo kategori. Më shumë kanë qarqet Tiranë me 54 raste, Durrës me 35 raste dhe Fier me 33 raste. Ndërsa më pak Gjirokastra, me

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

3 raste.

- Beqar/e, janë 71 raste ose 17.75%. Numri i viktimave nga kjo kategori është 28% më i ulët se ai autorëve. Më shumë kanë qarqet Tiranë me 18 raste dhe Shkodër e Lezhë, me nga 9 raste, ndërsa Berati, nuk ka asnjë rast.

- I/e ve, ndryshe nga autorët janë 23 raste ose 5.75% totalit, pra më shumë se 10 fish dhe më shumë kanë qarqet Tiranës, me 5 raste, Elbasan, me 4 raste.

- Bashkëjetues/e, janë 16 raste ose 4.04% dhe më shumë ka qarku i Tiranës, me 7 raste.

- I/e divorcuar, janë 13 raste ose 3.28% me një diferencë të vogël nga autorët dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 5 raste dhe Durrës, me 3 raste.

f. Profesion¹⁶ i autorëve dhe viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Profesioni i fermerit rezulton të jetë më i përhapuri në rastin e autorëve të vrasjeve në familje me 202 raste ose 51.01% dhe më pas vijjnë ata të profesionit punëtor me 154 raste ose 38.89% të totalit.

Treguesit statistikorë lidhur me profesionin e autorëve në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet Profesioni	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shuma	Mesat.	%
fermer	25	26	13	15	25	29	26	22	14	7	202	20.2	51.01
punëtor	24	21	18	9	20	21	17	9	8	7	154	15.4	38.89
ushtarak	1	1	0	0	0	1	2	0	0	1	6	0.60	1.52
nëpunës	0	0	0	2	2	2	2	2	0	1	11	1.10	2.78
nxën/stud.	3	3	1	1	5	1	2	0	3	2	21	2.10	5.30
emigrant	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	2	0.20	0.51

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:


« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth profesionit të autorëve në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Numri më i madh autorëve janë me profesionin e fermerit, me 202 raste ose 51.01%, që është afërsisht e barabartë edhe për viktimat dhe përbëjnë më shumë se

¹⁶ Për analizën e profesionit të autorëve dhe viktimave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën studimore, janë përdorur termat e profesioneve si më poshtë: Fermer, që nënkupton ata persona që punojnë e jetojnë në zonat rurale (fshat) dhe merren kryesisht me punë në bujqësi e blegtori, në pronat e tyre; Punëtor, që nënkupton ata persona që jetojnë kryesisht në qytet dhe nuk merren me punë bujqësi e blegtori; Ushtarak, që nënkupton ata persona që janë të armatosur me leje (oficer dhe ushtarë të FA, punonjës të PSH, Gardës së Republikës, etj.); Nëpunës, që nënkupton ata persona që të paktën kanë arsim të lartë; Nxënës/student, që nënkupton ata persona që janë duke vazhduar një shkollë ose janë të kësaj moshe; Emigrant, që nënkupton një person që është në emigracion, por ka në RSH pjesëtarë të familjes së tij.

gjysmën e të gjithë treguesve. Më shumë kanë qarqet Fier, me 33 raste dhe Tiranë, Lezhë e Elbasan, me 23 raste, ndërsa më pak në qarku Gjirokastrë, me 1 rast.



- Punëtorët, janë 154 raste ose 38.89% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 44 raste, Durrës, me 23 raste dhe Fier, me 17 raste, ndërsa më pak qarku Kukës, me 3 raste.

- Nxënësit/studentët, kjo kategori ka numër të ulët në raportin e përgjithshëm, megjithatë është i treti për autorët, me 21 raste ose 5.30% të totali dhe është me një diferencë të vogël me viktimat, me 23 raste ose 5.75% të totalit. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 7 raste dhe Shkodër, me 5 raste.

- Nëpunësit janë shumë pak në raport me numrin e përgjithshëm të autorëve, me 11 raste ose 2.78% dhe më shumë ka qarku i Tiranës, me 4 raste.

- Ushtarakët, përbëjnë numrin më të vogël, me 6 raste ose 1.52%.

- Emigrantët, janë vetëm në 2 raste.

Numri më i madh i viktimave në rastet e vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare janë me profesionin fermer me 215 raste ose 53.75% dhe më pas vijnë ata të profesionit punëtor me 150 raste ose 37.5%.

Treguesit statistikorë lidhur me profesionin e viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare


Vitet Profesi oni	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shum a	Mes at.	%
fermer	25	26	13	15	25	29	26	22	14	7	202	20.2	51.01
punëtor	24	21	18	9	20	21	17	9	8	7	154	15.4	38.89
ushtarak	1	1	0	0	0	1	2	0	0	1	6	0.60	1.52
nëpunës	0	0	0	2	2	2	2	2	0	1	11	1.10	2.78
nxënës/student	3	3	1	1	5	1	2	0	3	2	21	2.10	5.30
emigrant	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	2	0.20	0.51

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth profesionit të viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:



- Numri më i madh i viktimave janë me profesionin fermer me 215 raste ose 53.75%, që është afërsisht e barabartë me atë të autorëve nga kjo kategori dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 32 raste, Lezhë, me 27 raste dhe Fier e Shkodër, me 24 raste, ndërsa më pak Gjirokastra, me 1 rast.

- Punëtorë, janë 150 raste ose 37.50% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 44 raste dhe Durrës, me 19 raste ndërsa më pak qarqet Kukës, me 3 raste dhe Dibër 4 raste.

- Nxënës/student, janë në numër të ulët në raportin e përgjithshëm, megjithatë është i treti për viktimat, me 23 raste ose 5.75 %. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 7 raste dhe Shkodër, me 5 raste.

- Nëpunës, janë në numër të ulët në raport me numrin e përgjithshëm me 9 raste ose 2.25% dhe më shumë në qarkun e Tiranës, me 5 raste.

- Ushtarakë, përbën numrin më të vogël, me 1 rast ose 0.25% të tyre.

- Emigrantët, janë vetëm në 2 raste.

f. Punësimi¹⁷ i autorëve dhe viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.


Numri më i madh autorëve të vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare janë të kategorisë “të vetëpunësuar”, me 178 raste ose 44.95% të totalit.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth punësimit të autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:

- Numri më i madh i tyre është nga kategori e të vetëpunësuarve, me 178 raste ose 44.95% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 26 raste, Fier, me 21 raste dhe Durrës e Shkodër me nga 20 raste, ndërsa më pak në qarku Gjirokastër, me 1 rast.

Treguesit statistikorë lidhur me punësimin e autorëve në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Vitet Profesi oni	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Shum a	Mes at.	%
fermer	25	26	13	15	25	29	26	22	14	7	202	20.2	51.0
punëto r	24	21	18	9	20	21	17	9	8	7	154	15.4	38.8
ushtara k	1	1	0	0	0	1	2	0	0	1	6	0.60	1.52
nëpunë s	0	0	0	2	2	2	2	2	0	1	11	1.10	2.78
nxë/stu d.	3	3	1	1	5	1	2	0	3	2	21	2.10	5.30
emigra nt	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	2	0.20	0.51



- Të punësuar, janë 102 raste ose 25.76% që është 40 raste ose 39.22% më i lartë se ai viktimave për këtë kategori. Më shumë kanë qarqet Tiranë me 32 raste, Durrës me 13 raste dhe Lezhë me 10 raste, ndërsa më pak në qarkun Kukës, me një rast.

- I/e pa punë, janë 54 raste ose 13.64% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 11 raste dhe Durrës e Elbasan, me nga 8 raste, ndërsa më pak Berati e Gjirokastra, me 1 rast.

- Pensionistë janë 41 raste ose 10.35% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 8 raste dhe Fier e Elbasan, me nga 5 raste, ndërsa më pak Berat e Gjirokastrë, me nga 1 rast.

- Shkollarë (nxënës/student/kursant) përbëjnë numrin më të vogël, me 21 raste ose 5.30% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, me 7 raste dhe Shkodër, me nga 5 raste, ndërsa nuk kanë asnjë rast qarqet Berat, Elbasan, Korçë e Gjirokastrë.

Viktimat në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare rezultojnë me numrin më të madh të kategorisë “të vetëpunësuar”, me 195 raste ose 48.75% të totalit.

Nga analiza krahasuese e të dhënave statistikore, rreth punësimit të viktimave të rasteve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare gjejmë se:


- Numri më i madh i viktimave janë të kategorisë të vetëpunësuar, me 195 raste ose 48.75%. Vihet re që numri i viktimave i kësaj kategorie është më i madh me 17 raste ose 8.72%, se sa ai i autorëve. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 29 raste, Lezhë, me 27 raste dhe Durrës, me 23 raste, ndërsa më pak Gjirokastra, me një rast.

- Pensionistë, janë 67 raste ose 16.75% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, 20 raste dhe Fier, me 5 raste, ndërsa më pak në qarqet Berat, Vlorë, Berat e Korçë, me nga 2 raste.

Treguesit statistikore lidhur me punësimin e viktimave në rastet e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare

Punësimi	Vitet										Shum a	Mesa t.	%
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016			
I punësuar	9	8	8	4	6	10	9	5	2	1	62	6.20	15.50
I papunë	4	7	4	4	9	6	6	6	2	4	52	5.20	13.00
I vetëpunësuar	23	22	15	15	18	31	24	22	15	10	195	19.5	48.75
pensionist	7	5	4	8	11	7	8	8	6	3	67	6.70	16.75
në shkollë	3	2	4	1	5	3	1	2	3	0	24	2.40	6.00

¹⁷ Për analizën e gjendjes së punësimit të autorëve dhe viktimave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare për periudhën studimore, janë përdorur termat: i/e punësuar, që nënkupton ata persona që janë të punësuar në shtet ose privat; i/e vetëpunësuar, që nënkupton ata persona që janë të vetëpunësuar në zona rurale merren me bujqësi, ndërsa në ato urbane kanë një shërbim tregtar familjar; i/e pa punë, që nënkupton ata persona që janë të moshës së punës, por nuk kanë një vend pune të sigurt ose privat apo nuk janë të vetëpunësuar; Pensionist/e, që nënkupton ata persona që janë në pension, por më parë kanë punuar; Shkollar/e (në shkollë), që nënkupton ata persona që janë duke vazhduar një shkollë të çfarëdo niveli, në kohën që kanë kryer krimin.



- Të punësuar, janë 62 raste ose 15.50% dhe konstatohet se numri i viktimave të kësaj kategorie është 40 raste ose 39.22% më i ulët se ai autorëve. Më shumti kanë qarqet Tiranë, me 18 raste dhe Durrës, me 8 raste, ndërsa më pak Kukësi, me një rast.

- I/e pa punë, janë 52 raste ose 13% dhe më shumë kanë qarqet Tiranë, 20 raste dhe Fier, me 5 raste, ndërsa më pak në qarqet Berat, Vlorë, Berat e Korçë, me nga 2 raste.

- Shkollarë (nxënës/student/kursant) përbën numrin më të vogël, me 24 rast ose 6.00%, me një raport afërsisht të njëjtë viktimë-autor. Më shumë kanë qarqet Tiranë, me 8 raste dhe Shkodër, me 5 raste, ndërsa nuk kanë asnjë rast qarqet Berat, Gjirokastrë e Dibër.

6. Përfundime

Duke analizuar treguesve statistikorë, për rastet e vrasjeve të kryera për shkak të marrëdhënieve familjare, në periudhën 10 vjeçare 2007-2016, arrijmë në përfundimet, se:

- Numri i autorëve meshkuj është 9.1 herë më i madh në raport me femrat dhe numri i viktimave meshkuj është 1.3 herë më i madh në raport me femrat. Kjo rrjedhë e agresivitetit të lartë të meshkujve në familjen shqiptare, që është vazhde e mentalitetit të trashëguar për dominim të burrit (mashkullit) mbi gruan (femrën).

- Referuar statusit të pjesëtarit të familjes, në rolin e autorit apo viktimës, vrasja e bashkëshortes nga bashkëshorti përbën numrin më të madh dhe përqindjen më të lartë të viktimave, në raport me pjesëtarët e tjerë të familjes; bashkëshorti përbën numrin më të madh të autorëve të vrasjes dhe pothuajse numrin më të vogël të viktimave të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare; vëllai, si për viktimat edhe për autorët, në numër dhe përqindje është i dyti.

- Vitet e fundit të periudhës studimore, ka pasur një rënie të ndjeshme të numrit të këtyre vrasjeve, në zonat rurale janë të evidentuar më shumë raste vrasjesh (22.34%) se në zonat urbane. Kjo diferencë është një tregues i marrëdhënieve familjare më të emancipuara në zonat urbane.

- Motivi kryesor i vrasjeve në familje është ai për motive të dobëta, çfarë nënkupton se në përgjithësi në familjet shqiptare nuk u kushtohet rëndësi marrëdhënieve në familje dhe atyre në çift në veçanti, pasi çdo konflikt i vogël, hatërmbetje apo neglizhencë që në dukje është e parëndësishme, lihet pa u vlerësuar dhe akumulon në vetvete hendek në komunikim, deri në urrejtje dhe përfundon me vrasje apo tentativë vrasje.

- Mjeti kryesor i vrasjeve në familje janë armët e zjarrit, me 49% të së gjitha rasteve, që ana tjetër në 83% të rasteve janë pa leje dhe thika është e dyta 27.13%. Po kështu konstatohet se kanë ndodhur edhe rreth 20 vrasje aksidentale kryesisht me armë që rezultojnë pa leje ose edhe me leje, por të keqadministruara. Kjo kërkon një vëmendje

më të madhe të së gjithë strukturave shtetërore për kontrollin e administrimit të armëve të zjarrit dhe atyre të ftohta dhe veçanërisht të Policisë së Shtetit që ka detyrimet kryesore në këtë drejtim.

- Mjete të tjera për kryerjen e këtij krimi janë edhe mjete e forta, që gjenden kollaj dhe nuk duan ndonjë mjeshteri përdorimi, kryesisht janë përdorur ndaj viktimave me moshë të vjetër dhe ndaj femrave.

- Një mënyrë e vrasjes është edhe ajo me mbytyje, ku autorët janë nënat ndaj fëmijëve të mitur për të cilët bashkëshortët dyshojnë për atësinë apo të nuseve ndaj vjehrrave dhe ndodhin kryesisht në zona rurale.

- Ky krim ndodh më shumë në periudhën e verës, me 31.38% të rasteve, që është e lidhur me motin me temperatura të larta, ditët e gjatë dhe punët e stinës në pikun e tyre. Ndërsa ndodh e kundërta në dimër me 19.4% të rasteve.

- Vendi kryesor i kryerjes së vrasjeve në familje është banesa. Ky ambient për shkak të privatësisë, krijon kushte më të përshtatshme për autorët, si për kryerjen e krimit ashtu edhe për veprimet pas krimit (fshehjen e kufomës apo largimin nga vendi i ngjarjes).

- Një nga shkaqet që ndikon në këto vrasje është edhe niveli arsimor i autorëve dhe viktimave. Rezulton se si për autorët ashtu edhe për viktimat niveli arsimor në pjesën më të madhe është i ulët me rreth 80% të rasteve me arsim 8 vjeçar, fillor apo pa arsim.

- Në pjesën më të madhe të këtyre krimeve si autorët edhe viktimat janë të martuar, me rreth 70% të rasteve. Ndërkohë që konstatohet se pjesa më e pambrojtur në familje janë personat me statusin “i/e ve”, pasi ata janë me të viktimizuar, ndërkohë që janë autorë vetëm në dy raste.

- Profesionit i fermerit, përbën numrin më të madh si për autorët dhe për viktimat, me mbi 50%, të rasteve dhe së bashku me ata me profesion punëtor, përbëjnë afërsisht 90% të rasteve. Ndërsa raset nga kategoritë nëpunës dhe ushtarak, si për autorët dhe viktimat janë të pakta dhe më shumë kanë ndodhur në qarkun e Tiranës.

- Evidentimi i emigrantëve është bërë për shkak të perceptimit se nga kjo kategori ka shumë autor apo viktimë, por nuk rezulton kështu.

- Të vetëpunësuarit dhe të papunët përbëjnë numërim më të madh, si për autorët dhe për viktimat, me rreth 60%, për autorët dhe mbi 62% për viktimat. Ndërsa evidentohet fakti se shumë viktimë janë pensionistë, që për nga numri i viktimave, është dyta me 67 raste, çfarë tregon se kjo shtresë nuk gëzon respekt në familje.

Literatura

1. Elezi I., *E Drejta Penale*, Botimi I, SHBLU, 1989, Tiranë.
2. Buna Gj., *Kodi Penal*, Alb Juris, 2013, Tiranë.
3. Gjocovi Sh., O.F.M. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Kuvendi, Geer, 2001, Tiranë.
4. Hasluck M., *Kanuni Shqiptar*, Bleu I, Lisitan, 2005, Tiranë.
5. Taçi P., *Fjalor Termilogjik për policinë kriminale-gjyqësore*, AS, 2005, Tiranë.
6. Kostallari A., *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, 1973, Tiranë.
7. *Kushtetuta e RSh.*, Botim i QBZ, 2016, Tiranë.
8. *Kodi i Familjes*, Botim i QBZ, 2016, Tiranë.
9. Komunikata operative të Policisë së Shtetit për periudhën nga data 1 janar 2007 deri më 31 dhjetor 2016.

Dhuna në familje si vepër penale dhe masat për parandalimin e saj



■ **Dr. Andia LEVANAKU**
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit,
Akademia e Sigurisë
andia.levanaku@asp.gov.al

Abstrakt

Mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor është parakusht për zhvillimin e një vendi. Çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet. Familja është një formacion social në të cilin zhvillohet personaliteti i njeriut dhe si e tillë, përfaqëson një dukuri komplekse, prandaj është bërë objekt studimi në mjaft disiplina shkencore. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit, është një nga parimet më themelore të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në mbrojtje të familjes. Kështu, Kushtetuta sanksionon të drejtën për një jetë familjare normale dhe mbrojtjen e veçantë të saj, pavarësisht nga mënyra si është krijuar. Mbrojtja e veçantë e familjes dhe e martesës është e lidhur drejtpërdrejt me gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale, e cila garantohet nga një sërë garancish bazë dhe juridikionale. Kushtetuta garanton një sërë të drejtash që lidhen me familjen si: e drejta për të krijuar familje; e drejta për të jetuar në familje; e drejta për të gëzuar një jetë private të qetë; e drejta për të respektuar barazinë bashkëshortore; mbrojtja e posaçme e fëmijëve, etj. Pavarësisht shenjtërisë që lidhet me familjen dhe mbrojtjen e veçantë që gëzon, dhuna në familje është një fenomen shqetësues në Shqipëri. Veprat penale dhe format e dhunës janë nga më të rëndat, të cilat shkojnë nga dhuna emocionale, seksuale deri në vrasjen e viktimës. Në këtë kuadër, janë marrë një sërë masash për parandalimin e dhunës në familje. Masa legjislative që konsistojnë në ndryshime ligjore, në miratimin e një pakete ligjore për dhunën në familje, në ashpërsimin e dënimeve penale, apo në krijimin e mekanizmave mbrojtës, strukturave të posaçme pranë qeverisjes qendrore dhe vendore, e cila kulmoi me hapjen e Zyrës së Ndhmës Juridike dhe Koordinimit të Dhunës në Familje, më 25.11.2017, si bashkëpunim i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, e cila në thelb të misionit ka ofrimin e këshillimit ligjor falas, parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Fjalëkyçe:

dhunë në familje, vrasje, dhunë ekstreme, mbrojtja e jetës, faktorë risku.

1. Hyrje

Dhuna në familja dhe sidomos dhuna ndaj grave ka marrë përmasa shqetësuese në shoqërinë shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka një tendencë në rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje, sidomos pas hyrjes në fuqi të ligjit për dhunën në familje.¹ Dhuna në familje në shoqërinë shqiptare shfaqet në të gjitha format e saj, deri në ekstrem. Vetëm në vitin 2017 janë regjistruar 14 vrasje në nivel kombëtar si pasojë e dhunës në familje. Analiza e statistikave që lidhen me këto vepra penale dhe që gjenden komplekse në 65-70% të rasteve të dhunës në familje portretizojnë një panoramë komplekse, ku shifrat e pasqyruar të raportimeve janë ana tjetër e medaljes, e përpjekjeve që synojnë të nxisin raportimin e këtyre rasteve. Që prej vitit 2010 e në vazhdim, rastet e raportuara të dhunës në familje pësuan rritje të ndjeshme, ku raporti i viktimave gra ishte pothuajse sa trefishi i atyre burra.²

Veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje janë kthyer në një fenomen që kërkon vëmendjen e të gjithë shoqërisë dhe bashkërendim nga të gjitha strukturat ligjzbatuese. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit, është një nga parimet më themelore të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në mbrojtje të familjes. Kështu, Kushtetuta sanksionon të drejtën për një jetë familjare normale dhe mbrojtjen e veçantë të saj, pavarësisht nga mënyra si është krijuar. Koncepti i mbrojtjes dhe parandalimit në nivel kombëtar fillon nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshkues i të gjithë legjislacionit. Ajo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme në përfaqje me standardet ndërkombëtare.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

¹ Ligji nr.9669, dt 18.12.2006, ndryshuar, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

² Statistika nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Garancitë dhe baza juridike garantuese e të drejtave lidhur me familjen

Mbrojta e veçantë e familjes dhe e martesës është e lidhur drejtpërdrejt me gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale, e cila garantohet nga një sërë garancish bazë dhe juridiksionale. Kushtetuta garanton një sërë të drejtash që lidhen me familjen si: e drejta për të krijuar familje; e drejta për të jetuar në familje; e drejta për të gëzuar një jetë private të qetë; e drejta për të respektuar barazinë bashkëshortore; mbrojtja e posaçme e fëmijëve, etj.³ Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut: “Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht.”

Shumica e dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë bërë detyruese, si pjesë e së drejtës. Vendet veprojnë sikur dispozitat e saj të ishin ligj, duke e bërë kështu Deklaratën, të detyrueshme. Shumë vende kanë integruar të drejtat njerëzore të sipërpërmendura në dispozitat e tyre kushtetuese, duke garantuar kështu lirinë e individëve, pavarësisht nga gjinia apo mosha e tyre, nga dhuna në familje. Si ligj suprem i një shteti, një kushtetutë deklaron vlerat më të thella të shtetit dhe deklarata e shtetit që abuzimi i grave cenon vlerat e tij më të thella, është e rëndësishme. Gratë duhet t’i përdorin këto deklarata kushtetuese për të bërë presion për ndryshime legjislative dhe për të kërkuar dëmshpërblim për dështimin e shtetit në mbrojtje të grave në familje. Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut që u miratua në vitin 1950 dhe hyri në fuqi në 1953, është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 2 tetor 1996. Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin kombëtar dhe në këtë mënyrë, gjyqësori, në nivel kombëtar, mund dhe duhet të marrë në konsideratë dispozitat e kësaj Konvente.

Një tjetër dokument i rëndësishëm në këtë kuadër është Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” e njohur si CEDAW, konsiderohet si një kartë ndërkombëtare e të drejtave të grave. Ajo përcakton diskriminimin në një mënyrë shumë të rëndësishme, duke bërë të qartë që gratë kanë të drejtën e një gëzimi të plotë dhe të barabartë të së gjitha të drejtave të tyre njerëzore. CEDAW, synon të sigurojë barazinë, si detyrim parësor për shtetet palë (neni 2) dhe përmirësimin de facto të pozitës së grave (neni 3-24) duke nënkuptuar veprime pozitive. Ajo lufton ideologjinë gjinore sunduese (neni 5.a) duke kërkuar një ndryshim të qëndrimit tradicional ndaj gruas, që pengon gratë në realizimin e të drejtave të tyre (duke përfshirë eliminimin e stereotipave gjinorë të fshehur në legjislacion). Ndonëse vetë teksti i konventës nuk shprehet drejtpërdrejt për dhunën ndaj grave, rekomandimi nr. 19, i përpunuar nga Komiteti i CEDAW-t, një organ i krijuar nga vetë konventa, është shprehur se konventa duhet interpretuar në mënyrë të tillë, që të përfshijë edhe dhunën me bazë gjinore në dispozitat dhe detyrimet që krijon. Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës”, (edhe kjo e ratifikuar nga Shqipëria) në nenin 19 të saj parashikon: “Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga lëndimet dhe keqtrajtimet fizike e psikologjike. Qeveritë duhet të sigurojnë që fëmijët të jenë nën kujdes të përshtatshëm dhe t’i mbrojnë ata prej dhunës, abuzimit dhe neglizhimit të prindërve ose të kujtdo tjetër që kujdeset për ta. Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

³ Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit) mbështetet mbi parimin se pabarazia gjinore është një arsye rrënjësore e dhunës me bazë gjinore dhe kontribuon në viktimizimin e gruas.

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Duke konsideruar faktin se koncepti i torturës dhe i trajtimeve mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, së fundmi është zgjeruar dhe konceptohet jo vetëm si akt i kryer nga persona të veshur me funksion zyrtar, por edhe nga individë, - dhe shteti është përgjegjës për mbrojtjen e qytetarëve nga trajtime të tilla, - Kushtetuta ofron mbrojtje ndaj dhunimit të së drejtave të njeriut në përgjithësi dhe, të gruas në mënyrë të veçantë, duke përcaktuar: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues”.

3. Dhuna në familje si vepër penale

Dhuna në familje është kriminalizuar në Shqipëri që prej vitit 2012. Veç përkufizimit që i jep Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, cituar më lart, ligji shqiptar e përkufizon: “*çdo akt dhune, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën*”.⁴

Dhuna në familje, si vepër penale është parashikuar në Kodin Penal në 2012, dhe ndryshimin e fundit e ka pësuar në 2013. Konkretisht neni 130/a parashikon: “*Rrahja si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues, ish-bashkëjetues, gjini e afërt apo krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik dënohet me burgim gjer në dy vjet.*

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues, ish bashkëjetues, gjini e afërt apo krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin psikik të tij dënohet me tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues, ish-bashkëjetues, gjini e afërt apo krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë me tepër se 9 ditë, dënohet me burg deri në 5 vjet.

Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur ose në prani të fëmijëve dënohen nga një deri në pesë vjet.”⁵ Ky nen nuk është i vetmi që ndëshkon aktet e dhunshme në familje. Marrëdhëniet familjare në shumë dispozita parashikohen si rrethanë rënduese.

Legjislacion penal dhe procedural penal parashikon dispozita për sa i përket trajtimit të veprave penale, këtu vrasjen, (nenet 76 – 83, 85 të Kodit Penal), kanosjen (neni 84); plagosjen, e rëndë me dashje (neni 88, 88/a, 88/b), plagosjen e lehtë me dashje

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

⁴ Neni 2 i ligjit 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në familje.”

⁵ Neni 130/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

(neni 89), plagosjen e rëndë nga pakujdesia (neni 91), plagosjen e lehtë nga pakujdesia (neni 92), dëmtime të tjera me dashje (neni 90), marrëdhëniet me dhunë, etj., neni 79/c shton se “vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale” dënohet jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Dhuna në familje është rrethanë rënduese në veprat penale si ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas (neni 93), shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99), marrëdhënie seksuale (nenet 100-107), vepra të turpshme (neni 108), rrëmbimi (neni 109, 109/a, 109/b), heqja e paligjshme e lirisë (neni 110), trafikimi (neni 110/a), dhunimi i banesës (neni 112), prostitucioni (neni 113), shfrytëzimi i prostitucionit (nenet 114, 114/a 114/b); fyerja (neni 119), shpifja (neni 120); ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121), përndjekja, (121a), përhapja e sekreteve vetjake (neni 122), pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (neni 123); braktisja e fëmijëve të mitur (neni 124); keqtrajtimi i fëmijës (neni 124/a) mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125); marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127); trafikimi i të miturve (neni 128/a); shtytja e fëmijëve në krim (neni 129); shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130); kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (vjedhja me dhunë/vjedhja (nenet 134, 137, 139, 140, 141); mashtrimi (neni 143); shkatërrimi i pronës (nenet 150-154); prishje e qetësisë publike (neni 274); përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275); vetëgjyqësia (neni 277).

4. Analizë e figurës së veprës penale së dhunës në familje

Ndër kriteret e përdorura për të përcaktuar nivelin e lëndimit përfshihet shkaktimi i paaftësisë për punë si pasojë e lëndimit. Këto klasifikime kanë ndikim në drejtim të ndjekjes penale, sepse plagosja e lehtë me dashje (neni 89) dhe dëmtime të tjera me dashje (neni 90) ndiqen penalisht në bazë të rregullave për ndjekjen private. Megjithatë, plagosja e lehtë me dashje dhe dëmtime të tjera me dashje që cilësohen brenda dhunës në familje, sipas nenit 130/a të KPSH-së, marrin një dëmin më të ashpër dhe ndiqen penalisht *kryesisht*. Ndjekja penale vazhdo dhe kur viktimja refuzon të bëjë kallëzim apo tërhiqet nga procesi në çdo shkallë dhe fazë të procedimit.

Subjektet që gëzojnë mbrojtje sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale janë: bashkëshortët, ish-bashkëshortët, bashkëjetuesit, ish-bashkëjetuesit, gjinia e afërt. Sipas Kodit të Familjes me gjini të afërt kuptohet: të paralindurit, të paslindurit, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe motrave; krushqia e afërt, ku sipas Kodit të Familjes përfshihen prindërit e nuses, dhëndrit, vëllezërit e nuses, dhëndrit, thjeshtri, thjeshtra, njerku, njerka.⁶

Format e shfaqjes së dhunës në familje janë të ndryshme që nga dhuna fizike, e cila është më e dukshme dhe e lehtë për tu provuar nga strukturat, dhuna psikologjike që lidhet me shkatërrimin e ndjenjës së vetëvlerësimit të një individi si pasojë e sjelljes, e fjalëve të një anëtarë të familjes. Kjo mund të përfshijë kritika të vazhdueshme, përçmim, poshtërim, sharje e degradim të personit, izolimin e dhunshëm nga familja, shoqëria dhe puna. Dhuna ekonomike ka të bëjë me kontrollin mbi të ardhurat financiare të familjes apo në ndalimin e pjesëmarrjes së familjarit në vendimet për shpenzimet e parave, madje

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

⁶ Ligji nr. 9062, date 8.5.2003 Kodi i Familjes, i ndryshuar.

dhe refuzimi për para për nevojat bazë të familjes. Dhuna shoqërore ka të bëjë me kontrollin e jetës e të lëvizjeve të viktimës nga dhunuese. Dhuna seksuale përfshinë detyrimin për veprime e sjellje seksuale pa pëlqimi e bashkëshortes/ bashkëshortit, bashkëjetueses/ bashkëjetuesit. Dhuna e asistuar ka të bëjë me dhunimin që pëson personi i cili është i detyruar të asistojë një skenë dhune, ndonëse ai nuk është subjekt i drejtpërdrejtë në dhunë. Këtu mund të përmendim dhunën e asistuar që pëson fëmija ndërsa dhunohet në çdo formë nena e tij apo pjesëtarë të tjerë të familjes.

Dhuna seksuale është një nga format më pak të raportuara si një formë e rëndë e dhunës në familje. Marrëdhëniet seksuale me dhunë mes bashkëshortëve dhe bashkëjetuesve janë shtuar me ligjin nr. 144/2013. Pra në vitin 2013 për herë të parë parashikohet si krim i rëndë kryerja e marrëdhënieve seksuale pa dëshirë mes bashkëshortëve ose bashkëjetuese.

Më konkretisht: *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me te rritura ose mes bashkëshorteve dhe bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre dënohet me burg nga tre gjer në 10 vjet.”*⁷

5. Gjetjet e analizës

Në analizë të figurës së veprës penale, rezulton se objekti i këtij neni janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë, paprekshmërinë seksuale të bashkëshortëve/ bashkëjetuesve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale. Ana objektive apo *modus operandi*⁸ është përdorimi i dhunës fizike dhe psikike. Dhuna dhe mungesa e pëlqimit është element thelbësor për të pasur këtë figurë krimi. Ky nen konkurren me nenin 130 të Kodi Penal *dhuna në familje*. Ana subjektive e kryerjes së këtij krimi është vetëm me dashje të drejtpërdrejtë. Subjekti pasiv është i përgjithshëm, ndërsa subjekti aktiv është i posaçëm, vetëm bashkëshorti apo bashkëjetuese, që të kemi këtë vepër penale. Në rastin e marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, subjekt aktiv mund të jetë secili prej bashkëshortëve apo bashkëjetuesve. Në praktikën tonë gjyqësore, janë dënuar penalisht subjektet aktive, të cilët nuk kanë ushtruar dhunë, por kanë kryer marrëdhënie seksuale me subjektin pasiv në kundërshtim me dëshirën e saj.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale pa dëshirën e subjektit pasiv është konsideruar si vepër penale e kryer në kushtet e dhunës psikike. Jurisprudenca i bën një interpretim shumë të gjerë dhunës, aq sa fut në këtë kategori sjelljeje që mund të quhen shtrënguese, vetëm në një mënyrë krejtësisht indirekte. Dhuna seksuale mes bashkëshortëve, kulturalisht apo në varësi të arsimit të viktimës, shpesh nuk njihet si vepër penale dhe është më pak e adresuar. E rëndësishme në këto vepra penale është trajtimi i viktimës, apo hetimi me në qendër viktimës. Viktimat e dhunës në familje dhe të abuzimit seksual kanë një sërë të drejtash dhe garancish bazuar në ndryshimet e fundit ligjore të vitit 2017 që pësoi Kodi Procedurës Penale. Por, edhe hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur bën një trajtim të investigimit me në qendër viktimën. Neni 58 dhe 58/a parashikojnë një sërë të drejtash të viktimës si: të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim, shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet; të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes; të

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

⁷ Neni 102 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë shtuar me ligjin 144/2013.

⁸ Term latin, mënyra se si është realizuar veprimi kriminal.

zgjedhë mbrojtës/ndihmë juridike falas; të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit; të informohet për arrestimin e autorit, lirimimin. Të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin/pushimin e gjykimit. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre. Gjithashtu, ka të drejtë: të pyetet pa vonesë nga një o.p.gj. ose prokuror i të njëjtës gjini; të kërkojë të dëgjohet nëpërmjet mjeteve audiovizive; të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim; të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit; të kërkojë marrjen e provave;

të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimimin e tij; të informohet për pushimin e çështjes.

6. Përfundime

Për sa i përket masave parandaluese të dhunës në familje, përveç *urdhrave të mbrojtjes* dhe *urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes*, që jo gjithmonë kanë dhënë rezultat, një trajtë e rëndësishme do të ishte koordinimi i strukturave përgjegjëse. Ky koordinim do të shërbente që këto raste jo vetëm të raportoheshin, por këtyre grave dhe fëmijëve, t'u jepej edhe një zgjidhje më afatgjatë, ku të parandalohet përshkallëzimi i dhunës dhe kontakti me autorin. Në këtë kuadër, janë marrë një sërë masash për parandalimin e dhunës në familje. Masa legjislative që konsistojnë në ndryshime ligjore, në miratimin e një pakete ligjore për dhunën në familje, në ashpërsimin e dënimeve penale, apo në krijimin e mekanizmave mbrojtës, strukturave të posaçme pranë qeverisjes qendrore dhe vendore, e cila kulmoi me hapjen e Zyrës së Ndhmës Juridike dhe Koordinimit të Dhunës në Familje, më 25.11.2017, si bashkëpunim i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, e cila në thelb të misionit ka ofrimin e këshillimit ligjor falas, parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje.

Autoritete të tjera përgjegjëse për një reagim të koordinuar janë: bashkitë, policia, punonjës të shërbimeve sociale, gjykata, prokuroria, përfaqësues nga Njësia për mbrojtjen e fëmijëve, o.j.f. të ndryshme që mund të ofrojnë strehëza apo ndihmë psikologjike dhe sociale për viktimat, specialistë të shëndetësisë, përfaqësues nga zyra e përmbarimit, përfaqësues nga drejtoria arsimore, si edhe nga stafi edukues (mësues/e), përfaqësues nga zyra e punësimit, përfaqësues të komuniteteve fetare. Nëpërmjet këtij koordinimi do të ishte i mundur ofrimi i mbrojtjes, informacionit, shërbimit, si dhe adresimi i saj në shërbime të tjera të përshtatshme. Në kuadër të luftës së dhunës në familje, do të vinte në ndihmë edhe organizimi i seancave informuese në shkollë, në komunitet, apo me shtresa vulnerabël ku shpjegohen të drejtat, mënyrat e adresimit të këtij krimi, trajtimi i viktimës, për parandalimin e rasteve ekstreme të dhunës që çojnë deri në vrasje të viktimës.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Referenca

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
3. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
4. Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur, ligji nr. 37/2017.
5. Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 9062, datë 08.05.2003, i ndryshuar.
6. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.
7. Kodi i Procedurës Penale Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 705, datë 21.03.1995, i ndryshuar.
8. Konventa e Këshillit të Europës, "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", ligji nr. 104/2012
9. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar "Për masa ndaj dhunës në familje".
10. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
11. Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar mbi masat për mbrojtjen ndaj dhunës në familje



■ **MSc. Ervid ÇOBAJ**
Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit
ervid.cobaj@asp.gov.al

Abstrakt

Dhuna në familje është një problem i përhapur shëndetësor global, që kapërcen kufijtë dhe ndodh në të gjitha kulturat dhe shoqëritë anembanë botës. Të kuptuarit e veçorive brenda një shoqërie të caktuar është kyç për zhvillimin e reformave legjislative dhe hartimin e politikave, të nismave parandaluese dhe atyre të ndërhyrjes, si dhe të sistemeve të mbrojtjes dhe përkrahjes për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në familje. Në Shqipëri, dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek gratë dhe fëmijët, si edhe tek familjet dhe bashkësitë. Shqiptarët priren ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare, dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Duke qenë se dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet apo trajtohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat përgjithësisht vuajnë në heshtje. Komisarariatet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato të shërbimeve sociale nuk janë të detyruara me ligj të grumbullojnë dhe të prezantojnë të dhëna mbi dhunën. Shqipëria është një nga vendet e pakta në Evropë që nuk regjistron, publikon dhe prezanton zyrtarisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni. Ekzistojnë një sërë argumentesh të cilët kërkojnë të tërheqin vëmendjen e politikanëve lidhur me marrjen e masave parandaluese dhe luftën kundër dhunës në familje siç janë: argumenti i drejtësisë sepse çdo individ duhet të gëzojë të drejtën themelore për të jetuar, argumente të cilësisë së jetës sepse në shumicën e rasteve gratë që i mbijetojnë dhunës në shumicën e rasteve vuajnë nga probleme shëndetësore, psikologjike dhe fizike. Në këto kushte dhuna në familje nuk mund të injorohet si fenomen social por edhe shëndetësor. Numri në rritje i krimeve në shoqërinë tonë është një fakt i dhimbshëm dhe brengosës, institucionet duhet të fokusohen në parandalimin e sjelljeve devijante dhe jo vetëm në pasojat e këtyre sjelljeve. Misioni ynë duhet të jetë reduktimi i krimit, zvogëlimi i shkallës së recidivizmit, krijimi dhe rritja e sigurisë për shoqërinë. Në këtë material do të gjeni të trajtuar konceptet bazë në lidhje me masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, raportit i të drejtës ndërkombëtare me të drejtën e brendshme, gjithçka kjo e trajtuar në një aspekt teorik dhe e ilustruar me disa shembuj nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut si dhe disa raste të praktikës shqiptare në këtë drejtim.

Fjalëkyçe:

dhunë, familja, legjislacion kombëtar, legjislacion ndërkombëtar, masë parandaluese.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

“Jam kundër dhunës pasi edhe nëse në dukje bën mirë,
e mira është e përkohshme, ndërsa e keqja që bën është e përhershme.”
-Mahatma Gandhi

1. Hyrje

Gjendja e grave shqiptare, veçanërisht për sa i përket dhunës në familje, është përqësuar gjatë dhjetë viteve të fundit. Në periudhën e komunizmit problemet e dhunës në familje konsideroheshin tabu. Askush nuk guxonte t'i bënte ato publike. Ato konsideroheshin si jo ekzistuese, ose në rastin më të mirë problemi trajtohej nga Organizata e Partisë. Edhe sot, Shqipëria ende nuk ka një kuadër ligjor që t'i mbrojë gratë nga dhuna në familje, por nuk ka as bashkëpunim midis policisë, juristëve, punonjësve socialë dhe punonjësve të shëndetësisë për të mbështetur gratë e dhunuara. Dhuna ndaj grave shqiptare është përqësuar edhe nga prevalenca e lartë e trafikimit dhe prostitucionit në vend dhe në vendet e Ballkanit.

Dhuna kundër grave në Shqipëri duhet të analizohet në kontekstin e kulturës dhe traditave shqiptare. Studimi i dhunës në familje është i komplikuar, sepse ai është një fenomen që ndodh prapa dyerve. Njerëzit nuk preferojnë të flasin mbi këtë çështje sepse ata e konsiderojnë atë çështje private dhe burim turpi. Gjithashtu, ky problem mbështetet nga mentaliteti tradicional dhe patriarkal që është thellësisht i rrënjosur në kulturën shqiptare. Rrënjët e keqtrajtimit të vazhdueshëm të grave shqiptare nga burrat janë të vjetra dhe të thella dhe janë të lidhura me mungesën e respektit. Duket kontradiktor fakti që Kanuni (kodi i ligjeve zakonore të përdorura në pjesën veriore të Shqipërisë) përfshin akte që e deklarojnë gruan si të paprekshme. Për një kohë të gjatë studimet dhe të dhënat mbi dhunën në familje kanë munguar plotësisht. Në vitin 1996, shoqata e grave “Refleksione”, organizoi të parin studim kombëtar mbi dhunën në familje, financuar nga Programi PHARE Democracy.

Dhuna në familje ka edhe origjinë institucionale. Është e vërtetë që karakteristikat individuale dhe normat sociale e “ushqejnë” dhunën, por këto nuk janë të vetmit shkaqe. Individët ose grupet që ushtrojnë dhunë favorizohen nga mungesa e kuadrit ligjor ose e moszbatimit të ligjit që i bën ata përgjegjës për sjelljet e tyre.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Nuk ka dyshim se viktima e parë e dhunës në familje është vetë gruaja që e përjeton atë. Studimet mbi këtë problem tregojnë se gruaja reagon në forma të ndryshme ndaj dhunës në familje. Shumica prej tyre reagojnë duke fajësuar vetveten për dhunën në shtëpi. Ato gjithmonë besojnë se mund ta kishin shmangur nevrifikosjen e partnerit të tyre. Ato thonë “ah, sikur ta kisha bërë darkën në kohë; ah, sikur të kisha folur me zë më të ulët!”. Ato harrojnë ose nuk duan të besojnë se bashkëshorti violent do të gjejë një arsye tjetër për t’i dhunuar ato. Ato mbartin shumë stres mbi vete duke u përpjekur të kontrollojnë sjelljet e tyre dhe të kënaqin burrat e tyre. Një grup tjetër i grave të abuzuara ndjehen të pashpresa në situatën që ndodhen, sepse ato mendojnë se dhuna në familje është pjesë e jetës bashkëshortore. Ato kanë parë të njëjtin model me nënat e tyre dhe kanë dëgjuar se edhe gjyshet e tyre nuk kanë qenë më mirë. Kështu, ato e konsiderojnë dhunën si pjesë të jetës së tyre. Grupi i tretë i grave të dhunuara fillojnë të nënvleftësojnë vetveten dhe mendojnë se ato nuk janë të përshtatshme për partnerët e tyre, ato besojnë se nuk kanë vlera, se ato nuk vlejnë për asgjë, nuk janë të zonjat të bëjnë asgjë dhe e vendosin veten në pozicion varësie. Gra të tjera reagojnë duke u ankuar për sjelljet e burrave të tyre, fillimisht mes familjarëve dhe më pas, në rastet e dhunës së përsëritur, ato kërkojnë ndihmë tek specialistët. Të tjera gra reagojnë duke u larguar nga shtëpia dhe duke kërkuar strehim tek familjarët apo në strehëzat për gratë. Disa të tjera fillojnë të kenë probleme të shëndetit mendor dhe bëhen të varura tek anëtarë të tjerë të familjes duke e përkeqësuar situatën më tej. Në çdo rast, secila grua e abuzuar gjen mënyrën e saj të reagimit ndaj dhunës, gjë që varet nga niveli i ndërgjegjësimit, i arsimimit, aftësia për të luftuar në mbrojtje të vetvetes, mbështetja që merr nga familja e origjinës, situata ekonomike, mbështetja nga fëmijët, informacioni që ajo ka mbi shërbimet sociale ekzistuese, etj.

Artikulli është mbështetur në dy drejtime kryesore, në drejtimin teorik (shqyrtimi i literaturës) dhe në drejtimin praktik (vëzhgimet direkt dhe indirekte të seancave gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes). Qëllimet e këtij artikulli janë si vijon: të analizohen përmasat, frekuenca dhe natyra e problemit, të identifikohen grupet vulnerabël të dhunës në familje, shkaqet dhe pasojat e saj, të dhënat, ligjet, politikat, programet, studimet dhe shërbimet; të identifikohet pozicioni i aktorëve kyç; të bëhen rekomandime se si të përfshihen aktorë të ndryshëm për ta vazhduar këtë studim me hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ardhshëm. Ne shpresojmë se ky studim do të ketë një impakt në çështjen e dhunës në familje dhe do të rrisë interesimin e publikut.

2. Legjislacioni kombëtar lidhur me dhunën në familje

Parlamenti shqiptar ka kaluar ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili kishte si qëllim të parandalonte dhe të reduktonte dhunën në familje në të gjitha format e saj nëpërmjet masave të përshtatshme ligjore dhe t’u garantonte mbrojtje, nëpërmjet mjeteve ligjore, anëtarëve të familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje.¹

Ligji ka katër objektiva kryesore: 1. krijimin e një rrjeti të koordinuar autoritetesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e

¹ Ligji nr. 10 329, datë 30.9.2010 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje; 2. orientimin e përpjekjeve për krijimin e strukturave dhe të autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal për mbështetjen e viktimave dhe për parandalimin e dhunës në familje; 3. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje; dhe 4. sigurimin/garantimin e shërbimeve të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta për viktimat e dhunës në familje të ofruara nga gjykatat dhe nga agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit, në përputhje me ligjin.

Ligji përkufizon si dhunë “çdo veprim ose mosveprim të një personi ndaj një tjetri, që sjell si pasojë një cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik”. Në vijim, si dhunë në familje përkufizohet “çdo akt dhune i ushtruar ndërmjet personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”. Sipas ligjit, te pjesëtarët e familjes përfshihen: a. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesit ose ish-bashkëshorti/ja ose ish-partneri/ja bashkëjetues; b. vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; c. bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”; d. gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es; e. vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit; f. fëmijët e bashkëshortëve apo të partnerëve bashkëjetues.

Ligji parashikon masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga gjykata (një vendim i lëshuar nga gjykata, i cili parashikon masat mbrojtëse për viktimën) dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (një urdhër i përkohshëm nga gjykata, i cili është i vlefshëm derisa ajo të lëshojë një urdhër mbrojtjeje). Kur kërkesa për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje paraqitet nga policia ose nga prokurori, edhe nëse viktimja (nën presion) dëshiron ta tërheqë padinë/paditë ose ta pushojë çështjen, kjo nuk do të ndikojë në vazhdimin e procesit gjyqësor. Dhe meqë gruaja e dhunuar është dëshmitarja kryesore, ligji e përkufizon atë si “dëshmitare e detyruar për të dëshmuar”. Moszbatimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje përbën veprë penale sipas nenit 320 të Kodit Penal; për pasojë, autori i saj mund të arrestohet pa mandat arresti.²

Në Shqipëri, megjithëse kompetencat e policisë për të hyrë në ambientet private janë përgjithësisht të kufizuara, ky ligj parashikon që policia mund të hyjë në një banesë private në kushtet e dhunës në familje nëse një gjë e tillë kërkohet nga një person, i cili në dukje banon në atë ambient ose nëse punonjësi i policisë ka arsye të besojë që një person në ambient është subjekt i një sulmi ose rrezikon të sulmohet.

Është e rëndësishme të theksohet se ligji organizon gjashtë institucione qeveritare në një rrjet të koordinuar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, për lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Autoriteti drejtues sipas këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 11 Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Sipas ligjit “Për Masat Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, lëshimi i një urdhri mbrojtjeje ose i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk i ndalon palët e interesuara të nisin gjithashtu një proces penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që klasifikohen si vepra penale. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, ekzistojnë

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

² Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 320.

dispozita të tjera që mund të zbatohen për të trajtuar krimet lidhur me dhunën në familje; disa prej tyre lidhen me abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve. Këto vepra penale përfshijnë, por nuk kufizohen te:

- neni 76: vrasja e kryer me dashje (dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet);³
- neni 77: vrasja me dashje që lidhet me një krim tjetër (vrasje me dashje që paraprind, shoqëron, fsheh ose pason një krim tjetër, dënohet me jo më pak se 20 vjet burgim);⁴
- neni 78: vrasja me paramendim (vrasja me paramendim dënohet me burgim nga 15 deri në 20 vjet; vrasja e kryer për interes, hakmarrje ose gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se 25 vjet ose me burgim të përjetshëm).⁵
- neni 79: vrasja me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës (e kryer ndaj një të mituri, ndaj një personi me aftësi të kufizuara fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; kundër një dëshmitari denoncues [të veprës penale], viktimës, palëve të tjera ndërgjyqëse; më shumë se një herë; kundër dy ose më shumë personave; në mënyrë të tillë që i shkakton vuajtje të veçanta viktimës, dënohet me jo më pak se 25 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm);⁶
- neni 84: kanosja (kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit).⁷

Sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë⁸, për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 dhe 106 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e palës së dëmtuar, e cila mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Me fjalë të tjera, çështja shqyrtohet vetëm nëse viktima paraqet një ankim, dhe zakonisht përgatitja e të gjithë çështjes është përgjegjësi e viktimës. Viktima duhet të mbledhë prova dhe dëshmitarë dhe ta paraqesë çështjen në gjykatë. Shteti përgjithësisht nuk asiston në ndjekjen penale.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përmban gjithashtu një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj një bashkëshorti dhe fëmijës/fëmijëve. Kodi i Familjes trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe abuzimin dhe neglizhencën ndaj fëmijëve. Për shembull, neni 62 parashikon që “bashkëshorti abuzues mund të detyrohet të largohet nga banesa bashkëshortore”. Megjithatë, ky nen nuk ka dispozita të tjera procedurale.⁹

3. Legjislacioni ndërkombëtar

Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar konventat ndërkombëtare, rekomandimet e mekanizmat monitorues dhe legjislacionin e brendshëm, më konkretisht:

- *Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* dhe protokollat e saj që sanksionojnë se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare

³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 76.

⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 77.

⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 78.

⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 79.

⁷ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 84.

⁸ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 284.

⁹ Kodi i Familjes, neni 62.

ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.¹⁰

- *Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (“CEDAW”) dhe protokollin e saj shtesë, si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 të Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijëve” dhe protokollet e saj shtesë dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.*¹¹

- Kartën Sociale Europiane të Rishikuar që kërkon që shtetet anëtare të përmirësojnë standardet e tyre të jetesës dhe mirëqenien e tyre sociale.¹²

- Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” që përcakton detyrimet e shteteve të shmangin përfshirjen në akte dhune kundër grave.¹³

- Konventën e Këshillit të Europës “Mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” që u kërkon shteteve anëtare të marrin të gjitha masat për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të hetuar me efektivitet e rastet e trafikimit.¹⁴

- Konventën e Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual” që i kërkon shteteve nënshkruese të marrin të gjitha masat ligjore, administrative dhe institucionale ose masa të tjera për parandalimin e të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për mbrojtjen e fëmijëve.¹⁵

- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, dhe rekomandime të tjera përkatëse.¹⁶

- Rekomandimet e Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAË) të miratuara në vitin 2016 dhe rekomandimet në raportin e parë të vlerësimit mbi Shqipërinë, të Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës “Mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (GREVIO), të publikuara më 24 nëntor 2017.¹⁷

- Legjislationin e brendshëm për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁸, Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,¹⁹ Kodi i Procedurës Civile dhe ai i Procedurës Penale, të ndryshuar, Kodi i Punës, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ligji nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore” i ndryshuar; ligji nr 44/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, etj si dhe një sërë aktesh

¹⁰ Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

¹¹ Marrëveshja ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike.

¹² Karta Sociale Europiane.

¹³ Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”.

¹⁴ Konventa e Këshillit të Europës “Mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

¹⁵ Konventa e Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

¹⁶ Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e grave nga dhuna”.

¹⁷ Rekomandimet e Komitetit mbi eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW).

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 25.

¹⁹ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë.

nënligjore për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit; Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve; Strategjia kombëtare e barazisë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020, etj.

4. Konkluzione

Në përfundim të këtij punimi theksojmë nevojën për veprim nga një gamë e gjerë aktorësh, duke përfshirë qeverinë e Shqipërisë, organizatat kombëtare, OJQ-të lokale, policia, zyrtarët ligjorë dhe gjyqësor, punonjës të përkujdesje shëndetësore, dhe drejtuesit e komunitetit. Fushat në të cilat duhet të punohet përfshijnë:

- fuqizimin e angazhimit dhe veprimit kombëtar në trajtimin e dhunës në familje (p.sh. në promovimin e barazisë gjinore dhe të së drejtave të grave, si dhe pajtimin me marrëveshjet ndërkombëtare; drejtimin e fushatave efektive të lobimit rreth çështjes së dhunës në familje; themelimin, implementimin dhe monitorimin e përgjigjeve shumë-sektoriale të koordinuar për të trajtuar dhunën në familje; përfshirjen e drejtuesve politik, të komunitetit, fetar dhe të tjerë për të folur kundër dhunës në familje; përmirësimin e kapacitetit të mbledhjes së të dhënave në monitorimin e dhunës në familje);

- promovimin e parandalimit (p.sh., fushata për ndryshimin e sjelljes për të pakësuar dhunën në familje);

- fuqizimin e reagimit të sektorit mjekësor të kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje (p.sh., zhvillimin e një reagimi gjithëpërfshirës të sektorit mjekësor të kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje që do të përmirësonte veprimet e punonjësve mjekësor të kujdesit shëndetësor në identifikimin, trajtimin, mbështetjen, dhe këshillimin e viktimave të dhunës në familje; trajnimin e punonjësve mjekësor të kujdesit shëndetësor mbi problemet e shëndetit fizik, riprodhues dhe mendor të përjetuar nga viktimat e dhunës në familje; zhvillimin e procedurave, protokolleve, dhe mjeteve të vlerësimit për identifikimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje).

- mbështetjen e grave që jetojnë me dhunë në familje dhe ofrimin e mbështetjes dhe shërbimeve ndaj grave që kërkojnë të largohen nga marrëdhëniet e dhunshme së bashku me fëmijët e tyre (p.sh., fuqizimin e mbështetjes së qendrave të ndihmës për gratë që jetojnë me dhunë në familje; ofrimin e shërbimeve strehuese ndaj grave kur ato duan të largohen nga një marrëdhënie e dhunshme; zhvillimin e një sistemi referimi);

- sensibilizimin e policisë, zyrtarëve ligjorë dhe gjyqësor ndaj dhunës në familje, nevojave të viktimave të dhunës në familje, dhe praktikave më të mira për ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje;

- ndëshkrimin e dhunuesve.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Referenca

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Konventa e mbrojtjes ë të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.
3. Deklarata universale e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1948.
4. Pakti ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
5. Deklarata universale e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1996.
6. Pakti ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat qytetare dhe politike, 1996.
7. Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (CEDAW), 1979.
8. "Protokolli fakultativ", Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, 1999.
9. Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës ndaj grave, 1993.
10. Konventa e Këshillit të Europës "Mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual".
11. Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë.
12. Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
13. Kodi i Familjes.
14. Ligji nr. 10 329, datë 30.9.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18. 12. 2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

~ Sesiioni II ~

Praktika të trajtimit të konflikteve, dhunës dhe vrasjeve brenda familjeve shqiptare

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Këndvështrim kulturor i dhunës ndaj grave



■ **Dr. Merita PONI**

Dept. Sociologji, Universiteti i Tiranës
meritaponi@gmail.com

Abstrakt

Artikulli analizon faktorët kulturorë që nxisin vrasjen dhe dhunën ndaj grave. Normat tradicionale veprojnë njëtrajtësisht pavarësisht vendndodhjes gjeografike dhe shërbejnë si rregullatorë të sjelljes në familje dhe bashkësi. Kultura shërben si një gjenerator i fuqishëm në përcimin e vlerave morale. Lidhur me pozitën brenda familjes, gratë kanë një vend të nënrenditur ndaj burrave dhe madje konsiderohen si pronë e bashkëshortëve. Gratë në studim dëshmojnë se janë përballur në mënyrë sistematike me dhunën psikologjike dhe fizike të bashkëshortëve. Konfliktet me familjarët kanë qenë të shumtë dhe si fitil kanë shërbyer paragjykimet që flenë në shtratin e normave kulturore. Gratë shprehen se shpeshësia me të cilën ato paragjykojnë i ve ato në një gjendje alarmante ankthi. Ato pohojnë se paragjykimet përdoren si justifikim për t'i ndëshkuar moralisht dhe fizikisht. Normat kulturore që justifikojnë dhunën ndaj grave po ndikojnë edhe në (keq)edukimin e brezit të ri. Me gjithë imponimin kulturor, gratë nuk e gjejnë veten tek përkufizimet tradicionale. Përplasja mes normave tradicionale që vendosin gruan nën autoritetin mashkullor dhe kërkesave të kohës për sukses personal, autonomi dhe vetëmjaftueshmëri ekonomike përbën një burim të pashtershëm konflikti brenda familjes. Për të ndrequr pasojat e ndikimeve kulturore, duhet një ndërhyrje më e madhe e organizmave shtetërore në sferën e marrëdhënieve private që t'i mbrojnë gratë prej dhunës në familje.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Fjalëkyçe:

kulturë, familje, marrëdhënie gjinore, gra, dhunë.

1. Hyrje

Ky studim ka në fokus elementet kulturore që ndikojnë në nxitjen e dhunës ndaj grave, siç janë normat tradicionale, lidhur me rolet sociale dhe stereotipat gjinore. Studimi shqyrton ndikimin që këto norma kanë tek paragjykimet ndaj grave dhe se si paragjykimet për gratë jetësohen në kontekstin kulturor dhe social, në sferën private të familjes. Studimi është bërë me gratë e zonës së Farkës, komunë e qarkut të Tiranës, dhe gjetjet u përkasin kryesisht atyre, por, në shkallë të caktuar, mund të kenë vlefshmëri edhe për gratë në kontekstin aktual kulturor në Shqipëri. Studimi jep një panoramë të paragjytimeve për gratë, përgjatë periudhës së tranzicionit passocialist.

Paragjykimet vendosin pengesa të shumta kulturore për arritjet e vajzave dhe grave në planin personal dhe si grup shoqëror. Pengesat mund të variojnë që nga nënvlerësimi i aftësive e deri tek nënrenditja e grave si shtresë më e ulët sociale, që Simone de Beauvoir do ta cilësonte si “seksi i dytë” (de Beauvoir, S., 20023:425). Pasojat e paragjytimeve për gratë janë të shumta dhe rezultojnë në pabarazi të thella mes grave dhe burrave në shumë aspekte të jetës, kryesisht në pasuri, status dhe ndikim shoqëror, pasi vetë përkatësia gjinore cilësohet prej studiuesve si një prej shembujve më domethënës të shtresëzimit shoqëror (Giddens, A., 1997:227). Dallimet në pasuri dhe status janë ngushtësisht të lidhura edhe me një lloj tjetër të diferencimit shoqëror, me përjashtimin nga sfera influente e pushtetit publik që ushtrohet përmes pjesëmarrjes në politikë.

Paragjykimet janë mendësi që ndikojnë tek qëndrimet. Ato janë konstrukte psikosociale të formuara në kohë dhe jo të dhëna një herë e përgjithmonë. Forca me të cilën shfaqen dhe godasin paragjykimet kushtëzohet prej shumë faktorëve, ndër të cilët më i rëndësishmi është mjedisi shoqëror me elementët përbërës: normat kulturore

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

(besimet, qëndrimet, vlerat), struktura dhe funksionimi i institucioneve shoqërore (familja, edukimi, puna dhe feja) si dhe ndërveprimi simbolik mes njerëzve që bashkëjetojnë në këtë mjedis. Në vendet ish-socialiste, pozita e grave është përkeqësuar sepse ato humbën një pjesë të së drejtave të fituara në socializëm, siç ishin: pjesëmarrja në punë, përfaqësimi në politikë dhe mbrojtja sociale për fëmijët. Pas vitit 1990, me rifillimin e funksionimit të ekonomisë së tregut, marrëdhëniet shoqërore u marketizuan, mbrojtja shoqërore ra, mundësitë e jetës për gratë u përkeqësuan dhe barazia sociale u zhduk nga fjalori politik (Fraser, N., 1997:3).

Gjithashtu, regresi socio-ekonomik u shoqërua edhe me një rritje të valës së paragjyqimeve kundër vajzave dhe grave, duke justifikuar edhe heqjen e përfitimeve të mëparshme, me pretekstin se u ishin dhuruar dhe nuk i kishin fituar me meritë. Një mendësi e tillë ka qenë përhapur edhe në vendin tonë, fill pas shpërbërjes së regjimit socialist. Në kushtet e transformimit të thellë të shoqërisë shqiptare, gjatë viteve të tranzicionit passocialist, paragjyqimet për gratë u rikthyen me një forcë të shtuar goditëse. Megjithëse përgjatë shekullit të XX, punësimi i grave përmirësoi pozitën e tyre në sferën ekonomike, juridike dhe shoqërore, sfera private e familjes u prek më pak nga këto ndryshime (Pomeranz, K., 2009: 123; Wolf, M., 1985:125). Familja vazhdoi të ishte mbretëria e patriarkatit, ku vajzat dhe gratë vuanin më së shumti rrjedhojat e shumanshme të paragjyqimeve shoqërore. Brenda mureve të shtëpisë, ende gratë vazhdojnë të mbajnë të vetme mbi shpatullat e tyre peshën kryesore të përgjegjësisë të përkujdesjes dhe shërbimit.

2. Metodologjia sasiore

Ky studim u mbështet në metodologjinë sasiore të kërkimit social. U përzgjedh kjo metodë kërkimi për arsye se shërben edhe për të pasqyruar gjendjen edhe për të investiguar shkaqet e paragjyqimeve. Shkaqet për sjelljen paragjyquese mund të jenë personale (si niveli i lartë i konformizmit me stereotipat dhe autoritarizmin e theksuar) dhe shoqërore (imponim i normave kulturore mbi individin). Në këtë kërkim theksi është vënë më shumë tek këto të fundit, duke i ndërlidhur reciprokisht me karakteristikat e pjesëmarrëseve në studim si mosha, statusi martesor, arsimi, punësimi, etj.

Kërkimi sasior përmbledh disa hapa studimi si: shqyrtimi i kuadrit teorik, përcaktimi i çështjeve të kërkimit, hartimi i projektit studimor, përcaktimi i koncepteve që do përdoren më dendur në studim, përzgjedhja e vendit, përcaktimi subjekteve, mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave dhe rezultatet e kërkimit. Metodologjia sasiore është ngushtësisht e lidhur me anketimin, i cili përfaqëson ende një ndër metodat më të rëndësishme në fushën e kërkimeve sociologjike (Dervishi, Z., 1998:43).

Megjithëse është huazuar si koncept prej shkencave të natyrës, matja në kërkimin sasior nuk ka të njëjtin kuptim si në shkencën e fizikës, pasi sjellja njerëzore nuk katribute të matshme fizike. Me matje në shkencat sociale kuptohet vlerësimi itributeve, karakteristikave dhe veçorive dalluese të njerëzve në lidhje me sjelljen e tyre, si grup shoqëror ndaj dukurive shoqërore. Në këtë studim me matje kuptohet përcaktimi dhe vlerësimi i tyre karakteristikave të subjekteve të kërkimit që kanë kuptim për studimin dhe të tilla janë atributet demografike si: mosha, vendbanimi, përkatësia krahinore ose nënkulturore, përkatësia fetare, statusi martesor, niveli i arsimimit dhe punësimi. Këto karakteristika kanë kuptim për studimin sepse ndikojnë në peshën që kanë paragjyqimet tek vajzat dhe gratë dhe në reagimet e vajzave dhe grave ndaj tyre.

Përmes matjes, në studim, janë saktësuar në mënyrë më të qartë lidhjet (korrelacionet) mes koncepteve si ndikimi i nivelit të shkollimit tek statusi i punësimit ose ndikimi i pavarësisë ekonomike tek „imunizimi” ndaj pasojave të paragjykimeve, etj. Koncepte të tilla si opinionet dhe qëndrimet e të anketuarave për aftësitë e grave, për vlerat morale, për format e reagimit kundër paragjykimeve janë të pamatshme në kuptimin e ngushtë të fjalës, por duke përcaktuar tregues për matjen e parapëlqimeve, besimeve dhe qëndrimeve në pyetësonin e anketës është bërë e mundur që të përcaktohen shkallë matëse. Këto koncepte janë matur duke përdorur teknika kërkimi të tilla si shkallën e Likertit (me pesë pohime), përzgjedhjen parësore të përgjigjeve alternative të pyetësorit, përcaktimin e përgjigjes për nga rëndësia sipas opinionit të përgjigjedhënesës, etj. Qëndrimet mund të maten vetëm në mënyrë të tërthortë duke koduar përgjigjet gjatë përpunimit së të dhënave. Kërkimi sasior paraqet epërsi edhe për shkak se informacioni i mbledhur përpunohet më lehtësisht me anë të metodave matematikore dhe informatizimit, duke kuantifikuar përgjigjet e duke i paraqitur ato në vlera sasiore. Natyrisht, duke pasur parasysh faktin se “numrat nuk flasin vetë”, të gjitha paraqitjet statistikore janë interpretuar.

3. Ndikimet kulturore tek mendësitë qw mbështesin dhunën ndaj grave

Në Farkë, popullsia ka përbërje heterogjene: me vendas nga pjesa kodrinore dhe malore e Tiranës dhe me të ardhur kryesisht nga rrethet e Kukësit dhe të Dibrës. Megjithëse në mendësitë e shumicës së banorëve veprojnë norma kulturore të krahinës së Tiranës, ekziston edhe një përzierje e ndërsjellët nënkulturash mes vendasve dhe të ardhurve për shkak të bashkëjetesës disavjeçare në të njëjtin territor. Edhe pse mund të mos kenë ndikimin e dikurshëm, normat tradicionale, të mbartura ndër shekuj dhe të përmbledhura në kode sjelljeje, veprojnë ende dhe shërbejnë si rregullatorë të sjelljes në familje dhe bashkësi. Kanunet me më shumë ndikim janë: Kanuni i Bendës - për vendasit; Kanuni i Lumës - për banorët me origjinë nga qarku i Kukësit dhe Kanuni i Skënderbeut - për banorët e malësisë së Tiranës dhe Dibrës. Të tre kanunet kanë shumë ngjashmëri me Kanunin e Lekë Dukagjinit, aq sa duken si nënvariate të tij. Kanunet kanë pasur shumë ndikim në mendësitë dhe sjelljen e banorëve të zonave rurale dhe kanë shërbyer si *ligje* për banorët. Ndikimit të tyre nuk i shpëtonte dot asnjë familje pa u ndëshkuar moralisht nga bashkësia. Agjencia e kontrollit kolektiv ka shërbyer si mekanizëm për zbatimin dhe ruajtjen e normave kanunore deri në ditët e sotme. Sikurse thuhet në Kanunin e Skënderbeut “Kanuni asht ligj për të gjithë, përndryshe ndahesh prej shoqnisë” (Ilia, F., 1993:17). Ndëshkimet për moszbatim të normave kanunore nuk ishin vetëm morale, por edhe materiale, si: djegie shtëpie, grimja katundarisht e pjesëtarit të familjes që nuk zbatonte kanunin, lëçitja ose dëbimi i familjes nga vëllazëria e katundi, djegia e shtëpisë dhe rrënimi i pasurisë, gjobat, etj.

Me gjithë ngjashmërinë mes tyre, kanunet dallojnë për nga ngjyresat nënkulturore që kanë ndikim tek banorët mbi të cilët zbatohet. Të ardhurit në Farkë, duke qenë nga Kukësi dhe Dibra, kanë rrjetin e tyre simbolik të vlerave nënkulturore, i cili ndryshon paksa nga ai i nënkulturës tiranase. Të ardhurit janë të lirë t’i përmbahen vlerave të nënkulturës së tyre, për aq kohë sa nuk janë në kundërshtim me normat e vlerat të vendasve. Për ruajtjen e traditës nënkulturore nga komunitetet e ardhura në një zonë pritëse, si pasojë e migrimit të brendshëm Zyhdi Dervishi shprehet: “Në shoqërinë

AKADEMIA E SIGURISË


Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

tradicionale shqiptare, komunitetet e vogla të banorëve të një fisi ose fshati kishin hapësirë të konsiderueshme të zhvillonin traditat e veta nënkulturore, me kusht që të mos cenonin normat kryesore kulturore dhe interesat e grupimeve shoqërore më të mëdha si banorët e bajrakut” (2013:35). Gjithashtu, etnografia shqiptare, Andromaqi Gjergji që ka studiuar me imtësi mënyrën e jetesës së banorëve të fshatrave, vëren se “në jetën e përditshme marrëdhëniet e jetës familjare në fshat rregulloheshin nga norma e zakone të pashkruara kanunore” (2002:48).

Në studim 72.0 për qind janë gra të martuara, të cilat dëshmojnë se kanë qenë pre e paragjyqimeve të shumta në të gjitha fazat e jetës bashkëshortore që nga fejesa e deri sa janë bërë nëna. Edhe pse janë paragjykuar më shumë në martesë, gratë pohojnë se me paragjykimet në familjen dhe fisin e bashkëshortit janë përballur më herët, që në fejesë, ku 21 për qind e grave janë paragjykuar si të fejuara dhe 23 për qind janë paragjykuar si nëna. Përqindja relativisht më e ulët e paragjyqimeve në kohën e fejesës ka të bëjë me faktin se, gjatë kohës që janë të fejuara, vajzat nuk jetojnë në shtëpinë e bashkëshortit e, për pasojë, familjarët dhe të afërmit e tij nuk kanë mundësi të kenë kontakte, ndërveprim dhe komunikim të përditshëm me to.

Shkaqet e paragjyqimeve në familjen e bashkëshortit



Martesa e sjell gruan në shtëpinë e bashkëshortit që bëhet edhe banesa e re e saj, ku mund të kalojë pjesën më të madhe të jetës së saj. Në shtëpinë e burrit, nusja bëhet pjesëtare e familjes së tij. Që në fejesë familjet e të fejuarve kanë deklaruar se tani ata u bënë një shtëpi, përmes miqësisë së lidhur me fejesën e fëmijëve të tyre. Në martesë, gruaja, bashkëshorti dhe familjarët e tij janë në një marrëdhënie shumë më të ngushtë se sa në fejesë. Gjatë bashkëjetesës me gruan, familjarët e bashkëshortit kanë mundësi të konfirmojnë paragjykimet dhe hamendësimet mbi karakterin dhe sjelljen e saj. Gratë janë ndjerë thujse njësoj të paragjykuara nga familjarët e bashkëshortit në martesë, 65.4 për qind, pothuajse sa edhe në fejesë, 68.3 për qind.

Paragjykimet në martesë janë të një natyre tjetër nga paragjykimet në fejesë. Nëse në fejesë, familja e djalit interesohej për familjen e vajzës, më shumë se sa për vajzën, për të lidhur një krushqi të mirë, në martesë ajo që vihet në shënjestër të paragjyqimeve është vajza si grua e martuar tashmë, e cila vihet në provë për të vërtetuar nëse krushqia ja ka vlejtur apo jo, pra gruaja e martuar tregon edhe vlerën e familjes së saj. Paragjykimet në martesë përkundrajt grave bëhen më shumë në drejtim të sjelljes dhe shkathtësisë për punë. Këto kanë qenë edhe kriteret mbi të cilat nusja është marrë, shëndeti i mirë për të punuar dhe sjellja e mirë për të duruar. Sikurse thuhet edhe në Kanunin e Bendës:

“Gruja e mirë nuk qet za” (Goci, H., 2010:49). Paragjykimet ushqehen nga tradita kulturore, sipas së cilës gruaja duhet të durojë shumë dhe shërbejë mirë. Gratë e sotme mund të mos i përmbushin krejtësisht këto pritshmëri të familjarëve të burrit, sado të sjellshme dhe punëtore të jenë. Ato nuk mund të sakrifikojnë personalitetin e tyre për hir të normave të lindura në shekujt e kaluar dhe që i vendosin gratë në pozitë shumë inferiore në familje, më të ulët edhe se të një fëmije, me gjithë zbatimin e tyre deri pak dekada më parë. Prandaj, gratë paragjykohe si për sjelljen ashtu edhe për aftësitë e tyre për të shërbyer me përlulesi nën urdhrat e familjarëve të bashkëshortit.

3.1 Nënrenditja patriarkale e grave

Janë paragjykuar nga bashkëshorti 13.7 për qind e të anketuarave. Pozita e burrit ndaj gruas në traditën kulturore kanunore zë një vend të veçantë. Për arsye se shumica e paragjytimeve për gruan burojnë nga mënyra se si është rregulluar marrëdhënia burrë-grua në normat kanunore, është në interes të studimit të parashtrihen për analizë këto rregullime. Bashkëshorti është personi më të cilin gruaja ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe natyra e kësaj marrëdhënie në norma dhe në realitet meriton një vëmendje të veçantë. Moszbatimi me përpikëri i normave kanunore në jetën e përditshme shkakton një mori paragjykimesh kundrejt grave të martuara. Edhe paragjykimet e të tjerëve ndaj gruas lidhen shpesh me qëndrimet e saj ndaj normave kanunore në marrëdhëniet me bashkëshortin.

“Në familjen patriarkale, burri zë vendin kryesor në veprimtarinë ekonomike, ndërsa gruaja nuk ka rol as në ekonomi, as në shoqëri” (Tirta, M., 2001:232). Bashkëshorti ka një vend të privilegjuar në familjen shqiptare, sipas traditës kulturore. Në të gjitha kanunet, burri njihet si i pari i shtëpisë dhe si autoriteti i padiskutueshëm para gruas dhe fëmijëve. Vetëm burrit i lejohet të ketë jetë shoqërore, jashtë shtëpisë dhe të marrë pjesë në pleqësi e kuvend. Në normat kulturore kanunore ka pasur ndikim të madh edhe feja islame, sipas së cilës: “Burri është më i pushtetshëm se gruaja, për dy arsye: e para, për shkak se është më i fuqishëm dhe e dyta për shkak se ka përgjegjësinë për institucionin e familjes”. Prej këtij buron pozita e privilegjuar e burrit si udhëheqës i familjes dhe pozita e nënrenditur e gruas si qenie e varur nga burri. Sipas islamit, vatra familjare është si një shtet i vogël ku burri gëzon të drejta të pakufishme ndaj gruas, sepse është zot shtëpie, përgjegjës i familjes, autoriteti i shtëpisë; pas tij janë të lidhur gruaja dhe fëmijët, ndërsa gruaja i bindet zotit të shtëpisë. Studiuesi i të drejtës së familjes, Beqir Topalloglu ka vënë në dukje se:

“Në Kuran, burrat drejtojnë, ndërsa gratë binden. Edhe sipas koncepteve të sotme juridike, në institucionin e familjes burri zotëron të drejta prioritare në raport me gruan. Gruaja mban mbiemrin e tij dhe e ndjek pas, ai vendos për shtëpinë dhe përfaqëson familjen, pa lejen e tij gruaja nuk mund të merret me ndonjë punë, ajo nuk përziehet në punë të fëmijëve përveç rritjes dhe edukimit të tyre.” (Topalloglu, B., 1997:90). Sipas normave kanunore, e vetmja detyrë e burrit ndaj gruas është t’i sigurojë asaj dhe fëmijëve ushqim: “Burrat nuk punojnë në shtëpi, ata shërbehen për çdo gjë prej grave” (Young, A., 2000:22).

3.2 Rrahja e gruas

Gruaja në kanun nuk trajtohet si një qenie madhore me të drejta si të burrit. Ajo ka

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

“ Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare ”

një pozitë thujse fëmijërore në shtëpi, për sa i përket të drejtës së fjalës dhe vetëkontrollit. Edhe në gjuhën jo verbale gruaja detyrohet prej normave kanunore të mbajë një qëndrim trupor dhe pamor prej të nënshtruarë (qëndrim gatitu në këmbë, me kokën ulur dhe sytë përtokë) në shenjë përlulje ndaj autoritetit mashkullor, kushdo qoftë ai: bashkëshorti, babai, vëllai më i madh, vjehëri, kunetërit, etj. Për këtë dukuri shprehet edhe studiuesi i kulturës shqiptare Zyhdë Dervishi: “Në shoqërinë tradicionale shqiptare, vajza ose gruaja kur bisedonte me babanë, vëllanë më të rritur dhe sidomos me bashkëshortin, nuk i shikonte në sy, por e mbante kokën dhe shikimin ulur. Një model sjelljeje i tillë, ... shprehte status të nënrenditur të vajzës ose gruas.” (2008:372).

Burri mund ta shajë, qortojë dhe ndëshkojë me fjalë dhe më dhunë fizike gruan nëse e sheh të arsyeshme. Normat kanunore e ndalojnë gruan t’i kthejë fjalë burrit dhe ajo duhet të bëjë si t’i thotë ai: “Rrahja e gruas kur shihet e arsyeshme vlerësohet si një mënyrë e vënies se të drejtës së burrit në vend nga ana e kanunit” (Young, A., 2000:22). Kur gruaja i kthen fjalë burrit, ajo quhet e *pasoj*, pra nga familje jo e mirë. Ndaj gruas ushtrohet një trysni e dyfishtë për t’u sjellë mirë sipas kanunit, pra t’i bindet pa kushte burrit dhe familjarëve, sepse: e *para* nderon veten dhe e *dyta* nderon sojin, familjen e saj.

Në kanunin e Bendës thuhet se “Burri ka tagër t’i bërtasë dhe ta rrahë gruen kur t’i kthehet fjala e kur s’i bindet” (Goci, H., 2010:47). Në kanunin e Lumës, në nenin 130, rrahja e gruas ligjërohet kur ajo nuk e dëgjon burrin dhe familjarët e tij: “Burri ka të drejtë me e rrehë, me e lidhë, e mshelë (mbyllur) brenda gruen kur ia kthen fjalën e kur nuk ndigjon” (Hoxha, Sh., 2013:106). Nëse gruaja ankohet tek prindërit e saj për dhunën e të shoqit, këta mund t’i kërkojnë arsyes dhëndrit se përse ai ua dhunon vajzën që ata ia kanë dhënë “për rrnës, jo për kmës” (për të jetuar, jo për ta mbytur), dhe po qe se ky nuk pranon të japë shpjegime, atëherë çështja del në pleqni. Por, sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 168, kur gruaja ikën prej burrit, sepse ai “ja *nxin jetën*”, prindërit e saj ja çojnë prapë burrit në derë, nëse binden se ajo ka faj dhe e sigurojnë burrin se ajo “s’ka me ba ma faj” (Hoxha, Sh., 2013:112). Po qe se gruaja nuk pranon të kthehet më tek burri, shtëpia e saj bie në gjak më burrin. Dhuna mund të shkojë deri aty sa burri mund edhe ta ndëshkojë gruan me “çupim”, dëmtim të fytyrës si prerja e hundës, e buzëve dhe plagë të tjera që lenë shenja të pashlyeshme. Megjithëse parashikohet në Kanun, një ndëshkim i tillë nuk është zbatuar në praktikë.

3.3 Vrasja e gruas sipas normave kulturore kanunore

Kanuni i Bendës i jep të drejtë burrit ta vrasë gruan “për nder të prish për dy punë: për kurvni e për mik të premë” (Goci, H., 2010:47). Gjithashtu, burri e vret gruan edhe kur ajo vjedh pasurinë e shtëpisë dhe e ndan atë tek të tjerët. Në rast se nusja ikën me një burrë tjetër, prindërit e saj bien në gjak me shtëpinë e dhëndrit të parë (Po aty:52). Edhe në Kanunin e Lumës, lejohet vrasja e gruas kur ajo “zihet nja më nja (njëri përmbi tjetrin) me një burrë të huej”, kur vret fëmijën e saj dhe kur pret mikun në besë” (Hoxha, Sh., 2013:100). Fëmijët nuk i përkasin nënës me kanun, por babait, përmes linjës së gjakut, prandaj nëna që vret fëmijën, vritet sepse ka vrarë fëmijën e burrit, pra i ka një gjak borxh familjes së burrit, i cili lahet vetëm më gjak. Ndërsa babai që vret fëmijët e vet nuk i ka gjak kurrkujt se ka vra “pjellën e vet”. Në Kanunin e Skënderbeut, gruaja vritet për dy arsye: për tradhti bashkëshortore dhe për mik të premë në besë. Gruaja konsiderohet se ka kryer tradhti bashkëshortore nëse ajo kapet në flagrancë dhe

jo kur i dalin fjalë. Nëse i dalin fjalë, që është mirë të vërtetohen, ajo ndahet nga burri, por normat kanunore e lejojnë ndarjen me fjalë edhe po nuk u vërtetuan ato.

Gruan që kryen tradhti ndaj burrit e vret si rregull i shoqi, por nëse ajo zihet në akt e sipër me ndonjë, ajo vritet prej atij që e sheh. Në Kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 175, thuhet se gruaja që vritet për imoralitet nuk ka të drejtë varri, trupi i saj i hidhet kafshëve ta hanë: “*Gruen e shnjërueme (e përdalë) që gjendet nja më nja me një burrë të huej e vret kush e gjen për seri, ajo nuk ban gjak, nuk shtihet në dhe, xhenazen (kurmin) le t’ia hanë sorrat*” (Ilia, F., 1993:113). Për gruan e martuar, fishekun e japin prindërit e saj tek burri, që ky ta vrasë nëse ajo ikën nga shtëpia dhe nëse pret mikun në besë. Ndërsa në paragrafin 1889, thuhet se gruaja dhe vajza në moshë martese vriten “*kur zihen keq dhe fishekun e lëshon vetë katundi në shpinë të saj*” (Po aty:149). Gruaja vritej edhe kur lindte fëmijën e parë para kohe. Për lindje të parakohshme, në muajin e shtatë të shtatzënisë me sa duket nuk kishte njohuri, dhe gruaja vritej pasi, sipas kanunit, fëmijën e kishte konceptuar në marrëdhënie paramartesore ose jashtëmartesore. Në Kanunin e Bendës thuhet: “*Nëse u martu e lind gruaja para kohe, burri ka të drejtë me i futë fishekun pas shpine*” (Goci, H., 2010:48).

4. Diskutim mbi gjetjet

Paragjykimet për gratë janë shprehje e perceptimit shoqëror për rolet sociale të grave dhe ndikojnë në realizimin e mundësive vetjake të tyre. Në këtë kuptim, paragjykimet lipsen parë lidhur ngushtë me perceptimet shoqërore të ndikuara thellësisht nga elementet kulturore të mjedisit shoqëror në të cilin zhvillohen. Kultura shërben si një gjenerator i fuqishëm për agjencitë shoqëruuese që përçojnë tek pjesëtarët e së njëjtës kulturë normat dhe vlerat morale të asaj shoqërie. Procesi shoqëruues i ekspozon të gjithë individët, që në lindje ndaj formësimit kulturor, pavarësisht gjinisë së tyre. Gjithashtu, duke marrë parasysh faktin se paragjykimet janë konstrukte sociale dhe jo të dhëna njëherë e përgjithmonë, ky studim trajton edhe mundësitë dhe dinamikën e ndryshimit të paragjykimeve.

Me gjithë ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe ndryshimet politike që kanë pasuar shpërbërjen e regjimit socialist, paragjykimet për gratë vazhdojnë të jenë rezistente ndaj ndryshimeve. Rezistenca kulturore që shprehet përmes ruajtjes së normave konservatore nxit paragjykimet dhe diskriminimin për vajzat dhe gratë. Varësia ekonomike dhe niveli i ulët i ndërhyrjes së organizmave shtetërore në sferën e marrëdhënieve private, për të marrë në mbrojtje interesat e gruas, e kanë ekspozuar këtë të fundit ndaj formave të shumta të diskriminimit. Për më tepër, që pas vitit 1990, në zonën ku kryhet studimi ka një prani të shtuar të familjeve të zhvendosura nga krahina të tjera, në kërkim të një jete më të mire, pranë kryeqytetit. Prania e të ardhurve dhe mosnjohja me vendasit ka ndikuar në rritjen e vigjencës së ndërsjellët të së dyja grupimeve ndaj sjelljes së vajzave dhe grave që shprehet më së shumti në marrjen në kontroll të lëvizjeve jashtë shtëpisë, shoqërimin jashtë shtëpie vetëm me meshkuj ose të afërm të familjes, ndalimin e shoqërimit me meshkujt me të cilët nuk kanë lidhje fisnore, e deri në izolim shtëpiak. Edhe pse ushtrohet “në interes” të nderit të vajzave dhe grave, kontrolli i tyre nga meshkujt ka shkaktuar probleme serioze për të drejtat e vajzave dhe grave siç janë: braktisja e shkollës, pengimi i iniciativës private ekonomike, mungesa e lirisë së zgjedhjes e deri kufizimi i mundësive për punësim.

Jo vetëm kultura e vendit në përgjithësi, por edhe nënkultura në veçanti ndikon në

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

shkallën e paragjytimeve për gratë. Në zonën ku është kryer studimi, elementët nënkulturorë të zonës janë përzier me element të nënkulturave të tjera të mbartura nga familjet e ardhura në zonë si pasojë e migrimit të brendshëm. Kësaj përzierje nënkulturore i mbivendoset edhe difuzioni kulturor që përcillet në zonë nga të afërmit të banorëve të zonës që janë emigrantë jashtë shtetit e që vijnë të qëndrojnë herë pas here në zone dhe që ruajnë komunikim të vazhdueshëm me familjen e origjinës. Studimi reflekton ndikimin që kjo mbivendosje kulturore ka në evoluimin e paragjytimeve për gratë në zonën e Farkës. Paradoksalisht, në vend që të ofronte mundësi integrimi në jetën kryeqytetase, migrimi ka çuar në izolim shtëpiak të grave të ardhura. Gjithashtu, qëndrimet e vendasve dhe mendësitë e të ardhurve kanë çuar në grupim të tyre sipas përkatësisë krahinore.

Vajzat dhe gratë e kanë të vështirë të përshtaten me kërkesat e normave kulturore dhe sjelljen prej skllaveje të gruas në familjen e bashkëshortit. Ato janë të arsimuara, një pjesë edhe me shkollë të lartë. Ky brez i mirëarsimuar nuk e gjen veten tek përkufizimet tradicionale të normave kulturore për vajzën dhe gruan dhe përpiqen t'i kundërshtojnë normat. Përplasja mes kërkesave të traditës së të kaluarës, që e mbanin gruan të ndrydhur dhe të shtypur nën autoritetin mashkullor brenda familjes dhe kërkesave të kohës për sukses personal, autonomi dhe vetmjaftueshmëri ekonomike është një burim i nxehtë konflikti mes brezit të vjetër dhe vajzave dhe grave që jetojnë në shoqërinë pasmoderne.

5. Përfundime

Me rënien e regjimit socialist totalitar dhe rikthimin tek tradita kulturore, pozita e gruas pësoi regres për sa i përket të drejtave si individ brenda dhe jashtë familjes. Rikthimi tek normat kanunore ndodhi në një moment kur shteti u shpërbë, dhe kur shoqëria u ndodh në kushtet e anemisë së vlerave. Kapja pas vlerave të së shkuarës ishte si një varkë shpëtimi për familjen e gjendur në dallgët e pamëshirshme të ndryshimeve shoqërore. Rënia e regjimit socialist u pasua nga shembja e sektorit të prodhimit bujqësor dhe industrial në vend, gjë që shkaktoi shpunësim masiv të popullatës sidomos të vajzave dhe grave, të cilave papunësia u hoqi privilegjin ekonomik, duke i vene në varësinë ekonomike dhe shoqërore të meshkujve të familjes, të cilët të shtyrë edhe nga rritja e kriminalitetit e rritën vigjilencën për ruajtjen e nderit të vajzave dhe grave.

Përhapja e trafikut të qenieve njerëzore, ku vajzat e trafikuar furnizonin tregtinë e “mishit të bardhë” e justifikoi kontrollin familjar të meshkujve mbi liritë e lëvizjes dhe seksuale të vajzave dhe grave. Mosfunksionimi i strukturave shtetërore të rendit publik bëri që rolin ruajtës për sigurinë e vajzave dhe grave ta merrte familja, kryesisht meshkujt. Kundërshtimi i vajzave dhe grave ka hasur në përgjigje të dhunshme nga ana e familjarëve meshkuj të cilët e kanë përdorur dhunën ndaj grave si mjet bindjeje. Pamundësia e strukturave shtetërore për të marrë në mbrojtje vajzat dhe gratë e dhunuara ndikoi në rritjen e dhunës brenda familjes.

Në studim, vajzat dhe gratë dëshmojnë se janë përballur në mënyrë sistematike me dhunën psikologjike dhe fizike. Konfliktet me familjarët kanë qenë shumë të pranishme përgjatë gjithë jetës së tyre dhe si fitil kanë shërbyer paragjykimet që i kanë penguar për të lëvizur të lira jashtë shtëpisë, për t'u arsimuar, punësuar, për të pasur jetë sociale dhe familjare me zgjedhjen e tyre. Paragjykimet për vajzat dhe gratë janë të shumta dhe flenë në shtratin e normave kulturore që e nënrendisin gruan brenda familjes, duke e

kufizuar në shërbime ndaj të tjerëve lindje fëmijësh. Ndër shkaqet kryesore për paragjykimet ndaj vajzave dhe grave janë: sjellja, aftësitë, veshja, komunikimi dhe kujdesi për familjarët e bashkëshortit.

Referencat

1. De Beauvoir, Simone: *Seksi i dytë*, Vëllimi i parë, Shtëpia Botuese "Çabej" Tiranë, 2003
2. Dervishi, Zyhd: Veçori të anketimit për dukuri demografike në realitetin shqiptar, *Revista Demografike*, 1(1):43-53, 1998
3. Dervishi, Zyhd, b: *Lente të ndërveprimit simbolik*, Shtëpia Botuese "Emal", Tiranë, 2008
4. Dervishi, Zyhd: *Nëpër degëzime të kulturës shqiptare*, Emal, Tiranë 2013
5. Fraser, Nancy: *Justice interrupts: critical reflections on the "post-socialist" condition*, Routledge, New York, 1997
6. Giddens, Anthony: *Sociologjia*, Shtëpia Botuese "Çabej", Tiranë, 1997
7. Goci, Haxhi: *Kanuni i Krahinës së Bendës*, Shtëpia botuese "Ombra GVG", Tiranë, 2010
8. Gjergji, Andromaqi: *Mënyra e jetës në shekujt XII-XX*, Shtypshkronja "Kotti", Korçë, 2002
9. Hoxha, Shefqet: *Kanuni i Lumës*, Shtëpia botuese "Pavarësia", Tiranë, 2013
10. Ilija, Frano: *Kanuni i Skanderbegut*, Editrice la Rosa, Milot, 1993
11. Pomeranz, Keneth: *The great divergence: China, Europe and the making of the modern world economy*, Princeton University Press, Princeton, 2009
12. Tirta, Mark: *Etnologjia e përgjithshme*, Shtëpia Botuese "Geer", Tiranë, 2001
13. Topalloglu, Beqir: *Gruaja ne Islam*, (Përkthyer nga Mit'hat Hoxha), Universiteti Marmara, Stamboll, 1997
14. Wolf, Margery: *Revolution postponed: women in contemporary China*, Stanford University Press, Stanford, 1985
15. Young, Antonia: *Women Who Become Men: Albanian Sworn Virgins*, Berg, Oxford, 2000

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Ndikimi i mjedisit familjar, tek veprat penale të të miturve



■ **MSc. Dorina ARAPI**
Komisariati nr. 2, Policia e Shtetit
arapidorina2@gmail.com

Abstrakt

Ekziston një ligj i pashkruar, por prej epokash i trashëguar sipas te cilit mbi bazë të kontratave religjioze apo juridike, siç është martesë, nga pema gjenealogjike rrjedhin trashëgimtar. Në fakt është çifti, linja kryesore prej nga rrjedh pasardhësi, i cili apriori ka fituar te drejtën e përkatësisë. Martesa në vetvete është një kontratë juridike apo religjioze, kjo në bazë të kulturave respektive, që domosdoshmërisht i jep parimisht pasardhësit identitet. Kur një prind i jep identitetin fëmijës së tij? Që në momentin e dhënies së emrit. Dhënia e identitetit si një person individual dhe me të drejta të plota nis që nga ky çast. "Identitas" si njësi e bërthamës familjare që gëzon privilegje, detyrime dhe te drejtën e trashëgimisë. Në aspektin psikologjik pasardhësi merr identitet dhe gëzon te drejtën e përkatësisë, e njohjes së origjinës, e plotësimit të trungut te bërthamës familjare. Së brendshmi është 'tabula rasa', në aspektin e një kuadri që duhet mbushur dhe e t'i japë formë, gjë e cila arrihet në transaksionin ndijor reciprok. Kjo do të thotë, se që në momentin e lindjes vendoset raporti primar i dhënies së përkujdesjes nëpërmjet përcjelljes së figurës simbolike të nënës. Fëmija është një qenie në bërje e sipër, çdo ditë merr formë nga prindi. Injektohet çdo ditë, emocionalisht, shpirtërisht, afektive, investim psikologjik, fizik, material, dhe ndërtohet një marrëdhënie e dhënies së asaj mungese që ai fëmijë ka më shumë domosdoshmëri. Kur çifti (prindërit) nuk është i aftë të menaxhojë konfliktet e tij, i shfaq kudo të parët që vuajnë pasojat janë fëmijët sidomos ata të moshës 0-9 (vjeç), sepse në këtë stad kanë nevojë për përkujdesje. Tema ime e studimit konsiston të 'Të miturit në konflikt me ligjin, vendosja e drejtësisë me ta'. Ka një ligj të pashkruar, por që bëhet domosdoshmërisht pasojë për të ardhmen e fëmijës. Ky ligj është vet prindi.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Fjalëkyçe:

familje, i mitur, vetëvlerësim, ndjenjë faji, ligji.

1. Hyrje

Dhuna në familje në ditët e sotme është kthyer në fenomenin më të zakonshëm në shoqërinë e Shqipërisë. Duke shtuar numrin e divorceve në rritje të menjëhershme dhe duke rrezikuar me të pambrojturit e shoqërisë të cilët janë fëmijët duke u përballur me ligjin dhe institucionet ligjore që shpesh here e kthejnë familjen akoma më disfunktionale saqë arrijmë në pikën ku shoqëria e ardhshme ka probabilitet më të lartë për të qenë më devijante dhe e pashëndetshme. Vet ndarja e familjes në njësi më të vogël apo më të madhe, sipas rastit tejçon një problematikë e cila nuk merr fund kurrë. Thuhet se më të dëmtuarit janë fëmijët, të cilët në vartësi të moshës përjetojnë traumat e tyre. Kjo do të thotë se sjelljet, rregullat, vendimmarrjet dhe përkujdesjen nuk kanë më natyrshmërinë fillestare dhe origjinalitetin. Çdokush përpiqet ta harrojë jetesën e mëparshme sepse e dinë që ajo është një dhimbje më vete. Më të prekurit e ndarjes familjare janë fëmijët. Ata jo vetëm që nuk ambientohen dot me sjelljet e reja, por rikërkojnë vazhdimisht lidhjet e humbura.

2. Përkufizime

Familja është një grup individësh që lidhin në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë. *I mitur*, sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijës, koncepti “i mitur” nënkupton personin që nuk ka mbushur ende moshën tetëmbëdhjetë vjeç. *Periudha e miturisë* e cila përkon në një pjesë të madhe të saj edhe me adoleshencën, përbën një etapë delikate në jetën e një personi, plot ankth, duke vënë në provë subjektin në marrëdhëniet e tij ndërpersonale e sociale. Termit i mitur dhe adoleshent

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

në këtë punim kanë të njëjtin kuptim.

Vetëvlerësim është komponent vlerësues i konceptit për veten. Ai përfshin një vlerësim subjektiv emocional që secili prej nesh i bën vetes së tij.

Ndjenjë një faji mund të jetë një simptomë. Më e rëndësishmja është e këta fëmijë ndihen të pavlefshëm dhe përjetojnë ndje një faji.

Ligji është një sistem rregullash dhe normash shoqërore që njerëzit duhet të ndjekin në një shoqëri apo vend.

3. Hipoteza

Duke u mbështetur në literaturën e lexuar dhe duke sjellë shpesh nëpër mend idetë e mia rreth realizimit të kësaj teme, unë ndërtova një hipotezë kryesore, udhëheqëse të gjithë studimit, e cila normalisht është e ndjekur nga disa objektiva ose shumë mirë të quajtura mikrohipoteza, pasi gjithsecila prej tyre duhet vërtetuar, në mënyrë që, të mund të vërtetohet hipoteza kryesore. *Hipoteza kryesore: Kur vetë familja është dhunuesi i parë i të drejtave të fëmijës çfarë pritet të ndryshoj nga drejtësia shqiptare?* Është e vështirë të shquash me bindje, një familje që funksionon normalisht. Në fakt sado i fshehtë të jetë konflikti familjar është jetëshkurtër për të qëndruar i tillë, përderisa bëhet gjykata organi kryesor i ankesave te tilla. Në të vërtetë konflikti në familje dhe reflektimi i tij në ambientin social, ku potencialisht te gjithë pjesëtarët, vjen një moment që i bëhet me dije, vetëm organit të drejtësisë që është gjykata. Kjo e fundit edhe pse simboli i ekuilibrit dhe dhënies së vendimeve të drejta, në thelb konsiderohet si Turpi i Familjes. Të miturit në konflikt me ligjin janë pasoja e familjeve disfunksionale dhe të dështuara qysh në bërje. Ndaj kjo paranteze shërben për shqyrtimin e statusit të së miturit nga familja tek ambienti i jashtëm.

Për të vërtetuar hipotezën kryesore, studimi kaloi përgjatë disa fazave, që në vetvete mund të konsiderohen si mikrohipoteza:

1. Fëmijët që vijnë nga familje disfunksionale kanë vetëvlerësim të ulët dhe mbartin ndjenja faji, gjë që çon në ulje të motivimit për të jetuar shëndetshme mendërisht.
2. Fëmijët janë më të vetmuar dhe kanë probleme me socializimin.
3. Pasojat e stresit posttraumatik tek të miturit pas procesit dhe përbaljes me ligjin.

4. Metodologjia

4.1 Qëllimi i studimit

Studimi e vë theksin tek rëndësia e mjedisit rrethues mbështetës, familja kujdestare, gjykata, shoqëria, institucionet e ndryshme, në përmirësimin e gjendjes psikologjike të fëmijëve. Është e rëndësishme të kuptohet se për të kaluar në trajtimin e vështirësive të drejtpërdrejta të divorcit, të punohet me gjendjen psikologjike të këtyre fëmijëve, vetëvlerësimin e tyre dhe rëndësinë e vendosjes së ekuilibrit. Duke qenë një proces i gjatë, ai i trajtimit të fëmijëve nga familje disfunksionale, puna me familjen dhe vetëvlerësimin mbeten hapi i parë, realizimi me sukses i të cilit, çon drejtpërsëdrejti në një trajtim më të suksesshëm dhe integruar. Tema nuk synon të tregojë dhe as mbart në vetvete kuptimin, se puna me familjen është e mjaftueshme për rritjen e vetëvlerësimit. Por ajo është një faktor shumë i rëndësishëm, që ndikon në përmirësimin e saj. Gjithashtu duhet theksuar se përbalja me ligjin në moshe të hershme ka pasoja të mëdha në

shëndetin mendor dhe shoqëri. Gjithashtu dua te theksoj dhe të lloboj fuqishëm për prezencën sa më efektive të punonjësve social dhe psikologëve profesional të jenë realist në vlerësimet e dhëna dhe profesionist në çdo rast që asistojnë në gjykata, polici, institucionet etj.

4.2 Instrumentet

Ky punim është cilësor, ku jo çdo rezultat i dalë prej tij përgjithësohet. Funkcionon si pikë orientimi dhe shpërndarje e informacioni në lidhje me rastet e familjeve disfunktionale dhe vënia në qendër të dhënies së ndihmës dhe përkrahjes më të pambrojturve, të miturve. Instrumente përdorur janë:

- vëzhgimi gjatë punës në Policinë e Shtetit, studime rasti konkrete të prekura nga fenomeni divorc nga familjet që kanë përfunduar në dyert e gjykatës për arsye primare dhunën;

- vendimet e dhëna nga gjykata;
- shqyrtimi i literaturës;
- krahasimi midis vlerësimit juridik përballë vlerësimit psikologjik.

4.3 Objektivat

- Ndërgjegjësimi dhe mbështetjen që duhet dhënë për të miturit që vijnë nga familje disfunktionale.

- Vënia në pah e rëndësisë së rolit mbështetës të prindërve dhe institucioneve në rritjen e vetëvlerësimit të fëmijëve.

Ndërtimi i manualeve psikologjike dhe trajnues për prindërit institucionet si gjykata, polici, për vlerësimin fillestar rasteve të dhunës në familje.

5. Përmbledhje

Një opinion i Frojdit mbi shoqërinë thotë: “Civilizimi solli më shumë dituri, individualizëm, dhe rregulla të reja në shoqëri, por ekziston një pjesë biologjike natyrore te njeriu që ka gjithmonë tendencën të plotësojë dëshirat e veta, duke shkatërruar marrëdhënie”. Gjë e cila induktohet së pari në familjet moderne të cilat e organizojnë kohën në formë të tillë, ku secili te marr rolin e vet. E keqja më e madhe e sotme është mungesa e komunikimit dhe prezenca e prindit si figurë në jetën e fëmijës. Formimi i personalitetit bëhet më shumë individual se vet fëmija, dhe ai e percepton veten si narcistik në idetë e tij. Pse adoleshenca është pragu më delikat i krijimit të personalitetit?

Sepse së pari vet fëmija në këtë stad është delikat dhe konfuz në ide. Sepse ai është duke njohur anën e vet emocionale dhe atë seksuale të cilën nuk di ta kontrollojë. Arsyet kryesore të shfaqjes së çrregullimit të personalitetit:

- familjet disfunktionale;
- divorci, përjetohet shumë keq nga ana emocionale dhe afektive te fëmija;
- prindit abuzues; prind autoritar që abuzojnë me pushtetin; prind shfrytëzues që e përdorin fëmijën; prind dhunues;
- prindi incestuoz; janë kategoria më e neveritshme, që i përdorin fëmijët e tyre si objekt për faljen e kënaqësisë seksuale duke abuzuar fizikisht me të miturin;
- statusi socioekonomik;

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

- prindërit joprezent.

5.1 Profili i të miturve në konflikt me ligjin

Vështrim i përgjithshëm i profilit të së miturve në konflikt me ligjin. Nuk ekziston një përshkrim unik i profilit të së miturve në konflikt me ligjin, pasi një sjellje antisociale shfaqet si pasojë e ndërthurjes së faktorëve psikologjikë, familjarë dhe socialë shumë të ndryshëm rast pas rasti. Në rastin e çrregullimeve psikike të dyshuara si favorizuese sjelljesh antisociale, vetëm në një numër të kufizuar të rasteve, sjellja delinkuente shfaqet e lidhur me çrregullimet psikotike që shquhen nga një alternim i ashpër i kuptimit të realitetit. Çrregullimet e përshkruara nën termin e psikopatisë janë vënë re tek rreth 15%-20% e delinkuentëve. Ndonjëherë personaliteti i delinkuentit mund të duket si normal, apo i pacenuar. Kalimi në aktin kriminal të adoleshentit nuk është veçse një episod rinor reaksioni që do të kalojë në maturim. Problemi qëndron tek ndihma që i duhet dhënë subjekteve të tilla të dalin nga kjo gjendje. Sipas D. W. Winnicott, në rrënjën e tendencës antisociale, ka gjithmonë një mungesë, qoftë thjeshtë nga një impuls i dhënë nga nëna ku ajo ka qenë e mbyllur në vetvete, e ligështuar, qoftë kur familja ka qenë jokompakte apo ka tendenca antisociale.

Ka gjithmonë një bërthamë të shëndoshë e menjëherë një ndërprerje, pas së cilës gjërat nuk kanë qenë më si më parë. Duket sikur fëmija antisocial kërkon në një mënyrë, apo në një tjetër të bëjë të njohur borxhin që bota ka ndaj tij, apo duke u përpjekur që bota të riparojë atë që ka shkatërruar. Nga një këndvështrim delinkuencën mund ta konsiderojmë si shenjë të falimentimit të një procesi psikik normal të socializimit. Shkurt, gjithçka që do të vërë në punë mekanizmin e të mësuarit të tolerancës së frustracionit dhe identifikimit rrezikon të jetë në origjinë të sjelljeve antisocial. Që një adoleshent të kryejë një veprë penale do të thotë se veprimi në vetvete ka kohe që ka nisur të behet. Fillimisht ai është bërë mbi trupin dhe psikikën e adoleshentit, që do të thotë se mbi të është ushtruar presion psikologjik në një kohë shumë të gjatë duke e transformuar qenien e tij, nga familja apo kushdo qoftë tjetër. Në momentin e kryerjes së veprës penale janë përballja e dy situatave të menjëhershme.

E para është gjendja e rëndë konfuze e pashpjegueshme dhe tepër e lodhshme, që nuk përkthehet në asnjë përgjigje. Së dyti është iluzioni i një mbështetjeje emocionale, që i është premtuar nga grupi shoqëror që e ka sjellë në këtë gjendje. Nga vetë natyra qenia e adoleshentit është e miksuar në emocione dhe ndjesi jo të qarta, momentale, të pashpjegueshme si gjendje, shpesh herë dhe pa ditur psenë e veprimit.

5.2 Dhuna në familje

Të qenit dëshmitarë të dhunës në familje ndikon në rritjen e problemeve të sjelljes, sidomos te fëmijët meshkuj. Po ashtu sipas studimeve të kryera në këtë fushë rezulton se në shumë familje ku ushtrohet dhunë ndaj nënave, ushtrohet dhunë njëkohësisht dhe ndaj fëmijëve. Të qenit i abuzuar, apo dëshmitar i dhunës në familje mendohet se prek sjelljen e të miturve dy herë më shumë sesa të qenit vetëm dëshmitar i dhunës. Një tjetër faktor që e rrit riskun në familjet e dhunshme, përfshin incidencën e lartë të problemeve të tjera të sjelljes, si abuzimi me alkoolin dhe burgimi. Distresi psikologjik i nënave në mënyrë indirekte është gjithashtu një faktor që ekspozon fëmijën ndaj një risku më të lartë, duke qenë se këto nëna janë të padisponueshme emocionalisht për tu kujdesur

për ta. Duhet pasur parasysh identifikimi i dhunës fizike apo psikologjike, mbi subjektin ku edhe është kryer. Më pas është e lehtë të identifikohet dhunuesi, që është njeri nga pjesëtarët e tjerë të familjes. Në familjet që përjetohet dhune familjare është e rëndësishme të kuptohet:

- intensiteti i dhunës familjare;
- format sesi shfaqet ajo, tek çdo pjesëtar i familjes;
- aftësitë prindërore të secilit prind;
- efektet e dhunës në familje tek secili fëmijë;
- lloji i keqtrajtimit të përdorur, mbi fëmijën.

5.3 Divorci i prindërve

Krahasuar me djemtë prindërit e të cilëve kanë qëndruar të martuar, djemtë me prindër të divorcuar mendohet se shfaqin më shumë probleme të sjelljes antisociale dhe jokompliante rreth moshës 10 vjeçare. Sidoqoftë, duke marrë parasysh faktorët e shumtë që lidhen me funksionimin apo mosfunksionimin e familjes, është e vështirë të nxirren konkluzione të sakta mbi efektin real që ka divorci i prindërve në sjelljen e mëvonshme të fëmijëve. Sipas rezultateve të një studimi të kryer, rreth 45% e prindërve të djemve të mitur me probleme të sjelljes, vuajnë nga çrregullimi antisocial i personalitetit. Nivele të njëjta janë raportuar për abuzimin me substanca dhe depresionin.

5.4 Psikologjia e të miturit

Psikologjia e të miturit zhvillohet në përputhje me mjedisin, kulturën dhe zhvillimin e aftësive të ndryshme. Sipas të dhënave të publikuar në vitin 2000, nga një studim i bërë në spitalet e psikiatrisë në Amerikë, rezultoi se shumica e çrregullimeve mendore e ka gjenezën në moshën e fëmijërisë së hershme, ndaj e theksoj dhe një herë se faktori familje është vendimtar në krijimin e një zhvillimi të drejtë mendor.

5.5 Mënyra e funksionimit të organit gjyqësor

Organi gjyqësor operon nëpërmjet tre kompetenteve të saj që janë psikologu gjyqësor, avokati dhe së fundmi ai që jep vendimin është gjyqtari. Më tepër do ndalemi tek roli i psikologut.

5.6 Roli i psikologut

Psikologu pasqyron çështjen para gjyqtarit dhe avokatëve të palëve mbrojtëse duhet të ketë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, kjo sidomos te çështjet e ndarjeve martesore, ku ky element është vendimtar për të ardhmen e fëmijës. Ka dy lloj vlerësimesh që varen nga lloji i çështjes së marrë në shqyrtim. Së pari, kur fëmija ka kryer veprën penale dhe së dyti, rastet e kujdestarisë së fëmijës kur ndodh divorci.

6. Konkluzione

6.1 Pasojat e stresit posttraumatik tek të miturit

PTSD, (*Post Traumatic Stress Disorder*), apo çrregullimi i stresit posttraumatik, është një traumë që vazhdon të ketë pasojat e saj, pas ndodhjes së ngjarjes. Është një proces në


**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

kohë, vuajtje që manifestohet në sjellje jonormale nga përditshmëria e personit. Këto lloje traumash e kanë prejardhjen e tyre që nga fëmijëria e personit në fjalë dhe ruhen në kujtesë për gjatë gjithë kohës së adultërisë. Trauma në vetvete është një ngjarje që kërkon përgjegjësi. Këtu jepet përqindja e një popullate, përkatësisht e moshave të ndryshme që vuajnë nga PTSD-ja. Ky studim është bërë në terren, në vartësi të sondazhit nga pyetësorët e shpërndarë. Ka rezultuar se përqindja më e lartë e personave që vuajnë nga PTSD-ja janë të moshës adulte, kjo për arsye sepse trauma tashme është konkretizuar tek qelizat nervore, të funksionimit të përgjithshëm të trurit.

Grafiku 1



6.2 Krahasimi i drejtësisë psikologjike me atë juridike

Të miturit janë shkak dhe pasoja e vetë jetës së adultit sepse modeli fillestar që ai përthith për të vepruar është vet i rrituri. Të qenit i drejtë me të miturin, si në aspektin juridik dhe atë psikologjik, është së pari detyrim moral, kundrejt brezit të ri. Së dyti, është një angazhim madhor që kërkon gjykim racional dhe të detajuar, kundrejt vetë moshës së të miturit.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Tabela 1

Drejtësia psikologjike	Drejtësia juridike
<ul style="list-style-type: none"> - Nuk mund të flasim për drejtësi. - Gjykojmë veprimet dhe statusin mendor ku ndodhet individi. - Shpjegon lidhjen shkak-pasojë. - Klasifikon gjendje dhe sjellje - Shpjegon sepse ky veprim është anormal për tu kryer në rastet kur kemi kryerjen e një vepre penale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Jep zgjidhje çështjes - Merr në duar fatin e të miturit - Përcakton kush do ta marrë nën kujdestari të miturin. - Jep dënimin sipas Kodit Penal kur kemi rastet e Veprave Penale.

7. Përfundime

Kjo tezë e paraqitur në formën e një studimi, ka treguar lidhjen e hallkave të sistemit të përgjithshëm të funksionimit të gjykatave dhe drejtësisë, kundrejt akteve penale, apo mbrojtjes së të drejtave të së miturve, kjo e parë në sektor të ndarë, në vartësi të rasteve të paraqitura. Kjo tezë është vlerësuese konkrete dhe reale, duke e bërë më të prekshëm problematikën. Në thelb një studim cilësor, subjektiv dhe realist i punës, përgjatë këtyre tre viteve duke u ndalur mbi problematikën kryesore të konfliktit ligjor me të miturin. Edhe pse e studiuar në aspektin psikologjik, i mituri shihet gjithmonë si individi më i brishtë që vuan pasojat e zgjedhjes së prindërve. Jam e mendimit se gjykata është vendi që na njeh së pari me problemin që ka qëndruar i fshehur brenda familjes. Trajtimi i të miturit nga gjykata dhe vet procesi gjykimor është në interesin më të lartë kundrejt fëmijës, meqë tashmë ai e ka humbur kujdesin e familjes. Vet psikologjia e të miturit është irracionale. Të qenit i drejtë dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve është një detyrim moral dhe përgjegjës, për një të ardhme më të mirë. Që një i mitur të bëhet pjesë e konfliktit ligjor dhe që çështja e tij të jetë e përmasave të tilla që të gjykohet juridikisht, për këtë përgjegjësi është tjetër kush, dhe subjekti kryesor është prindi, i cili është individi që e ka rënduar gjendjen. I mituri vetë nuk është i aftë të gjykojë dhe as të marrë vendime për veten e tij. Nuk është i aftë të dalloj të mirën nga e keqja, ndaj edhe pse në kushtet e të gjykuarit nga ligji, ai është krejt i mbrojtur nga ky organ, meqë nuk ka qenë e aftë ta kryej si funksion familja e vet. I mituri dënohet me ligj, duke u shkëputur nga familja, për të shkuar në një qendër rehabilitimi, por dëmtimi dhe dënimi më i madh është e gjithë struktura e funksionimit psikik, e cila tashmë është e dëmtuar dhe e parikuperueshme për tu ribërë funksionale në lidhje me këtë familje. Jam e mendimit se nuk ka gjykim të drejtë dhe drejtësi veçse përpjekje nga ana institucionale që juridikisht, i mituri të mbrohet më shumë fizikisht sesa psikologjikisht, nga ana e familjareve të vet, sepse sido që te jete çështja e gjykimor, i mituri është i pari dhe i vetmi që vuan pasojat e një vepre të pabërë nga ai, edhe pse është i detyruar ta shpjegojë atë. Pyetja ime që nuk ka marrë ende shpjegim është:

Kur familja është e para që dhuron apo abuzon me fëmijën, çfarë mund të presë ky fëmijë dhe shoqëria nesër?

Ndaj, është e këshillueshme që çdo hap nga ana e adultit se nesër do të bëhet prind të marrë parasysh çdo rrezik dhe sakrificë familjare kundrejt fëmijës me qëllim që ai të rritet i sigurt dhe i mirëformuar për nesër.

Bibliografia

1. Figley, C. R., (1986) *Family traumatic stress*.
2. Figley, C. R. (1986) "Post-traumatic stress: The role of family. Emotional". *First Aid: Journal of Crisis Intervention* Full, 58-70.
3. Canfield, E. K., *Young Woman and the sexual*.
4. Krikpatrick, M., red. (1980) "Revolution". *Woman Sexual Development*, New York.
5. Freud, S., (1981), *The Standart Edition of the Complete Psychological, works of Sigmund Freud*.
6. Hardy, S. B., (1981), *The woman that Never Evolved*. Cambridge: Harvard University Press.
7. Chodorow, N. (1989) *Feminism and Psychoanalytic Theory*. Cambridge: Polity Press, and New Haven, CT: Yale University Press.
8. Farrington, P., Barnes, C., Lambert, S., (1996) "The concentration of offending in families". *Legal and Criminological Psychology*, 1 (Part 1), 47-63.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Perceptime e profile të vrasjeve në familjet shqiptare



■ **MSc. Anisa AGASTRA**
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë
anisa.agastra@asp.gov.al

Abstrakt

Në këtë punim paraqitet një analizë e thelluar statistikore e psikosociale e vrasjeve në familjet shqiptare, e autorëve dhe viktimave, bazuar në një metodologji sasiore dhe në treguesit subjektiv që masin perceptimet e të anketuarve. Si instrument kërkimor është përdorur pyetësori. Është realizuar një proces anketimi me tre grup-shënjestra: “punonjës policie”, “popullatë” dhe “të dënuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare” në shtatë IEVP (Institucion i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale) në Shqipëri. Qëllimi i punimit ndahet në dy pjesë: së pari, përcaktimi i perceptimeve të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar për nivelin e rrezikshmërisë dhe veçorive të vrasjeve në familjet shqiptare, autorëve e viktimave; së dyti, përcaktimi i veçorive të të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri me anë të profileve. Përgjatë punimit do të ketë gjetje edhe për perceptime të të anketuarve për parandalim të vrasjeve në familjet shqiptare, si dhe për raportin individ-institucion në lidhje me këtë çështje.

Punonjësit e policisë dhe popullata e anketuar perceptuan rritje të dhunës e vrasjeve në familjet shqiptare në periudhën 2007-2016, me autorë kryesisht meshkuj e viktimë kryesisht femra, të një niveli të ulët arsimor e të grupmoshës 31-50 vjeç, që ndodhin kryesisht te bashkëjetuesit, partnerët, kushërinjtë apo djali ndaj babait. Ndërsa, të dënuarit për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare rezultuan kryesisht meshkuj, të grupmoshës 31-50 vjeç; të martuar para dënimit; me nivel të ulët arsimor; me probleme në punësimin e tyre, me të ardhura të ulëta dhe pa historik të mëparshëm kriminal. Viktimë ishte kryesisht bashkëshortja, kushërirri dhe djali. Tensionet emocionale janë problematike, si tek të dënuarit, ashtu edhe tek viktimat. Vrasjet në familjet shqiptare rezultuan si krime të paplanifikuara.

Gjatë punimit do të paraqiten gjetje më të thelluara si dhe rekomandime lidhur me masat, politikat e sugjerimet që kanë dhënë të anketuarit për parandalimin e reduktimin e vrasjeve në familjet shqiptare. Ata theksuan më së shumti nevojën për bashkëpunime institucionale, fushatat sensibilizuese dhe programe të veçanta profesionale e trajnuese.

Fjalëkyçe:

profile, të anketuar, vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, veçori psikoemocionale, autor, viktimë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

1. Hyrje

Në vendin tonë vrasjet brenda familjeve janë një dukuri problematike që shqetëson shoqërinë shqiptare. Kronikat në lajmet e përditshme apo diskutimet e shumta për vrasjet e bashkëshortit ndaj bashkëshortes, e djalit ndaj babait, midis vëllezërve apo mes kushërinjve, tregojnë për një shqetësim që ka nevojë të analizohet. Qëllimi i këtij punimi është trajtimi dhe profilizimi i vrasjeve brenda familjeve shqiptare, nisur nga perceptimi i të anketuarve dhe nën lentën e atyre që e kanë kryer këtë krim, si dhe paraqitja e karakteristikave demografike, statistikore e psikoemocionale të autorëve e viktimave. Për realizimin e punimit është përdorur metodologji sasiore dhe është zgjedhur si instrument kërkimor, pyetësi. U hartuan tre pyetësorë të standardizuar, që i referohen periudhës analizuese 2007-2016, të cilët iu shpërndanë tre grup-shënjestrave të anketuara. Nga ky proces u mblodhën të dhëna mbi të cilat u realizua analizë variabëlësh, analizë faktoriale dhe analizë me blloqe në fund, për të nxjerrë prototipe apo profile përmbledhëse. Secili nga pyetësorët ka një shkallë të lartë standardizimi, që do të thotë, pyetjet janë të standardizuara, të strukturuara, të renditura, të mbyllura dhe prodhojnë informacion të krahasueshëm, qoftë në analizën e një pyetësi, qoftë në analizën e kryqëzuar të informacionit nga të tre pyetësorët. Kampioni u nda në tre grup-shënjestra të synuara: “punonjës policie” (156), “popullatë” (378) dhe “autorë (të dënuar) për vrasje në familje” (50). Kampioni në total, përbëhet nga 584 persona të anketuar, ku 65% janë popullatë, 27% punonjës policie dhe 8% autorë të dënuar për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare në 7 IEVP në Shqipëri, përkatësisht në IEVP-në e Tiranës, Korçës, Lezhës, Fushë-Krujës, Lushnjës, Fierit e Peqinit. Në procesin e anketimit të tre pyetësorët u plotësuan në mënyrë direkt e të drejtpërdrejtë nga të anketuarit. Hipoteza e shtruar në këtë punim është “*Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në familjet shqiptare kryhen për shkak të problemeve ekonomike dhe psikoemocionale.*”



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

2. Niveli i dhunës dhe vrasjeve në familjet shqiptare: perceptime së të anketuarve¹

Në procesin e anketimit me punonjësit e policisë dhe popullatës së shënjuar u synua të mblidhej një informacion rreth perceptimit të tyre për vrasjet në familjet shqiptare. Nga të anketuarit, më shumë se gjysma e punonjësve të policisë (67.31%) dhe popullatës (69.3%) së shënjuar, mendojnë se dhuna në familje është “shumë” problematike në Shqipëri. Ndërsa gjysma e punonjësve të policisë (50%) mendojnë se niveli i dhunës në familje është rritur “shumë” në dhjetëvjeçarin e fundit (2007-2016) kurse më shumë se gjysma e popullatës (58.2%) mendojnë se ky nivel është rritur “disi”.




Punonjësit e policisë qëndrojnë të lëkundur në mendimin se ka “shumë” rritje të nivelit të vrasjeve në familjet shqiptare (51.9%) apo “disi” (45.5%) kurse popullata

¹ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: “punonjës policie”, me kampion përfaqësimi 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe “popullatë”, me kampion përfaqësimi 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegjin e Policisë”.

mendon se ka shumë rritje të nivelit të tyre (69.8%). Sipas 53.2% e punonjësve të policisë dhe 52.6% e popullatës mendojnë që vrasjet në familje ndodhin nga pakujdesia dhe 51.9% e punonjësve të policisë dhe 56% e popullatës mendojnë se ka rritje të këtij krimi në periudhën analizuese 2007-2016.

3. Tipologjia e vrasjeve në familjet shqiptare, autorëve e viktimave²

Në këtë pjesë është realizuar matja e perceptimeve të të anketuarve rreth tipologjisë të krimit të vrasjes, autorëve apo viktimave, në familjet shqiptare. 66% e punonjësve të policisë dhe 46.5% e popullatës mendojnë se sjellja apo veprimet e mëparshme të viktimës nxisin disi autorin për të kryer vrasje në familje.




Duke parë kronikat e lajmeve në media apo të dhëna statistikore një ndër pyetjet që u shtrua në pyetësor ishte problematika e vetëvrasjes tek ata që kishin kryer vrasje brenda familjes. Nga sondazhi rezultoi se 72.4% e punonjësve të policisë dhe 65.34% e popullatës mendojnë se ka disi probabilitet që pas vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare të ndodhë një vetëvrasje.

51% e punonjësve të policisë dhe 49.1% e popullatës mendojnë që forma më e përhapur e dhunës në familje është dhuna fizike ndërsa 44% e punonjësve të policisë dhe 42.7% e popullatës mendon se është dhuna psikologjike. Ajo pjesë e dhunës që nuk duket, perceptohet si problem. Sa i përket aspektit gjinor, sipas mendimit të më shumë se gjysmës së të anketuarve³, femrat janë më të predispozuar për të qenë viktimat të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, kurse meshkujt janë më të predispozuar për të qenë autorë të këtyre vrasjeve.

² Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: punonjës policie, me kampion përfaqësimi 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe popullatë, me kampion përfaqësimi 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë "Kolegjin e Policisë".

³ Nga sondazhi, sipas mendimit të 90.74% të punonjësve të policisë dhe 82.51% të popullatës, viktimat e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare ishin më të predispozuar të ishin femrat. Ndërsa sipas mendimit të 91.93% të punonjësve të policisë dhe 90.84% të popullatës autorët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë më të predispozuar për të qenë meshkujt.


**Sipas mendimit tuaj,
Kush ka më shumë probabilitet për të qenë viktimë e vrasjeve në familje?**



95.77% e të popullatës u shprehën se nuk kishin pasur në familjen e tyre anëtarë të dhunshëm që kishin abuzuar me ta dhe 96.3% e tyre nuk kishin pasur as anëtarë abuzivë të dhunshëm kundrejt anëtarëve të tjerë në familje. Duket se këtu ka vend për subjektivitet pasi është pjesë e kulturës sonë që mos të tregohen tërësisht të hapur kur vjen puna tek jeta personale apo familjare.

Të anketuarit kryesisht mendojnë se vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare ndodhin më shpesh mes bashkëjetuesve sipas 39.96% të punonjësve të policisë dhe mes partnerëve, sipas 45.83% e popullatës, pavarësisht nëse janë të martuar ligjërisht apo jo. Dy predispozitat e tjera më të mundshme janë nga djali ndaj prindërve (14.13% e punonjësve të policisë dhe 10.67% e popullatës) dhe mes kushërinjve (10.14% e punonjësve të policisë dhe 15.05% e popullatës). Ndërsa më pak të mundshme për të ndodhur janë dhëndri ndaj vajzës sipas 9.42% të punonjësve të policisë dhe nga babai ndaj vajzës sipas 10.4% të popullatës. Kjo të lë të mendosh që shumica e vrasjeve mes anëtarëve të familjes ndodhin për shkak të konflikteve në çift, që përshkallëzohen me vrasje, nga mashkulli ndaj femrës: me viktimë femrat. Ndërsa ka edhe vrasje mes kushërinjve meshkuj që ndodhin më së shumti për konflikte të çastit, të pronësisë, etj., siç do t'i shohim më gjerësisht edhe nga të dhënat e vetë të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.


Sipas sondazhit, grupmosha më e prirë për të abuzuar në familje është 31-50 vjeç, sipas mendimit të më shumë se gjysmës së të anketuarve (55.6% e punonjësve të policisë dhe 53.6% e popullatës) ndërsa grupmosha më e prirë për të qenë viktimë e abuzimit është 31-50 vjeç sipas 41% të punonjësve të policisë dhe, ajo deri në 18 vjeç, sipas 33.8% të popullatës. Shpesh bëhet pyetja se përse njerëzit qëndrojnë në marrëdhënie abuzive që çojnë në marrëdhënie të pashëndetshme dhe ndikojnë në nxitjen e vrasjeve. Të anketuarit (44.61% e punonjësve të policisë dhe 40.7% e popullatës) mendojnë se njerëzit qëndrojnë në një marrëdhënie abuzive brenda familjeve shqiptare kryesisht për shkak të varësisë ekonomike.



Problematika me faktorin ekonomik që lidhet me mungesën e punësimit, të ardhurat e pamjaftueshme, pagat e ulëta, etj., ndikojnë në gjendjen psikoemocionale të njerëzve duke krijuar kaos, tranzicion, negativitet, rëndesa të gjendjes emocionale e psikike çka prodhojnë pakënaqësi, padrejtësi dhe abuzime në marrëdhënie, që përshkallëzojnë deri në vrasje.

Sipas mendimit të punonjësve të policisë, problematikat më të mëdha dhe shanset për të ndodhur vrasjet, janë në familjet që vijnë nga nivele të ulëta arsimore, arsim 8 ose 9 vjeçar ose pa arsim, në rastin e autorëve dhe të viktimave, ndërsa popullata i percepton autorët e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si të paarsimuar ose me arsim të ulët 8 ose 9 vjeçar kurse viktimat i percepton nga të gjitha nivelet arsimore, me një rend zbritës probabiliteti nga të paarsimuarit (28%) deri te ata me arsim pasuniversitar (5%).


Niveli arsimor i autorëve të vrasjes në familje



AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »



4. Profili i autorëve të vrasjeve në familjet shqiptare sipas perceptimeve të të anketuarve⁴

Përgjatë kësaj pjese do të paraqiten perceptime të punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar për faktorë të jashtëm, që lidhen me raporte individuale dhe faktorët e brendshëm, që lidhen me veçori psikoemocionale, që nxisin autorët për të kryer vrasje brenda familjeve shqiptare. Pyetësi drejtuar të anketuarve ishte i standardizuar dhe këta faktorë, janë përzgjedhur nga hulumtimi në literaturë vendase e të huaj dhe janë përzgjedhur e unifikuar, si më të mundshmit, që ndikonin përgjithësisht në nxitjen e këtij krimi.

Sipas mendimit të të anketuarve faktorët e jashtëm më shumë ndikues në nxitjen e autorëve për të kryer vrasje brenda familjeve shqiptare janë:

- abuzimi me drogën (sipas 59.87% e punonjësve të policisë dhe 67.7% e popullatës);
- abuzimi me alkoolin (sipas 63% e punonjësve të policisë dhe 67.46% e popullatës);
- xhelozia (sipas 45% e punonjësve të policisë dhe 55.56% e popullatës);
- çështjet e pronësisë (sipas 50% të popullatës ndërsa 51% e punonjësve të policisë mendojnë se ndikojnë disi);
- papunësia (ndikon shumë sipas 53.2% të punonjësve të policisë dhe kurse popullata është më skeptike mes të ndikuarit disi (44.71%) dhe shumë (43.12%);
- problemet dhe vështirësitë ekonomike (sipas 66% e punonjësve të policisë dhe 52.64% e popullatës);
- çështjet e nderit (ku si punonjësit e policisë, ashtu edhe popullata mendojnë se çështjet e nderit ndikojnë deri diku, duke qëndruar mes “disi” (46.15% punonjës policie dhe 43.39% popullatë) apo “shumë” (45% punonjës policie dhe 47.35% popullatë).

Abuzimi me alkoolin e bën personin të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm për veprimet e veta dhe kjo prodhon sjellje që dalin jashtë arsytimit, që nxisin agresivitetin, shtojnë konfliktin e dhunën dhe përshkallëzojnë deri në vrasje. Ndërsa xhelozia, mund

⁴ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: *punonjës policie*, me kampion përfaqësimi 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe *popullatë*, me kampion përfaqësimi 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë “Kolegjin e Policisë”.

të jetë prezent në ato që quhen ndryshe “krimet e pasionit” mes partnerëve, bashkëjetuesve, bashkëshortëve, etj. Edhe papunësia dhe të pasurit e një pune, por të paqëndrueshme apo të papaguar mirë, ndikojnë në një gjendje të përgjithshme vështirësish e problemesh ekonomike e psikoemocionale që bëhen nxitëse për problematikën e kriminalitetit në familje, ku përfshihen konfliktet, dhuna e deri te vrasjet. Nga ana tjetër, çështjet e nderit mund të lidhen më së shumti me ruajtjen e nderit dhe moralit të femrës, por edhe me besimin, ndershmërinë, ruajtjen e fjalës së dhënë, etj., dhe sipas të dhënave nga mendimet e të anketuarve, nuk ndikon në një masë shumë të madhe, por mbetet një problem prezent nxitës i autorëve për të kryer vrasje.

Sipas mendimit të të anketuarve faktorët e jashtëm që ndikojnë *disi* në nxitjen e autorëve për të kryer vrasje brenda familjeve shqiptare janë:

- fjalët fyese dhe ofenduese ndaj viktimës (sipas 61.5% e punonjësve të policisë dhe 69.31% e popullatës);

- debatet, grindjet e konfliktet e çastit (sipas 64% e punonjësve të policisë dhe 51.9% e popullatës);

- mentaliteti patriarkal i autorëve (sipas 38% punonjës policie dhe 27.25% popullatë);

- dobësimi i kontrollit të prindërve (sipas 60% e punonjësve të policisë dhe 57.67% e popullatës);

- rënia e figurës autoritare të babait (sipas 65% të punonjësve të policisë ndërsa popullata është e dyzuar mes të ndikuarit *disi* (43.39%) apo aspak (41.27%).

Nga diskutimet me disa prej punonjësve të policisë e popullatës, fjalët fyese e ofenduese janë prezent e ndodhin mes familjarëve, por nuk nxisin autorët deri në atë masë sa të kryejnë vrasje. Ato më tepër ndikojnë në një abuzim psikoemocional të viktimës. Kjo të lë të kuptosh, se opinionin nuk e justifikon dhunën ekstreme në familje, edhe nëse viktimia ka përdorur fjalët fyese apo ofenduese ndaj autorit. Sipas mendimit të të anketuarve faktorët e jashtëm që nuk ndikojnë aspak në nxitjen e autorëve për të kryer vrasje në familjet shqiptare janë: vuajtja nga sëmundje të rënda si zemra, kanceri, etj. (sipas 51% e punonjësve të policisë dhe 56.61% e popullatës) dhe punësimi i femrave (sipas 69.84% të popullatës ndërsa punonjësit e policisë qëndrojnë mes të ndikuarit *disi* (42%) apo aspak (39%).

Sipas të anketuarve, faktorët e brendshëm që nxisin *shumë* autorët për të kryer vrasje në familjet shqiptare janë:

- depresioni (sipas 61% e punonjësve të policisë dhe 59.26% e popullatës);

- nevoja e autorëve për të nënshtruar (punonjësit e policisë mendojnë që ndikon nga “*disi*” (57.7%) në “*shumë*” (27.6%) kurse popullata mendon se ka nga “*disi*” (45.5%) në “*aspak*” (34.92%) ndikim);

- çrregullimet mendore të autorëve (sipas 52% e punonjësve të policisë dhe 59.5% e popullatës);

- sëmundjet mendore (sipas 48% e punonjësve të policisë dhe 59.26% e popullatës).

Sipas të anketuarve, faktorët e brendshëm që nxisin *disi* autorët për të kryer vrasje në familjet shqiptare janë:

- zemërimi dhe tensioni i brendshëm (sipas 56% e punonjësve të policisë dhe 60.8% e popullatës);

- ndjenja e frikës së autorit (sipas 57.7% e punonjësve të policisë dhe 57.14% e popullatës);

- ndjenja e pasigurisë së autorit (sipas 62.82% e punonjësve të policisë dhe 52.91% e

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

popullatës);

- mungesa e besimit në vetvete e autorit (sipas 54% e punonjësve të policisë dhe 52.12% e popullatës);

- problemet me ndjesinë e autoritetit (sipas 62.8% e punonjësve të policisë dhe 52.12% e popullatës);

- luhatjet e humorit të autorëve (sipas 55.1% e punonjësve të policisë dhe 49.21% e popullatës);

- mendimet e përsëritura dhe të fiksuara të autorëve (sipas 62% e punonjësve të policisë dhe 53.7% e popullatës);

- zbrazëtia emocionale e autorit (sipas 61% e punonjësve të policisë dhe 49.47% e popullatës).

5. Profili i viktimës së vrasjes në familjet shqiptare sipas të anketuarve⁵

Sipas të anketuarve faktorët e jashtëm që ndikojnë *më shumë* te viktimat për të nxitur vrasje brenda familjeve shqiptare janë:

- abuzimi i viktimave me substancat⁶ (sipas 42.9% të punonjësve të policisë dhe 57.41% e popullatës);

- abuzimi i viktimave me alkoolin (sipas 47% e punonjësve të policisë dhe 54.76% e popullatës);

- xhelozia e viktimës (sipas 48% e punonjësve të policisë dhe 54% e popullatës);

- tradhtia e viktimës (sipas 65% e punonjësve të policisë dhe 66.4% e popullatës);

- vështirësitë ekonomike të viktimës ('disi' sipas 46% punonjës policie e 45.5% popullatë dhe 'shumë' sipas 43% punonjës policisë dhe 39.95% popullatë).

Sipas të anketuarve, faktorët e jashtëm që ndikojnë *disi* te viktimat për të nxitur vrasje në familjet shqiptare janë:

- debatet, grindjet e konfliktet e çastit që krijon viktimat (sipas 63% e punonjësve të policisë dhe 57.67% e popullatës);

- mungesa e kushteve të strehimit (sipas 70% e punonjësve të policisë dhe 57.7% e popullatës);

- fjalët fyese e ofenduese të viktimës ndaj autorit (sipas 64% e punonjësve të policisë dhe 58.47% e popullatës);

- kërkesa për divorc nga viktimat (sipas 56.4% e punonjësve të policisë dhe 60.32% e popullatës);

- mentaliteti patriarkal i viktimës (sipas 54.5% e punonjësve të policisë dhe 53.2% e popullatës);

- "të qenit pa punë" e viktimës (sipas 54% e punonjësve të policisë dhe 48.7% e popullatës).

Ndërsa vuajtja e viktimës nga sëmundje të rënda si zemra, kanceri, sipas 53% e punonjësve të policisë dhe 53.7% e popullatës nuk ndikon aspak në nxitjen e autorit për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.

Sipas të anketuarve faktorët e brendshëm që ndikojnë *më shumë* të viktimat për të

⁵ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: punonjës policie, me kampion përfaqësime 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe popullatë, me kampion përfaqësime 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë "Kolegjin e Policisë".

⁶ Drogë, substanca psikoaktive, depresantë.

nxitur vrasjet në familjet shqiptare janë kur:

- viktima vuan nga depresioni (të anketuarit qëndrojnë të lëkundur mes të ndikuarit disi (46% punonjës policie e 34.7% popullatë) dhe të ndikuarit shumë (38% punonjës policie dhe 48.1% popullatë);

- viktima vuan nga çrregullimet mendore (sipas 48.1% të popullatës dhe 47% të punonjësve të policisë që mendojnë se ndikon disi);

- viktima vuan nga sëmundjet mendore (sipas 48.4% të popullatës dhe 44% e punonjësve të policisë që mendojnë se ndikon disi).

Sipas të anketuarve faktorët e brendshëm që ndikojnë *disi* te viktima për të nxitur vrasjet në familjet shqiptare janë:

- zemërimi dhe tensioni i brendshëm i viktimës (sipas 58% e punonjësve të policisë dhe 54% e popullatës);

- ndjenja e të frikës tek viktima (sipas 53.2% e punonjësve të policisë dhe 54% e popullatës);

- ndjenja e pasigurisë së viktimës (sipas 59% e punonjësve të policisë dhe 51% e popullatës);

- mungesa e besimit në vetvete e viktimës (sipas 60.9% e punonjësve të policisë dhe 43% e popullatës);

- nevoja e viktimës për të nënshtruar (sipas 61% e punonjësve të policisë dhe 43% e popullatës);

- luhatjet e humorit të viktimës (sipas 51.9% e punonjësve të policisë dhe 42.6% e popullatës);

- mendimet e përsëritura dhe të fiksuara të viktimave (sipas 53.2% e punonjësve të policisë dhe 47.4% e popullatës);

- zbrazëtia emocionale e viktimës (sipas 55% e punonjësve të policisë dhe 42.3% e popullatës).

6. Mendime dhe rekomandime të të anketuarve për masa parandaluese, reduktuese e trajnuese⁷

54% e punonjësve të policisë së anketuar perceptojnë se vrasjet në familjet shqiptare realizohen me armë zjarri, ndërsa 23% e tyre, perceptojnë se ndodhin me objekte të mprehta si: thikë, xham, sëpatë, etj. 53% e tyre mendojnë se koha më e shpeshtë kur ndodhin vrasjet në familje është në mbrëmje. Pothuaj të gjithë (96.8%) mendojnë se vrasjet kryhen brenda në banesën e familjes dhe se denoncimet për këto vrasje brenda qarkut të Tiranës, janë të regjistruara më shumë në komisaratin nr. 5 (21%), në komisaratin nr. 3 (10%) dhe në komisaratin nr. 4 (8%). Ata mendojnë se pjesa më e madhe e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare ndodhin në qarkun e Tiranës (28%), që pasohet më tej nga qarku i Shkodrës (12%), i Korçës (11%), etj. Sipas mendimit të tyre, këto vrasje ndodhin në këto qarqe që janë më të mëdha e me më shumë banorë.

64.5% e popullatës së kampionuar shprehu besim te institucioni i policisë për zgjidhjen e problematikave e tyre familjare, ndërsa 17.2% u shprehën se kishin më shumë besim në miq dhe familjarë. Ndërsa punonjësit e policisë nënvizojnë që duhet më shumë punë

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

⁷ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: "punonjës policie", me kampion përfaqësimi 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe "popullatë", me kampion përfaqësimi 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë "Kolegjin e Policisë".


me organet e pushtetit vendor (29.1%) dhe sistemin e drejtësisë (20.2%) për trajtim dhe parandalim të çështjeve të tilla. Nisur nga eksperiencia e punës, 29.1% e punonjësve të policisë konstatojnë se organet e pushtetit vendor janë më pak bashkëpunues dhe më problematikë në ndjekjen, trajtimin apo parandalimin e ngjarjeve të dhunës e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

Sipas përgjigjeve të të anketuarve, tre masat kryesore që duhen ndërmarrë për parandalim të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë: bashkëpunime institucionale (sipas 26.6% të punonjësve të policisë dhe 21.7% të popullatës), fushata sensibilizuese (sipas 20.8% të punonjësve të policisë dhe 30.2% të popullatës) dhe programe të veçanta profesionale (sipas 13.9% të punonjësve të policisë dhe 12.5% të popullatës). Fushatat sensibilizuese duhet të kenë qëllim parësor orientimin e popullatës për të zgjidhur konfliktet në familje në rrugë institucionale dhe jo me vetëgjyqësi. Në këtë linjë, është e nevojshme bashkëpunimi në nivel shtetëror e privat për organizimin e hartimin e një projekti, mbi tre linja kryesore: fushatat sensibilizuese në shoqëri, trajnimet për profesionistët (punonjës policie, psikolog, mjek, etj.) dhe programe të veçanta në kurikulat mësimore për trajtim dhe menaxhim të konflikteve që në nivelet bazë të shkollimit. Paraqitet nevojë për komunikim e bashkëpunim më të madh mes SPZ-ve të zonave me banorët dhe, trajnime të punonjësve të policisë dhe grup-shënjestrave në shoqëri, për komunikim më të mirë, për menaxhim të stresit dhe ruajtje të vetëkontrollit, si dhe për zgjidhjen e menaxhimin e konflikteve.


62.82% e punonjësve të policisë, treguan se kishin bërë trajnime për dhunën dhe kriminalitetin në familje ndërsa 82.1% e tyre u përgjigjën se kishin nevojë për trajnime të vazhdueshme dhe module të posaçme për dhunën në familje. Rekomandimet e tyre për tematikat e nevojshme që të trajtohen në trajnimet e ardhshme për kriminalitetin, dhunën e vrasjen në familje janë: nevoja për trajtim të psikologjisë e profilit të autorit/viktimës (19.6%), trajtimin e viktimës (19.3%), pasqyrimin e ndryshimeve në legjislacion rreth kësaj çështjeje (14.7%), tema që lidhen me masat e marra në ndërhyrje në vendin e ngjarjes (13.7%), trajtimin e rasteve të veçanta 12.1%, praktika urdhra mbrojtjeje 9.8%, trajtim i autorit 5.6%, informacione teorike 3.9%. Ata shprehën më shumë nevojën për tema të profilit psikosocial, legjislativ dhe praktika policore në lidhje me ndërhyrjen në vendngjarje në këto trajnime.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:
« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »



Tematika e nevojave për trajnime të punonjësve të policisë, të anketuar për kriminalitetin, dhunën e vrasjen në familje




Punonjësit e policisë të anketuar treguan se detyrat e përgjegjësitet ku ndjehet më shumë vështirësi në lidhje me ndjekjen e çështjeve të dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë mbrojtja dhe garantimi i sigurisë së viktimës (20.23%), përgjigja ndaj njoftimeve të viktimave (14.12%) dhe orientimi i viktimave për shërbime sociale (10.31%), ndërsa theksojnë se kanë më shumë vështirësi të bashkëpunojnë me organet e pushtetit vendor dhe sistemin e drejtësisë.

Niveli i vështirësive që ndjehet punonjësit e policisë të anketuar në lidhje me ndjekjen e çështjeve të dhunës apo vrasjeve në familje



Niveli i vështirësive që ndjehet punonjësit e policisë të anketuar për bashkëpunime me institucionet e mëposhtme në lidhje me ndjekjen e çështjeve të dhunës apo vrasjeve në familje



AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:


« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

7. Profil i të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri⁸

Në këtë pjesë të punimit do të trajtohen profile të të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, në IEVP-të në Shqipëri si dhe profile të përgjithshme të këtij krimi në vendin tonë, bazuar në analizën e të dhënave si rezultat i procesit e anketimit me 50-të të dënuar në shtatë IEVP-të në Shqipëri. Kjo i shërben qëllimit të punimit dhe hipotezës së shtruar për sa i përket kushteve objektive, veçorive dhe motiveve nxitëse të vrasjeve brenda familjeve shqiptare.

Sipas të dhënave statistikore nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në periudhën 2013-2016 paraqitet një numër më i lartë i arrestimeve të autorëve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, ku përkatësisht në vitin 2016 janë arrestuar 28.8%, në vitin 2015, 18.5%, në vitin 2014, 14.4% dhe në vitin 2013, 10.3% e autorëve⁹. Kjo jo se ka më shumë vrasje në këto vite, por se vetëm në këto vite ato janë kualifikuar ekskluzivisht me termin “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare”, sipas nenit 79/ c të Kodit Penal.

Paraqitje grafike në % e sipas viteve, e të arrestuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, të cilet janë duke vuajtur aktualisht dënimin



Nga viti 2013, vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare është përcaktuar më vete si vrasje e cilësuar, lidhur më objektin e veprës penale. Në vitin 2017 ka një rënie të ndjeshme të arrestimeve të autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare. Në periudhën 1998-2000 ka një numër shumë të ulët të arrestimeve, që arrin në vlerën 2.06%. Kjo shpjegohet me atë që, vrasjet në familje gjatë asaj periudhe, janë kualifikuar si vrasje të thjeshta dhe janë raportuar e regjistruar si të tilla.


Nga kampioni i të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri, 88% janë meshkuj, 52% të grupmoshës 31-50 vjeç; të arrestuar kryesisht në periudhën 2013-2016, 60% të martuar para dënimit; 70% banues në qytet, kryesisht në qytete të mëdha si Tirana (15%), Shkodra (12%), Elbasani (8%) dhe lindur në Fier (12.4%), Tiranë (12,4%), Shkodër (11.34%) e Durrës (6.2%); 54% jetonin në familje të

⁸ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin korrik 2017 me grup-shënjestrën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar në shpërndarje në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë-Krujë, Lushnjë, Fier, Peqin).


⁹ Të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Tiranë për statistikën e të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP-të në Shqipëri për vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare për harkun kohor 1998-2017.

përbërë nga 4-5 anëtarë; 52% me nivel të ulët arsimor 8-9 vjeçar; 58% ishin të punësuar para dënimit, nga të cilët 44% punonin në sektor privat, kryesisht si punëtor krahu (16%), në zanate si mekanik, hidraulik, elektrikist (14%) apo punë të çfarëdoshme si p.sh., mbliidhnin hekura, mirëmbanin objekte (10%) dhe shofer (8%); me të ardhura mesatare mujore nga nën 20.000 lekë të reja (34%) deri 20.000-40.000 lekë të reja (22%) dhe pjesa më e madhe e tyre ishin pa historik të mëparshëm kriminal, nga ku 86% e tyre nuk kishin kryer më parë vrasje dhe 82% e tyre deklaruan se nuk kishin kryer më parë krime të tjera si vjedhje, plagosje, dhunë fizike apo fjalë ofenduese.



TË DËNUARIT PËR VRASJE NË FAMILJE NË SHQIPËRI (sipas gjinisë)



TË DËNUARIT PËR VRASJE NË FAMILJE NË SHQIPËRI (sipas grupmoshave)



Statusi civil i të dënuarve për vrasje në familje, para dënimit aktual



AKADEMIA E SIGURISË



Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

16% e të anketuarve janë beqarë dhe 12% të divorcuar. 78% e tyre deklaruan se nuk kishin qenë të martuar më parë, ndërsa një pjesë e vogël (22%) deklaruan se kishin qenë të martuar më parë, ndër të cilët vetëm 24% deklaruan që kishin vetëm një herë qenë të martuar më parë.

Shkalla e punësimit të dënuarve për vrasje në familje para dënimit			
Punësimi	%	Sektorët	%
I/e punësuar	58%	Sektor publik	20%
I/e papunë	42%	Sektor privat	44%
Pa përgjigje	0%	Pa përgjigje	36%
Total	100%	Total	100%

Duke parë trendin më të lartë të punësimit në sektor privat dhe nga biseda me të dënuarit, prirja është që edhe këta të punonin punë fizike në sektorë privat që nuk kërkojnë arsim të lartë. Gjatë intervistave me të dënuarit në kohën që ata plotësonin pyetësorin, disa prej tyre u shprehën: “Kemi punuar ç’të gjenim. Nuk kishim pretendime e shumë mundësi zgjedhjesh. Na duhej për të ngrënë bukë e për të rritur fëmijët...” Nga pjesa e të dënuarve që kishin qenë punëtor krahu, ¼ ose 4% e tyre punonin si të tillë në Greqi. Ndërsa vetëm 4% kishin qenë punonjës policie.



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Familjet sot janë gjithnjë e më të vogla dhe solide. Forma e të jetuarit po ndryshon e është në tranzicion dhe kjo, ka shkaktuar jo pak probleme që kanë ndikuar edhe në shtimin e kriminalitetit në familje. Nga të dhënat rezulton se ata fitonin të ardhura të ulëta mujore, çka vërteton problemet ekonomike në familjet ku është kryer vrasje. Nga teoritë psikosociale, problemet e punësimit, arsimimit dhe mungesa e të ardhurave ndikojnë drejtpërdrejtë në sistemin psikikoemocional të individit. Kjo prodhon konflikt të individit me vetveten dhe me të tjerët, me shumë mundësi me ata që janë më afër, me familjen. Përshkallëzimet e rëndimet e konflikteve dhe të stresit të krijuar nga mosplotësimi i nevojave si rrjedhojë e arsimit të ulët, papunësisë, punëve jo të mirëpaguara dhe të çfarëdoshme, dhe mungesës së të ardhurave, çojnë në shpërthime

të çastit ose në tensione për periudha të gjata kohore, të cilat kulmojnë me vrasje. Këto përfundime teorike konkretizohen me veçoritë e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare në vendin tonë, që janë produkt i problemeve ekonomiko-shoqërore të shoqërisë.

Gjatë bisedave, ata deklaruan se nuk kishin qenë as të dënuar apo nuk kishin një historik kriminal për ngjarje të tjera në kundërshtim me ligjin. Vetëm 2% e tyre deklaruan se kishin kryer vrasje më parë, vetëm një herë, nga të cilët 4% kishin kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, 2% vrasje jashtë familjes dhe 16% kishin kryer forma të tjera të krimit apo sjelljeve e akteve devijante. Ata janë njerëz me probleme socio-ekonomike, që në pamundësi për të ndryshuar situatën dhe problematikat, për të përballuar vështirësitë dhe për të ruajtur vetëkontrollin, si produkt i tensioneve të brendshme të akumuluar, shpërthejnë drejt vrasjes. Për këtë arsye e jo vetëm, shtrohet nevoja për rishikim të strategjive ekzistuese dhe ndërmarrje masash, strategjish e politikash të reja në dimensione sociale, ekonomike e politike për parandalimin dhe reduktimin e këtij krimi.

8. Profili i vrasjeve në familjet shqiptare¹⁰


Nga periudha 1993-2016, 40% e të dënuarve të anketuar deklaruan se vrasjet i kishin kryer në periudhën tre vjeçare 2013-2015 dhe 41% e tyre deklaruan se i kishin kryer në 21 vitet e tjera të periudhës, ndërsa nuk ka një korrelacion mes stinëve dhe kryerjes së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare pasi muajt kur kanë ndodhur vrasjet janë të shpërndarë kryesisht në tetor (10%), dhjetor (8%), korrik (8%), qershor (8%) e mars (8%). 18% e të dënuarve për VSHMF deklaruan se kishin vrarë bashkëshorten, 10% e tyre kushëririn/rën, 10% djalin e 8% bashkëshortin dhe kjo përkon me mendimin e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar me faktin se vrasjet ndodhin më shpesh mes partnerëve, bashkëjetuesve e kushërinjve. 86% e të dënuarve deklaruan se nuk e kishin menduar apo planifikuar më parë krimin e kryer, që ishte një krim i çastit dhe rrjedhojë e përjetimeve dhe problematikave të brendshme e të jashtme familjare.

Në vitin 1997 është evidentuar një rritje e vrasjeve në vitin 1997 (6%) në raport me vitet e tjera para periudhës 1993-2016. Brenda këtij harku kohor prej 24 vitesh, shifra e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në tre vite, 2013-2015 (40%), është pothuaj e njëjtë me shumën e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare të ndodhura në 21 vitet e tjera (42%), ndërsa 18% janë të padeklaruara. Kjo shpjegohet me atë se, në periudhën 1993-2012, vrasjet në familje janë kualifikuar si vrasje të thjeshta dhe janë raportuar e regjistruar si të tilla e jo specifikisht si vrasje në familje. Pra, nuk është realisht kjo, shifra e vërtetë e autorëve të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve për periudhën 1993-2012 e që gjenden në IEVP-të. Ndërsa nga viti 2013, vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare është përcaktuar më vete si vrasje e cilësuar lidhur më objektin e veprës penale.

Ndërsa një pjesë jo e vogël (8%) mohonin të kishin kryer vrasjen dhe kërkonin drejtësi, pasi pretendonin se ishin dënuar në mënyrë të padrejtë. Ata ishin të zellshëm në

¹⁰ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin korrik 2017 me grup-shënjestrën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar në shpërndarë në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushëkrugë, Lushnjë, Fier, Peqin).

diskutim për të treguar rrjedhën e ngjarjes. Në bisedat me të dënuarit ata shpreheshin të penduar për krimin që kishin kryer, duke theksuar se ishte një veprim i ndodhur nga gjaknxehtësia e momentit. Por, nga rrëfimet e tyre, ata pohonin se kishin pasur problematika në familjen e tyre ose problematika me veten, me punën, me stresin e zemërimin. Vrasjet brenda familjeve shqiptare janë rrjedhojë e akumulimeve të brendshme të tensionit që vjen si pasojë e problematikave të brendshme e të jashtme që përjeton individi, që shpërthejnë në këto krime të çastit.





9. Profili psikoemocional i të dënuarve për vrasje në familjet shqiptare¹¹

86% e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare nuk ishin përdorues droge; 68% nuk abuzonin me alkoolin; 62% nuk kishin qenë nën efektin e alkoolit në momentin kur kishte ndodhur ngjarja; 48% nuk kishin ndjerë luhatje humori dhe 40% nuk ishin ndjerë të irrituar pa kuptuar arsyen; 50% kishin qenë të zemëruar e të acaruar në momentin kur kishte ndodhur ngjarja; 56% nuk kishin vuajtur nga depresioni; 58% nuk kishin shkuar të vizitoheshin në profesionistë të shëndetit mendor dhe 56% nuk kishin marrë trajtime e kura profesionale për shëndetin mendor; 52% nuk e kishin menduar të kryenin vetëvrasje; 62% nuk kishin qenë të pajisur me urdhër mbrojtjeje. Ata e perceptonin veten si: të dhimbsur (16.11%), të rregullt (14.77%), të sinqertë (10.07%), emocionalë (9.4%), të kujdesshëm (8.5%), mesatarisht tradicionalë (32%) e liberal (24%). 76% e tyre u shprehën të penduar për veprën e kryer dhe që potë riktheheshin në kohë, nuk do ta kishin kryer vrasjen. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve, mes 15%-40%, ishin të lëkundur, i shmangeshin apo nuk i përgjigjeshin pyetjeve që lidheshin me aspektin psikoemocional apo të shëndetit të tyre.

Luhatjet e humorit janë ndjerë, pavarësisht lëvizjeve në përqindje sipas deklaratave

¹¹ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin korrik 2017, me grup-shënjestrën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar, të shpërndarë në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë-Krujë, Lushnjë, Fier, Peqin).

të të dënuarve. Përqindjet tregojnë për një luhatje në mendime e përgjigje, që çojnë drejt supozimit se ndjesia e irritimit pa kuptuar arsyen nuk është ndërë shumë nga të dënuarit përpara dënimit.



Duhet theksuar se në vendin tonë vazhdojnë të jenë problem e tabu çështjet e shëndetit mendor, ndërëgjegjësimi për t'u vizituar, për t'u kuruar, etj. Fakti që pjesa më e madhe e tyre nuk janë vizituar te një profesionist i shëndetit mendor vë në dyshim deklaratën e më shumë se gjysmës së të dënuarve, që nuk vuanin nga depresioni apo shqetësime të shëndetit mendor. Ka mundësi që edhe mund të kenë vuajtur, por nuk kanë qenë në dijeni për shkak të neglizhencës, turpit apo mungesës së kulturës për t'u vizituar e për t'u kuruar. Kjo do të thotë se të dënuarit më tepër hamendësojnë se nuk kanë vuajtur nga probleme të shëndetit mendor. Problematika më e madhe është mungesa e trajtimit dhe kurimit të këtyre problemeve, që nga fazat më të lehta e deri


AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

tek ato më të rëndat. Kjo do të thotë që gjendja psikike e emocionale përkeqësohet, rëndohet, përshkallëzohet dhe kur tejkalon masën, çon deri në vrasje.

Përgjigjet e të dënuarve për vrasje në familje, të anketuar nëse kishin menduar të vrisni veten pas kryerjes së krimit?



Këto janë përgjigje subjektive që lënë vend për dyshim, pasi edhe gjatë bisedave me të dënuarit, shumica e tyre nguronin apo e shmangnin këtë pyetje duke dhënë një përgjigje “jo” e duke vazhduar më tej. Pjesa më e madhe e tyre shprehën pendim për veprën që kishin kryer. Nuk mohonin konfliktet e ndjesitë e tyre ndaj konfliktit, problematikës apo viktimës, por theksuan se nuk ia vlen të kryenin vrasjen.


10. Raporti “i dënuar – viktimë – institucion”, para ngjarjes së vrasjes¹²

76% e të dënuarve të anketuar deklaruan se nuk kishin pasur më parë anëtarë të dhunshëm që abuzonin me ta apo me pjesëtarë të tjerë të familjes si dhe 74% e tyre deklaruan se nuk kishin pasur konflikte të mëparshme në familjen e tyre, përveç atij që çoi në kryerjen e vrasjes. 38% e tyre nuk kishin kërkuar ndihmë për zgjidhjen e konfliktit dhe 34% kishin kërkuar ndihmë, nga të cilët 18% tek familja, 13% tek shoqëria e miqtë dhe 9% tek policia. Nga ana tjetër, në raste konfliktesh apo problemesh të ardhshme familjare, pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar (28.81%) zgjedhin policinë si institucionin tek i cili do të drejtoheshin, si vazhdim kjo i logjikës së pendesës për vetëgjyqësinë që kishin kryer ndërsa 25.42% e tyre vazhdojnë të zgjedhin familjarët e miqtë, ashtu sikundër kishin vepruar në të kaluarën.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:



« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »



¹² Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin korrik 2017 me grup-shënjestërën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar në shpërndarë në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë-Krujë, Lushnjë, Fier, Peqin).

Ka një mospërputhje mes asaj se si të dënuarit e anketuar kishin vepruar dhe çfarë mendojnë për zgjidhjen e konfliktit. Nga njëra anë ata kishin kërkuar ndihmë të miqtë e familjarët për të zgjidhur konflikte që kishin pasur dhe nga ana tjetër, shprehen se nëse konfliktet në të ardhmen do t'i zgjidhnin duke iu drejtuar organeve të policisë. Kjo mund të interpretohet si vazhdim i logjikës së tyre që shfaqen të penduar për vrasjen dhe që kanë më shumë besim te institucionet, si policia apo sistemi i drejtësisë, pasi zgjidhja me vetëgjyqësi kishte pasoja të rënda.

64% e të dënuarve për VSHMF deklaruan se nuk kishin fyer apo ofenduar më parë viktimën, 54% e fajësonin viktimën se me sjelljen e manifestuara në momentin e ngjarjes e kishin nxitur atë për kryerjen e vrasjes; 52% e fajësonin për kryerjen e aktit, kryesisht për shkaqe si provokime me fyerje (15.31%), tradhti (8.16%) dhe ofendime e të bërtitura (8.16%).



11. Profili psikoemocional i viktimës së vrasjeve në familjet shqiptare¹³

Viktimat e vrasjeve në familjet shqiptare në 50 % të rasteve nuk kishin abuzuar fizikisht apo seksualisht me autorin/en e vrasjes; në 38% të rasteve kishin ofenduar e fyer autorin/en, ku 36% e tyre ishin ndier nën presion nga viktimja. Në bazë të korrespondimit të përqindjeve, pjesa që është ndjerë e ofenduar dhe e fyer, ka ndërë

¹³ Analizë e të dhënave statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar në muajin korrik 2017 me grup-shënjestërën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar në shpërndarë në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushëkrugë, Lushnjë, Fier, Peqin).

edhe presion nga viktima, ndërsa 32% nuk u përgjigjën. 36% e të dënuarve deklaruan se viktimat nuk abuzonin me alkoolin dhe 44% e tyre u shprehën se viktimat nuk ishin nën efektin e alkoolit në momentin kur kishte ndodhur vrasja, si dhe 52% e tyre deklaruan se viktimat nuk abuzonin me drogën. 26% e të dënuarve u shprehën se viktimat kishin luhatje humori, 26% nuk kishin ndërsa 36% deklaruan se viktima nuk vuante nga depresioni. Pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar deklaruan se viktimat kishin probleme me irritimin dhe agresivitetin, ku 38% mendonin që viktimat ishin të irrituara vazhdimisht dhe 42% mendonin se viktimat ishin të dhunshme dhe agresive. Niveli i refuzimit të përgjigjeve është i lartë në të dyja pyetjet, pasi më pak se gjysma e të anketuarve nuk i është përgjigjur pyetjes nëse viktima kishte luhatje humori apo vuante nga depresioni.

12. Gjetje, përfundime e rekomandime

Të anketuarit mendojnë se niveli i dhunës dhe i vrasjeve në familjet shqiptare është shqetësues dhe ka një tendencë rritjeje në 10vjeçarin e fundit 2007-2016, për shkak të kushteve ekonomike, konflikteve të akumuluar dhe stresit e shqetësimeve emocionale. Sipas perceptimeve dhe të dënuarve, vrasjet në familje kanë më tepër natyrë mashkullore me autorë kryesisht meshkuj dhe midis meshkujve. Ndërsa vrasjet mes partnerëve shfaqen problematike me viktima kryesisht femra. Këto vrasje ndodhin në familje me nivel të ulët arsimor dhe ekonomik, si dhe në grupmoshën 31-50 vjeç. Autorët apo viktimat perceptohen me probleme me abuzimin me drogën e alkoolin, probleme emocionale apo çrregullime mendore e depresion që nxisin vrasjet. Ndërsa të dënuarit për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare rezultuan se nuk ishin abuzues me drogën apo me alkoolin, nuk vuanin nga sëmundje e çrregullime mendore apo nga depresioni dhe kishin luhatje emocionale, tension e zemërim. Vrasjet ndodhin më së shumti mes partnerëve, bashkëjetuesve, kushërinjve dhe nga djali ndaj babait.

Sipas punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar, faktorët që nxisin më shumë autorët për të kryer vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare janë: abuzimi me substancat dhe drogën, xhelozia, papunësia, problemet dhe vështirësitë ekonomike, depresioni, çrregullimet mendore dhe sëmundjet mendore ndërsa faktorët që nxisin më shumë viktimat për të manifestuar veprime që më pas shërbejnë për autorin si shkak i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë: abuzimi me substancat dhe alkoolin, xhelozia dhe tradhtia, ndërsa të dënuarit fajësonin viktimën për nxitjen e vrasjes kryesisht për shkak të fjalëve ofenduese e fyese dhe tradhtisë.

Ndërsa pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe të popullatës së anketuar, mendojnë se fjalët fyese e ofenduese të përdorura nga autori apo nga viktima, ndikojnë deri diku si shkak për kryerjen e vrasjeve në familje. Shumica e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar mendojnë se grindjet dhe konfliktet e çastit mes autorit dhe viktimës ndikojnë deri diku në nxitjen e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, ndërsa të dënuarit e anketuar u shprehën se vrasjen e kishin kryer pikërisht si pasojë e konflikteve apo grindjeve të çastit dhe nuk e kishin planifikuar më parë. Pjesa më e madhe e punonjësve të policisë dhe popullatës së anketuar mendojnë se ka disi prirje për të ndodhur vetëvrasje pas vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare ndërsa pjesa më e madhe e të dënuarve të anketuar u shprehën se nuk kishin menduar vetëvrasjen pas ngjarjes së ndodhur. Në bazë të gjetjeve nga procesi i anketimit me të tre

grup-shënjestrat, nisur nga perceptimi i punonjësve të policisë dhe popullatës dhe deklaratat e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, vërtetohet hipoteza se vrasjet në familjet shqiptare kryhen për shkak të problemeve ekonomike dhe psikoemocionale.

Për zgjidhjen e konflikteve në familje të dënuarit ose nuk kishin kërkuar ndihmë, ose ishin drejtuar te miqtë e familjarët, ndërsa shprehën më shumë besim në të ardhmen te Policia e Shtetit për t'u drejtuar në raste problemesh në familje. Ndërsa rekomandohen ndërmarrja e masave e politikave parandaluese si nxitja e fushatave sensibilizuese për menaxhimin e konflikteve dhe emocioneve, hartimi i programeve e strategjive koordinuese parandaluese të dhunës e vrasjeve në familjet shqiptare dhe hartimi e planifikimi i trajnimeve profesionale për punonjësit e policisë e profesionistë të tjerë për këtë çështje.

Referenca

1. *Të dhëna statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar ne muajin qershor 2017 me grup-shënjestrat: punonjës policie, me kampion përfaqësimi 156 studentë në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe popullatë, me kampion përfaqësimi 378 kursantë në Kolegjin Profesional të Lartë "Kolegjin e Policisë".*
2. *Të dhëna statistikore të grumbulluara nga procesi i anketimit i realizuar ne muajin korrik 2017 me grup-shënjestrën e të dënuarve për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. Kampioni përfaqësues ishte me 50-të të dënuar në shpërndarë në 7 IEVP në Shqipëri (IEVP Tiranë, Korçë, Lezhë, Fushë-Krujë, Lushnjë, Fier, Peqin).*
3. *Të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Tiranë, për statistikat e të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP-të në Shqipëri për vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare për harkun kohor 1998-2017.*

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Dhuna në familje si shkak për keqtrajtim, abuzim dhe shfrytëzim



■ MSc. Qetësor Gurra
Akademia e Sigurisë
qetesor.gurra@asp.gov.al

Abstrakt

Synimi i këtij punimi është të trajtojë dhunën në familje si shkak për keqtrajtim, abuzim dhe shfrytëzim parë nën spektrin e një analize imtësore historike, sociale, ligjore, krahasuese kundruar nën spektrin hapësirë dhe kohë në varësi të çështjeve që do të vijojnë. Është e rëndësishme të ofrohen studime dhe shifra konkrete të cilat të paraqesin një tablo të gjendjes reale të këtij fenomeni edhe pse dyshohet gjithnjë për vërtetësinë e tyre, por përveç konstatimit faktik një analizë e thellë vijon ndër faqe duke e pëmbyllur me faktorët kryesorë dhe rekomandime cilësore afatgjata dhe afatshkurtra. Një pjesë e konsiderueshme e punimit do të merret me përfaqesim ligjore dhe vakuomet që pritet të përmirësohen dhe mbushen nga vendi ynë por dhe shembuj konkretë zgjidhje - eksperience - dhënëse nga vendet e rajonit me pothuajse të njëjtat problematika si në por dhe vendet me standarde të cilat kanë suportuar dhe dhënë maksimum kundrejt kësaj problematike. Ndofta mund të duket një tematikë e përfolur dhe përdorur mediatikisht por në të vërtetë drama e familjeve viktime qëndron mbi të gjitha tek fëmijët, shpresa dhe motori i së ardhmes. Çfarë politikash mbart shteti për t'i mbrojtur këta të fundit. Çfarë ofron në pamundësinë totale të mbështetjes, ndihmës ekonomike? Si mbrohen dhe parandalohet prekja dhe cenimi i fëmijëve nga grabitqarët e ligjit dhe uzurpuesit e shtetit të së drejtës? Është e trishtueshme të shohësh tablonë e qartësisë e cila mbi të gjitha këtë grupmoshë e lë në mëshirë të fatit. Është detyra e shtetit, masave efçente të pushtetit qendror dhe lokal, organizatave dhe bashkëpunimit me aktorët ndërkombëtarë e vetmja zgjidhje.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Fjalëkyçe:

dhunë, fëmijë, analizë imtësore, masa konkrete, politika mbështetëse, ndihmë ekonomike, përfaqesim ligjore.

1. Hyrje

Dhuna në familje është kthyer në një fenomen tejet të përhapur çka konstatohet me shume dhimbje në realitetin shqiptar. Rastet e panumërta që deklarohen në media dhe jo vetëm janë një pjesë e vogël e deklarimeve faktike që pasqyrojnë vërtetësinë dhe realitetin. Një jetë e mirë kolektive apo individuale ndikohet nga shumë faktorë, një nga faktorët më të rëndësishëm është dhe familja. Me të drejtë familja është cilësuar si njësi bazë e shoqërisë, pasi ajo siguron një mbrojtje të veçantë për anëtarët e saj, por sa masa mbrojtëse siguron familja sot? Kjo është e diskutueshme. Familja shqiptare si pasojë e tranzicionit që vendi ynë ka kaluar është lëkundur shumë, kjo lëkundje shihet në rastin e dhunës në familje. Kjo ka qenë arsyeja përse kam zgjedhur të trajtoj gjerësisht modestish këtë temë:

- dhunën si një fenomen antiligjor që kërkon vëmendje për zbatimin e procedurave standarde nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, kur ata përballen me raste të ushtrimit të dhunës në familje;

- si një fenomen social që ka tërhequr madje edhe vëmendjen e organizmave ndërkombëtare e që trajtohet prej tyre si shkelje e të drejtave të njeriut;

- si një fenomen që ka qenë dhe mbetet në qendër të vëmendjes nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile në vend.

2. Standardet ndërkombëtare dhe shqiptare për dhunën në familje

2.1. Standardet ndërkombëtare për dhunën në familje

Në ditët tona, standardet ligjore ndërkombëtare ndalojnë qartë dhunën në familje,

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

si dhunim i të drejtave njerëzore kryesore dhe lirive themelore, të mëposhtme, të garantuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut për të gjithë individët:¹

1. e drejta për barazi²,
2. liria nga diskriminimi³,
3. e drejta e jetës, lirisë dhe sigurisë personale⁴,
4. liria nga tortura dhe trajtimet mizore, çnjerëzore ose poshtëruese⁵,
5. e drejta e njohjes si një person para ligjit⁶,
6. e drejta për barazi përpara ligjit⁷,
7. e drejta për mjete juridike nga gjykata kompetente⁸,
8. e drejta për barazi në familje⁹,
9. e drejta për standardin më të lartë të arritshëm, për shëndetin fizik dhe mendor¹⁰.

Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR): “Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht.”¹¹

Shumica e dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë bërë detyruese, si pjesë e së drejtës. Vendet veprojnë sikur dispozitat e saj të ishin ligj, duke e bërë kështu UDHR-në një ligj. Shumë vende kanë integruar të drejtat njerëzore të sipërpërmendura në dispozitat e tyre kushtetuese, duke garantuar kështu lirinë e individëve pavarësisht nga gjinia apo mosha e tyre, nga dhuna në familje. Si ligj suprem i një shteti, një kushtetutë deklaron vlerat më të thella të shtetit dhe deklaratat e shtetit që abuzimi i grave cenon vlerat e tij më të thella, është e rëndësishme. Gratë duhet t'i përdorin këto deklaratat kushtetuese për të bërë presion për ndryshime legjislative dhe për të kërkuar dëmshpërblim për dështimin e shtetit në mbrojtje të grave në familje.

Normat dhe direktivat ndërkombëtare në lidhje me dhunën në familje, ekzistojnë në tri nivele të ndryshme:

- Kombet e Bashkuara (KB),
- Këshilli i Evropës (KE),
- Bashkimi Evropian (BE).

2.1.1 Niveli i Kombeve të Bashkuara

Dokumentet e Kombeve të Bashkuara kanë të bëjnë me njohjen e dhunës në familje, si dhunim i të drejtave njerëzore sipas së drejtës ndërkombëtare dhe formë e diskriminimit kundër grave, si edhe njohjen e përgjegjësisë së një shteti për aktet private të dhunës kundër grave. Këto dokumente janë të tipave të ndryshëm dhe fuqia e tyre ndryshon nga detyruese në jodetyruese ligjërisht.

¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948.

² Po aty, neni 1.

³ Po aty, neni 2.

⁴ Po aty, neni 3.

⁵ Po aty, neni 5.

⁶ Po aty, neni 6.

⁷ Po aty, neni 7.

⁸ Po aty, neni 8.

⁹ Po aty, neni 16.

¹⁰ Po aty, neni 26.

¹¹ Po aty, neni 28.

Megjithatë, pavarësisht nivelit të tyre detyrues, koleksioni i dokumenteve të Kombeve të Bashkuara në këtë fushë ka ndikim të fortë në zgjerimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e grave.

Normat detyruese ligjore të Kombeve të Bashkuara:

- konventa ndërkombëtare “Për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991;
- konventa ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991;
- konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAË)¹².

CEDAW konsiderohet si një kartë ndërkombëtare e të drejtave të grave. Ajo përcakton diskriminimin në një mënyrë shumë të qenësishme, duke bërë të qartë që *gratë kanë të drejtën e një gëzimi të plotë dhe të barabartë të së gjitha të drejtave të tyre njerëzore*. CEDAW, synon të sigurojë barazinë, si detyrim parësor për shtetet palë (neni 2) dhe përmirësimin de facto të pozitës së grave (neni 3-24) duke nënkuptuar veprime pozitive. Ajo lufton ideologjinë gjinore sunduese (neni 5.a) duke kërkuar një ndryshim të qëndrimit tradicional ndaj gruas, që pengon gratë në realizimin e të drejtave të tyre (duke përfshirë eliminimin e stereotipave gjinorë të fshehur në legjislacion). Ndonëse vetë teksti i konventës nuk shprehet drejtpërdrejt për dhunën ndaj grave, rekomandimi nr. 19, i përpunuar nga Komiteti i CEDAW-t, një organ i krijuar nga vetë konventa, është shprehur se Konventa duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe dhunën me bazë gjinore në dispozitat dhe detyrimet që krijon.

Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës”, (edhe kjo e ratifikuar nga Shqipëria) në nenin 19 të saj parashikon: “Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga lëndimet dhe keqtrajtimet fizike e psikologjike. Qeveritë duhet të sigurojnë që fëmijët të jenë nën kujdes të përshtatshëm dhe t’i mbrojnë ata prej dhunës, abuzimit dhe neglizhimit të prindërve ose të kujtdo tjetër që kujdeset për ta...”

- *Normat e politikës së Kombeve të Bashkuara: Deklarata “Për eliminimin e dhunës kundër grave”*. Deklarata “Për eliminimin e dhunës kundër grave” (DVAË), miratuar në vitin 1993, e përcakton kështu dhunën ndaj gruas: “Dhunë ndaj grave është dhuna me bazë gjinore që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimin ose vuajtjen fizike, seksuale apo psikologjike të gruas, përfshi edhe kërcënimet për kryerjen e veprave të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirive, që ndodhin si në jetën publike ashtu dhe në jetën private”. Deklarata pranon se dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë në familje. DVAË specifikon veprimet që duhet të ndërmarrë një shtet për të eliminuar dhunën që ndodh në sferën private: të hartojë legjislacionin e duhur penal; të zhvillojë plane kombëtare të veprimit për të eliminuar dhunën kundër grave, në bazë të burimeve që disponon; të sigurojë shërbime sociale për gratë-viktima të dhunës; të marrë masa për të siguruar trajnimin e zyrtarëve publikë të cilëve u është besuar zbatimi i ligjeve, për t’i bërë ata të ndjeshëm ndaj nevojave të grave; të sigurojë që në buxhetin e qeverisë të caktohen burime të mjaftueshme për të luftuar dhunën në familje. DVAW bën të qartë se veprimi i shteteve palë duhet të matet kundrejt standardeve ndërkombëtare që artikulojnë qartë një strategji për eliminimin e dhunës kundër grave në familje.

¹² CEDAW është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe ka hyrë në fuqi, më 11 maj 1994. Me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, Republika e Shqipërisë aderon edhe në Protokollin Shtesë të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

2.1.2. Niveli i Këshillit të Europës

Këshilli i Europës (KE), si organizatë ndërqeveritare rajonale, ka drejtuar vëmendjen nga mbrojtja e të drejtave njerëzore, që nga themelimi, në vitin 1948. Aktualisht, ai përfshin 46 shtete anëtare. Sistemi i të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës është bazuar në traktatet, të cilat përcaktojnë detyrimet për shtetet anëtare dhe dokumente jodetyruese, si: direktiva, rekomandime dhe rezoluta. Traktatet e të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës janë:

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Europiane), që u miratua në vitin 1950 dhe hyri në fuqi në 1953; është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 2 tetor 1996.

- Karta Sociale Europiane (1965)

- Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese 1989; është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1997.

Konventa Europiane ka peshë të veçantë për shtetet anëtare. Ratifikimi i saj përbën një kusht politik de facto për t'u anëtarësuar në Këshillin e Europës. Të gjitha shtetet anëtare të KE-së duhet ta përfshijnë Konventën Europiane në legjislacionin kombëtar. Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin kombëtar dhe në këtë mënyrë, gjyqësori, në nivel kombëtar, mund dhe duhet të marrë në konsideratë dispozitat e kësaj Konvente.

2.1.3. Niveli i Bashkimit Europian

BE-ja e adreson barazinë gjinore përmes një numri direktivash, rezolutash, rekomandimesh dhe aktesh, të nxjerra nga Këshilli i Bashkimit Europian, Komisioni Europian dhe Parlamenti Europian.

Në vitin 1986, Parlamenti Europian miratoi rezolutën "Për dhunën kundër grave" Ajo bëri thirrje për njohjen ligjore të përdhunimit martesor, për organizimin e trajnimeve për ata që mund të jenë në kontakt me viktimat e dhunës në familje, dhe rekomandoi që grave t'u sigurohet asistencë ligjore.

Në vitin 1997, Parlamenti Europian miratoi rezolutën për nevojën për të ndërmarrë një fushatë të gjerë të BE-së për tolerancë "zero" ndaj dhunës kundër grave.

Presidenca e BE-së, çështjen e dhunës në familje e ka vendosur në agjendën politike që prej vitit 1998 dhe ka miratuar një numër rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje.

Në konferencën e BE-së për dhunën kundër grave, të mbajtur me 1999, u krijuan pesë forume ekspertesh për të shqyrtuar aspekte të caktuara të dhunës në familje: përmbajtjen, shkaqet e fshehura dhe pasojat, mundësitë ligjore për të luftuar dhunën në familje, parandalimin, ndihmën për organizatat dhe bashkëpunimin me institucionet dhe rrjetet europiane dhe punën me dhunuesit. Konferenca miratoi rekomandimin e forumeve të eksperteve për shtetet anëtare. Mbledhja e ekspertëve të BE-së për dhunën kundër grave, e mbajtur në vitin 1999, dha rekomandime për modele të përbashkëta për veprim në ndihmë të luftës kundër dhunës. Ka përpjekje, për të bërë të mundur, që lufta ndaj dhunës në familje të jetë kriter për anëtarësim në të ardhmen.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

2.2. Standardet ligjore shqiptare për dhunën në familje

2.2.1 Aktet normative për mbrojtjen nga dhuna në familje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshkues i të gjithë legjislacionit. Ajo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme në përfaqje me standardet ndërkombëtare. Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare të shtetit tonë. Kushtetuta¹³ parashikon se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Kurse, në ndërtimin e hierarkisë normative, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara¹⁴, i ka dhënë fuqi ligjore. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, pasi botohen në Fletoren Zyrtare, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik¹⁵. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë¹⁶. Në terminologjinë e Kushtetutës shqiptare nuk ka kategorizime apo “etiketime gjinore”. Në këtë dokument të rëndësishëm përdoren përemra të tillë, si: “të gjithë”, “kushdo”, “askujt”, “kujtdo”, “secili” etj. dhe kjo për të treguar se bashkësia njerëzore së cilës i drejtohet dispozita, nuk bën asnjë përjashtim.

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe I lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Duke konsideruar faktin se koncepti i torturës dhe i trajtimeve mizore, çnjerëzore apo poshtëruese së fundmi është zgjeruar dhe konceptohet jo vetëm si akt i kryer nga persona të veshur me funksion zyrtar, por edhe nga individë, dhe shteti është përgjegjës për mbrojtjen e qytetarëve nga trajtime të tilla, Kushtetuta ofron mbrojtje ndaj dhunimit të së drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të gruas në mënyrë të veçantë duke përcaktuar: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues”¹⁷.

Kushtetuta, që në pamje të parë duket sikur ofron vetëm dispozita deklarative, ka krijuar mekanizma garantues të përgjithshëm për mbrojtjen nga dhuna, të tilla si: Avokati i Popullit, sistemi gjyqësor, Gjykata Kushtetuese. Përmendja e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Kushtetuta u hap rrugë garancive juridiksionale ndërkombëtare. Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund t’i paraqiten kërkesa nga çdo person, organizëm joqeveritar ose grup individësh që pretendojnë se janë të dëmtuar nga ndonjë shkelje e shtetit shqiptar e të drejtave të njohura nga Konventa ose protokollat e saj.

¹³ Kushtetuta e RSh neni 5.

¹⁴ Po aty, neni 116.

¹⁵ Po aty, neni 122.

¹⁶ Po aty, neni 18/2.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 25.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

2.2.2 Ligjet

Legjislacioni shqiptar për dhunën në familje përbëhet nga dispozita procedurale dhe materiale të parashikuara në:

1. Kodin Penal,
2. Kodin e Procedurës Penale,
3. Kodin e Familjes, si dhe,
4. Ligjin për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

Kodi Penal parashikon dispozita për sa i përket trajtimit të veprave penale, përfshirë këtu vrasjen, plagosjen, dëmtime të tjera me dashje, marrëdhëniet seksuale me dhunë, etj.

Kodi Penal dhunën në familje nuk e përmban si figurë të veçantë të veprës penale. Megjithatë, si rrethanë rënduese, ai parashikon çdo vepër penale që kryhet ndaj fëmijëve, grave shtatzëna, personave me paaftësi, përsëritjen e dhunës në familje në mënyrë sistematike, ose veprën që kryhet duke përfitur nga marrëdhëniet familjare.

Si vepra penale të përcaktuara në Kodin Penal që kanë të bëjnë me dhunën në familje përmendim:

vrastja (nenet 76 – 83, 85 të Kodit Penal); kanosja (neni 84); tortura (nenet 86 dhe 87); plagosja e rëndë me dashje (neni 88, 88/a, 88/b); plagosja e lehtë me dashje (neni 89); dëmtime të tjera me dashje (neni 90); plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91); plagosja e lehtë nga pakujdesia (neni 92); ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas (neni 93); shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99); marrëdhënie seksuale (nenet 100-107); vepra të turpshme (neni 108); rrëmbimi (neni 109, 109/a, 109/b); heqja e paligjshme e lirisë (neni 110); trafikimi (neni 110/a); dhunimi i banesës (neni 112); prostitucioni (neni 113); shfrytëzimi i prostitucionit (nenet 114, 114/a 114/b); fyerja (neni 119); shpifja (neni 120); ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121); përhapja e sekreteve vetjake (neni 122); pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (neni 123); braktisja e fëmijëve të mitur (neni 124); mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125); marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127); trafikimi i të miturve (neni 128/a); shtytja e fëmijëve në krim (neni 129); shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130); kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (vjedhja me dhunë/vjedhja – (nenet 134, 137, 139, 140, 141); mashtrimi (neni 143); shkatërrimi i pronës (nenet 150-154); prishje e qetësisë publike (neni 274); përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275); vetëgjyqësia (neni 277).

Kodi i Procedurës Penale. Në pjesën më të madhe të veprave penale Kodi i Procedurës Penale, parashikon ndjekjen penale nga organet shtetërore (Prokuroria), mirëpo një sërë veprash të tjera penale, të një rrezikshmërie shoqërore më të vogël ndiqen me ankim nga individ i dëmtuar. Kështu për veprat penale të një rëndësie më të vogël, të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari ka të drejtën e ngritjes së akuzës dhe merr pjesë në gjykim si palë, prandaj quhet i dëmtuari akuzues. Disa nga veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, hyjnë në kategorinë e veprave që ndiqen me ankim, drejtpërdrejt në gjykatë, nga i dëmtuari akuzues.

Nëpërmjet këtyre dispozitave, ligjvënësi i jep mundësi personit të dëmtuar të fillojë procesin penal dhe ta ndjekë atë, për veprat penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të dhe me të drejtat personale të tij. Kjo mundësi i jepet të dëmtuarit për vepra penale të konsideruara me rrezikshmëri shoqërore të ulët.¹⁸ Të tilla janë edhe këto nene të

¹⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 59/1.

Kodit Penal, të cilat, siç u përmendën më lart, ka të ngjarë të ndodhin edhe në kuadrin e marrëdhënieve familjare: dëmtime të tjera me dashje (neni 90); plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91); plagosja e lehtë nga pakujdesia (neni 92); dhunimi i banesës (neni 112); fyerja (neni 119); shpifja (neni 120); ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121) përhapje e sekreteve vetjake (neni 122); mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125); marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127).

Kodi i Familjes, ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Ai përshkohet nga parimi se martesat dhe familja mbështeten në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Ato gëzojnë mbrojtje të veçantë të shtetit. Ky Kod, solli disa dispozita të reja, të cilat mbrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e bashkëshortit të dhunuar. Duke konsideruar faktin se në një pozitë të tillë ndodhet shpesh gruaja, mbrojtja që këto dispozita sigurojnë, është e rëndësishme për të. Kështu, neni 63 parashikon për herë të parë masa urgjente kundër dhunës bashkëshortore dhe në mbrojtje të familjes, duke detyruar dhunuesin të largohet nga banesa bashkëshortore për një periudhë 3-vjeçare.

Në legjislacionin shqiptar nuk parashikohet kompensim i veçantë për viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, ka dispozita të përgjithshme që mund të zbatohen në këto raste.

Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ka si qëllim (neni 1 i ligjit) parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar. Ky ligj do të trajtohet më gjerësisht më poshtë.

Krahas legjislacionit kryesor, ka edhe një sërë ligjesh të tjera që mund të ofrojnë mbështetje për një luftë të gjithanshme ndaj dhunës me bazë gjinore, përfshi edhe dhunën në familje, si p.sh.: Ligji nr. 9198, datë 1.7.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri", i cili synon të sigurojë realizimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuara në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të përcaktojë masa për të eliminuar diskriminimin gjinor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në jetën publike të vendit dhe të përcaktojë përgjegjësitë e administratës qendrore dhe vendore për të hartuar politika për përkrahjen e një shoqërie gjinore të barabartë.

3. Strategjitë dhe Planet e veprimit për parandalimin e dhunës në familje

Qeveria shqiptare, me mbështetjen e disa organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve të ndryshme ka hartuar disa strategji që mund të gjejnë zbatim dhe janë në funksion të parandalimit të dhunës në familje si:

- *Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje*, e cila përcakton politikat dhe veprimet konkrete të strukturave, përfshi edhe organet e policisë për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje.

- *Strategjia e Shërbimeve Shoqërore, 2005-2010*, që ka Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta – Drejtoria e Shërbimeve Sociale. Ky dokument u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 265, datë 28.4.2005. Në kuadër të kësaj strategjie janë evidentuar grupe kryesore të individëve që kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime sociale. Një prej tyre janë gratë ku, përveç grupeve të tjera, përfshihen: gratë e dhunuara (viktimat e dhunës në familje) dhe gratë e divorcuara.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

- *Strategjia kombëtare për zhvillimin social dhe ekonomik.* Kjo strategji synon zbatimin e politikave sociale zbutëse të varfërisë. Ajo vë theksin tek sigurimi i shërbimeve të veçanta që do t' u ofrohen kategorive të prekshme të popullsisë (fëmijëve, të rinjve, grave, të moshuarve) për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Strategjia nuk përmend në mënyrë të veçantë dhunën në familje dhe nuk parashikon politika mbrojtëse, por i shërben parandalimit të saj.

- *Strategjia e punësimit dhe e formimit profesional.* Në kuadrin e kësaj strategjie parashikohen të aplikohen programe për gratë e papuna dhe me probleme të thella sociale, e cila i shërben parandalimit të dhunës së mëtejshme në familje.

- *Strategjia kombëtare shqiptare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore: kuadri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit, 2005-2007.* Kuadri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit, 2005-2007, e konsideron dhunën në familje si shkak të trafikimit dhe me aktivitetet e parashikuara në këtë kuadër, mendohet që kanë ndikuar edhe mbi dukurinë e dhunës kundër grave dhe fëmijëve. Mbështetja nga qeveria e programeve të ndryshme për arsimin, shtypin dhe mënyrat e tjera të informimit të komunitetit e sidomos të grave, fëmijëve e grupeve në rrezik rreth trafikimit, përbën një objektiv specifik të këtij kuadri strategjik. Kjo strategji së fundmi është në proces rishikimi dhe rinovimi për të mbuluar periudhën në vazhdim.

- *Strategjia dhe Plani i veprimit "Për veprimtarinë e Policisë së Shtetit për periudhën 2007-2013"*, ku përcaktohen synimet e objektivat që do të arrijë Policia e Shtetit në kuadrin e policimit në komunitet dhe parandalimin e goditjen e krimit. Po ashtu përcaktohet dhe ngritja e strukturave të reja për herë të parë, të cilat do të merren direkt me parandalimin e trajtimin e dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e të miturve.

4. Rreziku që u kanoset më së shumti fëmijëve shqiptarë

Disa ndër kërcënimet kryesore që u orvaten fëmijëve shqiptarë janë si në vijim:

- Fëmijët pa kujdes prindëror janë në një rrezik të lartë diskriminimi, kujdesi të pamjaftueshëm, abuzimi, dhe shfrytëzimi. Ata shpesh vendosen pa qenë nevoja dhe për një kohë të gjatë në institucione ku atje marrin pak stimulim dhe vëmendje individuale të cilën e kanë tej mase të nevojshme për t'u rritur cilësisht me potencialin e tyre të plotë.

- Një numër i konsiderueshëm lindjesh nuk regjistrohen çdo vit. Përveçse është një e drejtë njerëzore, regjistrimi në lindje është jetik që ata të kenë akses në shërbime.

- Metodatat e dhunshme për disiplinimin e fëmijëve janë të përhapura: në kontekstet rurale dhe urbane dhe në të gjitha kategoritë social ekonomike – të varfër dhe të pasur.

- Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre hasin vazhdimisht barriera për të gëzuar të drejtat e tyre njerëzore bazë dhe për përfshirjen e tyre në shoqëri. Ata shpesh përjashtohen nga arsimimi, dhe shërbimet sociale dhe shëndetësore bazë.

- Fëmijët në situatë rruge dhe puna e detyruar që shpesh interferon me arsimimin e fëmijëve.

- Përdorimi i burgosjes për fëmijët duhet të jetë, sipas ligjit, mjeti i fundit.

Për të plotësuar nevojat e atyre fëmijëve që janë më në rrezik, janë ngritur Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) në nivel bashkie. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve kanë

tre funksione kryesore¹⁹:

- (1) të vlerësojnë dhe monitorojnë situatën e fëmijëve dhe familjeve në rrezik;
- (2) të koordinojnë referimet e mbrojtjes në nivel vendor dhe reagimet;
- (3) të kryejnë identifikimin dhe menaxhimin e rasteve shumëdisiplinore më urgjente brenda çdo bashkie. Të gjitha shërbimet janë falas, dhe të orientuara drejt fëmijëve dhe familjeve më vulnerabël.

Derisa Shqipëria të përkthej në hapa konkretë rekomandimet e studimit global të KB mbi dhunën ndaj fëmijëve të cilat ndalojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve dhe dhënien prioritet të parandalimit dhe objektivit i mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, dhe dhunës nuk do të arrihet. Legjislacioni mund të ndihmojë të ndryshojë normat sociale si qëndrimi ndaj punës së fëmijëve por legjislacioni, nëse nuk mbështetet nga një konsensus social, mund të mos jetë efikas. Bota që në duam të ndryshojmë është një botë ku vajzat dhe djemtë nuk janë pre e dhunës, shfrytëzimit, dhe ndarjes së panevojshme nga familja; dhe ku ligjet, shërbimet, dhe praktikat minimizojnë vulnerabilitetin e fëmijëve.

Ka dy mënyra që ndihmojnë për të ndërtuar një mjedis mbrojtës. Një mënyrë është duke fuqizuar qeverisjen qendrore dhe vendore, dhe sistemin e të dhënave për të mbledhur, analizuar, dhe shfrytëzuar të dhënat mbi situatën e fëmijëve sa më mirë. E dyta ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve sociale në mënyrë që fëmijët e marginalizuar mund të gjenden dhe t'u ofrohet përkujdesje si dhe për të parandaluar vulnerabilitetin nga kërcënimet në të ardhmen. Por kjo kërkon përpjekje kolektive nga çdo profesionist që duhet të raportojë dhe të ndjekë çdo shenjë të abuzimit të fëmijëve. Zbatimi i ligjit dhe sistemi gjyqësor duhet të veprojnë ndaj atyre që dënohen për abuzime ndaj fëmijëve. Çdo profesionist dhe punonjës i administratës publike jep llogari për ndihmën e dhënë për të siguruar mirëqenien e fëmijëve dhe për bashkëpunimin me profesionistë të tjerë, komunitetet, dhe familjet në mënyrë që një mjedis i vërtetë mbrojtës të mund të krijohet për fëmijët.

5. Të dhëna mbi gjendjen faktike të dhunës në familje dhe mbi të gjitha nen fokus dhuna mbi fëmijët

Një studim i kryer nga Bashkimi Evropian në vitin 2011 shprehet se 98% e njerëzve tani janë të vetëdijshëm përdhunën në familje në të gjithë BE-në krahasuar me 94% në sondazhin e mëparshëm²⁰.

- Ndërgjegjësimi për dhunën në familje ndaj grave është shumë i lartë në të gjithë BE-në, falë medieve të tilla si televizioni (92%), gazetat dhe revistat (59%) duke informuar shumicën dërrmuese të qytetarëve të BE rreth problemit²¹.

- Dhuna në familje mbetet shumë e zakonshme: një i anketuar në katër në të gjithë BE-në e njeh një grua midis miqve ose në rrethin familjar e cila është viktimë e dhunës në familje. Që nga sondazhi i mëparshëm, përqindja e evropianëve thonë se e njohin një viktimë të dhunës në familje nga rrethi i miqve ose familjes së tyre duke e rritur përqindjen nga 19% në 25%²².

- Gratë kanë më shumë gjasa se burrat të njohin një grua që ka vuajtur dhunën në

¹⁹ UNICEF, *Children and Violence Study*, Innocenti Digest No 5, f. 4.

²⁰ EU, *Violence against women and children: an EU-wide survey*, 2011, pag 12

²¹ Po aty, f. 13.

²² Po aty.

familje. Ndërkohë që ato gjithashtu kanë më shumë gjasa se burrat të jenë të vetëdijshme për njerëzit të cilët e kryejnë këtë krim, dhe më shumë gjasa për ta parë problemin seriozisht dhe për të avokuar ndëshkime më të ashpra për ata që janë përgjegjës.

- 78% e evropianëve e pranojnë se dhuna në familje është një problem i zakonshëm.

Qëndrimet ndaj dhunës në familje në përgjithësi janë bërë shumë më të ashpra, në baze të anketimit në fjalë përqindja ka një rritje të konsiderueshme (në 86%, nga 63%) duke thënë se dhuna është e papranueshme dhe gjithmonë duhet të dënohet me ligj²³.

- Dhuna seksuale dhe fizike shihen si format më serioze të dhunës që preken gratë me 85% të së anketuarve në të dy rastet duke pasur parasysh këtë këto janë “shumë serioze”.

- Ekziston mbështetje e fortë për përfshirjen e BE-së në çrrënjosjen e dhunës në familje

kundër grave 87% e të anketuarve mendojnë se BE-ja duhet patjetër të përfshihet megjithatë, ndërsa shumica e njerëzve besojnë se ligjet janë në vend për të parandaluar dhunën, shumë pak (14%) janë të njohur me masat specifike të BE-së për të trajtuar dhunën si problem.

- Deri javën e kaluar llogaritet që në Sistemin e Ministrisë së Drejtësisë është ofruar ndihme juridike familjare për 447 aplikues, 342 aplikues femra, 30 individë që kane aplikuar për urdhra mbrojtje dhe 19 për dhunë në familje. Shumë pak konstatime faktike në krahasim me realitetin që lë tej mase për të dëshiruar.

- Dhuna mbi fëmijët është një fenomen global. Ajo shfaqet si në vendet tashmë të zhvilluara dhe, në një përmasë më të madhe, edhe në vendet në zhvillim. Është kjo arsyeja që organizata të tilla ndërkombëtare si UNICEF, ËHO, ILO, etj., kanë shfaqur një interesim në rritje për të adresuar këtë fenomen. Të dhënat të referuara në dokumentet e këtyre organizatave tregojnë për përmasën dhe llojet e ndryshme të dhunës që ushtrohet mbi fëmijët. Çdo vit në të gjithë botën më shumë se 1 milion fëmijë detyrohen forcërisht të prostitutojnë, trafikohen dhe shiten për qëllime seksuale ose përdoren në pornografinë fëmijërore.

- Në botë, çdo vit rreth 40 milion fëmijë pësojnë abuzime.

- Përdorimi i ndëshkimit trupor si mjet për disiplinimin e fëmijëve pranohet në opinionin e njerëzve dhe ligjërisht në shumë vende të botës dhe është i përhapur. Studimet në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shtetet e Bashkuara kanë zbuluar se 90% e të gjithë fëmijëve ndëshkohen fizikisht gjatë fëmijërisë.

- Në vitin 2000, rreth 57 000 fëmijë nën moshën 15 vjeç vdiqën si rezultat i dhunës në shtëpi.

Fëmijët më të vegjël janë në rrezik më të madh: niveli i vrasjeve në shtëpi për fëmijët e moshës 0-4 vjeç është dyfish i krahasuar me atë të fëmijëve 5-14 vjeç (5.2 në 100,000 krahasuar me 2.1 në 100,000). Shkaku më i zakonshëm i vdekjes është plagosja në kokë²⁴.

- Megjithëse të dhënat për abuzimin seksual të fëmijëve është vështirë të shtihen në dorë ose të merren, OBSH vlerëson se rreth 20% e grave dhe 5-10% e burrave kanë pësuar abuzim seksual si fëmijë. Në Shtetet e Bashkuara rreth 44% e viktimave të përdhunimit janë nën moshën 18 vjeç dhe rreth 15% janë nën moshën 12 vjeç.

- Llogaritet që 67 milion fëmijë të moshës 5-14 vjeç të jenë angazhuar në punë të parrezikshme fëmijësh. Mbi 180 milion fëmijë janë përfshirë në punësim të rrezikshëm.

²³ Po aty, f. 14.

Megjithëse një sërë vendesh kanë kryer studime lidhur me dhunën kundër fëmijëve, përmasa dhe shkaqet e këtij fenomeni nuk janë studiuar ende aq sa duhet. Është kjo arsyeja që, kohët e fundit, Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ka ndërmarrë një studim lidhur me dhunën kundër fëmijëve ku ka përfshirë qeveritë e të gjitha vendeve. Megjithëse në planin teorik pohohet se dhuna duhet përdorur në rastet kur është e nevojshme, në praktikën e përditshme dhuna fizike dhe psikologjike është mjeti kryesor për disiplinimin e fëmijëve si në shtëpi ashtu edhe në shkollë.

-Raporti i përgatitur nga UNICEF për vendin tone në vitin 2006 në lidhje me bërthamën familje dhe abuzimin kundrejt fëmijëve shprehet se format e dhunës fizike kundër fëmijëve të përdorura në shtëpi dhe në shkollë të raportuara nga fëmijët janë përkatësisht si më poshtë: shkulja e veshëve (60.10%-38.5%), pickimi (55.70%-36.9%), goditja me shpullë në trup (52.60%-34.3%), goditja me shpullë në kokë (49.20%-35.6%), shkulja e flokëve (41%-29.7%), tërheqja dhe shtytja me forcë (34.60%-39.1%), goditja me objekt në trup (27%-38.2%), goditja me shqelm (26.80%-25.8%), goditja me objekt në vithe (26%-13.6%), goditja me grusht në trup (20.50%-19.6%), kafshimi (19.10%-12.8%), shtrëngimi për fyti (12.20%-9.6%), goditja me grusht në kokë (7.60%-10%)²⁵.

- Përdorimi i pëllëmbëve, krahut, grushtit, shqelmit, sendeve të cilat përplasen në trupin e viktimës dhe gjithashtu edhe të kafshimeve, pickimeve, përplasjeve, tërheqjeve shtyrjeve dhe izolimit të viktimës në vende të caktuara, si rregull, të frikshme, është një tregues i karakterit të dhunës fizike dhe i ashpërsisë me të cilën ajo shfaqet. Format më të shpeshta të dhunës fizike në shtëpi dhe në shkollë janë ato me goditje dhe përkatësisht: një në dy fëmijë goditen në kokë e trup në shtëpi, ndërsa një në tre goditen edhe në shkollë. Kjo do të thotë se në shtëpi fëmijët përjetojnë më shumë akte të dhunës fizike sesa në shkollë. Fëmijët janë të prirë të denoncojnë më shumë dhunën që e ushtrojnë mbi ta fëmijët e tjerë dhe më pak të prirë të denoncojnë dhunën e mësuesve. Sido që të ndodhë trajtimi i rasteve të denoncimit të dhunës nuk merret seriozisht.

- Format më të përhapura të dhunës psikologjike që përdoren në shtëpi të raportuara nga fëmijët janë: të bërtiturat (95.3%), mbajtja e mërisë (39.5%), kërcënimi me fjalë (39%), përdorimi i nofkave dhe i epiteteve jodashamirëse (35.8%), kërcënimi me objekte (18%), kërcënimi me dëbim (14%), kërcënimi me braktisje (6%), mallkimi. Prindërit janë më të prirë se mësuesit ta përdorin mbajtjen e mërisë si një dhunë psikologjike mbi fëmijët, si formën e rrallë ashtu edhe formën e shpeshtë të saj. Prindërit janë më të prirë se mësuesit të përdorin nofka dhe epitete të tjera keqëse, si rrallë ashtu edhe dëndur. Mësuesit janë më të prirë se prindërit t'i dëbojnë nxënësit nga shkolla si kur e përdorin rrallë këtë ndëshkim psikologjik, ashtu edhe kur e përdorin dëndur atë²⁶.

- Studimi zbuloi se ekziston një prirje që në shtresat e ulëta dhe më pak të arsimuara të shoqërisë të përdoret më shumë dhunë fizike, ndërsa në shtresat e mesme dhe me më shumë arsim të ekzistojë prirja drejt heqjes dorë nga përdorimi i dhunës fizike dhe animi nga përdorimi i dhunës psikologjike.

- Fëmijët që shfrytëzohen për punë i nënshtrohen një dhune të shumëfishtë: dhunës familjare, dhunës së rivalëve që shesin në territore fqinjë dhe që duan t'u rrëmbejnë klientelën, dhunës së kamerierëve të lokaleve të shumta ku këta hyjnë për të shitur

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

²⁴ EU, *Violence towards children in the EU - European Parliament study*, 2012, f. 25.

²⁵ Po aty, f. 26.

Po aty.

²⁶ Po aty, f. 27.

mallrat e tyre, dhunës së policëve që patrollojnë në territoret ku këta shesin.

- Fëmijët e intervistuar raportuan se 13.3% e tyre ngacmohen seksualisht nga fëmijë, nxënës të tjerë (49.4%), nga persona të tjerë (28.1%), dhe nga mësuesit e vet (22.5%).

- Studimi zbuloi se mbizotërojnë braktisjet në mosha shumë të vogla, kryesisht braktisjet që në maternitete, por nuk mungojnë as shpërfilljet e fëmijëve. Në çdo tre fëmijë që mbahen në institucionet e përkujdesjes shoqërore në vitet 2000-2005 njëri është i braktisur që në lindje, ndërsa dy të tjerët vijnë nga familje me vështirësi të caktuara.

- Arsyet e përdorimit të dhunës kundër fëmijëve lidhen me filozofinë e dobisë që sjell dhuna, me psikologjinë e humbjes së vetëkontrollit, me përdorimin e dhunës si instrument për disiplinim kur fëmijët dhe nxënësit nuk respektojnë standardet e caktuara të sjelljes. Mosbindja ndëshkohet me dhunë në 32.8% të rasteve, mospërgatitja e duhur në mësim në masën 17.4%, zhurma dhe rrëmuja në masën 26.9%²⁷.

- Pasojat psikologjike të dhunës prekin nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të fëmijës, mundësinë zhvillimore të tij dhe kultivojnë sjelljen e dhunshme. Specifikisht: 13.4% e fëmijëve të anketuar pohojnë se vetëvrasja u ka shkuar ndër mend të paktën një herë dhe të shumtën mbi katër herë; të sigurt dhe shumë të sigurt ndjehen 65.6% e nxënësve, ndërsa 34.4% e tyre ndjehen as të sigurt e as të pasigurt, të pasigurt e shumë të pasigurt. Kjo do të thotë se një e treta e nxënësve percepton pasiguri të niveleve të ndryshme të cilat lidhen të gjitha me përdorimin e dhunës.

-Ushtruesi më i shpeshtë i dhunës fizike dhe psikologjike në shtëpi është nëna, ndërsa ushtruesi më i ashpër është babai. Nëna ushtron më shumë dhunë kur fëmijët janë më të vegjël, ndërsa babai ushtron më shumë dhunë të fëmijët e rritur.

-Në përgjithësi të rriturit meshkuj në shtëpi (babai, gjyshi) ushtrojnë më shumë dhunë fizike mbi pjesën tjetër mashkullore (fëmijët djem), ndërsa pjesa e rritur femërore (nënat, gjyshet, motrat më të rritura) ushtrojnë më shumë dhunë mbi pjesën tjetër femërore (fëmijët vajza).

6. Rekomandime

Kjo temë do të shërbejë si një udhëzues për të gjithë aktorët civile dhe publikë në funksion të detyrimeve ligjore që ata kanë për të marrë masa efektive në një kohë të shpejtë dhe me veprime ligjore, për parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Disa nga rekomandimet më themeltare pavarësisht se në tërësi ato janë të pafundme do të përmendja:

- fuqizimin e angazhimit dhe veprimit kombëtar në trajtimin e dhunës në familje në kuadrin e promovimit të barazisë gjinore dhe të drejtave themeltare në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, në drejtimin e fushatave efektive të lobimit rreth çështjes së dhunës;

- themelimi, implementimi, monitorimi i përgjigjeve shumësektoriale të koordinuara për të trajtuar dhunën në familje;

- përfshirjen e drejtuesve politike, të komunitetit, atij fetar dhe të tjerë për të folur kundër dhunës në familje;

- përmirësimin e kapacitetit të mbledhjes se të dhënave në monitorimin e dhunës në familje;

- promovimin e parandalimit për ndryshimin e sjelljes për të pakësuar dhunën në familje;

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

- fuqizimin e reagimit të sektorit mjekësor të kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje duke përfshirë zhvillimin e një reagimi gjithëpërfshirës të këtij sektori;
- mbështetjen e grave që jetojnë me dhunë në familje dhe ofrimin e mbështetjes ndaj shërbimit të kësaj gjinie vulnerabël në varësi të situatave;
- sensibilizimin e policisë, zyrtareve ligjore dhe gjyqësor ndaj dhunës në familje, nevojave të viktimave të dhunës në familje, praktikave me të mira për ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje;
- për mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të dhunës në Shqipëri është i nevojshëm një kompleks ndërhyrjesh në fusha të ndryshme; disa prej këtyre ndërhyrjeve kanë efekte parandaluese, disa të tjera fokusohen te trajtimi i viktimave të dhunës;
- mbulimi ligjor i të gjitha formave të dhunës në të gjitha mjediset ku banon dhe mëson fëmija (në shtëpi, shkolla, institucione të shëndetit fizik dhe mendor, qendra banimi të fëmijëve, në ambiente paraburgimi, komunitete, mjedise publike), me parashikimin e masave të duhura ndëshkimore;
- dëmshpërblimi dhe kompensimi i viktimave të dhunës;
- raportimi i detyrueshëm i çdo akti dhune të kryer ndaj fëmijëve nga punonjës të sektorëve të shëndetësisë dhe të arsimit;
- integrimi dhe rehabilitimi të fëmijëve viktimë të dhunës ose të fëmijëve dëshmitarë të dhunës;
- të ngrihet në nivel qendror një strukturë e veçantë qeveritare (së bashku me strukturat në nivel lokal) që të merret para së gjithash me trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve;
- të ngrihet një strukturë e veçantë parlamentare që të merret veçanërisht me dhunën ndaj fëmijëve;
- të ngrihet një sistem që do të merrej me ankesat e fëmijëve që vuajnë episode dhune në
 - arsim dhe në institucione të kujdesit social;
- të ngrihen agjenci të veçanta publike për raportimin e detyrueshëm dhe vullnetar të rasteve që përfshijnë dhunën ndaj fëmijëve;
- të ngrihen njësi këshillimore dhe rehabilitimi që merren me rastet urgjente ku ka dhunë
 - ndaj fëmijëve;
- të ngrihen qendra rehabilitimi afatgjata për fëmijët viktimë të dhunës ose fëmijët dëshmitarë të dhunës;
- të rishikohen lëndët shkollore me qëllim që të pakësohet stresi te mësuesit dhe nxënësit dhe të merren masa për trajnim lidhur me menaxhuesit e stresit;
- të shtrihet shërbimi psikologjik në të gjitha institucionet e edukimit dhe të përkujdesjes
 - shoqërore duke e mbështetur atë në të dhëna me të besueshme;
- të zhvillohen politika dhe programe, në bazë kombëtare dhe lokale, që të trajtojnë arsytet dhe faktorët themelorë që dhunohen fëmijët;
- të ngrihen mekanizma për monitorimin e politikave dhe programeve (shtetërore ose private, të organizatave jofitimprurëse) që merren me dhunën ndaj fëmijëve, të bëhen sondazhe periodike për dhunën ndaj fëmijëve dhe për ndikimin që kanë sanksionet ligjore në këtë fushë;
- të ngrihet një sistem arkivimi dhe informimi periodik lidhur me dinamikën e dhunës kundër fëmijëve;

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

- të përfshihet në raportimet statistikore të INSTAT-it numri i fëmijëve të vdekur si pasojë e dhunës së verifikuar ose të dyshuar;
- të bëhen fushata në shkallë të gjerë dhe sistematike për ngritjen e ndërgjegjësimit të popullatës në përgjithësi dhe të forcave arsimore në veçanti mbi qëndrimin e ligjit ndaj përdorimit të dhunës, mbi qëndrimin e mjekësisë, psikologjisë, psikiatrisë dhe pedagogjisë ndaj saj, mbi pasojat e dhunës, mbi efektet shkatërruese të dhunës psikologjike, mbi të drejtat e fëmijëve për paprekshmëri fizike dhe psikike, etj.;
- të bëhen trajnime dhe programe të tjera (vizitat në shtëpi) me prindërit për pajisjen e tyre me shprehitë e prindërimit dhe mënyrat alternative të disiplinimit të fëmijëve.
- të bëhen trajnime të punonjësve të edukimit, shëndetësisë dhe të përkujdesjes shoqërore për diagnostikimin e hershëm dhe raportimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve;
- të botohen trajtesa lidhur me disiplinimin e fëmijëve, të cilat sfidojnë përdorimin e dhunës dhe ofrojnë teknika jo të dhunshme për arritjen e objektivave të mirërritjes së fëmijës etj.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Bibliografia

Ligjet e marra parasysih

1. Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
2. Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare".
3. Ligji nr. 8719, datë 19.12.2000 "Për një shtesë në ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi. doganori Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8473, datë 14.4.1999.
4. Ligji nr. 9125, datë 29.7.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligj nr. 8085, datë 12.3.1996.
5. Ligji nr. 8175, datë 23.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë".
6. Ligji nr. 8204, datë 10.4.1997 "Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë".
7. Ligji nr. 8733, datë 24.1.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë".
8. Ligji nr. 9062, 8.5.2003 "Kodi i familjes".
9. Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë".
10. Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës".
11. Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë".
12. Ligji nr. 8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
13. Ligji nr. 8092, datë 21.3.1996 "Për shëndetin mendor".
14. Ligji nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare".
15. Ligji nr. 8442, datë 21.01.1999 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare".
16. Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për avokatin e popullit".
17. Ligji nr. 7650, datë 17.12.1992 "Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në kodin e familjes".
19. Ligji nr. 7986, datë 13.9.1995 "Për inspektoratin shtetëror të punës".
20. Ligji nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit".
21. Ligji nr. 8321, datë 2.4.1998 "Për policinë e burgjeve".
22. Ligji nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar"
23. Strategjia Kombëtare për Fëmijët, 03.03.2001.
24. Strategjia Kombëtare kundër trafikut të qenieve njerëzore", paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave.

Botime

25. Hazizaj, A., Barkley, Th., (2000), *Awaiting trial, a report on the situation of children in Albanian police stations and pretrialdetention centers.*
26. UN, *After the UN Study - what next? A discussion paper on possible outcomes of the UN Study on Violence against Children.*
27. UNICEF, *Children and Violence*, Innocenti Digest No 2.
28. Babani, A., (2002), *Domestic violence against women in Albania, Eliminating the Worst Forms of Child Labour, A Handbook for Parliamentarians*, ILO and the IPU.
29. APA (1996), *Is Youth Violence Just Another Fact of Life.*
30. *Konventa mbi të drejtat e fëmijës (CRC)*, Shqipëria.
31. OBSH (2001), *Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës*, 28 shtator 2001.
32. U.S. Department of Justice (2000), *Rape, Incest & Abuse National Network citing Sexual Assault of Young Children as U.S. Department of Justice, 2000, Reported to Law Enforcement.* Bureau of Justice Statistics, U. S. Department of Justice.
33. INSTAT, *Rapid Assessment of Trafficking in Children for Labor and Sexual Exploitation in Albania*, Tirana.
34. *Strategjia Kombëtare për Fëmijët*, RSH, (2001).
35. *Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara*, (2004).

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Parandalimi i krimit në familje



■ **MSc. Besnik SHEHAJ**
Akademia e Sigurisë
shehaj.besnik@asp.gov.al

Abstrakt

Parandalimi i krimit në familje përbën vërtet një sfidë për Policinë, jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë botën e zhvilluar demokratike. Sipas një anketimi në Britaninë e Madhe, rezultojnë se 45% gra dhe 26% burra kishin përjetuar të paktën një incident të dhunës familjare gjatë jetës së tyre. Në SHBA raportohet se rreth 60% e grave amerikane janë sulmuar fizikisht gjatë jetës së tyre nga një partner ose bashkëshorti. Një studim i të dhënave të dhunës në familje në Australi zbuloi se 1 në 3 gra dhe 1 në 5 burra kanë përjetuar të paktën një incident të dhunës nga një partner aktual ose ish-partner, që nga moshën 15 vjeçare. Në vendin tonë raportohen nga Policia mesatarisht 1500 krime në familje në vit ose 4.1 raste në ditë, ndërsa mesatarisht 22.5% e vrasjeve të ndodhura në vit janë pasojë e dhunës në familje. Ndërkohë, është i njohur botërisht fakti se vetëm një përqindje e vogël e rasteve të dhunës në familje denoncohet në Polici, ku nga të dhënat e Byrosë Australiane të Statistikave rezultojnë se 80% e grave dhe 95% e meshkujve, që kishin përjetuar dhunë nga një partner, nuk kishin kontaktuar kurrë me policinë. Shkaqet e këtij lloji krimi dhe pasojat përbëjnë një fushë të veçantë studimi, që kërkojnë një trajtim kryesisht në aspektin psiko-social të fenomenit dhe janë objekt i shkencave të psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë, etj. Por synimi ynë në këtë kumtesë është të trajtojmë vetëm aspektin e masave të mirëfillta policore për parandalimin dhe reduktimin e krimit në familje, i cili shpesh përshkallëzohet në krime të rënda ose me përsëritje, të nxitura nga psikologjia e hakmarrjes, gjakmarrjes, padrejtësisë, vetëgjyqësisë, etj.

Analiza e të dhënave statistikore, rasteve tipike apo tipologjive më të shpeshta, e opinionëve të specialistëve të Policisë në terren, e intervistave me personat e viktimizuar nga krimi në familje, si dhe hulumtimi i eksperiencave ndërkombëtare, na ka dhënë mundësinë të arrijmë në disa përfundime interesante dhe rekomandime të vlefshme për veprimtarinë e Policisë në përballimin e sfidës për parandalimin e këtij lloji krimi.

Fjalëkyçe:

dhunë psikike dhe fizike, marrëdhënie familjare, krim në familje, fëmijë të mitur, urdhër mbrojtje, urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

1. Hyrje

Parandalimi i krimit në familje përbën vërtet një sfidë për Policinë, jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë botën e zhvilluar demokratike. Sipas një anketimi në Britaninë e Madhe, rezulton se 45% e grave dhe 26% e burrave të përfshirë në kampion kishin përjetuar të paktën një incident të dhunës familjare gjatë jetës së tyre.¹ Në SHBA raportohet se rreth 60% e grave vendase amerikane janë sulmuar fizikisht gjatë jetës së tyre nga një partner ose bashkëshorti.² Një studim i të dhënave të dhunës në familje në Australi zbuloi se 1 në 3 gra dhe 1 në 5 burra kanë përjetuar të paktën një incident të dhunës nga një partner aktual ose ish-partner, që nga moshën 15 vjeçare.³ Në vendin tonë raportohen nga Policia mesatarisht 2810.3 krime në familje në vit (Figura 1) ose 7.6 raste në ditë,⁴ ndërsa mesatarisht 22.7% e vrasjeve të ndodhura në vit (Figura 2) janë pasojë e dhunës në familje. Ndërkohë, është i njohur botërisht fakti se vetëm një përqindje e vogël e rasteve të dhunës në familje denoncohet në Polici, ku mund të përmendim si fakt të dhënat e Byrosë Australiane të Statistikave që tregojnë se 80% e grave dhe 95% e meshkujve, që kishin përjetuar dhunë nga një partner, nuk kishin kontaktuar kurrë me policinë.⁵

¹ Hatzidimitriadou, E. (2011), *Domestic Violence in England: a cross-sectional survey of community prevalence and its impact on health-related factors*, London: Kingston University https://www.kent.ac.uk/tizard/research/seminars/documents/Tizard%20seminar_161113.pdf, (shikuar më 15.03.2018)

² Malcoe, L. H., et al. (2004), "Socioeconomic disparities in intimate partner violence against Native American women: a cross-sectional study", në: *BMC Medv.2; PMC446227*. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC446227/>, (shikuar më 15.03.2018)

³ ABC. net (2016), "Fact-file domestic violence statistics". <http://www.abc.net.au/news/2016-04-06/fact-file-domestic-violence-statistics/7147938>, (shikuar më 15.03.2018)

⁴ Statistikat zyrtare të Policisë së Shtetit 2007-2017

⁵ <http://www.abs.gov.au/AUSSTATS/abs@.nsf/Latestproducts/25AF91125718ADF1CA257C3D000D856A?opendocument>, (shikuar më 15.03.2018)

Krime në familje, regjistruar nga Policia e Shtetit për vitet 2007-2017




Figura 1

Vrasjet në familje kundrejt totalit për vitet 2007 - 2017 në Shqipëri




Figura 2

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Shkaqet e këtij lloji krimi dhe pasojat përbëjnë një fushë të veçantë studimi, që kërkon një trajtim, kryesisht në aspektin psikosocial të fenomenit dhe janë objekt i shkencave të psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë, etj. Por, synimi ynë në këtë kumtesë është që të trajtojmë vetëm aspektin e masave të mirëfillta policore për parandalimin dhe reduktimin e krimin në familje, i cili shpesh përshkallëzohet në krime të rënda ose me përsëritje, të nxitura nga psikologjia e hakmarrjes, gjakmarrjes, padrejtësisë, vetëgjyqësisë, etj.

Analiza e të dhënave statistikore, rasteve tipike apo tipologjive më të shpeshta, e opinioneve të specialistëve të Policisë në terren, e intervistave me personat e viktimizuar nga krimi në familje, si dhe hulumtimi i eksperiencave ndërkombëtare, na ka dhënë mundësinë të arrimë në disa përfundime interesante dhe rekomandime të vlefshme për veprimtarinë e Policisë në përballimin e sfidës për parandalimin e këtij lloji krimi.

2. Karakteristikat dhe veçoritë e marrëdhënieve familjare

2.1 Ku dallojnë marrëdhëniet familjare nga ato të tjera në shoqëri

Në terma sociologjik familja konsiderohet si qeliza bazë e shoqërisë, që ka për mision bashkëjetesën e vullnetshme në çift me synim mirëqenien, sigurinë e jetës, integritetit dhe pronës, riprodhimin familjar, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Vetë termi qelizë, i huazuar nga shkenca e biologjisë, tregon karakteristikat e veçanta dhe thelbësore të familjes, që do të thotë një entitet i mbyllur, i aftë për t'u zhvilluar e riprodhuar në mënyrë të pavarur dhe në harmoni më mjedisin rrethues. Duke i njohur, por edhe për t'i mbrojtur e promovuar këto vlera të familjes, bashkësia ndërkombëtare dhe shtetet e veçanta kanë institucionalizuar familjen dhe funksionimin e saj nëpërmjet traktateve, konventave, marrëveshjeve e ligjeve. Kështu, mund të përmendim: Deklarata e OKB-së për të Drejtat Universale të Njeriut⁶, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷, konventat e OKB-së dhe të KE-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe grave nga dhuna, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁸, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë apo ligji specifik për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare,⁹ etj. Vetë fakti që në çdo shtet demokratik ekziston si pjesë e veçantë e legjisllacionit Kodi i Familjes, dëshmon se këto marrëdhënie janë shumë të rëndësishme për çdo shoqëri të civilizuar, por dhe specifike në raport me marrëdhëniet e tjera shoqërore të sanksionuara me norma juridike.

Nga studimi i këtyre akteve rezultojnë se veçoritë thelbësore të marrëdhënieve familjare janë:

- privatësia e marrëdhënieve familjare (integriteti);
- interesi më i mirë i fëmijës;
- mbrojtja e grave, fëmijëve dhe personave të paftë ose aftësi të kufizuara;
- detyrimi për përkujdesje.

2.2 Raporti i dhunës në familje, me të drejtat universale

Ndonëse familja është një entitet i "mbyllur", korpusi i lirive dhe të drejtave të njeriut është i zbatueshëm edhe në kushtet e marrëdhënieve familjare, pra siguria e jetës, pronës, shëndetit, integritetit, dinjitetit apo liria e fjalës, besimit, bindjeve, etj., janë të garantuara jo vetëm në traktatet ndërkombëtare, por dhe në legjisllacionin Shqiptar që synon përafrimin me *acquis communautaire*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh institutin e familjes dhe mbrojtjen e saj, barazinë midis burrit dhe gruas, mbrojtjen e veçantë të fëmijëve dhe njerëzve nën nevojë, etj. Kodi i Familjes rregullon në mënyrë të detajuar bashkëjetesën në çift dhe përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve, etj. Ndërsa, Kodi Penal sanksionin dënime si për vepra penale që cenojnë liritë dhe të drejtat themelore, ashtu dhe ato që cenojnë marrëdhëniet në familje. I tillë

⁶ Neni 16 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut

⁷ Neni 12 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

⁸ Nenet 53 e 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁹ Neni 1 i Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

është p.sh. neni 130/a i Kodit Penal¹⁰, ku dhuna ndaj pjesëtarëve të familjes cilësohet dhe dënohet si vepër penale më vete.

Mund të shtrohet pyetja se: pse duhet dënuar sipas këtij neni një vepër penale që parashikohet si e tillë, edhe në nene specifike si ai për rrahjen, kërcënimin, plagosjen, etj. në rrethana të tjera?! Por ligjvënësi, në parashikimin e dhunës në familje si vepër penale më vete, ka marrë pikërisht në konsideratë marrëdhëniet e veçanta që ekzistojnë midis autorit të krimit dhe viktimës, për shkak të bashkëjetesës në të njëjtin ambient dhe në mirëbesimit reciprok. Pra, autori në këtë rast, jo vetëm ka cenuar të drejtat themelore të individit në përgjithësi, por ka shpërdoruar besimin e viktimës për bashkëjetesë si dhe të drejtën e privatesisë familjare. Për këto arsye kryesore, në Kodin Penal të RSH është parashikuar si rrethanë rënduese: kryerja e veprës penale duke përfitur nga marrëdhëniet familjare,¹¹ si dhe me ndryshimet e fundit u parashikua si e tillë edhe shkella e urdhrave gjyqësor të mbrojtjes.

3. Kuptimi për dhunën në familje

3.1 Përcaktimi ligjor për dhunën në familje

Nisur nga përmasat dhe sensibiliteti i lartë ndaj dhunës në familje vitet e fundit në vendin tonë, për t'u dhënë një orientim të qartë organeve ligjzbatuese për kuptimin e zbatimin e njëlojtë të ligjit në këtë fushë, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë eksplicite në nenin 3 të ligjit përkatës se çfarë duhet të kuptojmë me termin “dhunë” dhe “dhunë në familje”¹², si:

“1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis *personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.*

Në fjalorin e përditshëm, fjala dhunë nënkupton veprimet aktive të një personi ndaj një tjetri, siç mund të jenë: dhuna fizike nëpërmjet goditjeve, shtyrjeve, tërheqjeve, etj.; dhuna morale nëpërmjet fyerjeve, sharjeve, etj.; dhuna psikologjike nëpërmjet frikësimeve, kërcënimeve, kanosjes me fjalë apo veprime, etj.; dhuna seksuale nëpërmjet përdhunimit apo shfrytëzimit për prostitucion, etj., ndërsa është e vështirë për t'u konceptuar e provuar dhuna me mosveprim. Autorët përsëritës ose me rrezikshmëri të lartë përdorin zakonisht këtë lloj dhune, në mënyrë që t'i shmangen fajësisë dhe dënimit. Prandaj është me interes të theksojmë disa nga format e dhunës me mosveprim, të cilat rast pas rasti provohen nga rrethanat, mjetet e pasojat e krimit. Kështu mosdhënia e ushqimit është sjellje tipike e dhunës me mosveprim; mosdhënia me dashje e ndihmës së parë në rast sëmundje akute apo aksidentale është lloj tjetër i dhunës me mosveprim; mosdhënia e mjeteve të tjera për jetesë si strehim, veshje, etj., përbën gjithashtu dhunë me mosveprim në marrëdhëniet familjare; mospërfillja, denigrimi, lënia në vetmi dhe pa përkujdesje e personave me aftësi të kufizuara është gjithashtu dhunë me mosveprim, etj. Këto janë disa nga rastet tipike të dhunës me mosveprim, por jo vetëm. Por e rëndësishme për një punonjës policie në trajtimin e rasteve të dhunës në familje është që

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

¹⁰ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, dhjetor 2014

¹¹Neni 50, germa “g” dhe “e/1” Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë, QBZ, Gusht 2017

¹²Neni 3, pikat 1 dhe 2 të Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

të vlerësojë dhe marrë në konsideratë jo vetëm veprimet aktive të autorit, por edhe mosveprimet e tij, që në ndonjë rast mund të jenë me pasoja më fatale se veprimet aktive, siç mund të përmendim shtytjen për vetëvrasje. Në praktikë janë konstatuar raste kur për shkak të mospërfilljes, denigrimit, lënies në vetmi dhe pa përkujdesje e viktimës, me qëllim, nga autori, ka ardhur për pasojë vetëvrasja e saj.

3.2 Disa nga shkaqet kryesorë të dhunës në familje

Në studimet sociologjike rezulton se shkak kryesor i dhunës në familje është *gjendja ekonomike*, sidomos në një shoqëri të konsumit si kjo e jona, kur nevojat janë gjithnjë më të mëdha se mundësitë, ekzistojnë premisa për konflikte në çift ose midis pjesëtarëve të tjerë të familjes. Edhe në vendin tonë përqindjen më të madhe të rasteve të dhunës në familje e përbëjnë ato me motive ekonomike.¹³

Në radhë të dytë të shkaqeve për dhunë në familje vjen *niveli arsimor* i autorëve apo dhe viktimës¹⁴; sa më i ulët të jetë ky nivel aq më të shumta dhe të shpeshta janë shfaqjet e dhunës nga këta protagonistë. Kjo shpjegohet me faktin se këta persona nuk dinë të menaxhojnë situatat para konfliktuale si: debatin, diskutimin, marrëveshjen e fjalës, argumentin, logjikën, etj. dhe, për të imponuar mendimin apo vendimmarrjen e tyre, përdorin dhunën. Në studime të ndryshme, renditet ndër shkaqet e dhunës në familje prejardhja ose të qenit banor i zonave rurale apo urbane, që për mendimin tonë nuk janë shkaqe të drejtpërdrejtë të lidhur me dhunën në familje, por me faktorët e tjerë si: gjendja ekonomike, gjendja arsimore, gjendja psikike, ndikimi i alkoolit apo drogave etj. Statistikat e dhunës në zona rurale ose urbane mund të shërbejnë vetëm për efekt të hartimit të strategjive parandaluese ndaj dhunës në familje, duke parashikuar masa dhe organizma specifike për këto zona banimi; p.sh. : sa efektivë policie duhet të ketë një strukturë kundër dhunës në familje në një zonë rurale apo në një zonë urbane, duke u nisur nga frekuenca e krimeve të këtij lloji në secilën zonë?

Në radhë të tretë të shkaqeve kryesore të dhunës në familje, renditen *varësia e autorëve nga alkooli dhe drogat, lojërat e fatit, huamarrja*, etj. Është i saktë konstatimi i disa studiuesve se edhe në këto raste shkak bëhet gjendja ekonomike, në pamundësi të përballimit të shpenzimeve nga vesi, por në fund të fundit është prania e vesit që çon në rrënim ekonomik, pasi të ardhurat që siguron familja mund të jenë të mjaftueshme për një jetesë normale, nëse nuk do të rëndoheshin nga mbishpenzimet për shkak të këtyre veseve.

Studiues të tjerë, përmendin një sërë shkaqesh të tjera si shkaktarë të dhunës në familje, si p.sh. gjendja sociale, përkatësia etnike, diferenca mentalitetesh e kulturash, idesh apo bindjesh, etj., por për mendimin tonë në esencë ato kanë substrat një nga tre faktorët kryesorë që kemi përmendur më sipër. Kështu, përvoja në çift ka treguar se kur ka nivel arsimor të lartë të partnerëve, evitohen ose kapërcehen ndasitë në kultura apo mentalitete. Nga ana tjetër, kur në familje ka nivel të lartë mirëqenie kapërcehen dallimet etnike apo ato sociale. Prandaj është e rëndësishme të përcaktohet saktë shkak i dhunës, që edhe kundërmatat të jenë të përshtatshme dhe efektive, si në planin strategjik, por edhe atë operacional të përditshëm. Kështu, është e rëndësishme të diferencosh një autor që është i dhunshëm nga vështirësitë ekonomike, nga një tjetër që është i dhunshëm

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

¹³Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtje kombëtare me bazë popullatën, INSTAT, 2013, faqe 30.

¹⁴Po aty, faqe 29.

për shkak alkoolizmit apo nën efektin e drogave, pasi edhe masat parandaluese ndaj njërit apo tjetrit do të jenë të ndryshme. Për shembull, në rast se për të parin do të kërkohet një urdhër mbrojtje që të ndalojë frekuentimin e banesës së viktimës, për të dytin do të kërkohet që urdhri i mbrojtjes të parashikojë trajtimin e autorit në një qendër rehabilitimi ndaj alkoolit ose drogave.

3.3 Rastet më të shpeshta të dhunës në familje

Nga statistikat e dhunës në familje rezulton se rastet më të shpeshta të saj konstatohen në formën e fyerjes, kanosjes, kërcënimit, frikësimit, mospërfilljes, braktisjes, izolimi, mos dhënies së mjeteve për jetesë, etj., që futen në kategorinë e dhunës psikologjike. Njohja dhe trajtimi i këtyre rasteve, që mund t'i quajmë si sinjale të para për mundësinë e shkallëzimit të dhunës në forma të tjera më agresive, ka shumë rëndësi për forcat e zbatimit të ligjit nga pikëpamja e punës parandaluese. Konstatimi, marrja në konsideratë, vlerësimi dhe kundërveprimi i përshtatshëm që në këtë fazë të hershme të dhunës në familje përbëjnë çelësin e suksesit në punën parandaluese. Ndërsa neglizhenca, mosvlerësimi, mosveprimi ose për më keq denigrimi i viktimës janë veprime që inkurajojnë autorin për të rritur agresivitetin e përshkallëzuar dhunën.

Në rend të dytë të rasteve të dhunës në familje vinë rrahjet, dëmtimet e ndryshme të qëllimshme, plagosjet, dhuna seksuale apo detyrimi për të prostituiuar, që futen në kategorinë e të ashtuquajturës dhunë fizike. Pra, siç shihet, secila prej tyre përbën në vetvete edhe vepër penale, pra kanë rrezikshmëri më të madhe shoqërore, por edhe për jetën e shëndetin e viktimës. Prandaj, masat parandaluese që duhet të merren në këto raste duhet të jenë në përputhje me agresivitetin e autorit dhe me pasojat e ardhura. Për shembull, në rastet e dhunës psikologjike do të rekomandonim përdorimin e mekanizmave ligjor më të butë, siç mund të jetë kërkesa për urdhër mbrojtje, ndërsa në shfaqjet e dhunës fizike duhen aplikuar masa më rigorozë ligjore deri në shoqërimi, ndalime apo arrestime në flagrancë, sipas rrethanave të rastit. Tolerimi dhe neglizhenca e autoriteteve të zbatimit të ligjit në këto raste, mund të jetë me pasojë fatale për viktimat e dhunës, deri në humbjen e jetës.

Në rend të tretë, jo për nga sasia dhe shpeshësia, se sa nga rrezikshmëria e madhe shoqërore dhe pasojat që sjellin përfshihen: plagosjet e rënda, dhuna seksuale, detyrimi për prostitucion, trafikimi dhe vrasja. Kuptohet se dëmi i shkaktuar në këto raste si ai individual edhe social është i parikuperueshëm, prandaj mekanizmat ligjor të parashikuar dhe kundërveprimi i organeve ligjzbatuese duhet të jetë me ashpërsinë më të madhe. Në analizën gjithëplanëshe të këtyre rasteve, rezulton se ato përgjithësisht kanë ndodhur edhe si pasojë e mungesës së punës parandaluese që duhet të bënin organet përkatëse ligjzbatuese, sidomos Policia që merr njoftim e para në këto raste.

4. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga Policia

4.1 Aktet normative dhe procedurat standarde të Policisë

Për vetë rëndësinë dhe sensibilitetin ndërkombëtar e kombëtar që ka dhuna në familje, siç e theksuam më sipër, janë të shumta edhe aktet normative që përcaktojnë, rregullojnë dhe sanksionojnë marrëdhëniet shoqërore në këtë fushë, duke përfshirë nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, konventa të OKB-ës e KE-së, Kushtetuta

e RSH, kodet e ndryshme, ligji i posaçëm për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare e deri tek Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për procedurat standarde ndaj rasteve të dhunës në familje¹⁵.

Por nisur nga këndvështrimi i kësaj kumtese, ne do të fokusohemi në trajtimin e atyre akteve që shërbejnë direkt në parandalimin e dhunës në familje gjatë veprimtarisë së përditshme të Policisë.

- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është instrumenti bazë ligjor, i cili duhet njohur e kuptuar mirë nga të gjithë punonjësit e Policisë, për të qenë të aftë gjatë zbatimit të tij në veprimtarinë e përditshme. Ky ligj jep në mënyrë tekstuale kuptimin për termin “dhunë” dhe “dhunë në familje”¹⁶. Gjithashtu, ai përcakton institucionet përgjegjëse për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe mënyrën e bashkërendimit të veprimtarive të tyre sipas fushës së përgjegjësisë. Në këtë ligj janë parashikuar mekanizmat e nevojshëm për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, siç janë masat e mbrojtjes, urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore, etj. Sa më mirë të njihet dhe zbatohet ky ligj nga punonjësit e Policisë, aq të suksesshëm do të jenë ata në parandalimin e dhunës në familje, në mbrojtje të jetës, shëndetit e pronës së viktimave, por edhe në rritjen e reputacionit të tyre në komunitet.

- Njohja dhe kuptimi i veprave penale të lidhura me dhunën në familje dhe veçanërisht nenin 130/a, pasi cilësimi i saktë i figurës së krimit në këto raste përbën zanafillën e gjithë zinxhirit të veprimeve administrative e procedurale, që duhen kryer deri në përcjelljen e akteve tek organet vendimmarrëse. Shpesh, viktimat për arsye të frikës apo sentimentalizmit ngurojnë të bëjnë kallëzim ndaj autorëve të dhunës, por punonjësi i Policisë duhet të dijë si të veprojë në rastet kur rrethanat tregojnë se autori ka kryer një vepër penale që ndiqet kryesisht. Në këto raste, ai duhet të jetë i ndërgjegjshëm se përgjegjësia ligjore ka rënë mbi të, që në momentin e marrjes së këtij njoftimi.

- Njohja e Kodit të Procedurës Civile apo Administrative dhe Kodit të Procedurës Penale, sa i përket rasteve të dhunës në familje, është një kusht pa të cilin nuk mund të ketë parandalim të suksesshëm të dhunës në familje. Kryerja e veprimeve procedurale me saktësi dhe në kohë, jo vetëm frenojnë veprimet e mëtejshme të autorit dhe i japin siguri viktimës në momentin e parë, por janë të rëndësishme për gjithë ecurinë e procesit deri në vendimmarrjen e organeve kompetente, në mënyrë sa më të shpejtë dhe të përshtatshme me situatën dhe rrethanat e ngjarjes.

- Njohja e mirë dhe zbatimi me rigorozitet i procedurave standarde¹⁷ të miratuara me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është një moment tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë së punonjësit të Policisë, në rastet e dhunës në familje. Këto procedura jo vetëm e orientojnë atë si të veprojë në një situatë konflikti në familje, por i garantojnë atij mbrojtje personale, siguri në veprime, mbështetje të përshtatshme ndaj viktimave, neutralizim të autorëve të rrezikshëm, bashkëpunim dhe mbështetje nga organet e tjera ligjzbatuese.

¹⁵ Procedura standarde për “Trajtimin e rasteve të dhunës në familje”, miratuar me Urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1118, datë 13.11.2017.

¹⁶ Neni 3, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

¹⁷ Procedura standarde për “Trajtimin e rasteve të dhunës në familje”, miratuar me Urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1118, datë 13.11.2017.

4.2 Veprimet e Policisë në terren, për parandalimin e dhunës në familje

Momenti i parë dhe kryesor i punës së punonjësve të Policisë në terren për të parandaluar dhunën në familje, është evidencimi (regjistrimi) i personave me prirje për këto sjellje dhe veprime të dhunshme ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes. Është veprim më se i ligjshëm dhe profesional që këta persona të jenë në vëmendje të punonjësve të Policisë në terren njësoj si kategoritë e tjera kriminale, për faktin se rrezikshmëria e tyre është e lidhur me rrethanat e kryerjes së krimit në një ambient të mbyllur, jashtë vëmendjes së publikut dhe mundësive objektive për t'u konstatuar nga shërbimet rutinë të Policisë apo organizmat e tjerë ligjor. Si bazë për evidencimin e këtyre personave duhet të shërbejë fakti se kundër tyre është lëshuar një urdhër mbrojtje më parë ose kanë qenë të dënuar për dhunë në familje. Nuk duhen lënë jashtë vëmendjes edhe persona të kësaj kategorie që kryejnë me përsëritje veprime dhune, por që viktimat nuk i kallëzojnë apo refuzojnë të bëjnë kërkesë për urdhër mbrojtje për shumë arsye, sidomos për arsye frikësimi, mungesa e mjeteve të jetesës, etj.¹⁸

Hapi i dytë që duhet bërë nga punonjësit e Policisë në terren (nënkupto punonjësit e strukturave operuese në komisariatet apo stacionet e Policisë), është që të regjistrojnë dhe të monitorojnë urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga gjykatat. Kjo është e rëndësishme për faktin se personat përsëritës dhe agresivë të dhunës në familje, kanë premisë për të mos i përfillur e shkelur ato, shpesh apo përgjithësisht për të frikësuar viktimat e dhunës që të mos ndërmarrin ose tërhiqen nga kallëzimi i veprës penale apo kërkesa për urdhër mbrojtje. Prandaj, ligjvënësi ka parashikuar si kundërmasë efektive, dispozitën që kur kërkesa për urdhër mbrojtje bëhet nga policia ose prokuroria, viktimat nuk mund të tërhiqet nga kërkesa apo kallëzimi i bërë¹⁹. Veprimet me iniciativë të punonjësit të Policisë ose prokurorit të çështjes në këto raste, jo vetëm dekurajojnë synimet e autorit, duke parandaluar ushtrimin e mëtejshëm të dhunës ndaj viktimës, por bëjnë që edhe kjo e fundit të ndjehet më e sigurt dhe bashkëpunuese, për të ndëshkuar autorin e dhunës. I rëndësishëm është gjithashtu fakti se, si kur kërkesa për urdhër mbrojtje bëhet nga punonjësi i Policisë apo edhe gjatë monitorimit të një urdhri mbrojtje në fuqi, duhet parashikuar e kontrolluar mirë masat mbrojtëse të parashikuara nga neni 10 i ligjit përkatës²⁰, në mënyrë që të caktohen apo kontrollohen ato masa që janë më efektive në funksion të parandalimit në secilin rast. Duke përfutur nga rasti vlen të theksohet fakti se në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare është parashikuar kërkesa për urdhër mbrojtje të menjëhershëm në rastet kur koha nuk pret deri në nxjerrjen e urdhrat të mbrojtjes nga gjykata (brenda 15 ditësh). Por përsëri koha e parashikuar nga paraqitja e kërkesës deri në nxjerrjen e urdhrat të menjëhershëm është 48 orë, e cila në disa raste lejon hapësirë të mjaftueshme veprimi për autorët, sidomos kur ngjarja ndodh në orët e vona të natës apo në zona larg qendrave administrative ose autorët janë agresivë dhe përsëritës. Ndonëse ligji për këto raste i referohet veprimit në kuadër të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, besojmë se nuk është zgjidhje e mjaftueshme, kur ky ligj jep vetëm mundësinë e shoqërimit të autorit deri në 10 orë. Një ndryshim në ligjin aktual, ku urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes të ekzekutohet me iniciativë në çast

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

¹⁸ Kreu IV i Udhëzimit të ministrit të Brendshëm Nr. 56/1, datë 27.05.2013, “Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”.

¹⁹ Pika 3 e nenit 16 i Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

²⁰ Po aty, neni 10.

nga punonjësi i Policisë, duke paraqitur njëkohësisht edhe kërkesën në gjykatë, do ta bënte më të efektshëm ligjin për këto raste, model ky që e gjejmë të parashikuar në ligjin e Kosovës²¹ dhe atë Austriak²².

Hapi i tretë, po aq i rëndësishëm sa dy të parët, por më shumë me karakter human është që punonjësi i Policisë duhet të ketë gjithmonë në telefonin e tij një numër kontakti me viktimën e krimit, gjithmonë me pëlqimin e saj/tij. Kjo është e domosdoshme për faktin se shpesh situatat e dhunës në familje janë të papritura dhe degradojnë shpejtë nga një konflikt verbal në përlëshje fizike, aq më tepër, që çdo gjë ndodh larg syve të publikut apo personave të tretë. Pra, viktimën në këtë rast duhet të ketë një “adresë” të sigurt dhe të besuar se ku të dërgojë sinjalin “SOS”, përveç linjës së gjelbër që vënë në dispozicion në këto raste OJF-të apo shërbimet sociale të njësive të pushtetit vendor. Në raport me këto të fundit, për vetë specifikën e punës së Policisë, kjo e fundit ka më shumë mundësi dhe autoritet për të ndërhyrë në kohë, kur viktimën bën thirrje për ndihmë emergjente.

Nga ana tjetër, mbajtja e një numri kontakti të viktimës apo e kontakteve fizike me të nga ana e punonjësit të Policisë, kur ky i fundit është me seks të kundërt, ka rrezikun e alibisë nga autori me pretekstin se veprimet e punonjësit të Policisë janë për shkak të relatave intime me viktimën. Shpesh, ata mundohen që në këto raste, të kërkojnë “dëshmitarë” apo dokumente “komprometues” për gjoja kontakte jo për shkak të detyrës, midis punonjësit të Policisë dhe viktimës. Prandaj, është e këshillueshme që punonjësi i Policisë që mban kontakte me viktimën e dhunës në familje të jete e/i të njëjtit seks. Ky veprim rekomandohet edhe në procedurat standarde të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nisur nga eksperiencia ndërkombëtare, por dhe ajo pozitive e krijuar vitet e fundit nga Policia e Shtetit.

Hapi i katërt duhet të jetë bashkëpunimi i menjëhershëm me institucionet dhe agjencitë e tjera përgjegjëse për mbrojtjen nga dhuna në familje, të parashikuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, siç janë: punonjësit e shërbimit social në njësitet e qeverisjes vendore, qendrat shëndetësore, OJF-të për pritjen dhe akomodimin e viktimave të dhunës, qendrat e rehabilitimit për viktimat e dhunës apo për rehabilitimin e autorëve të dhunshëm nën efektin e alkoolit ose drogave, përmbauesit gjyqësor, drejtuesit e shkollave apo psikologët e avokatët pa pagesë në listën e gjykatës, etj. Ky bashkëpunim konsiston sa në kërkimin e mbështetjes së tyre, aq dhe për të orientuar viktimat se ku duhet të kërkojnë informacion dhe ndihmë ligjore e të specializuar për t'u mbrojtur e parandaluar përsëritjet apo përshkallëzimin e dhunës.

Hapi i pestë, por jo i fundit, është që punonjësi i Policisë duhet të ndjekë në vazhdimësi ecurinë e procesit hetimor apo gjyqësor për rastet e dhunës në familje, pasi dihet se në këto faza marrëdhëniet midis autorit e viktimës acarohen akoma më tepër. Kjo situatë mund të shtyjë autorin që të ndërmarrë veprime të tjera dhune të shpejta e të befasishme, që në disa raste kanë qenë me pasoja fatale. Kur një kërkesë për urdhër mbrojtje apo kallëzim referohet në gjykatë apo prokurori, krijohet përshtypja se të dyja palët në konflikt janë qetësuar në një farë mënyre me shpresën se dikush do të vendosë të drejtën e pretenduar nga secili. Por, kjo paradigmë në disa raste është zhgënjyese, pasi autorët agresivë të dhunës apo përsëritës në këto raste intensifikojnë veprimet për të mbuluar gjurmët e mëparshme, duke i bërë presion viktimës që të tërhiqet nga hapat e

²¹ Udhërrëfyes për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, Prishtinë 2011, faqe 27

²² Logar, Rosa. *Ligjet në Austri për mbrojtjen nga dhuna. (E drejta e viktimave për ndihmë dhe mbrojtje nga dhuna)*, faqe 7.

ndërmarrë për zgjidhjen e konfliktit gjyqësish. Sa më refuzues të jetë qëndrimi i viktimës, aq më tepër shtohen premiset për veprime ekstreme dhune nga autori dhe gjithmonë të befashisme. Prandaj, monitorimi i masave të urdhrat të mbrojtjes në këto raste duhet të jetë shumë i kujdesshëm nga punonjësi i Policisë, duke mbajtur nën kontroll autorin, kontakte me viktimën, personat e afërt të saj/tij, fqinjët, punonjësit social apo të qendrave të pritjes së viktimave të dhunës, etj.

Nisur nga sa më sipër, por dhe eksperiencia e vendeve të përparuara demokratike, rezulton se në strukturat operuese të Policisë së Shtetit duhet të ngrihen e funksionojnë njësi të veçanta kundër dhunës në familje, sidomos në zona me frekuencë të lartë të këtij lloji krimi.

4.3 Organizimi dhe funksionimi i strukturave parandaluese

Ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare, parashikon një sërë strukturash shtetërore për parandalimin e dhunës në familje, por në interes të diskutimit tonë është se si duhet të jenë organizuar e si funksionojnë ato në Policinë e Shtetit, për të qenë sa më efektive dhe efçente.

Siç e përmendëm më lartë, e rëndësishme është që në komisariatet e Policisë ku janë regjistruar nivele të lartë të dhunës në familje të ketë njësi të veçantë kundër dhunës në familje, pasi veprimet administrative, procedurale dhe ato operacionale që ato duhet të kryejnë janë voluminoze nga pikëpamja burokratike, kërkojnë profilizim profesional, shpesh herë ato duhet të jenë proaktive e urgjente apo me kohë shtrirje të gjatë, etj. Do të ishte e këshillueshme që këto njësi të kishin ambiente më vete, mundësisht jashtë komisariateve apo stacioneve të Policisë, pasi viktimat më të shumta janë gra, vajza, fëmijë apo persona me aftësi të kufizuara, që duan një trajtim human dhe diskret. Si të tilla, mund të shfrytëzohen edhe qendrat e pritjes së viktimave apo zyrat e shërbimeve sociale në njësit e qeverisjes vendore, shkollat, qendrat e rehabilitimit, etj. Punonjësit e Policisë në këto struktura, duhen përzgjedhur nga persona që kanë punuar mbi 3 vjet në sektorë të tjerë të luftës ndaj krimit dhe, që kanë aftësi të mira komunikimi etik e psikologjik. Nisur nga raporti i veprave penale të dhunës në familje, me veprat penale në total të regjistruara nga Policia e Shtetit, që është afërsisht në masën 11,8 % (Figura 3), do të ishte e pranueshme që të njëjtin raport të kishin dhe efektivat e njësiteve të dhunës në familje me numrin e përgjithshëm të punonjësve të Policisë.

Përqindja e krimeve në familje kundrejt totalit të krimeve në Shqipëri




Figura 3

Një rol të rëndësishëm e të veçantë në parandalimin e dhunës në familje kanë sallat komandimit dhe informacionit, pasi ato janë edhe pritëset e para të njoftimeve për ngjarje të këtij lloji. Punonjësit e këtyre strukturave, duhet të marrin njohuri specifike dhe të trajnohen veçanërisht për trajtimin e rasteve të njoftimeve për dhunë në familje, si dhe koordinimin e shërbimeve në terren.

Edhe pse duhet e mund të ketë struktura të posaçme policore kundër dhunës në familje, nuk duhet të mënjahohen apo shmangen në asnjë rast nga përgjegjësia për konstatimin, raportimin dhe ndjekjen në flagrancë të rasteve të dhunës në familje nga shërbimet e Policimit në Komunitet. Me kapacitete njerëzore që kanë, të shtrirë në formë kapilare në territor, ato kanë mundësi të pazëvendësueshme për të marrë informacion e ndërhyrë në kohë në rastet e flagrancës.

Shërbimet e Patrullës së Përgjithshme kanë rol parësor në momentin e thirrjeve për ndihmë gjatë dhunës në familje, pasi janë ato të parat që shkojnë në vendin e ngjarjes, ku me veprimet e tyre profesionale jo vetëm duhet të izolojnë autorin, ndalojnë dhunën, të ndihmojnë viktimën, por duhet të kontribuojnë edhe me veprime të shpejta e të sakta, profesionale, për ecurinë e mëtejshme të procedimit, si: ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimin e provave, identifikimin e dëshmitarëve, etj. Për vetë specifikën që kanë rastet e dhunës në familje, këto shërbime duhet të marrin trajnime të veçanta në këtë fushë, për aq sa u takon të veprojnë.

Gjithashtu, një rol të pazëvendësueshëm në parandalimin e dhunës në familje, kanë shërbimet e luftës kundër krimit, sidomos ato kundër krimeve të rënda, pasi dihet se trafikimi i qenieve njerëzore për prostitucion apo fëmijëve të mitur fillon me dhunën në familje. Shpesh, për të mos thënë në të gjitha rastet, viktimat e trafikut të qenieve njerëzore kanë qenë në parë viktimat të dhunës në familje.

5. Konkluzione

Krimet në familje duhen vlerësuar dhe konsideruar si një aspekt i rëndësishëm i shkallës së kriminalitetit në vend, pasi jo vetëm zënë një volum jo të vogël në krahasim me veprat penale në total, por kanë tendencën të përshkallëzohen në krime më të rënda në një kohë shumë të shkurtër.

Duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore e individuale të krimit në familje, parandalimi i këtij krimi mbetet prioritet i Policisë së Shtetit.

Krijimi i njësive të veçanta të luftës ndaj krimit në familje është një nevojë imediate për Policinë e Shtetit, me punonjës Policie të aftë profesionalisht, por edhe të ndjeshëm nga pikëpamja humane.

Parandalimi i dhunës dhe krimit në familje, nuk është i mundur vetëm nga Policia, pa bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e aktorëve dhe faktorëve të tjerë institucional e social, siç parashikohen në ligjin përkatës.

Ndjekja me shpejtësi dhe në vazhdimësi, si dhe marrja e masave të përshtatshme ligjore në rastet e krimit në familje, si në rrugë administrative ashtu dhe penale, është veçori që duhet mbajtur parasysht nga punonjësit e Policisë.

6. Rekomandime

Është shumë e rëndësishme që të gjithë punonjësit e Policisë të njohin mirë dhe të zbatojnë me korrektësi legjislacionin në fushën e mbrojtjes ndaj dhunës në familje.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Trajnimi i punonjësve të Policisë së Shtetit për mënyrën e veprimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duhet bërë sipas shërbimeve dhe rolit të gjithsecilit në veprimtarinë e përditshme.

Krijimi dhe pajisja e njësive të specializuara të Policisë për veprimtarinë kundër krimit në familje me kapacitete njerëzore, ambiente punë dhe mjete të përshtatshme për specifikat e punës që kërkon zbulimi, parandalimi dhe ndëshkimi i këtij lloj krimi.

Rishikimi i akteve normative për dhunën në familje për të evituar boshllëqet që rezultojnë nga zbatimi praktik i tyre deri tani dhe pasurimi me masa të tjera kundërvepruese, duke marrë në konsideratë eksperiencat më të përparuara botërore në këtë fushë.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Bibliografi

1. Sahiti, Ejup. *Psikologjia gjyqësore*, Prishtinë 2007.
2. Sinani, Edvin. *Dhuna në Familje*, punim për Master Shkencor, Universiteti Hëna e Plotë "Beder", 2015.
3. Duka, Sofokli. Kumesë "Disa dukuri të kriminalitetit në familje", Akademia e Sigurisë, 2015.
4. INSTAT, *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, 2013
5. Logar, Rosa. *Ligjet në Austri për mbrojtjen nga dhuna. (E drejta e viktimave për ndihmë dhe mbrojtje nga dhuna)*. Wiener Interventionsstelle Gegen Geëalt in der Familie, Vienë, shtator 2013.
6. Puka, Avni. *MBROJTJA JURIDIKE E VIKTIMËS SË KRIMIT*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009.
7. Avokati i Popullit. *Raport për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit*, Korrik 2012.
8. Udhërrëfytes për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, Prishtinë 2011.
9. Statistikat zyrtare të Policisë së Shtetit 2007-2017.
10. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
11. Konventa e OKB "Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave". Qendra e Publikimeve Zyrtare, Fletore Zyrtare Ekstra 33, 2008.
12. Konventa e OKB-ës për të drejtat e Fëmijëve. Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, dhjetor 2016.
13. Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, Qendra e Botimeve Zyrtare, korrik 2010
14. Ligj nr. 104/2012 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"". Qendra e Botimeve zyrtare, Fletore Zyrtare Nr. 151, 2012.
15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Qendra e Botimeve Zyrtare, gusht 2016.
16. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, dhjetor 2014.
17. Kodi Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë. Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, korrik 2017.
18. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë, dhjetor 2014
19. Kodi Pr. Civile i Republikës së Shqipërisë, QBZ, gusht 2017.
20. Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Botimeve Zyrtare, dhjetor 2014.
21. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
22. Ligji Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit, i ndryshuar.
23. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
24. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje 2011-2015.
25. Udhëzimit të ministrit të Brendshëm Nr. 56/1, datë 27.05.2013, "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave".
26. Procedura standarde për "Trajtimin e rasteve të dhunës në familje", miratuar me Urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1118, datë 13.11.2017
27. https://www.kent.ac.uk/tizard/research/seminars/documents/Tizard%20seminar_161113.pdf
28. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC446227/>
29. <http://www.abc.net.au/news/2016-04-06/fact-file-domestic-violence-statistics/7147938>
30. <http://www.abs.gov.au/AUSSTATS/abs@.nsf/Latestproducts/25AF91125718ADF1CA257C3D000856A?opendocument>
31. https://www.kent.ac.uk/tizard/research/seminars/documents/Tizard%20seminar_161113.pdf

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

Këndvështrim i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare sipas treguesve subjektivë.

Perceptimeve të popullatës, punonjësve të policisë, të dënuarve për vrasje etj



■ **Dr. (Proc.) Anisa HYSEANI**
Policia e Shtetit
anisa.hysesani@asp.gov.al



■ **M.Sc. Skënder KALEMI**
Akademia e Sigurisë
skënder.kalemi@asp.gov.al

Abstrakt

Dhuna në familje sipas fjalorit ligjor online, përkufizohet si: çdo akt abuziv, i dhunshëm, i detyruar, kërcënues ose fjalë të shkaktuara nga një anëtar i një familje mbi një tjetër pjesëtar të familjes mund të përbëjnë dhunë në familje. Si rrjedhim mendojmë që përbën shumë interes të shikojmë perspektivën e dhunës në familje nga këndvështrimi i treguesve subjektivë, në mënyrë të tillë që të kuptojmë: Cilat janë marrëdhëniet e ndërvarësisë? Çfarë kushtëzon marrëdhëniet e detyruara dhe të dhunshme në familje? Cilat janë shkaqet e treguesve të dhunës në familje ne rastin e Shqipërisë (duke përfshirë këtu perceptimet e një sërë aktorëve, si p.sh: qytetarë, punonjësve të policisë, etj. Kjo duke përdorur dhe të dhënat nga respondentët nëpërmjet pyetësorit online që do lidhet pikërisht me trajtimin e subjektivit të mësipërm dhe statistikave që janë aktualisht në dispozicion mbi këtë fenomen. Duke marrë në konsideratë faktin që dhuna në familje mund të ketë forma të ndryshme duke variuar nga ajo fizike, në atë të dhunës psikologjike ose abuzimit verbal, duhet të pranojmë që është një problem i përgjithshëm që u përket gjithë shteteve dhe që jo gjithmonë mund të evidentohet, sepse ndodh kryesisht në marrëdhëniet personale ose qarqe të mbyllura. Nga ky fenomen janë të prekura jo vetëm grate, gjithashtu burrat ose fëmijët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, janë shpesh raste të këtij fenomeni. Nëpërmjet këtij artikulli ne do të përpiqemi të ofrojmë një analizë të plotë të shkaqeve, zhvillimit, perceptimit, politikave, ligjeve si dhe sugjerime të mëtejshme përsa i përket parandalimit të këtij fenomeni.

Fjalëkyçe:

tregues subjektivë, perceptim, forma të dhunës në familje, parandalim, politikat kundër dhunës ne familje, analizë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

“Unë jetoj në ferr nga një ditë në tjetrën. Por nuk mund të bëj asgjë për të shpëtuar. Nuk e di ku do të shkoja nëse do mundesha. Ndihem krejtësisht i pafuqishëm dhe kjo ndjenjë është mendimi im. Unë hyra me vullnetin tim të lirë, mbylla derën, dhe hodha poshtë çelësin.”

- Haruki Murakami

1. Hyrje

Nevoja për trajtimin e kësaj teme, erdhi praktikisht duke parë tendencën dhe perceptimin e rritjes së rasteve të dhunës në familje në Shqipëri. Për hartimin dhe zbatimin e çdo ligji e më tej të përkthyer në politika përkatëse, duhet që patjetër të kemi *feedback* të perceptimit të opinionit publik dhe gjithë grupeve të tjera të interesit, në mënyrë që zbatimi i politikave të mos jetë vetëm si rezultat i rrethanave të asaj që ne e perceptojmë si më të mirën e mundshme, bazuar në të dhëna objektive. Përpos matjes së perceptimit subjektiv të opinionit publik, mbi të gjitha nëpërmjet këtij punimi, synojmë krijimin e një kuadri të përgjithshëm informativ mbi fenomenin e dhunës në familje, si nga aspekti ligjor ashtu dhe nga konkluzionet e raporteve ndërkombëtare mbi këtë temë Dhuna në familje sipas fjalorit ligjor *online*, përkufizohet si: *çdo akt abuziv, i dhunshëm, i detyruar, kërcënues ose fjalë të shkaktuara nga një anëtar i një familje mbi një tjetër pjesëtar të familjes mund të përbëjnë dhunë në familje*.¹ Si rrjedhim, mendojmë që përbën shumë interes të analizojmë perspektivën e dhunës në familje nga këndvështrimi i treguesve subjektivë, në mënyrë të tillë që të kuptojmë: Cilat janë marrëdhëniet e ndërvarësisë? Çfarë kushtëzon marrëdhëniet e detyruara dhe të dhunshme në familje? Cilat janë shkaqet e treguesve të dhunës në familje ne rastin e Shqipërisë? Duke përfshirë këtu perceptimet e një sërë aktorëve, si p.sh. qytetarë, punonjësve të policisë etj. Kjo, duke përdorur edhe të dhënat nga respondentët nëpërmjet pyetësorit *online*, që është krijuar posaçërisht për trajtimin e subjektit të mësipërm dhe

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

statistikave që janë aktualisht në dispozicion mbi këtë fenomen. Duke marrë në konsideratë faktin që dhuna në familje mund të ketë forma të ndryshme duke variuar nga ajo fizike, në atë të dhunës psikologjike ose abuzimit verbal, duhet të pranojmë që është një problem i përgjithshëm që u përket gjithë shteteve dhe që jo gjithmonë mund të evidentohet, sepse ndodh kryesisht në marrëdhëniet personale ose qarqe të mbyllura. Nga ky fenomen janë të prekura jo vetëm gratë, por gjithashtu burrat ose fëmijët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, janë shpesh raste të këtij fenomeni.

Nëpërmjet këtij artikulli ne do të përpiqemi maksimalisht të ofrojmë një analizë sa më të plotë të shkaqeve, zhvillimit, perceptimit, politikave, ligjeve si dhe sugjerime të mëtejshme për sa i përket parandalimit të këtij fenomeni. Dhuna në familje, është një fenomen absolutisht i përgjithshëm, por nuk duhet të harrojmë që parandalimi si dhe prevalimi i këtij fenomeni, në çdo vend ndikohen patjetër shumë edhe nga rrethanat të tilla të personalizuar si:

- a. mentaliteti i një populli,
- b. respektimi i ligjit,
- c. kushtet ekonomike,
- d. cilësia e arsimit,
- e. cilësia e demokracisë,
- f. respektimi i të drejtave të njeriut.

Në përfundim, do dëshironim të shtonim që ky është një problem sa personal (pasi zhvillohet brenda ambientit të një familje dhe në mënyrë të pavëzhguar nga publiku), aq edhe komunitar e më gjerë shoqëror dhe pavarësisht se paraqitet shumë e vështirë parandalimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje, ne jemi të besimit se integrimi i përpjekjeve institucionale me shoqërinë civile dhe komunitetin, do të mund të sillnin rezultate shumë pozitive në këtë aspekt.

2. Përmbledhje e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006

Përkufizim: “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik².

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare; 3. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a). Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish–bashkëshorti/ ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; b. Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; c. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën b; ç. Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; d. Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit; e. Fëmijët e bashkëshorteve apo partnereve bashkëjetues.

4. “Viktimitë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara organeve kompetente.

6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën;

7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate. Autoritetet Përgjegjëse

1. Autoriteti Kryesor Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (M.P.Ç.S.SH.B.)

2. Autoritete të tjera Përgjegjëse të Linjës janë: a. Njësitë e Qeverisjes Vendore; b. Ministria e Brendshme; c. Ministria e Shëndetësisë; ç. Ministria e Drejtësisë; d. Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Brendshme ka këto detyra:

a. Krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë Drejtorive të Policisë;

b. Trajnimin e efektivave të policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.

Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar si dhe të fillojnë hetimet kryesisht (sua sponte). Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

Subjektet që mund të venë në dijeni organet përgjegjëse 1. Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t’i drejtohet me anë të një kërkesë, stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), Njësisë përkatëse Vendore (komunë, bashki), Qendrës Shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj apo të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme. 2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t’u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.³

3. Raporti GREVIO-s

Sipas raportit të GREVIO-s publikuar në nëntor 2017 këto ishin disa nga fushat kryesore ku raporti dilte në konkluzionin që duhej investuar: ndonëse GREVIO mirëpret ratifikimin e Konventës së Stambollit nga ana e Shqipërisë, ai ka identifikuar disa çështje prioritare që kërkojnë masa të mëtejshme nga autoritetet shqiptare për të respektuar plotësisht dispozitat e konventës. Duke marrë parasysh konsideratat e mësipërme, këto çështje lidhen me nevojën për të:

- garantuar që masat e marra në përputhje me Konventën e Stambollit të trajtojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore;

- ndjekur një qasje të qartë gjinore për t’iu përgjigjur dhunës ndaj grave;

- garantuar nivele të qëndrueshme dhe të forta të financimit për OJF-të e grave që punojnë për të mbështetur viktimat dhe për të parandaluar dhunën;

- bërë sistemin e kujdesit shëndetësor pararendës në luftën kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave, ndër të tjera duke i angazhuar punonjësit e kujdesit shëndetësor të trajtojnë dhunën ndaj grave si një çështje prioritare dhe detyrë profesionale;

- ngritur qendrat për krizat nga përdhunimi dhe/ose qendrat e referimit të dhunës seksuale, në kuadrin e një përgjigjeje shumë sektoriale me qëllim nxitjen e raportimit dhe për t’iu përgjigjur nevojave të viktimave;

- nxitur përpjekjet për të mbështetur dhe mbrojtur fëmijët dëshmitarë, veçanërisht sa i takon vendimeve gjyqësore për ushtrimin e të drejtës së kujdestarisë dhe të vizitave,

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

si dhe për procedurën e aplikimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes;

- mbështetur parimin e përgjegjësisë civile të punonjësve publikë që nuk e kryejnë detyrën e tyre për të marrë masat e duhura parandaluese dhe mbrojtëse në kuadër të objektivave të autoriteteve që ata kanë;

- ndryshuar legjislacionin penal të Shqipërisë që e bazon veprën penale të dhunës seksuale në mungesë të dhënies së miratimit të lirë dhe ta sjellë në përputhje me standardet e Konventës lidhur me procedimin *ex parte* dhe *ex officio*;

- përbushur plotësisht parimin e ndalimit të proceseve të detyrueshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve në rastet e dhunës ndaj grave;

- hartuar procedura të standardizuara për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të vdekshmërisë dhe dhunës së përsëritur për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluar nga Konventa;

- rishikuar dispozitat ligjore që vlejnë për urdhrat e përjashtimit emergjent, të cilat sipas ligjit shqiptar njihen si urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje, për të garantuar që në situatat e rrezikut të menjëhershëm, urdhra të tillë të mund të lëshohen pa vonesa të panevojshme me qëllim garantimin e sigurisë së viktimës;

- krijuar dhe financuar siç duhet një sistem efikas të ndihmës ligjore për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, i cili mbulohet nga Konventa.

Për më tepër, GREVIO ka identifikuar disa fusha shtesë ku nevojiten përmirësime me qëllim përbushjen e plotë të detyrimeve të Konventës. Ndër të tjera, këto lidhen me:

a) përkufizimin ligjor të dhunës në familje;

b) alokimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për makinerinë për luftën kundër dhunës ndaj grave si në rang bashkiak, ashtu edhe në qendror;

c) përgatitjen e kategorive së të dhënave administrative që pasqyrojnë llojin e marrëdhënies midis viktimës dhe dhunuesit për të gjitha format e dhunës ndaj grave;

d) organizimin e sondazheve që masin mbizotërimin e formave të dhunës ndaj grave, të pavlerësuara më parë, veçanërisht në lidhje me ngacmimin seksual, dhunën seksuale dhe martesën e detyruar;

e) përfshirjen e temës së dhunës ndaj grave në kurrikulat profesionale, programet e studimeve universitare, dhe skemat e zhvillimit profesional; rritje të financimit për strehët dhe shërbimet sociale;

f) aksesin në kompensim për viktimën; mbrojtja për të parandaluar martesat e detyruara të fëmijëve dhe masat mbrojtëse për viktimat, përfshirë fëmijët, gjatë seancave gjyqësore

4. Metodologjia e anketimit *online*

Nëpërmjet këtij anketimi *online*, qëllimi kryesor ka qenë anketimi dhe opinioni i qytetarëve nga mosha 18-60 vjeç, (duke marrë kryesisht parasysh dhe moshën e përdorueseve aktiv të internetit), banues në Shqipëri mbi:

a) dhunën në familje;

b) institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe menaxhimin e dhunës në familje.

Subjektiviteti i perceptimeve është pikërisht ai indikator i nevojshëm nga i cili, jemi përpjekur të krijojmë konkluzione përgjithësuese. Sigurisht, që pika më e fortë e këtij lloji anketimi është fakti që anonimatit absolut i lejon respondentët të jenë sa më ta hapur dhe transparentë në përgjigjet e tyre, por gjithashtu ky është dhe disavantazh në të

njëjtën kohë, pasi realisht nuk ke kontroll mbi cilësinë e përgjigjeve dhe as plotësimin korrekt të anketës. Për sa i përket balancës gjinore gjithashtu nuk mund të kemi një kontroll të plotë të saj. Përpos gjithë këtyre faktorëve, objektivi jonë kryesor që është matja e pulsit të opinionit publik, lidhur më temën e dhunës në familje, mendojmë që është plotësuar nëpërmjet përgjigjeve të respondentëve *online*, duke na dhënë dritë mbi çështjet e parashtruara në anketim. Për të pasur një kontroll minimalist, mbi anketimin *online* është përdorur sistemi i referimit, pra *link-u* i anketës i është shpërndarë pak a shumë grup-shënjestrave që kanë qenë pjesë e njohjes personale e profesionale apo grupe të interesit për sa i përket temës së trajtuar. Në këtë anketim *online*, gjithashtu jemi përpjekur mos të lëmë asnjë lloj gjykimi të nënkuptuar ndër pyetjet e formuluar. Është me interes dhe analizimi dhe interpretimi i raportit të gjykimit të respondentëve të kryqëzuar me të dhënat gjinore dhe moshore ose me profesionin e tyre në mënyrë që të kuptojmë dhe burimin nga aspekti i formimit apo arsimit me mënyrën e të gjykuarit, kjo jo për të dalë në konkluzione, sesa për të kuptuar se realisht qofte nga aspekti institucional, qoftë nga aspekti i ndërgjegjësimit të popullatës mbi dhunën në familje dhe format e saj, mënyrat e mbrojtjes etj.

5. Analizimi tërësor i përgjigjeve të anketës *online*

Në *Aneks*, gjen statistikat dhe interpretimin për secilën prej pyetjeve:⁴

-Respondentët e këtij anketimi *online*, rezultojnë të jenë nga rrethe të ndryshme si: Fieri, Tirana, Durrësi, Kavaja, Saranda, Kukësi.

-Profesionet e të anketuarve rezultojnë të jenë: inxhinier, mësues, pedagog, psikolog, punonjës social, student, polic, politolog, gazetar, ish të dënuar etj.,

-Përqindja më e madhe e të anketuarve janë të grupmoshës 18-35 vjeç.

Në rezultatet e këtij anketimi online në vija të përgjithshme vihet re që:

- Respondentët kanë një mosbesim në strukturat e policisë (nënkuptojmë këtu dhe të drejtësisë, pasi nëse bëhet fjalë për perceptim bazuar në të dhënat subjektive duhet të kuptojmë që zakonisht respondentët japin një gjykim tërësor), por veçanërisht është pikërisht gjinia femërore ajo me më pak besim në efikasitetin e strukturave të policisë në drejtim të parandalimit dhe menaxhimit të dhunës në familje, kjo ndoshta edhe për shkak se pavarësisht se viktimat mund të mos jenë vetëm femrat, statistikat tregojnë që kjo është gjinia që vuan më shumë dhunën në familje.

- Theksohet nevoja për një përmirësim të gjendjes ekonomike, e cila sipas respondentëve do të mund të krijonte më shumë pavarësi dhe stabilitet në marrëdhëniet familjare.

- Ka një gjykim pro efikasitetit të organizatave të shoqërisë civile në drejtim të ndërgjegjësimit dhe menaxhimit të dhunës në familje.

- Ka një dënim maksimal të dhunës në familje nga të gjithë respondentët.

5. Përfundime dhe konkluzione

Dhuna në familje, është një fenomen mbi të cilin nuk mund të japim gjykime të prera, e aq më pak receta të mirëpërcaktuara pasi kemi bërë diagnostifikimin e problemit, pasi përfshin një sërë aktorësh e faktorësh si dhe kontekstesh, por sipas nesh është shumë e rëndësishme që bazuar dhe në sondazhin *online* të realizuar të kemi në fokus këto

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

elemente:

1. ka nevojë për përmirësim të kuadrit ligjor në drejtim të evidentimit të formave të dhunës dhe fleksibilitetit në mënyrë që të ketë një reagim sa më të shpejtë parandalues;

2. rekomandojmë fuqishëm rritjen e ndërgjegjësimit të brezave të rinj (programe mësimore të integruara ku të përfshihet dhe ligji kundra dhunës në familje, funksioni i mekanizmave përgjegjës si dhe përkufizimi i dhunës në familje si diçka absolutisht e papranueshme;

3. trajnimin dhe fuqizimin e punonjësve të policisë për parandalimin dhe trajtimin sa më të shpejtë dhe efikas të rasteve të dhunës në familje;

4. ndërgjegjësimit e familjeve, sidomos në zonat rurale mbi dhunën në familje dhe mënyrën e denoncimit;

5. përmirësimin e imazhit të Policisë në opinionin publik në kuadër të trajtimit të rasteve të dhunës në familje;

6. trajtimi shumëdimensional jo vetëm i viktimave të dhunës në familje por dhe i abuzuesve pasi është e rëndësishme që ky kontingjent të mos jenë repetitivë;

7. fuqizimi dhe rritja e transparencës së organizatave të shoqërisë civile lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje;

8. politika më proaktive në këtë drejtim.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Bibliografia

1. Eurobarometer (2010), "Domestic Violence Against Women", *European Special Eurobarometer 344* (Wave 73.2, September 2010, Brussels, Belgium: TNS Opinion & Social E lexueshme, mars 2018, në:
http://ec.europa.eu/commfrontoffice/publicopinion/archives/ebs/ebs_344_en.pdf
2. Kuvendi, Republika e Shqipërisë (2017), *Rezolutë për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj*, Miratuar në datën 4.12.2017. E lexueshme, mars 2018, në:
<https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/12/rezolute-kunder-dhunes-ne-familje-dt-4-12-2017.pdf>.
3. Këshilli i Evropës (2009), *Strategjia e integruar kundër dhunës. Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna*, Council of Europe: Strasbourg Cedex. E lexueshme, mars 2018, në: <https://rm.coe.int/16806a44c6>
4. Haarr, Robin N. (2013), *Domestic Violence in Albania: 2013 National population-based Survey*, UNDP. E lexueshme, mars 2018, në:
<http://www.in.undp.org/content/dam/albania/docs/Second%20Domestic%20Violence%20Survey%202013%20english.pdf>
5. Baban, Adriana (2007), *Dhuna ndaj grave në familje në Shqipëri*, Tiranë: UNICEF. E lexueshme, mars 2018, në:
<https://www.unicef.org/albania/sq/domviol-alb.pdf>
6. Këshilli i Evropës (2017), *Raporti i GREVIO-s, për masat legjislative dhe të tjera që zbatohen dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, Strasburg, FR: Këshilli i Evropës. E lexueshme, mars 2018, në:
<https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/2018/03/23/raporti-i-grevio-s-per-masat-legjislative-dhe-te-tjera-qe-zbatojne-dispozitat-e-konventes-se-keshillit-te-evropes-per-parandalimin-dhe-luftimin-e-dhunes-ndaj-grave-dhe-dhunes-ne-familje/>
7. United Nation (2012), *Përmbledhje e legjislacionit shqiptar për dhunën në familje*, Tiranë: UN Albania.
8. Anektimi *Online*: grafika dhe interpretime, gjendet i plotë në:
Në: <https://www.analyzer.com:443/reporting/sharedreport?key=c14e5359-edf1-4736-bccb-6e9c1ae03f90>

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

Dhuna në familje dhe masat ligjore në parandalimin e saj



■ **Dr. Irvin FANIKO**
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë
irvin.faniko@asp.gov.al



■ **Dr. Shpëtim KARAKUSHI**
Prokuroria pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë Tiranë

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është cekja e elementëve kryesorë juridik dhe social të cilët ndikojnë në parandalimin dhe reduktimin, ashtu si edhe në lehtësimin e pasojave të këtij fenomeni shqetësues. Kjo do të kërkohej të arrihet duke analizuar gjendjen aktuale juridike nën aspektin normativ dhe të praktikës gjyqësore duke parë dhe efektet në veçanti të ligjit nr 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" si dhe në përditësimet e mëvonshme të tij, në lidhje me elementin parandalues dhe rehabilitues të normave penale, kjo në kushtet e një varfërie të legjislacionit në fusha të tjera të së drejtës.

Duke qenë se mbase problemi është më shumë social sesa juridik, në mënyrë të veçantë do të kushtohet vëmendje aktorëve e dukurive sociale, për të kërkuar të evidentohen shkaqet që sjellin këto pasoja, e nga kjo, më pas, të tentohet të gjenden zgjidhjet e mundshme të cilat do të mund të sillnin në mos zgjidhjen e të paktën minimizimin e këtij fenomeni. Me anë të këtij kërkimi shkencor do të përpiqemi të bëjmë të munduar të pasqyrojmë sesi mund të vihen në dukje fenomenet apo subjektet që mund të kenë një rol themelor në luftën kundër kësaj plage të shoqërisë, ashtu si edhe forcën për tu bërë ndërmjetësit e një ndryshimi social dhe kulturor.

Dhuna ndaj grave dhe subjekteve të dobëta në përgjithësi është një fenomen në rritje në territorin kombëtar. Më pak e theksuar, por jo për tu nënvlerësuar, është ajo në hapësirën e bulizmit. Sigurimi i një mbrojtjeje të përshtatshme për këto kategori është një problem që për fatin e keq sipas statistikave ka ardhur në rritje në vendin tonë. Çdo sistem ligjor ose normativ ndoshta edhe ato që janë më afër perfekte arrijnë në të shumtën e rasteve të ndërhyjnë vetëm në forma represive, pra atëherë kur është shkaktuar në mënyrë të pariparueshme dëmi.

Fjalëkyçe:

dhuna fizike, dhuna psikologjike, familje, gra, subjektet e dobëta, viktimat, pasoja, e drejta.

1. Karakteristikat dhe shtrirja e dhunës, veçanërisht te gratë, si subjekti më i prekur

Gati çdo ditë edhe nga ajo çfarë kronika¹ mediatike² na sjell, ndeshemi me episode dhune³ fizike e psikologjike në dëm të shtresave më të dobëta⁴ si gra, të moshuar, fëmijë, personave me aftësi të kufizuar të cilat konkretizohen në të shumtën e herëve në hapësirën familjare, në marrëdhëniet në përgjithësi, në ambientet e shkollave. Viktimat dhe agresorët i përkasin të gjithë klasave sociale dhe kultura të ndryshme si dhe të gjithë shtresave ekonomike, abuzimet dhe dhuna janë të kryera në pjesën më të madhe të rasteve brenda bërthamës familjare⁵.

Sa më sipër ndodh në nivel ndërkombëtar por, pak a shumë e njëjta situatë vihet re edhe në vendin tonë⁶. Dhuna ndaj grave dhe vajzave paraqet sot një problematikë të rënduar të shkeljes së të drejtave të njeriut, e cila është e pranishme në rang të gjithanshëm. Sipas një vlerësimi⁷ global të kryer përpara pesë vitesh mbi të dhënat që ishin të

¹ Bëhet fjalë për një fenomen të kuptueshëm në mënyrë emotive që duhet të përpunohet me kujdes nga operatorët e informacionit.

² Media është sot pushteti i katërt kundrejt një trindarjeje të bërë fillimisht nga Montesquie ndërmjet legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Aktualisht po mendohej se po afrohemish drejt një force të katërt të pushtetit siç është ai administrativ, një nënndarje e ekzekutivit pa politikën, por jo, ishte media me forcën e saj të informacionit.

³ Akt vullnetar, i ushtruar nga një subjekt mbi një tjetër, në mënyrë për ta detyruar të reagojë kundër dëshirës së tij.

⁴ Dervishi Z. *Sociologjia 1, Pjesa e Parë, ShBLSh. 1999. Tiranë.*

⁵ A. Del Vecchio (2011), *La tutela dei diritti delle donne nelle convenzioni internazionali*, f.2.

⁶ Zbatimi i ligjit 9669 të vitit 2006: "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin UMM/UM në Gjykatat e rretheve gjyqësor Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër dhe Sarandë. Periudha e monitorimit shtator 2014-maj 2015. Raport i hartuar nga Av. Iris Aliaj, Av. Aurela Boza Prof. Av. Aurela Anastasi, Fq. 6 e në vazhdim.

⁷ UN WOMEN (2013= <http://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures>

disponueshme 35% e grave në botë ka pësuar dhunë fizike ose seksuale nga ana e partnerit ose nga burra të tjerë. Në disa vende kjo vlerë arrin deri në 70%⁸.

Në botë janë gati 64 milionë bashkëshorte e fëmijë, ndërsa rreth 140 milion gra dhe vajza janë nënshtruar praktikave të ndryshimeve gjenitale⁹. Miliona të tjera, gra dhe vajza janë viktime të trafikut ilegal të qenieve njerëzore dhe përbëjnë pjesën më të madhe 55% të rreth 21 milion personave viktimave të punës së detyrueshme, dhe 98% të rreth 4.5 milion viktimave të shfrytëzimit seksual¹⁰.

Dhuna mbi gratë në shtetin fqinjë italian, kap shifra disa herë e më të mëdha: mbi 14 milion e grave italiane janë objekt i dhunës fizike, seksuale ose psikologjike në jetën e tyre. Pjesa më e madhe e këtyre dhunimeve janë të ushtruara nga partneri (si p.sh. 69.7% e përdhunimeve) ose nën aspektin familjar; në 24.8% të rasteve dhuna është kryer nga një i panjohur, kurse në 90% të rasteve kjo dhunë nuk është denoncuar asnjëherë. 1 milion e 400 mijë gra (6.6% e të përgjithshmes) kanë pësuar një lloj forme të dhunës seksuale përpara se të mbushnin 16 vjeç. Vetëm 18.2% e grave janë të vetëdijshme se ajo që kanë pësuar është një krim, ndërsa 44% e quajnë thjesht “diçka që ka ndodhur”; tek gratë nga 14 deri në 44 vjeç motivi i parë i vdekjes është dhuna¹¹.

Gratë në Itali	14.000.000 gra të dhunuara	1.400.000 (6.6% e totalit)	mendojnë se është krim	mendojnë se është “diçka që ka ndodhur”
		16 vjeçe	18.2%	44%
Dhunë nga partneri ose nën aspektin familjar	Përdhunime 69.7%	nga 14 vjeç	Pësojnë dhunë ekstreme	
I panjohur	24.8%	deri në 44 vjeç		

Tabela n. 1

Përdhunimet dhe format e tjera të dhunës seksuale kanë përbërë dhe përbëjnë një praktikë të zakonshme në fushën e luftërave me nuanca etnike¹², kujtojmë këtu luftërat e fundit në Ballkan dhe ato në shtetet afrikane. Edhe sipas studimeve të viteve të fundit në lidhje me zbatimin e ligjit 9669 të vitit 2006: “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” si dhe përditësimeve të mëpasshme, për periudhën shtator 2014 - maj 2015 në shtatë prej rrethve gjyqësore më të mëdha në Shqipëri, përjashtuar Tiranën, përqindja e palës paditëse grua (që në të shumtën e rasteve supozohet të jetë viktime të dhunës) shkon nga 77.2% në vendin me përqindje më të ulët në Shkodër në 86.3% në Pogradec¹³.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

⁸ Në Australi, Kanada, Israel, Afrikën e Jugut, dhe Shtetet e Bashkuara, dhuna në përgjithësi, e në veçanti ajo e ushtruar nga partneri, llogaritet ndërmjet 40% dhe 70% e totalit të vrasjeve me viktime të seksit femëror.

⁹ World Health Organization (2012), “Female Genital Mutilation: Fact Sheet No. 241,” Geneva.


¹⁰ International Labour Organization (2012), “ILO Global Estimate of Forced Labour: Results and Methodology,” f. 14, Gjeneva.

¹¹ ISTAT (2007), *La violenza e i maltrattamenti contro le donne dentro e fuori la famiglia* http://noi-italia2010.istat.it/index.php?id=7&user_100ind_pi1%5Bid_pagina%5D=32&cHash=29a6bcf0a, tek Marco Zupi e Sara Hassan Osservatorio di Politica Internazionale, La Convenzione del Consiglio d'Europa sulla prevenzione e la lotta contro la violenza nei confronti delle donne e la violenza domestica (Convenzione di Istanbul) n. 85 - dicembre 2013 A cura del CeSPI f.3.

¹² UNFPA (2010), *Lo stato della popolazione nel mondo - Generazioni del cambiamento: conflitti, emergenze, rinascita*, f.29.

¹³ Zbatimi i ligjit 9669 të vitit 2006: “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, si dhe përditësimet e mëpasshme, gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin UMM/UM në Gjykatat e rrethve gjyqësor Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër dhe Sarandë. Periudha e monitorimit shtator 2014-maj 2015. Raport i hartuar nga Av. Iris Aliaj, Av. Aurela Boza Prof. Av. Aurela Anastasi, Fq. 5 tabela numër 1.

Grafiku nr. 1



2. Zhvillimet historike ndërkombëtare të luftës kundra dhunës gjinore

Për sa u ndalëm më lart, mund të pohojmë me siguri se kategoria historikisht më e prekur kanë qenë gratë. Si rrjedhojë, kjo ka provokuar edhe një vëmendje më të madhe e të konsiderueshme tek institucionet kombëtare e ndërkombëtare të cilët, duke pasur në vëmendje këtë fenomen, kanë prodhuar një mori normash juridike të dedikuara mbrojtjes në sensin e gjerë të kësaj shtrese. Shkurtimisht, pas Luftës së Dytë Botërore etapat e sensibilizuese kundra dhunës ndaj gjinisë, fillojnë me lindjen e strukturimin e Kombeve të bashkuara, ku u krijua “Komisioni mbi Statusin e Grave” (CSW), me detyrën që të përgatiste rekomandime dhe raporte mbi temën e promovimit të së drejtave të grave në fushën socialekonomike, edukative si dhe atë politike.

Në vitin 1979 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të bashkuara, miratoi konventën “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundra grave” (CEDAW¹⁴) e cila hyri në fuqi në 3 shtator 1981, në një kohë rekord, krahasuar me të gjithë traktatet e mëparshme për të drejtat e njeriut edhe pse ratifikimet u shoqëruan me një numër të madh rezervash nga ana e shteteve nënshkruese¹⁵. Ky akt, përbën akoma edhe sot marrëveshjen juridike themelore në fushën e të drejtave të grave.

Konventa i lë hapësirë shteteve që të marrin masa edhe jo të ngjashme njëkohësisht, duke u përpjekur të realizojnë barazinë *de facto* (lat.) si rezultat i politikave të mundësive të barabarta të cilët kanë karakterizuar midis viteve ‘70-80 veprimtarinë për sa i përket çështjes së grave¹⁶.

E njëjta frymë e tillë vihet re në nenet 6 dhe 16 të CEDAW të vitit 1979¹⁷. CSW dhe CEDAW e ngritën problemin e dhunës ndaj grave¹⁸ në majat e programit të agjendave

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimit e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

¹⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në nëntor të vitit 1993.

¹⁵ M. Balboni (2004), *Gli strumenti di protezione internazionale e comunitaria dei diritti delle donne*, f.2.

¹⁶ P. Degani (2000), *Diritti umani e violenza contro le donne: recenti sviluppi in materia di tutela internazionale*, f.26.

¹⁷ Neni 6. Shtetet marrin çdo masë të mundshme, duke përfshirë edhe dispozitat legjislative, për të ndaluar, në çdo formë të saj, trafikun dhe shfrytëzimin e prostitucionit të grave.

Neni 16. 1. Shtetet marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin kundra grave në të gjitha çështjet që lidhen me martesat në marrëdhëniet familjare, dhe në veçanti, sigurojnë, mundësi të barabarta me burrat; a) të njëjtën të drejtë për të lidhur martesë; b) të njëjtën të drejtë për të zgjedhur lirisht shokun e jetës e të lidhin martesë vetëm me konsensusin e plotë. tek Osservatorio di politica internazionale, n 85. - dhjetor 2013 a cura di CeSPI (Centro di Studi di Politica Internazionale) f. 6.

¹⁸ deri në atë kohë e konsideruar më shumë një problem privat sesa një çështje publike e cila ka të bëjë me të drejtat e njeriut.

globale. Pasuan ndër vite, deklarata e asamblesë së Kombeve të Bashkuara “Mbi eliminimin e dhunës ndaj grave”, në qershor të 1993¹⁹, “Programi i veprimit” i Pekinit 1995²⁰, Statuti i Romës i Gjykatës Penale 1998²¹, rezolutat e Këshillit të Sigurisë “Gratë në konflikte”, numër 1325 e vitit 2000²², numër 1820 e vitit 2008²³, numër 1888 e vitit 2009²⁴, numër 2106 e vitit 2013²⁵ dhe numër 2122 e vitit 2013²⁶. Si akt ndërkombëtar i njohur, i një rëndësie të veçantë, me një rol kyç edhe në fushën e dhunës në familje është edhe konventa “Për të drejtat e fëmijëve” e ratifikuar në vitin 1991²⁷.

Aktualisht, nga ana e komunitetit ndërkombëtar edhe pse duke mbajtur standardet ndërkombëtare, vihet re një tendencë e të rregulluarit në mënyrë “zonale” të problemit, në një këndvështrim lokal, duke pasur mundësinë e kalibrimit të akteve ose përshtatjes sipas veçantive gjeografike, gjuhësore e kulturore²⁸ ose sipas problematikave të secilit kontinent përkatës. Në këtë frymë u miratua Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave si dhe dhunës në familje²⁹ (kjo konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2012), e hartuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës në datë 7 prill 2011 dhe hapur për nënshkrim në 11 maj 2011, me rastin e seksionit të 121-të të Komitetit të Ministrave në Stamboll. Hartimi i këtij instrumenti juridik është pritur me interes të madh në hapësirën ndërkombëtare, mbi të gjitha për shkak të frymës gjithëpërfshirëse, holistike ose tërësore që paraqet³⁰.

3. Dhuna në familje, në Shqipëri

Shqipëria siç mund të rrjedhë edhe nga sa cituam më lart është angazhuar ndaj

¹⁸ deri në atë kohë e konsideruar më shumë një problem privat sesa një çështje publike e cila ka të bëjë me të drejtat e njeriut.

¹⁹ Përfaqësuesit e 171 shteteve e aprovuan me votim të plotë një Deklaratë e një Program Aksioni për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore në botë, duke e vënë theksin mbi “rëndësinë e punës për eliminimin e dhunës kundër grave në jetën publike e private, për eliminimin e të gjitha llojeve të dhunës seksuale, shfrytëzimin dhe trafikimin e grave, për eliminimin e paragjytimeve në lloj, në administrimin e drejtësisë dhe për zgjidhjen e çdo konflikti që mund të lindë ndërmjet të drejtave për gratë dhe efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose të zakonshme, të paragjytimeve kulturore dhe ekstremizmit fetar. (neni 38) tek Osservatorio di politica internazionale, n. 85. – dhjetor 2013 a cura di CeSPI (Centro di Studi di Politica Internazionale) f. 6.

²⁰ 11. Dhunime të rënda në rastet e të ashtuquajturave “spastrime etnike” 12. Mbatjen e paqes në botë dhe eliminimin e çdo forme të dhunës. 116. Disa grupe grash si ato të minorancave etnike, refugjatet, emigrantet, ose gratë që jetojnë në varfëri Poaty f. 7.

²¹ Neni 7 Krimet kundra njerëzimit; Neni 8 Krimet e luftës. Po aty.

²² Përket me tematikën e mijëvjeçarit, duke prekur një temë e të të ashtuquajturit shtet të dobët dhe zgjatjen e luftës civile dhe konflikteve ndërkombëtare. Po aty dhe M. Zupi (2012), “I temi della 56a sessione della Commissione ONU sulla condizione delle donne”, f.30.

²³ kundra përdhunimeve seksuale ndaj grave... po aty f. 8.

²⁴ mbi dhunën seksuale kundra grave e fëmijëve në konfliktet e armatosura... po aty f. 8.

²⁵ Jo vetëm Këshilli i Sigurimit, po të gjitha institucionet, veçanërisht ato të Kombeve të Bashkuara ti japin fund këtyre masave shtrënguese. Po aty f. 8.

²⁶ Shtetet anëtare, Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Organizatat Rajonale dhe Shtetet anëtare në luftën e Women Empowerment, themeltare për paqen e sigurinë në botë. Po aty. F. 8.

²⁷ Ligji Nr. 7531, date 11.12.1991 “Për ratifikimin e konventës për të drejtat e fëmijës, Botim i QZB Dhjetor 2016.

²⁸ Marco Zupi e Sara Hassan Osservatorio di Politica Internazionale, La Convenzione del Consiglio d’Europa sulla prevenzione e la lotta contro la violenza nei confronti delle donne e la violenza domestica (Convenzione di Istanbul) n. 85 - dicembre 2013 A cura del CeSPI f.10

²⁹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 104/2012 datë 8 nëntor 2012 botuar në Fletoren Zyrtare e R. SH. Nr. 151 datë 23 nëntor 2012 f. 8246.

³⁰ Executive Director of UN Women Michelle Bachelet , <http://www.unwomen.org/en/news/stories/2011/5/un-women-executive-director-michelle-bachelet-welcomes-the-council-of-europe-convention-on-prevention>, UN Women Executive Director Michelle Bachelet welcomes the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence, Urges Member States to Move Towards Securing the Treaty’s Entry into Force.

instrumenteve juridik ndërkombëtar vetëm pas viteve '90. Mungojnë studime të mirëfillta lidhur me këtë fenomen në periudhën e para viteve '90, prandaj çdo konstatim ose vlerësim për këtë fenomen do të mbetet në kufijtë e kornizave të një opinionii. Mund të thuhet se, sigurisht, shteti totalitar kishte një kujdes të veçantë për familjen si edhe një program për emancipimin e gruas ose barazinë gjinore. Ndërsa, për sa i takon ngushtësisht dhunës dhe problemeve familjare në përgjithësi, kjo i ishte besuar organizatave të periudhës si: këshilli i lagjes, Fronti dhe organizatat e Partisë.

Pas viteve '90, Shqipëria aderoi ose ratifikoi pjesën më të madhe të akteve ndërkombëtare, të cilat i ofrojnë një tutelë familjes në sensin e gjerë, si edhe subjekteve përbërës të saj më të dobët siç janë gratë dhe fëmijët. Me miratimin e Kushtetutës të vitit '98³¹ barazisë gjinore, familjes dhe gruas, kjo edhe për shkak të përthithjes në të, të parimeve kryesore të Deklaratës Universale së të Drejtave të Njeriut³², iu dha një rilevancë kushtetuese. Pikërisht pjesa e dytë e saj, e cila citon dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në kreun e parë, ndalon diskriminimin për shkaqe gjinore³³. Gjithashtu edhe në kreun e katërt, në vijim, tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore i garanton familjes mbrojtjen e veçantë të shtetit³⁴, ndërsa nënave të reja dhe në veçanti fëmijëve i siguron një mbrojtje të veçantë ndaj dhunës, keqtrajtimit dhe shfrytëzimit³⁵.

Përveç traktateve të ratifikuar dhe Kushtetutës, burimet kryesore të së drejtës të rangjeve inferiore, por edhe më speciale, janë: kodi civil, kodi i familjes, kodi penal, - ky i fundit, sigurisht i natyrës represive. Sigurisht, më specifiku në këtë drejtim është ligji 9669/2006 (i ndryshuar) "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Ky ligj është tentativa e parë në llojin e vet, në Shqipëri, me një funksion parandalues, duke kërkuar përdorimin në minimum të masave represive. Qëllimi kryesor i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes së anëtarëve më të dobët të familjes nga elementë të dhunës brenda saj³⁶. Ky ligj kërkon të arrijë nëpërmjet krijimit të një rrjeti të koordinuar institucionesh i cili do të ofrojë mbrojtjen, mbështetjen si dhe rehabilitimin e viktimave³⁷. Gjithashtu, përcaktohen procedurat lidhur me vënien në lëvizje të gjykatave, përcaktohet juridiksioni dhe kompetenca duke i ofruar një tutelë juridiksionale problemeve objekt i këtij diskutimi shkencor.

Dhuna në kuptimin e përgjithshëm nënkupton një akt vullnetar, i ushtruar nga një subjekt mbi një tjetër, në mënyrë për ta detyruar të reagojë kundër dëshirës së tij. Sigurisht dhuna është një term i përdorur gjerësisht, në të cilin përfshihen një sërë sjelljesh e qëndrimesh por veçanërisht sipas ligjit 9669/2006, të sipërcituar, (i ndryshuar) "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", me termin "dhunë" kuptohet çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. Gjithashtu po në këtë ligj me termin "dhunë në familje", kuptohet çdo akt dhune, sipas përcaktimeve të sipërcituara, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare³⁸.

³¹ Kushtetuta e RSH-së ligj nr.8417, date 21.10.1998(Amenduar me ligjin nr. 9675, date 13.1.2007, me ligjin nr. 9904, date 21.4.2008, me ligjin nr.88/2012, me ligjin nr.137/2015 dhe me ligjin nr.76/2016)

³²<http://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20te%20Njeriut%20%281948%29.pdf>

³³ neni 18 i Kushtetutës së RSH.

³⁴ neni 53 paragrafi i dytë i Kushtetutës së RSH.

³⁵ neni 54 i Kushtetutës së RSH.

³⁶ neni 1 i ligjit 9669/2006 (i ndryshuar) "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

³⁷ neni 2 po aty.

³⁸ Raport për dhunën dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit Raport Korrik 2012 f.5.

Një vëmendje e veçantë këtij fenomeni i është kushtuar në kodin e ri të familjes³⁹, në ligjin për shëndetin riprodhues, etj. Në vitin 2012 në kodin penal të RSH u shtua një dispozitë e veçantë për dhunën në familje⁴⁰. Gjithashtu në vitin 2013 për rastet e dhunës ekstreme u parashikua me nen të veçantë vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare⁴¹, më parë mbase e parashikuar si rrethane rënduese.

Vlen të theksohet që pavarësisht se legjislacioni në këtë fushë tanimë është mjaft i pasur, ka akoma probleme lidhur me përplasjen e normave juridike duke rregulluar të njëjtën lëndë, dispozita të burimeve të ndryshme ligjore, gjë që krijon mjaft probleme në interpretimin ose gjetjen e ligjit të zbatueshëm për operatorët e së drejtës. Kjo duke hapur çështje në lidhje me hierarkinë e ligjeve ose gjetjen e ligjit special në raport me atë të përgjithshëm.⁴²

Sa për të sjellë një shembull, në pjesën kur ligji 9669/2006, (i ndryshuar) “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon nxjerrjen e një urdhri mbrojtje vetëm ndaj dhunuesit,⁴³ ndërkohë ky i fundit, si dhunues, ka përgjegjësi edhe sipas nenit 79 C të kodit penal, i cili në shumicën e paragrafëve të tij lejon ose kërkon nxjerrjen e një mase sigurie, sipas nenit 227 e vijues të kodit të procedurës penale; si për shembull, ajo e arrestit me burg, e cila do të bënte krejtësisht të panevojshëm për atë periudhë, nxjerrjen e një urdhri mbrojtje. Nuk ekzistojnë studime statistikore të mirëfillta, as historike e as aktuale, lidhur me numrin e pasojave normale dhe ekstreme të dhunës në familje, gjë që do të bënte të mundur edhe një vlerësim real mbi efektet e të rejave ligjore të ndërmarra pas vitit 2000.

Gjithsesi, ekzistojnë disa të dhëna të fragmentuara të cilat mund të na krijojnë një ide në lidhje me situatën e këtij fenomeni ndër vite. Nga monitorimi i shtypit të përditshëm për vitin 2002-2003, rezulton se kanë humbur jetën si pasojë e dhunës së ushtruar brenda familjes 56 gra e vajza në të gjithë Shqipërinë. Kanë pësuar dëme të rënda shëndetësore 74 gra e vajza të tjera⁴⁴.

Të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në Departamentin për Sigurinë publike, tregojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur ndjeshëm nga vetëm 94 raste në vitin 2005, në 2.526 raste në vitin 2012. Përveç kësaj, numri i padive penale për urdhra mbrojtjeje u rrit nga 0 raste në vitin 2005 (në vitin 2005 nuk kishte urdhra mbrojtjeje) në 1.234 raste në vitin 2010 dhe në 1562 raste në vitin 2011⁴⁵.

Për vitin 2017 rezulton që në qytetin e Tiranës të jenë dënuar për veprën penale të: “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130 i kodit penal i RSH-së; gjithsej janë 157 persona, e më konkretisht: 117 persona të dënuar për nenin 130/a/1, 1 person për nenin 130/a/2, 8 persona për nenin 130/a/3 dhe 31 persona për nenin 130/a/4⁴⁶.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

³⁹neni 62 i Kodit të Familjes së RSH. - Masat kundër dhunës “*Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës meqë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore*”.

⁴⁰neni 130 A, i Kodit Penal i ndryshuar me ligjin 144 datë 02 maj 2013 neni 33.

⁴¹neni 79 C i Kodit Penal të RSH.


⁴²*Legis specialis derogat legis generalis* (lat.); Një prej principeve të së drejtës në Romën e Lashtë.

⁴³neni 17 i ligjit 9669/2006 (i ndryshuar) “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

⁴⁴Monitorimi i shtypit i kryer nga Qendra e Gruas 2003-2004, Tiranë.

⁴⁵Raport i përgatitur nga Dr. Robin N. Haarr Konsulente ndërkombëtare e PNUD-it, Dhuna në familje në Shqipëri Vrojtim kombëtar me bazë popullatën nëntor 2013 f.1.

⁴⁶Statistika të Analizës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vitin 2017.



Grafiku nr. 2
 "Statistika të Analizës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë".

Për sa i përket popullatës së prekur nga ky fenomen, nga vrojtime të ndryshme rezultojnë që shumica e viktimave si edhe e agresorëve të tyre, kanë një nivel arsimor të ulët, gjithashtu ekonomikisht janë në një gjendje poshtë mesatares duke pasur probleme me punësimin⁴⁷; shumica e grave, në rastin në fjalë, kishte arsim tetëvjeçar (39,1%) ose arsim të mesëm/profesional (40,6%); vetëm 14,9% e grave ishin me arsim të lartë ose pasuniversitar.

4. Përfundimet

Të dhënat e mësipërme në këtë punim, tregojnë se shkaqet kryesore që sjellin si pasojë veprimet e dhunës ekstreme në familje janë ato me karakter social-ekonomik dhe kanë të bëjnë me emancipimin familjar, shoqëror e social, - sidomos të gruas në përgjithësi. Metodave preventive, siç janë ato të ndërmarra nga ligji 9669/2006 si edhe përditësimet e mëpasshme të tij dhe, masat represive të kodit penal, në shumtën e rasteve rezultojnë, - përkundrazi, - më shumë të dëmshme, si p.sh. : marrja e urdhrat të mbrojtjes (UM) nga gjykata duke larguar njërin prej bashkëshortëve nga familja, rrit problemet ekonomike duke shtuar kostot e strehimit. Ndërkohë që dënimi i njërit prej bashkëshortëve me masën e sigurisë "arrest në burg", sipas legjislacionin aktual në fuqi, në të shumtën e rasteve sjell probleme të parikuperueshme për familjen në përgjithësi si edhe për fëmijët në veçanti. Shpeshherë, burri, i cili është i vetmi burim të ardhurash në familje, burgoset, duke sjellë si pasojë mos mbulimin e kostove për ushqim, strehim etj, duke sjellë pasojë akoma edhe më të rënda për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e II-të shkencore kombëtare:

« Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimit e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare »

⁴⁷ Haarr, R.N. & Dharmo (2009). Dhuna në Familje në Shqipëri: Vrojtje Kombëtare me Bazë Popullatën. Tiranë, Shqipëri: UNDP. Sipas raportit të përgatitur nga Dr. Robin N. Haarr Konsulente ndërkombëtare e PNUD-it gusht të vitit 2013 të mbikëqyrur edhe nga INSTAT, shumica e grave kishte arsim tetëvjeçar (39,1%) ose arsim të mesëm/profesional (40,6%); vetëm 14,9% e grave ishin me arsim të lartë ose pasuniversitar.

Referenca

1. Marco Zupi, Sara Hassan, (2013), "Osservatorio di Politica Internazionale, La Convenzione del Consiglio d'Europa sulla prevenzione e la lotta contro la violenza nei confronti delle donne e la violenza domestica", *Convenzione di Istanbul n. 85 - dicembre*, CeSPI.
2. Iris Aliaj, Aurela Boza, Aurela Anastasi, (2006), *Raport. Zbatimi i ligjit 9669 të vitit 2006: "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, si dhe "Përditësimet e mëpasshme, gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin UMM/UM në Gjykatat e rretheve gjyqësor Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Dibër dhe Sarandë." (Periudha e monitorimit shtator 2014-maj 2015).
3. International Labour Organization, (2012), *ILO Global Estimate of Forced Labour: Results and Methodology*, Gjeneva.
4. Ligji nr. 104/2012 datë 8 nëntor 2012.
Fletorja Zyrtare e RSH, Nr. 151 datë 23 nëntor 2012, f. 8246.
5. Ligji 9669/2006 (i ndryshuar) "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
6. Ligji nr. 7531, date 11.12.1991, "Për ratifikimin e konventës për të drejtat e fëmijës", QZB, dhjetor 2016.
7. Raport për dhunën dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Raport, korrik 2012
8. Marco Zupi, (2012), *I temi della 56a sessione della Commissione ONU sulla condizione delle donne*, Osservatorio internazionale/servizi studi Parlamento, Rome., February 2012, 36 pp.
9. Paola Degani, (2000), *Diritti umani e violenza contro le donne: recenti sviluppi in materia di tutela internazionale*, Università di Padova - Centro di studi e formazione sui diritti della persona e dei popoli, Padova.
10. Marco Balboni, (2004), *Gli strumenti di protezione internazionale e comunitaria dei diritti delle donne*.
11. Angela Del Vecchio, (2011), "La tutela dei diritti delle donne nelle convenzioni internazionali", *Atti del Convegno in memoria di Luigi Sico*, red. Talitha Vassalli di Dachenhausen, Napoli, 2011, f. 315-329.
12. Zyhdj Dervishi, (1999), *Sociologjia 1, Pjesa e Parë*, Tiranë, ShBLSH.
13. UNFPA (2010), *Lo stato della popolazione nel mondo - Generazioni del cambiamento: conflitti, emergenze, rinascita*.
14. UNDP Haarr, R.N. & Dhamo (2009). *Dhuna në Familje në Shqipëri: Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri.
www.unwomen.org
15. QZB, *Konventa e Fëmijëve*. Elektronike në:
www.qbz.gov.al/botime/Konventa%20e%20femijëve.pdf
16. *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*. Elektronike në:
www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20e%20Njeriut%20%281948%29.pdf
17. ISTAT (2007), *La violenza e i maltrattamenti contro le donne dentro e fuori la famiglia* - Elektronike në:
<http://noi-italia2010.istat.it>

AKADEMIA E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

**« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »**



~ Sesiioni III ~

Konkluzione dhe rekomandime

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

PËRFUNDIME TË KONFERENCËS II-të SHKENCORE KOMBËTARE

“Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare”

1. Organizimi e qëllimi

Konferenca e dytë shkencore, me pjesëmarrje në nivel kombëtar, me titull: “Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare” u zhvillua në datën 26 prill 2018 në Akademinë e Sigurisë.

Kjo konferencë u përgatit dhe u organizua nga QKSH e Akademisë së Sigurisë me pjesëmarrje e përfaqësimit të disa institucioneve të tjera kërkimore shkencore. U përfaqësuan me punime: Lektorë të Qendrës së Kërkimeve Shkencore e të Fakultetit të Hetimit në Akademinë e Sigurisë, të Fakultetit të Sociologjisë në Universitetin e Tiranës, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit në nivel qendror e vendor, prokurorë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda e nga prokuroritë e rretheve, Shoqata Kombëtare e Avokatëve Penalistë etj.

Në punimet e paraqitura në Konferencë konstatohet një vëmendje e kënaqshme nga mjaft studiues dhe të interesuar për problemet e familjes dhe krimeve brenda saj. Tema e Konferencës rreth një problemi sa interesant kaq edhe të vështirë, siç është vrasja brenda familjes, tërhoqi praninë e një dimension relativisht të gjerë të interesuarish, studiues e pjesëmarrësish me punime e kumtesa që përfaqësonin Institucione të Arsimit të Lartë dhe struktura ligjzbatuese, pedagogë e lektorë me grada shkencore, punonjës të Institucioneve të Sigurisë, drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Kjo konferencë është e katërta që zhvillohet në Akademinë e Sigurisë nga QKSH dhe e dyta si konferencë kombëtare. Organizimi i Konferencës u bë sipas formatit të çdo Konferencë shkencore, me tematikë, me arritjen e disa synimeve të caktuar, që u paraqitën që në thirrjen e hapur, shpërndarë në uebsitet për këtë qëllim.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri” të realizuar së fundmi prej saj.

Për organizimin e drejtimin e Konferencës, u zgjodh Bordi Shkencor i Konferencës.

Punimet me abstraktet e paraqitura u botuan pa pagesë, në një numër special të veçantë të Revistës “Policimi dhe Siguria”, me ISBN dhe ISSN.

2. Përmbajtja

Përqendrimi i tematikës së Konferencës rreth një çështje aktuale dhe delikate për shoqërinë e individin, siç vlerësohet edhe dhuna ekstreme në familje, natyrisht që të mundëson të njihesh e të ballafaqohesh me një sërë problemesh. Spektri i përmbajtjes së këtyre problemeve varion nga vrasja, si krim kundër jetës, në vet kuptimin e marrëdhënieve familjare, në dobësimin e këtyre lidhjeve e shfaqjen e dhunës si tregues i qartë i degradimit të marrëdhënieve familjare e pararendës i mundësisë së aktit final, vrasjes së një anëtarit brenda saj. Në këtë kontekst, gjen vend e zbatim metoda e krahasimit midis zgjidhjeve juridike e atyre kanunore të traditës, nga e cila dalin përfundimet e rekomandimet, deri te kompleksi i masave parandaluese, që synojnë reduktimin e çdo

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:

“ Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare ”

lloj dhune brenda kësaj qelize jetike të shoqërisë.

Vrasjet janë e mbeten format më ekstreme të dhunës në familje dhe trajtimi e vështrimi i tyre historik në kushtet e vendit tonë, janë si një fill mendimi që përshkrijnë punimet e kësaj Konference, pavarësisht se vrasjet brenda marrëdhënieve familjare nuk përbëjnë problem të ri për shoqërinë shqiptare. Historia dhe faktet tregojnë se kjo dukuri ka shoqëruar shoqërinë shqiptare ashtu si në gjithë kombet e tjerë. Jo rastësisht ky fenomen ka gjetur trajtim të veçantë edhe në të drejtën zakonore penale shqiptare. Ai është problem po kaq i vjetër sa vrasja dhe historia e familjes në çdo shoqëri. Edhe pse shumë vende kanë mundur ta frenojnë deri diku këtë dukuri, në Shqipëri në periudha të ndryshme, vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare herë pas here kanë shënuar rritje.

Prandaj, ndër metodat bazë të përdorura në analizat e kësaj dukurie, zbatim më të gjerë në kumtesat e prezantuara gjen analiza krahasuese me periudhat e mëparshme. Kjo ka realizuar një synim të arritjes së disa objektivave të paraqitura midis qëllimeve të kësaj Konference, të evidentimit të problematikave, faktorëve nxitës të rritjes së formave të dhunës, dhënies së rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e dukurisë së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si edhe menaxhimit të konflikteve të ndryshme rreth saj.

Në kumtesat e prezantuara, trajtimi teorik i kësaj dukurie, studimi i dhunës ekstreme të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, krahas aspektit historik e juridik janë ndërthurur edhe treguesit objektiv, sipas statistikave dhe raporteve të rasteve realisht të evidentuara. Përveç kësaj, ato ndërthuren me treguesit subjektiv, që konstatohen e analizohen prej të dënuarve për vrasje në familje, prej perceptimit të publikut, madje edhe të punonjësve të policisë, të njerëzve të thjeshtë etj.

Trajtimi i problemeve në kumtesa pati një shtrirje të gjerë, multidimensionale, që nga syri i sociologut tek këndi i shikimit të juristit, nga vëzhgimi i psikologut tek kodet e penalistit, nga puna hetimore e parandaluese e punonjësit të sigurisë tek analiza e gjithsecilit sipas këndvështrimit të vet.

Të dhënat statistikore, si një formë e domosdoshme e metodave të studimit të këtyre dukurive, tregojnë se numri i rasteve të dhunës dhe krimeve të ndodhura në familje zë rreth 20% të numrit total të krimeve të ndodhura çdo vit. Veprat penale dhe format e dhunës janë nga më të rëndat, të cilat shkojnë nga dhuna emocionale, seksuale deri në vrasjen e viktimës. Për këtë -u theksua në studimet e paraqitura, në radhë të parë është e nevojshme një analizë dhe kuptim sa më i mirë nga gjykatat, prokuroria dhe policia gjyqësore i elementëve juridiko-penalë të kësaj figure krimi. Ato duhet të thellohen me një analizë e kuptim të të gjitha veçorive juridiko-penale të këtij krimi, si në objektin juridik dhe material të saj, në anën objektive të kryerjes së kësaj vepre penale, në subjektin dhe anën subjektive të saj. Këto ndihmojnë në efikasitetin e funksionimin e institucioneve për parandalimin e reduktimin e këtyre veprave kriminale.

Janë marrë një sërë masash ligjore për parandalimin e dhunës në familje. Martesa dhe familja sot gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit, si një nga parimet më themelore të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ndryshimet në Kodin Penal të bëra në vitin 2013 duke shtuar nenin 79/c “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, pas pothuajse 70 vitesh, sigurojnë dhe i rikthejnë mbrojtjen e posaçme pjesëtarëve të familjes nga vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare. Në legjislacioni penal që përfshin periudhën nga viti 1945 e deri në ndryshimet ligjore të vitin 2013 pjesëtarëve të familjes iu hoq mbrojtja e posaçme nga vrasjet brenda vetes, të cilën ajo e kishte gëzuar shekuj më parë. Kjo ndikoi negativisht si në parandalimin e vrasjeve në

familje ashtu edhe në mundësinë e reduktimit të vrasjeve e çfarëdo forme dhune brenda marrëdhënieve familjare. Prandaj në planin afatgjatë, shtimi i nenit 79/c, do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e numrit të vrasjeve në familje dhe në forcimin e institucionit të familjes shqiptare.

Ndër masat legjislative që konsistojnë në ndryshime ligjore, ishte edhe miratimi i paketës ligjore për dhunën në familje. Si rrjedhojë kjo sollti ashpërsimin e dënimeve penale dhe krijimin e mekanizmave mbrojtës, ngritjen e disa strukturave të posaçme pranë qeverisjes qendrore dhe vendore, që kulmoi me hapjen e Zyrës së Ndihmës Juridike dhe Koordinimit të Dhunës në Familje, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo masë, sikurse u theksua në Konferencë, në thelb të misionit të saj ka ofrimin e këshillimit ligjor falas, parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje.

Përmasat në rritje të këtij fenomeni, vit pas viti, janë një tjetër faktor që na bën të reflektojmë se, përveç shkaqeve ngushtësisht sociale, ekonomike dhe psikologjike, mund të ketë vend për përmirësim të punës parandaluese dhe hetuese të policisë. Parandalimi i krimit në familje përbën vërtet një sfidë për Policinë, jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë botën e zhvilluar demokratike. Metodot e anketimit, nëpërmjet të cilave u përfitua një njohje nga afër e mendimit individual e publik, sollën një sasi të konsiderueshme të dhënash, faktesh, kazusesh e situatash që shërbejnë për një sërë deduksionesh nga çdo studiues i këtyre dukurive. Të dhënat tregojnë se pothuajse të gjitha rastet e dhunës në familje drejtohen ose denoncohen në Polici. Kjo dëshmon se një pjesë e mirë e publikut të anketuar, pothuajse 70%, shprehin besim te institucioni i policisë për trajtimin e zgjidhjen e problematikave të tyre familjare. Punonjësit e policisë nënvizojnë që duhet më shumë punë me organet e pushtetit vendor dhe sistemin e drejtësisë për trajtim dhe parandalim të çështjeve të tilla.

Këto të dhëna, që pasurojnë studimet e kumtesat e paraqitura në Konferencë, vinë edhe nga anketimi me vet forcat e policisë, që shfaqin mendimet e problemet e tyre rreth masave efektive për reduktimin e këtij problemi. Kështu, të anketuarit nënvizojnë se çfarë masash konkrete duhen marrë për të parandaluar konfliktet, dhunën dhe vrasjet brenda familjes.

Sipas të dhënave anketore të punonjësve të policisë dhe të individëve të anketuar, rëndësi parësore i jepet:

- forcimit e bashkëpunimit institucional. Po kështu, nga këto burime vlerësohet shumë nxitja dhe organizimi i fushatave sensibilizuese dhe hartimi i programeve të veçantë profesional.

- në përqindje më të vogël renditen ndryshimet ligjore, ndërtimin e uebsiteve/linjave telefonike mbështetëse për autorët e viktimat, marrjen e masave për kushtet e strehimit dhe shërbimeve për autorët, etj.

- punonjësit e anketuar të policisë u shprehën se, detyrat e përgjegjësitë ku ata ndejnë më shumë vështirësi në lidhje me ndjekjen e çështjeve të dhunës apo vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare janë mbrojtja dhe garantimi i sigurisë së viktimës, përgjigja ndaj njoftimeve të viktimave dhe orientimi i viktimave për shërbime sociale.

- ndërsa theksojnë se kanë më shumë vështirësi të bashkëpunojnë me organet e pushtetit vendor dhe sistemin e drejtësisë.

3. Përfundime

- Nga punimet u vu në dukje se, siguria e jetës vjen ose kërcënohet edhe nga vet

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

pjesëtarët e familjes, prandaj rritja e sigurisë është një vlerë e fituar të cilën shoqëria shqiptare kërkon jo vetëm ta mbrojë atë që ka arritur, por dhe ta përmirësojë atë në mënyrë progresive. Për këtë është e nevojshme përmirësimi i informimit të komunitetit për punën që bëhet për parandalimin dhe reduktimin e krimit në përgjithësi dhe në këtë kuadër edhe të dhunës ekstreme e të vrasjeve në familje. Kjo do të ndikojë në rritjen e shkallës së objektivitetit në perceptimin e nivelit të sigurisë dhe të krimeve në familje, në rritjen e nivelit të kënaqësisë së publikut për punën e Policisë së Shtetit etj.

- Ka një tendencë të theksuar në rënie të numrit të vrasjeve gjatë periudhës së fundit, për shkak të marrëdhënieve familjare dhe një rritje të evidentimit të rasteve të tjera të dhunës në familje. Tendencat e mësipërme mund të shpjegohen, ndërmyjet të tjerave, me rritjen e ndërjegjësimit për denoncimin e rasteve të dhunës në familje ashtu dhe me efektin e ndryshimeve në Kodin Penal.

- Konferenca doli, veç të tjerave, me mjaft përfundime të përgjithshme dhe konkluzione praktike, që mund të shërbejnë e të japin ide orientuese në punën për të ardhmen, si për një organizatë sigurie, edukuese apo si një pjesëtar i familjes së sotme. Kështu, rezulton se dhuna në familje është një problem i përhapur global, që kapërcen kufijtë dhe ndodh në të gjitha kulturat dhe shoqëritë anembanë botës, pra të mos e konsiderojmë atë si një problem të veçuar apo shqiptar, si pohim i rëndomtë mediatik. Prandaj u theksua se të kuptuarit e veçorive brenda një shoqërie të caktuar është kyç për zhvillimin e reformave legjislativë dhe hartimin e politikave, të nismave parandaluese dhe atyre të ndërhyrjes, si dhe të sistemeve të mbrojtjes dhe përkrahjes të viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës në familje.

- Lidhur me pozitën brenda familjes, konstatohet se ka shumë raste ku gratë kanë një vend të nënshtruar ndaj burrave dhe madje deri diku konsiderohen si “pronë” e bashkëshortëve. Gratë dëshmojnë se janë përballur në mënyrë sistematike me dhunën psikologjike dhe fizike të bashkëshortëve. Konfliktet midis familjarëve kanë qenë e janë të shumta. Nga ky fenomen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, janë të prekura jo vetëm gratë, por edhe burrat e fëmijët.

4. Rekomandime

Disa rekomandime që dalin nga analiza e punimeve të Konferencës së dytë Kombëtare të QKSH në Akademinë e Sigurisë janë:

- Hartimi dhe zhvillimi i politikave të studiuara afatgjata për sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj fenomenit të konflikteve në familje, dhunës ekstreme dhe vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, për dhënien e informacionit të duhur mbi faktorët që ndikojnë dhe i kthejnë konfliktet në familje deri në vrasje si dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e tyre, etj.

- Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i politikave të studiuara afatgjata për fuqizimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj institucionalë gjithëpërfshirës dhe efikas, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunim të përgjegjshëm ndër-institucional, mes palëve pjesëmarrëse, Ministrisë së Brendshme e Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, në nivel qendror e vendor, të institucioneve të tjera që do të përfshihen në këtë proces si dhe të organizatave të shoqërisë civile, nën drejtimin e një organizmi koordinues kombëtar, me synimin koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare.

- Në zbatim të këtyre politikave të hartohet një Strategji Kombëtare për trajtimin

me prioritet, ndërgjegjësimin, parandalimin e reduktimin e konflikteve në familje, dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, garantimin e drejtësisë, rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave/mbijetuarve të kësaj dukurie, për të ndërtuar një shoqëri që iu garanton shtetasve të saj një jetë sa më të sigurt e pa kërcënime të dhunës ekstreme në familje si dhe të Planit Veprimit në zbatim të saj.

- Përfundimet dhe gjetjet e punimit na ndihmojnë në përcaktimin edhe të një prognoze të përafërt për këtë fenomen sipas së cilës dukuria e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në vendin tonë do të vazhdojë të ketë shifra të ulëta në raport me dhunën e konfliktet, në linja të vazhdueshme, sidomos në raportet në çift. Kjo për shkak të problemeve të mëdha social ekonomike, vetëgjyqësisë dhe mangësive në menaxhimin e situatave stresuese e konfliktuale që lidhet me nivelin e ulët ekonomik, kulturor e arsimor.

- Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së rekomanduar për koordinimin e punës për trajtimin, parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare do mundësojë që, të paktën për një periudhë afatmesme 5 vjeçare, shoqëria shqiptare të ndërgjegjësohet më tepër e të ballafaqohet më seriozisht me pasojat e kësaj dukurie.

Ky do të jetë fillimi i një investimi serioz për parandalimin e kësaj dukurie në të ardhmen, me ndikime në sigurinë publike.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

ENGLISH

A B S T R A C T S

“POLICIMI DHE SIGURIA”, NR. 10, APRIL, 2018

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

180

Murders due to family relations in Albania: an historical, juridical, analytical and psychosocial prognosis. Focus on years 2007-2016

PhD. Xhavit SHALA

The object of the study and research in this paper is to address the problem of murder due to family relationships in a historical, legal, chronological, social, psychosocial and analytical terms, focusing on the decade 2007-2016 and carrying out a comparative analysis with periods with the aim of identifying the issues, promoting factors, and providing some policy recommendations for preventing and reducing the occurrence of murders due to family relationships and conflict management and violence, in order to further improve the process of a communitarian intelligence-based policing. Homicide killings are not a new problem for the Albanian society. This phenomenon has accompanied the Albanian society as well as the other nations for a long time. Therefore, what was early found as a special case in the Albanian customary criminal law. Many countries have managed to stop this phenomenon, while in Albania at different times, homicide killings have increased. During this paper, the basic quantitative and the qualitative research methods and instruments, such as method of analysis and synthesis, comparative analysis, historical, juridical, comparison and confrontation as well as case studies have been applied. In addition to the theoretical approach, in the historical and legal aspect of this phenomenon, in the function of goal, about the intent and research objectives, are realized cross-linked, cross-linked and logical analyzes of literature, objective indicators (statistics and case reports actually identified) also subjectives (data from three compiled questionnaires (with target population groups, police officers and convicts for domestic killing). The main findings of this paper shows the level of the risk and the incidence of killings due to family relationships in Albania, factors and motivational motives, the most vulnerable groups, as well as the facts and challenges faced by state police structures, other law enforcement agencies as well as the Albanian society itself in the future. Conclusions and findings of this paper have helped us to determine a rough prognosis for this phenomenon over the medium term and have enabled us to make recommendations on the work of police officers and other structures within the meaning, information, preventing and reducing the occurrence of domestic murders, dictating the need for drafting a national strategy for this phenomenon.

.....

Overview of the legal situation in Albania

MSc. Arjan MUÇA

In the past years, Albania has strengthened its legislation regarding family violence (domestic violence) and the rights of protection of children and women, including ratification of the major international conventions and charters. As part of these measures, family violence was included as a specific offence in the Criminal Code in March 2012, whereas before crimes in the family were treated under the general provisions of crime. Therefore, there is limited available data on family violence in Albania and its prevalence in the general population. This study used the statistics of the family violence collected by the judicial police in the past 6 years. Despite a significant increase of the family violence cases in the period 2012-2014, the past three years have marked a generally stable number of cases. About 67 percent of all investigated cases of family violence have been physical assault and threats thereof,

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

while 21 percent of all family violence cases happened in the presence of the children. About 95 percent of perpetrators of family violence are males. Economic and financial difficulties are the main cause of family violence, followed by alcohol abuse, couple jealousy and property disputes.

.....

Criminal aspects of family murders, method of investigation and the means of finding evidences

PHd in process, Besnik MUÇI

Family murders are a very concerning phenomena for our society. Transition from a relatively conservative society in the family relationships into an open and free society, where every family member has equal rights, has brought collision within it. Also, the forced and complete demolition of property relations during the communist regime and the still unstable situation concerning the property owners in our country, even between family members, brings continuous conflicts, which may end up even in murder. That is why confronting this issue, is a huge and important challenge for our country and especially for the law enforcement institutions, of whom is the duty to identify, prevent, investigate, prosecute and punish the authors of these criminal offenses. In order to do this, initially is needed an analysis and a better understanding of the legal elements of this figure of crime from the court, the prosecution office and the judicial police. Thus, should be done the breakdown of all the elements, which are: the juridical and material object, objective side of committing a criminal offense, the subject and the subjective side. Particularly, the juridical and material object and the subject of the offense are the distinctive features for its legal qualification. As a very specific crime, committed mostly inside the very close family setting, with the objective side not very obvious to the outsiders and the lack of will of family members to cooperate with the criminal prosecution organs, makes finding and procedural administration of evidences difficult. That is why is highly important the application of specific methods of investigation to adjust to this particular crime. In the function of a specific investigation method, there should also be clearly specified and efficient means in finding and obtaining evidence. All the classic evidences such as testimony, confronting, identifications, experiments, expertise, material evidence and documents may and should serve in the process of proving of this criminal offense. But, special attention should be paid to means of searching evidence. Particular importance have observations, controls and tape recordings. In this paper we will make a juridical and criminal analysis of this criminal offense, of the investigation method, of the means of finding evidence and of the most typical evidences in this juridical and criminal process.

.....

Domestic violence and legal norms in Albania

MSc. Sajmir VISHAJ

In this paper will be presented a comparative structure of criminal norms interlinked in the Criminal Procedure Code in accordance with the Constitution of the Republic of Albania. Domestic violence is a worrying element we face every day. Both the perpetrators and the victims have an active role in this criminal act. Regarding the legislator, which has taken the initiative and from European norms, was adopted in 2006 the law on domestic violence. Problems in this area have gaps and leave room

for discussion. As in the penal code norms, they do not find an adequate approach to normality associated with this phenomenon. Often times there is an internal conflict between norms, whether or not a part of a family affects a stumbling block, losing the correction function that is expressed in the Constitution. It belongs to the legislator, social operators, individuals, and not only, to take the initiative to address the competent bodies for updating this criminal figure provided by the Criminal Code. An important role in preventing and reducing this play is not only the legislator but also the media in its entirety with the development force.

.....

Analytical overview of influencing factors in committing the crime of murder due to family relationships

MSc. Bilbil DERVISHI

In the commission or not of a criminal offense, at every individual, there are factors which encourage or restrain this one in their conduct. These factors, separately and collectively, play a very important role in committing crimes against life and especially those of murder, reflected by the doctrine but also by the legislator as “the most extreme form of violence”. For the crime of murder due to family relationships, which is the purpose of this work, the circumstances outlined here, as well as the author-victim relationship, are more specific as both the subject and object of this crime are part of the same family, according to the definitions, not of the Family Code itself, as a “biological family with blood relation”, but also of law no. 9669, dated 18.12.2006 “On Measures against Violence in Family Relations”, as amended by law no. 10329, dated 30 September 2010, which also includes other family relationships, such as: close relatives, adopted children, etc. In this paper, the cases provided by the article 79/C of the Criminal Code “Homicide Murder”, as well as those of domestic violence as a whole, will be considered, focusing and giving particular importance to the assessment of influential factors leading to the commission of this crime. As a key influencing factor in the course of this crime, several elements have been identified, which have an objective and subordinate influence, according to objective indicators such as the gender, age group, family ties, status, education, occupation and employment, both for authors and for their victims, although during this research there were also other elements and factors of appreciation and complementary, such as: place, time, vehicle, area, period and motive of completion of this crime. Based on the statistical indicators of this data, for the study period 2007-2016, which will be the object and purpose of this paper, we will try to make some recommendations based on the collected statistical data in order to prevent and minimize this the phenomenon, which affects all social groups indiscriminately, in space and time.

.....

Domestic violence as a criminal offense and the preventive measures.

PhD. Andia LEVANAKU

Key words: domestic violence, murder, extreme violence, life protection, risk factors. Protecting human life, dignity and human integrity is a precondition for a country's development. Every form of violence is an attack on human dignity and human rights violation, so it should not be tolerated. The family has a social formation in which the human personality develops, and it represents a complex phenomenon. Therefore it is a subject of study in many scientific disciplines. Marriage and the family have

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

special protection of the state, it is one of the fundamental principles sanctioned under the Constitution of the Republic of Albania, in the protection of the family. The Constitution sanctions the right to a normal family and its special protection, regardless of how it was created. The special family and marital protection is directly linked to the right for a normal family, which is guaranteed by basic and jurisdictional guarantee. The Albanian Constitution guarantees several rights about family, such as, the right to create a family; the right to live in a family; privacy of the family; the equity between husband and wife; the special protection of children, etc. Despite the sanctuary and the special protection of the family, domestic violence is a disturbing phenomenon in Albania. Criminal offenses and forms of domestic violence are severe and serious, from emotional abuse, sexual violence to killing of the victim. In this framework, there have been some measures to prevent domestic violence. Legislative measures consist of legal changes, the adoption of a legal package for domestic violence, or the creation of special structures from central and local government, which culminated with the opening of the Legal Assistance Office and Coordination of Domestic Violence, on November 25th, 2017, as a cooperation between the Ministry of Internal Affairs, the Ministry of Justice and the Ministry of Health, which at the core of the mission is offering free legal counseling, prevention and addressing family violence.

.....

International and internal legislation relating the measures for the protection of violence in family

MSc. Ervid ÇOBAJ

Violence in the family is a healthy problem open globally, which passes every border and affects every culture and society around the world. Understanding the purposes within a given company is the key to the development of legislative reforms and the organization of politics, for prevention and intervention initiatives, as well as for the protection and support systems for victims and for survivors of violence in the family. In Albania, family violence is a problem that negatively affects women and children, as well as families and communities. Albanians tend to consider violence in the family as a private, family matter, and as a normal part of married and family life. Since violence in the family often occurs behind closed doors and is not discussed, accepted or openly dealt in Albanian society, victims in general suffer in silence. Police commissions, legal offices, health care centers and social services are not required by law to collect and present data on violence. Albania is one of the few countries in Europe that doesn't register, publish and officially present data on the diffusion and dissemination of this phenomenon. There are a number of topics that seek to attract the attention of politicians linked to the taking of precautionary measures and the battle against family violence that are: the argument about justice because each individual must enjoy the right to live, arguments for the condition of life since in most cases women who survive violence suffer from health, psychological and physical problems. In these conditions the family violence can't be ignored as a social phenomenon but also as a healthy phenomenon. The growing number of crimes in our society is a painful and miserable fact, institutions must focus on the prevention of unsuitable behavior and not only on the consequences of these behaviors. In this paper we will suggest the reduction of crimes, the reduction of the degree of recidivism, the creation and growth of security for society. In this in this paper the aim will be to find the basic concepts concerning the measures of protection against family violence, the relationship of international law with the national law, all this treated in a theoretical aspect and illustrated with some examples from the jurisprudence of the European

Court of Human Rights and also some cases of the Albanian practice in this regard.

.....

Violence against women: Cultural implications

PhD. Merita PONI

The article takes into account the cultural implications of violence against women. The research argues how traditional norms impact behavior regardless geographical location and migration. It informs that cultural norms shape attitudes and beliefs. Culture serves as a powerful engine for moral values transmission. Given the cultural norms, women have a lower position in family relations and are subordinated to man. The study participants are women of the rural area of Farkë (Tiranë). They confess to be systematically subject of abuse and violence by husbands, who have made use of cultural norms to justify aggression. Due to the systematic violence women feel anxious and insecure in home. Let unpunished, the violence is used as a cultural method for education of young generation. Although cultural pressure, women do not agree with negative perceptions about them and blame the cultural norms for supporting violence against women. The use of cultural norms fuels the conflict between partners and impedes women personal achievement in family relations, economic advancement and political participation. To redress the cultural implications of violence against women, an increased intervention of state agencies is needed.

.....

Infants in conflict with the law, the settlement of justice

MSc. Dorina ARAPI

There is a relationship, such as marriage between husband and wife, from hereditary epochs according to which, based on religious and legal contracts, derived legitimate heirs. In fact, it is the couple, the main line, and from there the descendants became, who a priori have acquired the right of belonging. Marriage in itself is a legal or religious contract, on the basis of the respective cultures, which necessarily gives to the descendants the principle identity. When a parent gives identity to his child? Since the moment of giving the name. Giving identity as an individual and inviolable right of the person and it starts from this cast. "Identitas" an Ancient Roman Right, as a family nucleus that enjoys privileges, obligations and inheritance rights. In the psychological aspect, the successor takes on the identity and enjoys the right of belonging, recognition of the origin, of the filling inside the core of the family nucleus. In the interior there is a 'tabula rasa' case, in terms of a frame to be filled and give it a shape, which is achieved in the reciprocal sensory transaction, means, that at the moment of birth in the primary ratio of giving care through the follow up the symbolic figure of the mother. The child is a being in process, every day takes example from the parents. Every day emotionally, spiritually, affectively, psychological, physical, material investment is injected, and a relationship is established to give that lack that the child is most necessary. When a parent or both, are not able to manage conflicts between them, here we can imagine the first few who suffer the consequences of the children, especially those aged 0-9, because they are in need of care at this stage. My paper theme consists of 'infants in conflict with the law, establishing justice with them'. There is an unwritten law but necessarily a consequence for the future of the child, this law is only the parent.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

.....

Albanian homicides perceptions and profiles

MSc. Anisa AGASTRA

In this paper are presented homicides, perpetrators and victim's statistical and psycho-social analysis in Albanian families, based on a quantitative methodology and subjective indicators that measure perceptions of respondents. The questionnaire was used as a research tool. It was conducted a survey process where were included three target groups: police officers, population and homicide prisoners in Albania. The purpose of this paper is divided into two parts: the first one, determining the perceptions of the police officers and the population surveyed for the level of risk and characteristics of homicides, perpetrators and victims in Albania; the second one, determining and profiling Albanian homicide prisoners. Through this paper there will be findings about the perceptions of the respondents for the prevention of Albanian homicides, as well as the individual-institution report on this issue. Police officers and population respondent perceived an increase of domestic violence and homicides in Albania during the period 2007-2016, mostly with male perpetrators and female victims, who came from a lower educational level, of the age group 31-50, mostly occurring between coexisting's, partners, cousins or son against father. Whereas, Albanian homicide prisoners mostly resulted males of the age group 31-50; married before the murder occurred; with a low educational level; with employment problems, with low incomes and without a past criminal history record. The victim was mainly the spouse, cousins and the son. Emotional tensions are problematic to both homicide prisoners and victims. Albanian homicides resulted as unplanned crimes. In this paper it will be included in-depth findings and recommendations regarding measures, policies and suggestions provided by the respondents to prevent and reduce Albanian homicides. They mostly stressed the need for institutional co-operation, sensitizing campaigns and special vocational and training programs.

.....

Dhuna në familje si shkak për keqtrajtim, abuzim dhe shfrytëzim

MSc. Qetesor GURRA

The purpose of this paper is to treat domestic violence as a cause of ill-treatment, abuse and exploitation under the spectrum of a historical, social, legal, and comparative analysis of the subject under the spatial and temporal spectrum depending on the issues to come. It is important to offer studies and concrete figures which present a picture of the real situation of this phenomenon, although it is always suspected of their truthfulness but, besides the factual finding, a thorough analysis follows the page concluding the main factors and long term quality recommendations and Short. A significant part of the paper will deal with the legal approach and the vacuum that is expected to improve and fill in our country and concrete examples of solutions and experience from the countries of the region with almost the same problems as in and but with countries with standards that have supported and given the maximum against this problematic. Perhaps it may seem a pervasive and media-based theme, but in reality, the true drama of the victim's family lies above all with the children, the hope and the engine of the future. What policies does the state take to protect them latter. What does it offer to the total impossibility of support, economic aid? How do the

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

children's touch and violation of the law-abusers and occupants of the rule of law are protected and prevented? It is sad to see the tabloid of children left in the mercy of destiny. It is the duty of the state, the efficient measures of the central and local government, the organizations and the cooperation with the international actors, the only solution.

.....

Prevention of domestic crime

MSc. Besnik SHEHAJ

Preventing domestic crime is really a challenge for the police, not only in our country, but in the whole developed democratic society. In many studies undertaken for this worrying phenomenon in a nationally and internationally standing it is evidenced that the most stratified layer of this form of repressive violence reported to the police is that of women raped practiced by a current partner or ex partner. The causes of this type of crime and the consequences constitute a particular field of study that require a psychological-social treatment of the phenomenon and are the subject of the sciences of psychology, sociology, criminology, and so on. But our aim in this paper is to address only the aspect of genuine police measures to prevent and reduce domestic crime, which often escalates into serious crimes or repetition, fueled by the psychology of vengeance, blood feud, injustice, self-justice, etc. Analysis of statistical data, typical cases or most common typologies, opinions of field police specialists, interviews with persons victimized by domestic crime, and research on international experiences has allowed us to reach some conclusions interesting and useful recommendations for the Police's activity in facing the challenge of this type of crime.

.....

Perspective of murders cases due to family relations by subjective indicators (perceptions of the population, police officers, convicted for murder, etc.

PhD Candidate Anisa HYSESANI
MSc Skënder KALEMI

Domestic violence according to the online legal vocabulary is defined as : "Abusive, violent, compulsive, threatening or word-induced act by one member of a family over another family member may constitute domestic violence." [1] Consequently, we think it is of great interest to analyze the perspective of domestic violence from the point of view of subjective indicators in such way to understand: - What are the interdependent relationships? - What forces violent relationships in the family; - What are the causes of domestic violence indicators in the case of Albania (including the perceptions of a wide range of actors , such as citizens, police officers) etc., The feedback will also be provides using data from respondents through online questionnaires will be related precisely to the treatment of the above subject and the statistics currently available on this phenomenon Considering the fact that domestic violence may have different forms ranging from physical to psychological violence or verbal abuse, it is accepted as a general problem that concerns all countries and that may not always be evident because mainly occurs in personal relationships or closed circuits. From this phenomenon are affected not only women, but also men and/or children directly or indirectly, are often subjects of this phenomenon. Through this

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

article we will try to provide a thorough analysis of the causes, development, perception, policies, laws and further suggestions regarding the prevention of this phenomenon.

.....

Dhuna në famije dhe masat ligjore në parandalimin e saj

Ph.D. Irvin FANIKO

Ph.D. Shpëtim KARAKUSHI

The purpose of this paper is to list the main legal and social elements that influence the prevention and reduction as well as to alleviate the consequences of this disturbing phenomenon. This will be required to be achieved by analyzing the current legal situation under the normative and judicial practice, including the particular effects of Law No. 9669, dated 18.12.2006 "On Measures Against Violence in Family Relations" and its subsequent updates, with regard to the preventive and re-licensing element of criminal norms, in the light of the poverty of legislation in other areas of law. Since the problem is perhaps more social than juridical, it is especially important to pay attention to actors and social phenomena, to seek to identify the causes that cause these consequences, and then try to find possible solutions which could be brought to you by not solving at least the minimization of this phenomenon. Through this research we will try to try to reflect on how phenomena or subjects that can play a fundamental role in the struggle against this wound of society, as well as the strength to become mediators of a change, social and cultural background. Violence against women and weak entities in general is a growing phenomenon in the national territory. Less emphasized, but not to be underestimated, is that in the space of the bulism. Ensuring adequate protection for these categories is a problem that for bad luck according to statistics has increased in our country. Any legal or normative system perhaps even those that are closer to the perfect one can in most cases intervene only in repressive forms, ie when the damage is irreparably caused.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
famiije dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferenca e
II-të shkencore
kombëtare:*

« Dhuna
ekstreme në
familje dhe
masat për
parandalimin e
reduktimin e
vrasjeve
për shkak të
marrëdhënieve
familjare »

ISBN 978-9928-210-07-4

ISSN 2413-1334

AKADEMIA E SIGURISË



9 789928 210074 >



POLICIMI DHE SIGURIA

PRILL 2018



AKADEMIA E SIGURISË

Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



NR

10